

përsipër një barrë me shumë rëndësi, e cila do të sjellë si përfundim grumbullimin e një shume të madhe të hollash që do të shkojë në ndihmë të arkës së shtetit dhe do të përdoret për nevojat e rindërtimit të Shqipërisë.

Shumë tregëtarë të mëdhenj e të mesëm dhe shumë pronarë gjatë luftës kanë bërë fitime kolosale, ndërsa pjesa më e madhe e popullit luftoi dhe u shkatërrua ekonomikisht. Komisionet do të jenë ato që do të shqyrtojnë këto fitime, që do të bëjnë në rregull kategorizimin e tregëtarëve dhe do t'i taksojnë ata në bazë të fitimeve që kanë bërë. Por duhet të kihet kujdes në këto shqyrtime që të bëhen në rregull e të mos bëhen gabime, prandaj personat që do të zgjidhen në këto komisione duhet të jenë të vendosur në mendimet e tyre, të aftë për kryerjen e misionit, të gatshëm për punë dhe të mos bien në pozita miqësie e tarafilëku, në mënyrë që përfundimi të jetë i tillë që komisionet të mos dalin nga ky veprim me disa shuma të vogla e qesharake, por me shuma të mëdha të hollash.

Sigurisht edhe për krijimin e këtyre komisioneve do të jenë organizatat e Partisë ato që do të luajnë rolin më me rëndësi, si në krijimin e shpejtë të tyre, ashtu edhe në mirëfunksionimin e tyre.

Duhet të sqarohen mirë të gjithë anëtarët e Partisë, të kuptojnë rëndësinë e madhe që u jep Partia këtyre tri komisioneve dhe ta marrin çështjen me gjithë seriozitetin e duhur në mënyrë që këto të krijohen sa më parë që të jetë e mundur dhe përfundimi i tyre të jetë i shpejtë dhe me frutet e parashikuara nga Partia. Asnjë justifikim nuk do të pranohet për mungesë e neglizhencë. KQ i quan si probleme me një rëndësi të jashtëzakonshme që duhet të shtrohen e të zgjidhen me urgjencë, prandaj të gjitha organizatat e Partisë, i gjithë populli duhet të mobilizohet e t'u vijë në ndihmë komisioneve të sipërpërmendura se vetëm kështu do t'i arrihet qëllimit.

KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

UDHËZIME TË KQ TË PKSH PËR FORCIMIN MË TEJ TË PUNËS POLITIKO-EDUKATIVE DHE ORGANIZATIVE TË PARTISË NË USHTRINË NACIONAL-ÇLIRIMTARE

15 janar 1945

KOMITETEVE TË DIVIZIONEVE
KOMITETIT TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM
KOMITETEVE TË SHTABEVE TË KORPUSEVE
KOMITETEVE QARKORE
KOMITETIT QENDROR TË RINISË
KOMITETEVE QARKORE TË RINISË

Të dashur shokë,

Në Kongresin e Përmetit lëvizja jonë u paraqit e fortë si nga pikëpamja politike ashtu edhe nga ajo organizative. Doli me një ushtri të madhe dhe të fortë, që kishte mbledhur energji të reja dhe paraqiste të gjitha konditat për të shkuar edhe më përtej, për t'i dhënë Luftës nacional-çlirimtare karakterin nacional, për të zgjeruar kështu lëvizjen dhe për të çliruar zona të tëra, që ishin nën kontrollin e okupatorit dhe të yzmeqarëve të tij, «Balli Kombëtar» dhe «Legaliteti».

Bindja për ta zgjeruar luftën lindi nga prova që dhanë forcat tona, të cilat përballuan me sukses ofensivën e madhe të dimrit, dhe konsoliduan pozitën politike dhe ushtarake. Ushtria jonë ishte e gatshme për të avancuar. Vendimi i Kongresit të Përmetit që u muar për kalimin e forcave tona për në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut, i hapi rrugën Divizionit I Sulmues, që u formua në atë kohë, si reparti më i madh i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, për të avancuar, dhe, në marshim duke përballuar ofensivën e dytë të qershorit, ai çliroi pjesë të mëdha të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, duke goditur qendra të rëndësishme të reaksionit.

Çlirimi i këtyre vendeve, që deri në atë kohë ishin nën kontrollin e okupatorit, bëri që të mbushen radhët, të zgjerohet dhe

të forcohet ushtria, të ngrihet lëvizja dhe pushteti i popullit dhe të vazhdojë lufta e ashpër. Këtë kthesë të madhe të lëvizjes sonë e ndihmoi edhe gjendja e jashtme: ofensivat e mëdha, të vazhdueshme të Ushtrisë së Kuqe, çelja e frontit të dytë dhe luftërat e ashpra të ushtrisë jugosllave dhe të vendeve lirisdashëse.

Në këto kondita të reja ushtria jonë u organizua në reparte të mëdha, në korparmatë dhe, nga ana tjetër, në shumë raste braktisi mënyrën e luftimit në formë partizane dhe përdori luftën frontale. Këto ndryshime u bënë më të dukshme kur filloi etapa e luftërave për çlirimin e plotë të Shqipërisë. Këtu karakteri i luftërave pësoi një ndryshim të madh, si në Tiranë, në Qafën e Kërrabës dhe ajo e dy divizioneve, që vazhdoi me muaj në tokat e Jugosllavisë.

Çlirimi i plotë i Shqipërisë lejoi krijimin e korparmatave dhe organizimin e ushtrisë sonë në një ushtri të rregullt dhe moderne. Lufta e fundit për dëbimin e okupatorit solli edhe kapitullimin e plotë të të gjitha forcave të armatosura të të gjitha organizatave reaksionare dhe tradhëtare si «Balli Kombëtar» dhe «Legaliteti». Kjo pruri që të gjitha këto masa të hyjnë në ushtrinë tonë¹.

...Kjo gjendje përpara organizatës së Partisë në ushtri ka vënë detyra shumë të rënda nga ato të mëparshmet. Prandaj:

a) Është e domosdoshme që ta ngremë ushtrinë me një frymë të re, me frymën e lëvizjes nacional-çlirimtare, të ketë të zhvilluar shpirtin luftarak dhe ofensiv, të jetë e pajisur me njo-huritë e luftës moderne, të zotërojë armët e reja, të forcohet disiplina dhe të ngrihet një jerarki² e fortë. Në këtë ushtri të re duhet të ngremë të gjitha organet teknike administrative si pjesë të domosdoshme të një ushtrie moderne.

Edhe disiplina formale është e rëndësishme për të influencuar në modernizimin e ushtrisë, prandaj format e vjetra të partizanllëkut dhe familjariteti i periudhës së kryengritjes duhet të zhduken. Ndërsa dje në kohën e kryengritjes udhëheqësit fitonin besimin me familjaritetin dhe me trimëri individuale, sot duhet të fitojnë besimin dhe udhëheqjen me manovrimin e përsosur të njësive, me stërvitjen dhe edukimin e tyre dhe me zbatimin e rregullave, të detyrave dhe të disiplinës. Diferenca e gradës është një distancë e dukshme dhe duhet të dallohet. Për të respektuar

1 Është fjala për ish-pjesëtarët e grupeve të armatosura të organizatave të «Ballit Kombëtar», të «Legalitetit» etj. shumica e të cilëve qenë mobilizuar me forcë, ose ishin të gënjyer nga demagogjia e krerëve të atyre organizatave. Me shkatërrimin e bandave të armatosura të «Ballit Kombëtar» e «Legalitetit» në shtator, tetor dhe nëntor 1944 pjesëtarët e tyre të thjeshtë largoheshin në masë dhe një pjesë e madhe hynin vullnetarisht në radhët e Ushtrisë Nac.-Çl.

2 Centralizëm.

këto, të gjithë anëtarët e Partisë e sidomos kuadri në ushtri duhet të jetë shembull për të tjerët, ndërsa po ndodh e kundërta. Janë anëtarët e Partisë e sidomos kuadri që nuk respektojnë gradën dhe që kërkojnë të mbajnë akoma frymën e vjetër në ushtrinë partizane. Kjo rrjedh se shokët tanë duke menduar se janë anëtarë partie, janë shkujdesuar dhe kanë prishur disiplinën, ndërsa tamam se janë anëtarë partie duhet të jenë më të disiplinuar sepse në Parti, më shumë se kudo, ka përgjegjësi në punë, ka jerarki, ka disiplinë të çelniktë.

b) Udhëheqësit tanë politikë duhet të heqin dorë një herë e mirë nga mënyrat e vjetra të punimit, nga konferencat e thata dhe nga frazat boshe dhe të kopjuara. Këto na i tregojnë eksperiencia dhe rezultatet.

Duhet një punë politike intensive dhe e shumanshme. Ushtrisë sonë duhet t'i mësojmë: një edukatë të përgjithshme mbi problemet themelore të lëvizjes nacional-çlirimtare; me mësim sistematike dhe metodike mbi problemet aktuale politike dhe ushtarake, mbi situatën e jashtme dhe të brendshme dhe mbi gjendjen e brendshme të repartit; me sqarime të përditshme të ngjarjeve të çdo dite, ashtu siç ka për t'i ngritur Partia në organet e [shtypit të] Partisë, në organet e [shtypit të] Frontit dhe të ushtrisë.

Për t'ja mbërritur këtij qëllimi është e nevojshme që shokët tanë të fillojnë të mendojnë vetë, të përgatiten mirë, të mbajnë gjallë të gjithë repartin, të jenë të qartë para masës dhe t'i forcojnë lidhjet me masën e ushtrisë.

Është e nevojshme të ngrihet sa më shpejt aparati i agjit-propit dhe për t'ja arritur këtij qëllimi duhet që organizatat e Partisë ta marrin me gjithë seriozitetin e duhur dhe të kuptojnë rolin që do të luajë ky aparat. Agjit-propit do të organizojë shtypin dhe propagandën, manifestimet, do të përpilojë parullat, do të popullarizojë vijën tonë, sukseset tona, duhet të vërë në evidencë të gjitha ngjarjet, të gjitha problemet...

Për të ngritur këtë aparat duhet të ndjekim një kriter tjetër ndryshe nga i mëparshmi, në caktimin e përgjegjësve. Të caktojmë shokë që e kanë vijën politike të qartë, që të kenë prirje të shumta organizative, të jenë të vullnetshëm, entuziastë dhe punëtorë të palodhur. Të kemi kujdes përsëri që të mos biem në pozitë e para të gabuara, ku ndiqej kriteri që viheshin shokët që kanë pasë punuar më parë në këtë sektor ose që dinë të shkruajnë më mirë.

Duhet të kuptohet mirë që të drejtosh agjit-propin nuk do-methënë të dish të shkruash një artikull ose dy fjalë në një gazetë xhepi, por duhet të organizosh dhe të drejtosh të gjitha ato sa thamë më sipër. Për organizimin e këtij aparati u vjen një qarkore nga Shtabi i Përgjithshëm.

c) Nevoja e edukimit të kuadrit dhe e gjithë Partisë në ushtri është imediate dhe e lidhur me gjendjen e sotme të Partisë, gjendje e krijuar me zgjerimin e saj, me futjen e elementëve të rinj që shpeshherë nuk janë shumë të shëndoshë. Duhet të forcohet Partia në ushtri që të bëhet shembull dhe t'i japë tonin të gjithë punës, sepse mbi të rëndon i gjithë problemi i ushtrisë.

Në ushtrinë tonë të çelnikoset rinia. Organizata e Rinisë Komuniste duhet të bëhet një faktor me rëndësi për edukimin e ushtrisë, gjithashtu një faktor për edukimin e të rinjve komunistë, për të sjellë mijëra anëtarë nga radhët e saja në Parti, prandaj organizata e Rinisë Komuniste në ushtri duhet të forcohet dhe të zgjerohet. Duhet të luftohet sektarizmi në shtimin e radhëve të saja edhe për arsye se nuk ekziston tjetër organizatë e rinisë në ushtri. Deri sot është ndjekur si kriter kalimi i të rinjve komunistë drejtpërdrejt nga rinia në Parti pa kaluar në kurset e Partisë. Do të kalojnë drejtpërdrejt në Parti ata të rinj komunistë që tregojnë gjithë dashurinë për Partinë, që tregohen të lidhur me Partinë, të pastër dhe të shëndoshë, kurse pjesa tjetër duhet të kalojë në kurset e kandidatëve të Partisë.

Këtu është për t'u theksuar një çështje me rëndësi të madhe dhe jetike për Partinë: ajo e rekrutimit. Deri sot në kurset e kandidatëve nuk është punuar shumë. Disa herë kandidatët marrin pjesë në mbledhjet teorike të celulës, kurse shpesh bëhet akoma një punë e paktë dhe e përciptë me ta. Me kandidatët jo vetëm që duhet të bëhet një punë e madhe dhe intensive në kurse, por duhet të marrin pjesë rregullisht në mbledhjet teorike dhe në ato organizative, duke përjashtuar rastet me karakter konspirativ, kur flitet për strukturën, për planet e Partisë, për kuadrot dhe çdo gjë që do të ketë një karakter të tillë.

Aty ata do të mësojnë të rrahin dhe të studjojnë problemet e ndryshme dhe do të mësojnë të punojnë praktikisht. Nga ana tjetër është akoma e nevojshme të punohet edhe individualisht me ta, domethënë të ndihmohen sa më shumë dhe të jenë nën kujdesjen e anëtarëve të Partisë. Me një punë të tillë intensive dhe të kujdeshme, ata do të shkojnë në Parti të përgatitur dhe të aftë.

Në celulat e kompanive ka një ndarje pune: ushtarake, politike, për kulturë e arësim, për rini, kurse në byro nuk ekziston. Jo vetëm që kjo ndarje duhet të funksionojë rregullisht në celula dhe shokët të kryejnë me përpikmëri përgjegjësinë që u është ngarkuar, por nga ana tjetër kjo duhet të bëhet edhe në byro. Me punën politike dhe kulturën arësimore ngarkohet komisar i batalionit, për rininë është përgjegjësi i rinisë në batalion dhe me punë ushtarake të ngarkohet një shok tjetër nga zëvendëskomisarët e kompanive. Shokët duhet të kuptojnë se në byro, që është fo-

rumi i Partisë në batalion duhet të preokupohen për sektorët e tyre dhe të kërkojnë e të japin llogari.

Më parë në ushtri kishim ngritur seksionet politike të divizioneve për të ndihmuar organizatat dhe për t'i dhënë një impuls të madh punës. Funksionimi i shumanshëm i tyre kishte për qëllim t'i jepej formë e rregullt ushtrisë revolucionare. Puna e tyre, megjithëse dha rezultate prapëseprapë si të deleguar të Komitetit Qendror nuk patën mundësi të jepnin sa duhej në çdo anë dhe nuk e përmbushën dot këtë detyrë. Nga ana tjetër komitetet e divizioneve me karakterin e tyre këshillues dhe instruktues nuk kishin forcën e duhur për t'u bërë një udhëheqje shtyllë e Partisë në ushtri. Por megjithëqë ato nuk dhanë dot udhëzime të shëndosha dhe nuk mundën të forcojnë si duhet organizatat, prapë ato kanë ndihmuar punën në repartet tona.

Sot me zgjerimin e ushtrisë, me ngritjen e kuadrove të rinj në udhëheqje, me kalimin e një pjese të madhe të kuadrove të Partisë nga ushtria në pushtet dhe në lidhje me forcimin e organizatës së Partisë dhe me detyrat e mëdha që ka ushtria, del në shesh nevoja e krijimit të një udhëheqjeje të shëndoshë të Partisë në divizion.

Komiteti [i Partisë] në divizion është forumi më i lartë i Partisë në ushtri, me autoritet e përgjegjësi të plotë për organizatën e Partisë në divizion. Ky përbëhet prej zëvendëskomisarit të divizionit që është edhe sekretari i komitetit, prej komisarit të divizionit, prej përgjegjësit të rinisë në divizion dhe prej zëvendëskomisarëve të brigadave. Tre të parët formojnë sekretariatin e komitetit, i cili zgjidh çështjet e shpejta, mban lidhjet me anëtarët e tjerë dhe drejton punën nga mbledhja në mbledhje. Lidhjet me Komitetin Qendror i mban zëvendëskomisari i divizionit, ndërsa zëvendëskomisarët e brigadave raportojnë punën e tyre në komitetin e divizionit dhe shkëputin lidhjet që kanë pasur deri më sot me Komitetin Qendror. Në repartet e ndryshme që janë pranë shtabit të divizionit formohet një komitet, anëtarët e të cilit janë të shkëputur nga celulat, në rast se ka shumë anëtarë partie, përndryshe formohet një byro. Sekretari i këtij komiteti ose i byrosë merr pjesë si anëtar i komitetit të divizionit. Gjithashtu edhe për celulat që janë pranë shtabit të brigadave formohet një byro dhe sekretari i kësaj është në lidhje me zëvendëskomisarin e brigadës.

Zëvendëskomisari i divizionit është anëtar i shtabit, porse nuk duhet të preokupohet shumë në punët thjeshtësisht të shtabit, meqenëse ai ka përgjegjësinë e madhe të organizatës së Partisë në divizion. Ai është përgjegjës kryesor për mobilizimin e Partisë për kryerjen e detyrave që ngarkon shtabi dhe duhet të jetë në korrent për të gjitha problemet e ushtrisë në të gjitha drejtimet. Nga ana tjetër si përgjegjës i punës së Partisë dhe si anëtar i

shtabit jep vijën e Partisë në shtab. Komisari i divizionit është përgjegjës i punës politike dhe duhet të bjerë në kontakt me komisarët e brigadave. Ai është përgjegjës kryesor për ngritjen politike të kuadrove dhe të repartit. Njëkohësisht është dhe shefi i personelit në divizion, por për të qenë më i lirë në punën e tij ai e drejton këtë sektor pune duke ngritur një aparat të posaçëm. Përgjegjësi i rinisë në divizion duhet ta kuptojë se nuk është si i deleguar i rinisë, porse një anëtar i plotfuqishëm i këtij komiteti që shtron, diskuton dhe zgjidh të gjitha problemet e Partisë. Prandaj kur ky shkon në brigadë, për të kontrolluar dhe ndihmuar punën e rinisë, duhet të kuptohet se në këtë mënyrë i jepet ndihma konkrete nga ana e Partisë rinisë komuniste. Zyrtarisht ai do të jetë në seksionin e agjit-propit, por nuk duhet të ngarkohet dhe të preokupohet me këtë punë mbasi ky është i ngarkuar t'i vijë në ndihmë të shumanshme rinisë komuniste. Të gjithë anëtarët e tjerë si anëtarë të forumit më të lartë të Partisë në divizion jo vetëm që shikojnë organizatat e tyre, por preokupohen për të gjitha problemet e Partisë në të gjithë divizionin dhe kanë të drejtë të shkojnë në organizatat e tjera.

Komisari i korpusit ka të drejtë të shkojë në të gjitha komitetet e divizioneve dhe ka votë konsultative me përjashtim të rasteve kur është i deleguar i Komitetit Qendror.

Në Shtabin e Përgjithshëm dhe në shtabet e korpuseve nga të gjitha seksionet dhe nga shtabi i korpusit vetë, krijohet organizata e Partisë, organizohen celula në bazë të sektorit të punës së tyre (të seksioneve) dhe formohet një komitet. Të gjithë anëtarët e komitetit nuk duhet të jenë përgjegjës të celulave. Komitetet në Shtabin e Përgjithshëm dhe në shtabet e korpuseve sipas rastit ose lidhen me organizatat e qarkut ku janë ose direkt me Komitetin Qendror.

Në mbledhje të ndryshme të komitetit të divizionit thirren edhe komisarët e brigadave, si dhe shefat e agjit-propit të divizionit dhe të brigadave, me qëllim që këta të lidhen edhe më ngushtë me problemet e Partisë, si dhe për të koordinuar punën në sektorët e ndryshëm.

Raportet për Komitetin Qendror duhet të jenë të rregullta dhe në kohë të caktuara brenda ditëve 25-30 të çdo muaji.

Kryesisht ç'duhet të përmbajnë raportet që i vijnë Komitetit Qendror nga forumet më të ulta të ushtrisë dhe të qarqeve?

Çështjet dhe problemet më të rëndësishme që vendos dhe kryen organizata nga njëra periudhë në tjetrën, si dhe të gjitha ato që e preokupojnë. Këto duhet të përshkruhen të plota dhe të qarta. Të shkruhet mënyra e zgjidhjes dhe duke dhënë mendimin e tyre në shumë pika. Për çdo gjë që nuk janë të qartë, për çdo send të kërkohen sqarime. Kur bëhet fjalë në raportet për njerëz, të shkruhen emrat e tyre të plotë. Të hiqet dorë nga fra-

zat e thata, të cilat asgjë nuk sqarojnë, si p.sh. «kemi shumë dobësi, mungesa, por do t'i ndreqim» dhe me kaq. Duhet të thuhet ku janë këto mungesa, nëse mundet organizata t'i kapërcejë dhe nëse është në gjendje t'i plotësojë.

Me pak fjalë po nënvizojmë edhe një herë: Të keni kujdes të madh, të shikohet thellë dhe drejt, me syrin më objektiv gjendja e organizatës së Partisë dhe e ushtrisë dhe ashtu të na raportohet.

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

Të fala shoqërore
KOMITETI QENDROR
I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

P.SH. Qarkorja do të studjohet vetëm në komitetet që u drejtohet. Në organizatat të shpian vetëm ato gjëra që janë të nevojshme.

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

UDHËZIME TË KQ TË PKSH PËR FORCIMIN E PUNËS SË KOMISIONEVE PËR FITIMET E LUFTËS

31 mars 1945

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PKSH

Të dashur shokë,

Komisionet për fitimet e luftës që u formuan menjëherë pas vendimit të Kryesisë së KANÇ¹ kanë dalë sot me lista të ndryshme që përmbledhin shuma të konsiderueshme të hollash. Ky ligj, nga një anë i jep një zgjidhje për një kohë të mirë problemit financiar të vendit dhe kontribuon në rimëkëmbjen e ekonomisë së shkatërruar nga lufta, nga ana tjetër, është një grusht i fortë kundër spekulimit pasi në këtë mënyrë goditen rëndë ata që kanë bërë fitime kolosale dhe që në të vërtetë janë një pakicë njerëzish, të cilët kanë përfituar nga konditat e krijuara nga okupacioni dhe nga gjendja e luftës. Këta njerëz, që në marrëveshje ose të përkrahur prej okupatorit e tradhëtarëve kanë bërë mbi kurriz të popullit, që është hedhur pa rezerva në luftë për liri, pasuri kolosale e kanë spekuluar, kanë qenë dhe me qëndrimin e tyre sot janë një mbështetje e fortë për reaksionin. Prandaj me marrjen e tatimeve të luftës goditen rëndë edhe këto pozita, që ata përpiqen t'i mbajnë me çdo mënyrë. Ata janë përpjekur dhe përpiqen që me çdo kusht ta paraqesin këtë masë si të padrejtë

¹ Është fjala për ligjin Nr. 37 të Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar mbi tatimet e jashtëzakonshme për fitimet e luftës të datës 13 janar 1945. (Shih «Gazetën Zyrtare» Nr. 3, f. 5, viti 1945). Sipas këtij ligji tatoheshin të gjithë tregëtarët dhe industrialët e vendit tonë, të cilët gjatë kohës së pushtimit fashist kishin realizuar fitime përmbi 500 000 franga shqiptare. Tatimet ishin progresive prej 15 deri 80 për qind të shumës së fituar përmbi 500 000 frangat. Për vërtetimin e fitimeve dhe caktimin e tatimeve ishin emëruar komisionet për fitimet e luftës.

përpara popullit dhe ta konsiderojnë si një grabitje të qeverisë sonë dhe si një masë kundër pronësisë e inisiativës private.

Qëllimi i këtyre është jo vetëm që të mos paguajnë taksën, por edhe të ftohën popullin nga pushteti ynë. Këtu lind nevoja e një fushate të gjerë me shtyp e me konferenca në masë, me anën e të cilave të sqarohet populli mirë mbi këtë masë të drejtë, populli të kuptojë mirë se kujt i merren tatimet, duke vënë mirë në dukje se merren mbi 500 000 fr. shq., kur janë bërë këto fitime dhe në kurriz të kujt. T'u vihet mirë në dukje masave të popullit se si janë ligjet tona, si janë gjykuar, si kanë dalë e si aplikohen këto ligje. Me një fjalë të theksohet se ligjet tona janë të drejta, të studjuara mirë, brenda frymës së lëvizjes dhe të luftës sonë dhe që aplikohen me përpikmërinë më të madhe dhe gjithmonë në interes të popullit... Në këtë drejtim shtypi qendror do të fillojë një fushatë të gjerë dhe do t'ju ndihmojë mjaft, por ju me organet tuaja dhe me konferenca ja filloni punën menjëherë në lidhje me gjendjen e qarkut tuaj.

Duhet që populli të shohë jo vetëm drejtësinë e ligjeve tona, por edhe preokupimin e gatishmërinë e qeverisë sonë, për të përballuar dhe zgjidhur problemet e tij. Populli duhet të mobilizohet i gjithë për popullarizimin e këtyre vendimeve e ligjeve, ai duhet t'i kuptojë si ligje të tij e jo të mbeten të thata e të konsiderohen si të paaplikueshme, ashtu sikurse duan t'i paraqesin të interesuarit. Pushteti ynë nuk do të ritirohet e nuk do të bëjë asnjë koncesion, por përkundrazi, do të kërkojë e do të zbatojë vendimet gjer në fund, duke përdorur edhe masat më ekstreme kundër atyre që do të refuzojnë.

Ata sigurisht nuk kanë për të ndenjtur me duar lidhur, por do të përpiqen me çdo mënyrë të ndalojnë ekzekutimin e ta vonojnë, duke menduar që t'u bëhen koncesione e lehtësira, prandaj që tashti ata kanë filluar të hedhin parulla, se taksat janë shumë të mëdha, se s'kanë para, se janë dëmtuar nga lufta etj. Por realiteti është krejt ndryshe dhe nëse nga ana e pushtetit do të ketë neglizhencë, duke ju dhënë afatë e koncesione, kjo do të ishte një tërheqje që na diskrediton pse tregon dobësi të pushtetit dhe veç humbjes së madhe ekonomike, do të kemi edhe një humbje të madhe politike.

Shumat që do të paguhen janë të mëdha dhe natyrisht sikurse thamë edhe pretekstet e tyre do të jenë të shumta, prandaj pushteti duhet të tregohet i fortë e i pamëshirshëm, duke përdorur mbi ta çdo masë sekuestrimi e ndëshkimi. Këset duhet të tërhiqen brenda afatit me precizionin më të madh dhe meqenëse nuk do të kenë t'i paguajnë në të holla të gjitha taksat, një pjesë e tyre sigurisht do të shpërblehet me mallra të luejtshme e të paluejtshme. Këtu duhet të tregohet kujdes i jashtëzakonshëm që të mos bëhet asnjë shpërdorim e abuzim. Nga materiali që do të

grumbullohet do të bëjë vaki që depot e tregëtarëve të bëhen depo të shtetit, por këto depo duhet të organizohen e të ruhen me rigorozitetin më të madh. Asnjë majë gjilpëre nuk duhet të humbasë e të shkojë kot duke u shpërdoruar nga njëri o tjetri. Masa rigorozë e të pamëshirshme duhet të merren kundrejt abuzuesve cilëtdo qofshin këta. Populli duhet të shohë mirë autoritetin e pushtetit tonë, të respektojë organizimin dhe të kuptojë se sa i rreptë është pushteti ynë kundër abuzimit dhe se sa rëndë e dënon këtë. Në rast të kundërt do të diskreditohej e do të humbasim çdo parashikim.

Një gjë tjetër që duhet të vihet re është dallaverja që tregëtarët do të mundohen të luajnë duke fshehur depo të ndryshme dhe të bien sa më shumë pengesa, prandaj ju duhet të mobilizoni gjithë organizatën e Partisë e gjithë organizatat antifashiste për të hetuar e për t'i zbuluar duke i dhënë kështu ndihmën më të madhe pushtetit në zbatimin e kësaj barre me kaq rëndësi.

Si e shihni pushteti ynë vihet në këtë mënyrë përpara një prove serioze, ku është në lojë prestigji i tij, prandaj shokët e Partisë duhet të vihen në lëvizje e të punojnë pa u lodhur për ta forcuar e për ta bërë të vendosur që të zbatojë gjer në fund pa u lëkundur këtë vendim, të jetë gjakftohtë e korrekt në sjellje, por i drejtë dhe i rreptë. Duhet të zgjidhen njerëz të ndershëm, adaptë dhe energjikë dhe të kontrollohen si duhet pa i dhënë shkak që të bëhen abuzime e të ulet prestigji i pushtetit. Duhet t'i mbyllet dera çdo abuzimi dhe të merren masa ekstreme kundrejt atyre që do të tentojnë, pa marrë parasysh asgjë. Dhe këtu barra më e rëndë i bie Partisë, se tek ajo populli ka besim dhe ajo sot ka fuqinë e vendet kyçe në pushtet.

Të tilla udhëzime kanë për t'u ardhur edhe nga pushteti dhe ne, si përfundim, u theksojmë edhe një herë, se si duhet të tregoheni të vendosur të punoni në popull rreth këtij problemi me kaq rëndësi, vendimi të zbatohet pa rezerva dhe të mos bëhet asnjë tërheqje e koncesion, në rast se duam të ngremë lart prestigjin e pushtetit dhe përfundimi të jetë pozitiv në vendimin e marrur.

Të fala shoqërore

KOMITETI QENDROR

I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

UDHËZIME TË KQ TË PKSH NË LIDHJE ME KREMTIMIN E DITËS SË 1 MAJIT

25 prill 1945

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PKSH
KOMISARËVE TË KORPUSEVE
KOMITETEVE TË DIVIZIONEVE

Të dashur shokë,

Për ditën e 1 Majit inisiativën për organizimin e festës do ta kenë sindikatat, por ju duhet t'u jepni ndihmën tuaj konkrete. Megjithëse do ta marrin inisiativën sindikatat, kjo duhet të jetë një ditë feste për të gjithë, ku i gjithë populli të marrë pjesë bashkë me punëtorët për të treguar bashkimin dhe solidaritetin e tij në Shqipërinë e re.

Dita e 1 Majit është dita në të cilën të gjithë punëtorët e botës përkujtojnë dëshmorët e tyre të parë, të rënë duke rivendikuar të drejtat e tyre. Festohet qysh prej 1889-s prej të gjithë punëtorëve të botës në kujtim të të rënëve në Çikago, më 1886 në një demonstratë nga më të mëdhatë ku merrnin pjesë më se 10 000 punëtorë që kërkonin të drejtat e tyre. Policia ndërhyri dhe më se 60 punëtorë mbetën të vrarë në rrugët e qytetit. Demonstratat vazhduan me javë të tëra, ndërsa terrori arriti kulmin.

Kjo u bë dita në të cilën në të gjithë botën masat e gjera të punëtorëve tregonin solidaritetin e tyre në luftë për rivendikimin e të drejtave të tyre dhe për një jetë më të lumtur. Në kohë paqeje në Bashkimin Sovjetik u bë dita ku punëtorët premtorin të shtonin kontributin e tyre për rindërtimin e ekonomisë socialiste dhe mirëqenien e popujve të Bashkimit Sovjetik.

Fashizmi u përpoq me demagogjinë e tij ta përvetësojë, ta bëjë një ditë të punës së tij, një festë fashiste, duke e festuar me qejfe dhe ahengje për të hequr sytë e proletariatit që vuante nga realiteti i një shfrytëzimi të egër dhe për të larguar kështu masat nga

lufta kundër tij. Por masat panë qartë fytyrën e tij të vërtetë dhe në luftën e ashpër kundër fashizmit, dita e 1 Majit u bë dita e mobilizimit të të gjitha forcave të çdo vendi përparimtar, dita e ringjalljes së shpirttrave, e organizimit dhe e shumëzimit të forcave gjithmonë të reja për t'u hedhur më me ashpërsi në luftë kundër presionit dhe për të këputur bashkë me të prangat e robërisë. Kjo ditë, që dje në luftën kundër okupatorëve u bë dita e nxitjes për beteja të vazhdueshme dhe për fitore të reja për gjithë shtresat e popullit, sot aq më shumë duhet të jetë dita në të cilën populli të gjejë energji të reja për t'i shkrirë për rimëkëmbjen e vendit.

Por megjithëse do të marrë pjesë i gjithë populli dita e 1 Majit nuk duhet të humbasë karakterin e veçantë të saj, si ditë në të cilën punëtorët e të gjithë botës ngritën zërin e tyre kundër spekulimit dhe shfrytëzimit. Prandaj në konferenca të gjera të flitet mbi kontributin e madh që ka dhënë klasa punëtore për një botë të re me luftën e ashpër e të pareshtur të saj, me kontributin e madh që ka dhënë proletariati në luftën kundër fashizmit, në të cilën ai në shumë vende është bërë pishtari i saj. Të vihet në dukje kontributi i paçmueshëm i klasës punëtore të Bashkimit Sovjetik, shembull heroizmi në luftë kundër fashizmit dhe në punë për rindërtim, për të gjithë popujt e botës. Të flitet për kontributin që ka dhënë klasa punëtore e Shqipërisë për organizimin e grevave të saj si në Korçë, Kuçovë e gjetkë më 1932-1936, pjesëmarrjen aktive në luftën çlirimtare, sakrificat e panumërta në burgje e internime, dëshmorët që ka dhënë në këtë luftë, vendosmëria dhe vetëmohimi në luftën e armatosur si dhe njerëzit që ajo i ka dhënë nga udhëheqësit më të mirë të popullit.

Kjo fushatë e gjerë që do të bëhet në konferenca e mitingje duhet të pasohet nga shtypi. Të shkruhet mbi rëndësinë e ditës, mbi historinë e lëvizjes së klasës punëtore dhe rolin e saj, të vihet në dukje karakteri përparimtar i saj, të vihet në dukje se fashizmi, armiku i gjithë njerëzimit, ka qenë armiku më i egër i klasës punëtore, se tek ajo shihte armikun më të madh dhe të papajtueshëm për veten e tij. Të vihen mirë në dukje përpjekjet dhe lufta e pareshtur dhe e egër që fashizmi ka bërë për të shkatërruar klasën punëtore me metodat e tija: terror, masakra, korrupsion dhe demagogjia e poshtër e tij me të cilën donte ta bënte me vete këtë klasë, duke i dalë si mbrojtës, ndërsa i bënte shtypjen më çnjerëzore, tentativat dhe dallaveret e poshtra të tij për ta përvetësuar ditën e 1 Majit.

Kjo ditë në Shqipërinë e re nuk duhet të jetë vetëm dita e punëtorëve, që i bashkon ata për të rivendikuar të drejtat e tyre, por të jetë dita, në të cilën me inisiativën e sindikatave, Fronti të solidarizojë dhe të grumbullojë të gjitha masat e gjera të popullit, të cilat të manifestojnë e të kërkojnë që kjo ditë të bëhet me të vërtetë ditë aktivizimi i të gjitha energjive të gjalla, ditë në të ci-

lën populli i bashkuar si një trup i vetëm do të vërë të gjitha forcat e tija për t'i ardhur në ndihmë pushtetit në realizimin e të gjitha planeve për rindërtimin e vendit.

Dita e 1 Majit 1945 e gjen popullin shqiptar me një shtet të ri, me një pushtet demokratik popullor që s'e ka parë kurrë historia e Shqipërisë. Kjo ditë që në histori është ditë bashkimi dhe solidariteti për të drejta dhe përparim, duhet sot të jetë ditë mobilizimi i të gjitha forcave të punës, i të gjitha forcave popullore e përparimtare, punëtorë të çdo rangui, fshatarë, intelektualë, nëpunës për rindërtimin e vendit, për përforcimin e pushtetit për një jetë të re dhe të lumtur.

Në mitingje dhe manifestime të gjera që do të zhvillohen ditën e 1 Majit duhet të dalin detyrat rreth të cilave do të mobilizohet populli: organizimin dhe shtimin e punës për rindërtimin e vendit, për punimin sa më të gjerë e mirë të tokave, për përmirësimin e gjendjes ekonomike, për përforcimin e pushtetit, për zgjerimin dhe për forcimin e Frontit, për grumbullimin e të gjitha forcave vitale të popullit rreth pushtetit, për forcimin dhe solidaritetin e gjithë popullit për t'u ardhur në ndihmë të mjeruarve të luftës, për zhvillimin kulturalo-arësimor të popullit dhe për përgatitjen e punëtorëve specialistë, për forcimin e modernizimit e Ushtrisë sonë N.-Çl., për ngritjen kulturele e përmirësimin e jetës ekonomike të katundarit tonë, i cili ka bërë gjithë këto sakrificat dhe është shkatërruar nga kjo luftë.

Parullat që do të hidhen me rastin e 1 Majit do të jenë: Rroftë dita e 1 Majit, dita e mobilizimit të gjithë popullit liridashës në luftë kundër fashizmit! Rroftë dita e 1 Majit, dita e mobilizimit të popullit tonë në luftë kundër fashizmit dhe mbeturinave të tija dhe për rindërtimin e vendit tonë! Rroftë koalicioni i madh antifashist! Rrofshin aleatët e mëdhenj Anglia, Bashkimi Sovjetik e Amerika! Rroftë Ushtria e Kuqe dhe strategu i madh Stalin! Rroftë Këshilli Antifashist N.-Çl.! Rroftë Qeveria Demokratike! Rroftë Ushtria N.-Çl. dhe komandanti i saj gjeneral-kolonel Enver Hoxha! Rroftë Fronti N.-Çl. që bashkon të gjithë popullin shqiptar! Rroftë Partia Komuniste Shqiptare, flamurtarja e luftës për liri! Rroftë bashkimi i popullit shqiptar! Duam të njihet qeveria jonë demokratike nga aleatët tanë! Katundarëve të gjithë Shqipërisë, që brez pas brezi kanë derdhur djersë, që kanë derdhur kaq gjak për këtë popull u erdhi dita që të marrin tokën! Për forcimin e pushtetit demokratik për miqësinë dhe bashkimin e ngushtë vëllazëror me popujt e Ballkanit dhe në radhë të parë me popujt e Jugosllavisë! Lavdi të përjetshme dëshmorëve që dhanë jetën për lirinë e atdheut nga okupatorët barbarë fashistë! Lavdi të përjetshme dëshmorëve të rënë në luftë kundër fashizmit bashkë me luftëtarët jugosllavë në tokën e Jugosllavisë!

Kjo ditë për ne ka një rëndësi të veçantë se për herë të parë,

sidomos pas 6 vjet robërie festohet lirisht dhe me madhësinë e saj, është shenjë e ndjenjave tona të larta demokratike dhe përparimtare. Në këtë ditë gjithë populli të tregojë bashkimin e solidaritetin e tij për sigurimin e Shqipërisë së re. Në këtë ditë duhet të jepet sinjali i një pune sa më të madhe për të konkretizuar dëshirat e popullit, për të siguruar fitoret e korrura dhe për të fituar të reja.

Të fala shoqërore
KOMITETI QENDROR
I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**UDHËZIME TË KQ TË PKSH PËR FORCIMIN E PUNËS SË
ORGANIZATAVE TË GRUAS ANTIFASHISTE SHQIPTARE**

15 maj 1945

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PKSH
KOMITETEVE TË DIVIZIONEVE
KOMISARËVE TË KORPUSEVE
KOMITETIT QENDROR TË RINISË KOMUNISTE
KOMITETEVE QARKORE TË RINISË KOMUNISTE
ORGANIZATAVE TË PARTISË PRANË SHTABEVE TË
KORPUSEVE DHE SHTABIT TË PËRGJITHSHËM

Të dashur shokë,

«Përparimi i shoqërisë mund të çmohet në një mënyrë të saktë nga pozicioni shoqëror i gruas»¹ — ka thënë Marksi, dhe Lenini në lidhje me këtë thoshte se hyrja e grave dhe e vajzave në produksion është një fenomen me themel përparimtar. Duke u bazuar në thëniet e mësuesve të mëdhenj Marksit-[Engelsit]-Leninit-Stalinit, komunistët e të gjitha vendeve e çmojnë rolin e gruas në shoqëri, e shtrojnë problemin e gruas si një nga problemet e tjera të partive komuniste, duke pasur parasysh se gruaja përbën gjysmën e njerëzimit dhe se është një forcë e madhe për kauzën tonë.

Përfundimi i këtij konsideracioni të drejtë duket qartazi në Bashkimin Sovjetik, ku gruaja, në saje të të drejtave të barabarta që i ka njohur shteti sovjetik është ngritur në nivelin e qytetarëve sovjetikë, është bërë e aftë të kontribuojë në çdo fushë veprimi. Në luftën n.-çl. u njoh nga të gjithë popujt aftësia e kësaj pjese të shoqërisë.

Në vendin tonë gjatë kësaj lufte gruaja me ndihmën e Partisë sonë ka bërë hapa të mëdhenj përpara. KQ që në formimin e Partisë e ka shtruar problemin e gruas si çdo problem tjetër, por

¹ Shih: K. Marks e F. Engels. Veprat, vëll. 2, f. 224, botim i dytë rusisht.

megjithkëtë çështja e gruas nuk është marrë me seriozitetin e duhur nga organizatat tona. Për këtë shkak nuk janë arritur sukseset që mund të arriheshin në këtë sektor.

Në esencë gjendja e gruas ka ndryshuar mjaft. Në fushën politike gruaja ka kontribuar në Luftën n.-çl.; vetë konditat e vendit tonë gjatë okupacionit e kanë favorizuar për këtë. Gjatë Luftës n.-çl. ajo ka fituar besimin në forcat e saja dhe ka ndjerë nevojën e organizimit.

Duke çmuar vlerat e mëdha të masës së gruas dhe aftësitë e saja në dobi të pushtetit tonë dhe në bazë të kontributit që i ka dhënë luftës sonë, Qeveria Demokratike i ka njohur gruas të drejta të barabarta me burrin. Po me gjithë sukseset e arritura puna me gruan nuk ka ecur krahas sektorëve të tjerë të Partisë. Gruaja fshatare është me ne, por niveli i saj politik është mjaft i ulët, ajo nuk e di rolin e saj në jetën ekonomike të vendit tonë. Akoma s'është e qartë për atë se roli i saj është mjaft i rëndësishëm në të gjitha kampet e jetës.

Gratë e qyteteve nuk janë krejtësisht me ne sado që në dukje organizata këtu është më e gjallë. Me gratë punëtore ndër qytete nuk ka asnjë punë sistematike. . .

Partisë ato deri më sot i kanë dhënë fare pak anëtare. Gratë e shtresave të larta qëndrojnë indiferente ose në pozita të kundërta. Me to është punuar më keq se kudo. Me gratë profesioniste që janë fare të pakta tek ne është bërë një politikë e dobët, ato s'kanë gjetur përkrahjen, ngrohtësinë dhe ndihmën për perfeksionimin e punës së tyre. Me to është mbajtur qëndrim i njëlojtë si me gjithë të tjerat. Nuk duhet të jetë e zorshme për t'u kuptuar vlera e punës me gratë. Ato janë një pjesë e gjallë e popullit tonë e paprekur dhe e pashfrytëzuar në dobi të shoqërisë.

Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që ka ky sektor pune për Partinë dhe duke ditur se ç'rol mund të luajë gruaja në jetën e vendit tonë, megjithëse në qarkore të ndryshme e kemi prekur këtë pikë, e quajmë të nevojshme që t'ju shkruajmë edhe një herë gjerë e gjatë mbi punën me gruan.

1) Ju theksojmë se duhet ta keni parasysh që puna me gruan është një sektor pune i Partisë; komiteti qarkor si dhe gjithë organet udhëheqëse të Partisë duhet ta shtrojnë këtë çështje si çdo çështje tjetër. Duhet të dinë, që në qoftë se ka mungesa në këtë sektor përgjegjësia kryesore u bie atyre. Gjer tashti forumet e Partisë nuk janë interesuar sa duhet për punën me gruan. Kjo punë është parë si diçka që dinë ta bëjnë dhe duhet ta bëjnë vetëm shoqet. Edhe atje ku është treguar nga shokët një farë interesimi për këtë sektor pune, nuk e kanë shtruar këtë problem si një problem të Partisë, por kanë ndihmuar me bisedime ose udhëzime shoqet që punojnë në atë sektor. Shpeshherë këto këshilla e udhëzime

janë dhënë më këmbë jashtë mbledhjeve. Kjo mënyrë pune duhet të marrë fund.

2) Për të lehtësuar punën e k[omiteteve] qarkore në këtë sektor, KQ i Partisë vendosi që pranë komiteteve qarkore të formohet një komision prej 4-5 shoqesh nga më të mirat e organizatës dhe natyrisht nga ato që punojnë me gruan. Këto nuk duhet të jenë anëtare të komiteteve të nënprefekturave të mbledhura pranë komitetit për të formuar komisionin. Duhet të jenë shoqet më me eksperiencë në punën me gruan qofshin dhe anëtare të thjeshta partie. Ky komision nuk duhet të jetë një forum i dytë dhe nuk jep direktiva, direktivat i jep gjithmonë komiteti qarkor, komisioni ka një karakter vetëm konsultativ. Ai do të jetë pranë komitetit qarkor për ta bërë më të lehtë zbatimin e vendimeve të tij. Komisioni lidhet me k[omitetin] qarkor nëpërmjet shoqes që e drejton dhe që njëkohësisht është anëtare e k[omitetit] qarkor; shoqet e komisionit do ta ndihmojnë për punën me gruan duke qenë ato vetë në këshillat dhe presidiumet e grave. Udhëzimet do t'i japin në organizatën ku do të bëjnë pjesë. Meqë janë shoqe me eksperiencë në këtë sektor mund të parashatrojnë mënyrat konkrete të punës dhe të aktivizimit të grave. Ato duhet të shikojnë me kujdes udhëzimet e dhëna nga Partia dhe të dinë t'i vënë në zbatim dhe të insistojnë për përmbushjen e tyre. K[omiteti] qarkor kërkon llogari për moskryerjen e punës nga ky komision.

3) Si për çdo sektor tjetër ashtu edhe për punën me gruan në çdo komitet dhe në çdo celulë duhet të jetë një shoqe ose shok përgjegjës, shoku ose shoqja duhet të japin llogari për kryerjen e punës dhe mbarëvajtjen e këtij sektori në celulë ose komitet.

4) Duke qenë se shumë shokë nuk e kanë kuptuar se si duhet punuar me gruan, k[omitetet] qarkore duhet të kenë parasysh që duhet t'u jepen sqarime rreth kësaj pike dhe të kujdesen që nëpër celula të flitet rreth qëllimit dhe punës së organizatës antifashiste të gruas. Gjithashtu gjithë udhëzimet që vijnë nga KQ mbi këtë pikë të punohen në krejt organizatën.

5) Në lidhje me sektorin e gruas ne duhet të flasim mbi organizatën antifashiste të gruas. Organizata e gruas vlen për të grumbulluar masat e gjera të grave rreth organizatës politike të popullit tonë, Frontit N.-Çl., për t'i aktivizuar dhe lartësuar këto. . .

Sot duhet të kemi parasysh që të punojmë pareshur me gruan për të bërë që të gjitha masat e grave të aktivizohen. Me këtë rast duhet të përmendim që organizata e gruas nuk duhet të merret si një organizatë e ngurtë dhe se sukcesi i organizatës nuk qëndron në ngritjen e presidiumeve, në grumbullimin rreth këtyre të një numri të kufizuar grash dhe në aktivizimin e këtyre grave, po në një punë të gjerë masash. Baza e punës me gruan është puna masive në mëhallë e në fshat. Por për këtë arësye nuk duhet punuar në drejtim për të krijuar lidhje të forta midis këshillave e

presidumeve të gruas; presidiumet e grave nuk japin direktiva e urdhëra të prera, por ndihmojnë në aktivizimin e masave të grave. Duhet nën frymën dhe ndihmën e Frontit të bëjmë që të gjitha gratë pa përjashtim të kenë dëshirë për punë, të gjitha ta ndjejnë veten anëtare të organizatës së gruas, anëtare aktive të Frontit N.-Çl. Për të arritur këtu, për të aktivizuar gratë, është detyra jonë që të gjejmë punë për to dhe të kanalizojmë të gjitha forcat e grumbulluara të grave me anën e organizatës së tyre në interes të pushtetit tonë. Me një fjalë nuk ka vlerë krijimi formal i skuadrave e batalioneve të punës, në qoftë se nuk është menduar se ç'punë konkrete do të bëjnë këto skuadra ose batalione. Për këtë paraqitet e nevojshme që organizata e gruas të njohë problemet e pushtetit tonë dhe pushteti duhet të mendojë njëkohësisht se si t'i shtjerë në punë energjitë e gruas. Në këtë mënyrë organizata e gruas ndihmohet nga pushteti dhe ndihmon pushtetin, duke kryer kështu një nga detyrat kryesore të saja.

Për koordinimin e punës në mes të organizatave të ndryshme antifashiste dhe që këto organizata të ndihmojnë njëra-tjetrën, duhet të ketë një lidhje të ngushtë e një bashkëpunim të mirë në mes të presidumeve të gruas dhe të rinisë si dhe në mes të organizatës së gruas dhe të Frontit, natyrisht, rolin kryesor këtu duhet ta luajë Partia. Puna që bën organizata e gruas nuk është e veçantë nga ajo e Frontit. Fronti e bën punën si duhet kur interesohet edhe për punën me gruan edhe me rininë, sepse puna e të gjitha organizatave antifashiste është puna e Frontit N.-Çl. Bashkëpunimi në mes të këtyre organizatave duhet të shtrihet në të gjitha anët, dhe sidomos në punë politike, në konferenca, në kurse të ndryshme dhe në mënyrën e aktivizimit të masave. Gjer tani asgjë nuk është bërë në këtë drejtim. Jo vetëm që nuk ka ekzistuar lidhja e duhur në mes të organizatave të ndryshme, por edhe shoqet që kanë punuar në Front, me rini e pushtet nuk janë kujdesur aspak për punën me gruan. T'u theksohet shoqeve se çdo detyrë të veçantë që kanë nuk duhet t'i pengojë për të punuar me gruan, ato si gra kanë detyrë të punojnë në organizatën e tyre dhe kjo është një detyrë që ua ngarkon Partia.

Në punën me gruan konstatohen shumë mungesa. Është parë mjaft sektarizëm përsa i përket grumbullimit të të gjitha grave rreth organizatës së tyre, rreth Frontit N.-Çl. Ka shumë gra larg organizatës, se nuk janë gjetur mënyrat e përshtatshme për afrim. Akoma nuk janë aktivizuar dhe ato gra që kanë qenë indiferente ose që i kanë dhënë fare pak lëvizjes. Në disa qarqe bile, shoqet e monopolizojnë punën vetë pse tremben nga masat, nuk mbajnë një qëndrim të mirë me gratë e shtresave të larta.

Disa herë janë dhënë udhëzime ose mendime nga ana e sekretariatit për organizatat e gruas së qarqeve; këto nuk kryhen, dhe

shumë herë organizatat e Partisë nuk kanë fare ide, bile edhe shoqët përgjegjës nuk dinë se ç'bëhet në sektorin e gruas. Kjo vjen se shoqet që punojnë me gruan këto udhëzime i mbajnë për vete dhe nuk i shtrojnë në organizatën ku bëjnë pjesë.

Mungesa më e madhe në këtë sektor është puna me gruan e fshatit. Duket një tendencë e madhe çmobilizimi në shoqet; këto shpeshherë mbi interesat e punës vënë interesat e tyre private, kërkojnë që të qëndrojnë nëpër qytete, duke braktisur fshatrat. Kështu në disa qarqe puna e gruas kufizohet vetëm në punën e qytetit. Çështja e punës në fshat duhet shtruar seriozisht në organizatën e Partisë dhe e gjithë organizata të punojë për këtë. Gruaja shqiptare siç ka qenë gjatë Luftës n.-çl. është edhe sot, do të jetë dhe nesër një mbështetje e fortë për realizimin e sukseseve tona të mëtejshme. Duhet të dimë që, duke punuar me gruan e fshatit, të përgatisim anëtare partie fshatare që do të jenë garanci për Partinë tonë. Ky problem nuk do të zgjidhet duke dërguar nga një shoqe ose nga një partizane që ka ardhur nga rreshtat e ushtrisë, në ndonjë krahinë me 50 fshatra. Ky problem do të zgjidhet kur e tërë organizata e Partisë të mobilizohet për këtë. Të gjithë anëtarët e anëtarët që punojnë në fshat dhe që janë në Front, në pushtet e në rini do të punojnë me gruan dhe në qoftë se në fshatra ka vetëm shokë atëherë këta mund të ndihmojnë duke ardhur në kontakt e duke udhëzuar disa vajza ose gra fshatare që qëndrojnë më afër nesh; në konferencat e Frontit të flitet për nevojën e lartësimit të gruas dhe për ndihmën konkrete që pret pushteti prej saj. Puna në fshat duhet të ndihet si një detyrë me rëndësi nga të gjithë anëtarët e Partisë. Organizata e qytetit do të ndihmojë për këtë punë. Të bëhet menjëherë një fushatë e gjerë në të gjitha gratë që të dalin sa më shumë për punë në katunde, mund të dalin për një kohë të gjatë për një javë, mund të dalin për një ose për dy ditë në formë pikniku; por së pari duhet të dalin anëtarët e Partisë. Kjo del si direktivë e Partisë dhe nuk duhet të ketë lëshime. Në ekskursionet mund të shkojnë tok me elementë të rinisë ose të Frontit, me një grup teatral ose muzikor, të organizojnë mitingje në formë festive. Organizatat duhet ta shtrojnë këtë problem seriozisht dhe duhet të mendojnë për mënyrat e punës e bile në disa qarqe mund të themi për mënyrat e fillimit të punës. Mbi gjithë të tjerat gruaja fshatare dërgjet në një injorancë shumë të madhe, niveli politik i saj është shumë i ulët, asaj i jepen të drejtat që ka fituar, këto të drejta ja garanton qeveria jonë, por ajo nuk është koshiente për këto të drejta.

Për këtë duhet një punë e madhe politike duke punuar shumë dhe pa u lodhur për lartësimin e saj.

Edhe një herë ju përsërisim se puna e gruas është një sektor

pune për Partinë dhe se komitetet duhet ta marrin seriozisht këtë punë. Përgjegjësia para Partisë për mosmbarëvajtjen e punës në qarqet e ndryshme bie mbi forumet drejtuese.

Të fala shoqërore
**KOMITETI QENDROR
I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE**

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**UDHËZIME TË KQ TË PKSH MBI PUNËN POLITIKE ME
RASTIN E ZGJEDHJEVE TË DELEGATEVE PËR NË
KONGRESIN I TË FRONTIT DEMOKRATIK
TË SHQIPËRISË**

20 korrik 1945

Q A R K O R E

KOMITETIT QENDROR TË RKSH
KOMITETEVE QARKORE TË PKSH
KOMITETEVE QARKORE TË RKSH
KOMITETEVE TË DIVIZIONEVE

Kongresi i Frontit Nacional-Çlirimtar do të çelet në Tiranë më 5 gusht 1945. Kongresi do të dëshmojë unitetin politik të kombit në vijën e Frontit.

Zgjedhjet e delegateve për në kongres, simbas qarkores sonë Nr. 311 datë 12 korrik 1945, duhet të kthehen në një fushatë të madhe agjitacioni e propagande nëpër gjithë Shqipërinë.

Me këto zgjedhje duhet të angazhohen të gjithë anëtarët e Partisë, duhet të punojnë pareshtur në sektorin, fshatin, fabrikën, në treg ose në sindikata, me të rinj ose me gra, aty ku jetojnë e punojnë. Kjo punë do të jetë e paprerë dhe do të mobilizojë të gjitha masat e popullit në problemet tona.

Duhet të kuptojmë mirë që në këtë mënyrë ne nuk mobilizojmë Partinë në një problem të vetëm dhe lëmë pas shpine tërë punën politike. Por tërë problemet politike të Partisë sonë i shtrojmë me këtë frymë.

Me rastin e zgjedhjeve të frontit ne duhet të godasim rëndë reaksionin e brendshëm. Këtë nuk mund ta bëjmë pa pasur me vete masat e popullit, pa pasur me vete fshatarin, punëtorin, pa pasur gjithë ata që dje dhe sot kanë jetuar në indiferentizëm, pa vënë përpara punës të gjithë ata që duan t'i shmangen kësaj. Kjo është goditja më e fortë që mund t'i japim reaksionit, mobilizimi i masave në vijën tonë na jep armën më të fortë në duar.

Duhet të dalim sa më parë me vijën tonë përpara popullit dhe jo të presim parullat e reaksionit për t'i luftuar. Kjo mënyrë pune e le popullin të pasigurtë dhe jashtë luftës kundër reaksionit. Kurse detyra jonë është të mobilizojmë tërë popullin në vijën tonë politike, në vijën e Frontit, ta bëjmë një bllok të pathyeshëm kundër vijës së reaksionit.

Reaksioni i jashtëm ka ngritur kundër nesh reaksionin grek. Këta me provokacionet e tyre kërcënojnë independencën tonë. Ne ruhem nga provokacionet, por s'u shmangemi detyrave tona. Me rastin e zgjedhjeve ne duhet të ngremë të gjithë popullin shqiptar nën parullën e *bashkimit kombëtar* për mbrojtjen e independencës sonë të fituar me kaq gjak. Mobilizimi i tërë popullit për t'u mbrojtur nga çdo kërcënim i jashtëm i pret krahët reaksionit të brendshëm që inkurajohet vazhdimisht nga jashtë.

Ne e thërresim tërë popullin të bashkohet; kush është kundër këtij *bashkimi* është kundër lirisë, independencës, atdheut, demokracisë së popullit. Prandaj ne këta i godasim rëndë dhe i demaskojmë përpara gjithë popullit.

U theksua dhe më lart se pa punën e të gjithë anëtarëve të Partisë ne nuk mund të kemi sukses. Mobilizimi i tërë anëtarëve të Partisë duhet të ketë si rezultat mobilizimin e tërë popullit. Këtë duhet ta kuptojmë mirë.

Fushata për zgjedhjet e Frontit është një fushatë politike ku do të ngrihet çdo problem i ditës.

Duhet të shtroni problemin e ushtrisë, nevojën e mbajtjes të saj, organizimin e zgjerimit e saj dhe, mbi të gjitha, populli të dijë mirë se ushtria është garancia e independencës sonë. Kush nuk do ushtrinë s'do popullin dhe independencën.

Të shtrohet problemi i lidhjes së popullit me qeverinë e tij. Kjo qeveri është e vetmja që mendon për ta ruajtur independencën, për ta nxjerrë popullin nga çdo vështirësi ekonomike. Përpara popullit ne të ekspozojmë punën konkrete që është bërë për rimëkëmbjen e ekonomisë sonë e jo të mbetemi në frazat e thata agjitative siç është bërë deri më sot. Duhet të mobilizohet populli kundër spekullatorëve, akaparatorëve, kundër tregëtarëve që s'duan të paguajnë tatim-fitimet e luftës. Ky mobilizim i masave dobëson reaksionin e brendshëm pse edhe aty është dora e tij.

Duhet të mobilizohen masat e gjera të popullit për rindërtimin e atdheut, për të zgjeruar sa më tepër kulturën e arësimin për përmirësimin e jetës shoqërore.

E tërë kjo punë duhet të sistematizohet si në fshat edhe në qytet. Çdo fshatar i madh dhe i vogël duhet të jetë në këmbë kundër reaksionit. Ata që dje ishin me «Ballin» ose «Legalitetin» sot duhet të vihen përpara punës dhe të dalin nga pozitat e tyre falso.

Punëtorët e qyteteve dhe të fshatit të jenë në ballë të ofensivës, kundër reaksionit të brendshëm.

Me parullën e *bashkimit* të shenjtë ne do të këputim edhe elementët e borgjezisë së vogël, tregëtarët e zanatçinjtë, intelektualët, nëpunësit dhe këta të përpiqemi t'i shtiem në punë, t'i kontrollojmë dhe t'i drejtojmë mirë. Na duhet të bëjmë çmos që aktivizimi i elementëve të ndryshëm në vijën e Frontit të jetë diçka e gjallë që të nxjerrë përfundime në forcimin e unitetit politik të kombit e në forcimin e pushtetit popullor. Organizata e Frontit u zgjerua për të mobilizuar sa më shumë forca në anën tonë, për të thyer bllokun e reaksionit; kjo duhet kuptuar drejt edhe sot.

Përpara organizatave të rinisë, të gruas, të sindikatave punëtoresh, zgjedhja e delegatëve për në kongresin e Frontit, e cila, e përsërisim, duhet të kthehet në ofensivë kundër reaksionit të brendshëm dhe të shtrohet si një detyrë aktuale me rëndësi të dorës së parë. Agjit-propi të mendojë dhe të punojë vazhdimisht. Të organizohen konferenca, bisedime me elementë të ndryshëm.

Shtypi lokal të merret gjerë e gjatë me këto zgjedhje, të botojë korrespondenca nga krahinat. Të dërgoni korrespondenca në qendër. Të ndiqni qëndrimin që mban gazeta «Bashkimi». Të ngjiten kudo afishe me parullat e rastit. Fjalimet që do të mbahen në zgjedhjet ta prekin popullin, t'ja forcojnë dashurinë për liri, për independencë, për qeverinë dhe për ushtrinë e tij, dhe ta mbushin me urrejtjen më të madhe kundër reaksionit. Kështu populli të shpërthejë në manifestime vërtet spontane. Ne do të arrijmë këtu jo me duhet, por duke i vënë popullit para syve fakte konkrete dhe duke i treguar se e vetmja udhë për realizimin e aspiratave të tija është vija jonë.

Zgjedhjet e kongresit duhet të përfundojnë në një plebishit unanim për politikën e qeverisë demokratike kundër reaksionit.

Ju porositim të mendoni mirë për delegatët që do të zgjidhen për në kongres. Të punoni në mënyrë që një pjesë e mirë e delegatëve të jenë anëtarë partie, më shumë se gjysma të jenë njerëz shumë afër nesh, të tjerë të jenë elementë që duke u zgjedhur delegatë e duke punuar dhe ne me ta, të afrohen më shumë tek ne, të jenë elementë që ne me zgjedhjen e tyre për në kongres të fitojmë kredi. Këta të jenë tregëtarë të mesëm, intelektualë, pronarë të mesëm, me kredi në popull dhe njerëz me influencë. Sidoqoftë të shikoni dhe konditat e vendit.

Çdo gjë do të organizohet nga ana e Frontit.

KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë

LETËR E KQ TË PKSH MBI KONSPIRACIONIN

25 korrik 1945

KOMITETEVE QARKORE DHE KOMITETEVE TË NËNPREFEKTURAVE,
KOMITETEVE TË DIVIZIONEVE DHE BYROVE TË BATALIONEVE

Është vënë re se në përgjithësi nëpër organizatat tona ndjehet një farë dobësie përsa i përket konspiracionit si në çështjet e Partisë, ashtu edhe për çështjet në përgjithësi të shtetit.

Prandaj porositim të gjitha organizatat që t'i vënë një rëndësi të jashtëzakonshme konspiracionit dhe të ruajnë çdo gjë që duhet të ruhet. Duhet t'u theksohet mirë anëtarëve të Partisë se ç'rëndësi ka konspiracioni dhe se si ata duhet jo vetëm të edukohen për veten e tyre në këtë drejtim, por të edukojnë edhe popullin. Populli duhet të edukohet dhe të mësohet që të mos japë asnjë informatë që është në dëm të çështjes sonë. S'ka nevojë që të marrin vesh njerëz të huaj se ku është vendosur ushtria jonë, ç'reparte ndodhen në këtë ose atë vend. S'është nevoja të dinë të tjerët se si funksionojnë minierat tona, se ç'punëtori ka dhe se ç'prodhim nxjerrin. Për të mos përsëritur, ka shumë shembuj si këta që treguam më lart, prandaj duhet që shokët tanë ta kuptojnë mirë rëndësinë, ta marrin seriozisht këtë çështje dhe të mendojnë gjithnjë kur të flasin e të mos dekonspirojnë, sikurse ndodh shpeshherë ose pa kuptuar ose edhe më keq, për t'u dukur. Kjo frymë duhet të futet edhe në popull, për këtë duhet taktikë e punë, prandaj duhet të mobilizohen të gjithë anëtarët e Partisë të punojnë shumë në këtë drejtim në popull. Çështja duhet të shtrohet mirë e të mos alarmohet populli. Me pak fjalë jo të merret kjo si direktivë dhe menjëherë të fillojnë mbledhjet e popullit për t'i shpjeguar rëndësinë e konspiracionit, por duhet që kjo të kuptohet mirë nga anëtarët e Partisë, të cilët me punën e përditshme të tyre do të futin këtë frymë në popull. Kjo, pra, duhet të bëhet edukatë për popullin e të mos jetë vetëm e çastit, por të jetë si një detyrë e përhershme për çdo anëtar partie.

Vetëm po të veçrojmë në këtë mënyrë ne do të mundim të ruajmë çdo gjë e me ne bashkë i gjithë populli do të mësohet të ruajë çështjen tonë.

KOMITETI QENDROR I PKSH

Botohet sipas kopjes që
gjidhet në Arkivin Qendror
të Partisë

**UDHËZIME TË KQ TË PKSH MBI PUNËN PREGATITORE
PËR KONGRESIN E PARË TË SINDIKATAVE
(BASHKIMEVE PROFESIONALE) TË SHQIPËRISË**

2 shtator 1945

TË GJITHA ORGANIZATAVE TË P[ARTISË] NË QARQE E USHTRI

Të dashur shokë,

Jemi para kongresit të sindikatave¹, që shënon një fazë të re për klasën punëtore dhe është përfundimi i punës së kryer deri më sot nga organizatat e punëtorëve të krahut e të mendjes.

Edhe në kohët e para punëtorët janë përpjekur të organizohen për të siguruar të drejtat e tyre, por qeveritë e atëhershme kanë parë ndër to një rrezik të madh dhe i kanë goditur rëndë për t'i shkatërruar.

Me çlirimin e Shqipërisë nga okupatorët e me hedhjen e themeleve të shëndosha të regjimit demokratik, u krijuan kondita të tilla, që menjëherë mundi të ngrihet lëvizja punëtore në një shkallë të përshtatshme dhe të organizohen sindikatat. Por ky regjim demokratik jo vetëm që lejoi formimin e sindikatave, por i ndihmoi që të organizoheshin më së miri dhe u dha të gjitha mbështetjet që të mundin të realizojnë qëllimin e tyre.

Me reformat e ligjin e punës, me asistencën dhe preferencën në ndërmarrjet shtetërore që u bënë sindikatave, duket qartë interesim serioz dhe i gjallë që ka pushteti ynë për të përmirësuar dhe ngritur nivelin e jetesës së punëtorëve tanë. Planet e rindërtimit që po realizohen e do të realizohen nga pushteti ynë kërkojnë forca të reja pune e prandaj parashikimet për të zhdukur papunësinë, që ka kalbur deri sot vendin tonë, janë të kënaqshme.

Në këto kondita të reja, edhe lëvizja punëtore shqiptare, po merr proporcione gjithnjë më të gjera. Sot ndodhen të regjistruar gati më shumë se 20 000 punëtorë të krahut e të mendjes në

¹ Kongresi i parë i Sindikatave (Bashkimet Profesionale) të Shqipërisë u çel më 28 tetor 1945 në Tiranë.

sindikata dhe numri i atyre që s'janë regjistruar po zvogëlohet dita-ditës.

Ky është një hap shumë i madh po të marrim parasysh traditat e dobëta sindikale që ka trashëguar lëvizja punëtore në Shqipëri. Veç kësaj kongresi i gjen punëtorët të organizuar me këshilla e degë në të tëra qendrat ku ka punëtori në Shqipëri.

Këtu del në shesh edhe më mirë akoma vullneti dhe nevoja që ndjejnë punëtorët për t'u organizuar dhe vetëm në konditat e reja të sotme ka mundësi të duket se sa e gjerë mund të bëhet lëvizja sindikale në Shqipëri.

Kongresi e gjen klasën punëtore të organizuar dhe me shumë suksese relativisht me kohën në të cilën janë korrur. Në më pak se një vit janë organizuar e kanë filluar të funksionojnë kudo këshillat dhe degët sindikale.

Kongresi shënon fillimin e një etape të re, të një etape me një aktivitet më të madh e më të organizuar.

Kongresi i punëtorëve dhe i nëpunësve duhet të nxjerrë të fortë bashkimin e tyre, nga ky kongres duhet të dalin punëtorët me rezultate pune të dukshme, duhet të nxjerrin eksperiencë të gjerë, të nxjerrin një udhëheqje të shëndoshë e të gjallë, që të plotësojnë me nder e përpikmëri detyrat e mëdha dhe të rëndësishme, në mënyrë që klasa punëtore dhe nëpunësit të bëhen faktorë konstruktivë me rëndësi në Shqipërinë e re dhe të zënë vendin që i përket një force kaq të rëndësishme si është ajo e popullit punëtor në jetën politike dhe ekonomike të një vendi të lirë. Masat punëtore janë ato më përparimtare dhe duhet të grumbullojnë rreth vetes gjithë masat e tjera për t'i dhënë ndihmën dhe për të konsoliduar e përforcuar pozitat e pushtetit të ri demokratik, pse punëtorët e krahut e të mendjes paraqitin një forcë të madhe të popullit punëtor në Shqipëri dhe janë mbështetja e fortë e pushtetit demokratik të masave popullore në Shqipëri.

Kësaj mase punëtorësh e nëpunësish, këtij bashkimi forcash, duhet t'i japim të gjitha ndihmat për t'u bërë një bashkim i pafytyrshëm. Kësaj mase që përbën shtyllën më solide të forcës së pushtetit popullor, për të qenë ndihma e saj më efikase duhet t'i japim një vend të dukshëm në jetën shoqërore dhe shtetërore të Shqipërisë.

Siç duket puna e sindikatave është një problem direkt për Partinë tonë.

Organizatat e Partisë sonë duhet ta marrin këtë problem me seriozitetin më të madh dhe t'i japin çështjes sindikale ndihmën e tyre të vazhdueshme. Ato duhet të preokupohen për sindikatat, për njerëzit e sindikatave, për organizimin e tyre, për bashkimin e sindikatave, për forcimin e këtij bashkimi, pse aty dhe rreth tyre është gjithë masa e popullit punëtor e përparimtar, pse aty

do të gjejmë gati për t'i mobilizuar për çështjet e pushtetit tonë për rindërtimin e vendit, për ngritjen e ekonomisë sonë kombëtare e për zgjidhjen e çdo problemi të vendit tonë.

Të gjitha organizatat e Partisë si dhe Rinia Komuniste duhet t'i ndihmojnë sindikatat që të jenë në gjendje t'u përgjigjen detyrave të reja e të mëdha që u dalin sot përpara: të zhvillojnë sa më shumë aktivitetin e tyre në sipërmarrjet, në kontrollin e punës, dhe në shtimin dhe zhvillimin e produktivitetit.

Veç kësaj organizatat tona duhet të preokupohen për përmirësimin e gjendjes së tyre ekonomike, të përpiqen me çdo kusht që të mos i kalbë papunësia.

Nga kujdesi i madh që do të tregojnë organizatat tona, varet suksesi i madh që do të ketë Partia jonë në punën me masat punëtore.

Duhet të jetë e qartë se çështja e sindikatave lidhet direkt me Partinë, është një problem i rëndësishëm i saj, atje Partia jonë ka masat e gjera ku do të zgjerohet e forcohet me forca të reja e të sigurta dhe atje ajo do të hedhë bazat e shëndosha e do të krijojë shtyllën e fortë të Frontit Demokratik e të pushtetit popullor.

Në të vërtetë deri sot interesimi nga ana e organizatave tona ka qenë mjaft i dobët. Puna e sindikatave është konsideruar si një sektor pune pa ndonjë rëndësi të dukshme, për të cilën preokupohej vetëm shoku që qe ngarkuar.

Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe që ka ky sektor nuk lejohet paskëtaq që puna të vazhdojë me këtë ritëm shumë të javashëm e të vazhdojë të ekzistojë ky indiferentizëm që është treguar gjer sot.

Kujdesi i veçantë i organizatave të Partisë do të bëjë që të shtohet puna me sindikatat, të aktivizohen këto në punët e tyre dhe të kenë rezultatet e duhura.

Në kongres sindikatat duhet të dalin me një punë të dukshme, atje duhet të duket aktiviteti i madh i këtyre 10 muaj pune, të pasqyrohen sukseset e punëtorit të Shqipërisë së re demokratike. Atyre para kongresit u paraqiten disa detyra për kryerjen e të cilave organizatat tona do të japin gjithë ndihmat e tyre. Nga ana tjetër Rinia Komuniste duhet të punojë me rininë punëtore e të bëjë që kjo të jetë avangardë për punën e kongresit e për realizimin e detyrave.

Ja parullat rreth të cilave duhet të bëjmë mobilizimin politik të punëtorëve dhe të nëpunësve, në këtë kohë të kongresit dhe të përgatitjeve, po njëkohësisht të jenë edhe drejtimi i tyre politik e sindikal, të jenë detyrat e tyre të sotme:

a) pjesëmarrja aktive e sindikatave në programin e rindërtimit të vendit, për ndërtimin e fshatrave të djegura, të fshatrave

të varfëra që mbajtën peshën e luftës e në ndërtimin e vendit që ka shkatërruar armiku;

b) për të ngjallur shpirtin e punës, dashurinë e madhe për punë, për të ngritur dhe për të zhvilluar produktivitetin në shkallën më të lartë që mund të bëhet;

c) me një punë të madhe, me zhvillimin e aktivitetit të kooperativave dhe të industrive klasa punëtore, me punën e palodhur të saj të bëjë edhe kontrollin e punës¹;

d) lidhjet e bashkimit të punëtorëve dhe të nëpunësve me pushtetin demokratik të bëhen të forta, nën prizmin e të cilit do të realizohet çdo aspiratë, pse me një pushtet të fortë ato do të sigurojnë çdo gjë, pse e ardhshmeja dhe standardi i jetës së tyre është lidhur ngushtë me pushtetin demokratik;

dh) sindikatat të bëhen faktor vendimtar në vendin tonë, për të ndërtuar një jetë të lumtur, të qetë dhe të pasur, një të ardhshme më të mirë, dhe për këtë, për të arritur këtë ditë, sindikatat duhet të vënë të gjitha forcat;

e) sindikatat duhet të sigurojnë një vend të mirë në jetën shoqërore dhe shtetërore se e meritojnë, por këtë do ta sigurojnë me aktivitetin dhe me punën e tyre;

ë) të hidhen parulla që kongresi të mos gjejë jashtë sindikatave asnjë punëtor e nëpunës;

f) sindikatat si organizatë që aderojnë në programin politik të Frontit Demokratik duhet të jenë ato që të zbatojnë me besnikëri detyrat dhe vendimet e Kongresit I të Frontit Demokratik;

g) të zhvillohet ideja e aleancës në mes të punëtorëve, të fshatarëve dhe të intelektualëve si nevojë e domosdoshme për të siguruar dhe konsoliduar fitoret demokratike në vendin tonë dhe për rindërtimin e shtetit tonë demokratik;

gj) klasa punëtore, punëtorë e nëpunës duhet të luftojnë çdo sektarizëm dhe çdo ekstremizëm në radhët e tyre. Por nga ana tjetër të luftojnë pa mëshirë ata që s'janë për një punë të rregullt

1 Në vitin 1945 ndërmarrjet industriale dhe të ndërtimit që zotërohehin nga kapitalistët e vendit akoma nuk ishin shtetëzuar. Shtetëzimi i tyre filloi vetëm nga prilli i vitit 1946, në bazë të detyrave që vuri Plenumi V i KQ të PKSH.

Megjithkëtë në ligjin Nr. 19 të Këshillit Antifashist N.-Çl. të datës 15.12.1944, të gjitha ndërmarrjet industriale dhe shoqëritë e kapitalistëve shqiptarë ishin vënë nën kontrollin e shtetit. Një nga format e kontrollit shtetëror mbi këto ndërmarrje ishte kontrolli nëpërmjet vetë klasës punëtore, e cila luante rolin drejtues në shtetin e ri demokratik shqiptar. Pikërisht për forcimin e këtij kontrolli në punë bëhej fjalë në pikën c) të detyrave që u ngarkon KQ i PKSH punëtorëve dhe bashkimeve të tyre profesionale, me rastin e Kongresit të parë të Sindikatave.

e të disiplinuar, ata që kanë tendenca anarkiste. Të ruajnë pas-tërstinë e radhëve të tyre nga të tillë njerëz dhe nga këto tendenca që janë mbeturina të së kaluarës dhe të huaja për klasën punë-tore, të ruajnë demokracinë përparimtare të tyre, pse të tillë ele-mentë janë shkatërrimtarët e brendshëm të klasës punëtore dhe të nepunësve.

Të fala shoqërore
KOMITETI QENDROR
I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë

UDHËZIME TË KQ TË PKSH NË LIDHJE ME SHPALLJEN
E LIGJIT TË REFORMËS AGRARE NGA KËSHILLI
ANTIFASHIST NACIONAL-ÇLIRIMTAR

2 shtator 1945

KOMITETIT QENDROR TË RKSH
KOMITETEVE QARKORE TË PKSH
KOMITETEVE TË DIVIZIONEVE
KOMITETIT TË PARTISË NË USHTRI

TIRANË

Kryesia e Këshillit Antifashist aprovoi këto ditë ligjin për zbatimin e reformës agrare¹. Kjo është një nga reformat më të mëdha në terrenin politik, ekonomik të vendit tonë, prandaj duhet të popullarizohet me të gjitha mjetet dhe zbatimi i saj të jetë si një rezultat i madh i lëvizjes nacional-çlirimtare, një realitet me kuptimin e thellë politik, ekonomik e shoqëror për vendin tonë.

Organizata e Partisë duhet të jetë më këmbë dhe të mobili-zojë të gjitha organizatat antifashiste për ta bërë sa më të qartë dhe të kuptueshëm në popull ligjin e reformës agrare dhe të për-piqeni që të mos mbetet asnjë dyshim në politikën sociale të qeveri-së sonë.

Reaksioni dhe gjithë njerëzit që u preken interesat e tyre, do të përpiqen me çdo mjet ta bëjnë përpara popullit si të paaplikue-shëm ligjin e reformës agrare, ata mundohen të tronditin opinio-nin e fshatarëve dhe të ulin entuziazmin e tyre duke e nxjerrë

1 Ligji i reformës agrare u shpall nga Këshilli Antifashist Nacional-Çli-rintar më 29 gusht 1945 (shih «Gazetën Zyrtare», Nr. 39, viti 1945). Mirëpo me këtë ligj u lejuan disa gabime, të rrjedhura nga politika oportuniste e Sejfulla Malëshovës. Plenumi V i KQ të PKSH (shkurt 1946) e dënoi rëndë oportunizmin e Sejfulla Malëshovës. Në bazë të vendimeve të këtij plenumi, KQ dhe Qeveria e RPSH muarën masa rrënjësore për ndreqjen e gabimeve me anë të dekretligjit Nr. 253 të datës 27 maj 1946 (shih «Gazetën Zyrtare», Nr. 50, viti 1946).

si të pazonjën dhe me baza të dobëta qeverinë tonë, prandaj duhet të goditen rëndë parullat e tyre, të mos i lëmë që të zenë vend në popull dhe të përdoret çdo mjet që të shkëpusim një herë e përgjithmonë fshatarësinë nga influenca e agallarëve, e bejlerëve qofshin këta në grupe ose persona.

Agjitacioni dhe propaganda për këtë çështje duhet të jenë të gjithanshme. Organizatat e Frontit, të rinisë, të gruas, sindikatat duhet të bëjnë një propagandë kaq të fortë dhe të përgatitur mirë sa të bëjë efektin e plotë të kësaj fushate. Qëllimi ynë është që të lidhim sa më ngushtë masat e gjera të fshatit dhe gjithë pjesën përparimtare të popullit tonë me pushtetin demokratik. Këto lidhje duhet të jenë me zemër e të përhershme dhe të bëhen një bazë e shëndoshë për zgjedhjet e ardhshme të Asamblesë Kushtetuese. Reforma agrare duhet të shkëputë definitivisht lidhjet e fshatarësisë me bejlerët, agallarët e latifondistët.

Kjo fushatë e madhe, që do të bëhet për popullarizimin e reformës agrare, ka lidhje me fushatën e madhe të zgjedhjeve dhe ky sukses i madh duhet të zërë një vend me rëndësi në aktivin e realizimeve që kemi bërë gjer më tani. Të gjitha këto realizime e suksese që janë mbërritur nga pushteti ynë do të jenë mbështetje për përgatitjen e propagandës së zgjedhjeve.

Të përgatiten sa më mirë organizatat e Partisë, të Frontit, të rinisë, të gruas e të sindikatave që të jenë të zonjat të udhëheqin me sukses këtë fushatë të madhe politike, e cila duhet të sigurojë patjetër fitoren tonë. Me agjitacionin e propagandën tonë të vogël, të vëmë në dukje rolin e Partisë Komuniste si parti e punëtorëve dhe fshatarëve të varfër që ka gjithmonë për parim « t o k ë n f s h a t a r ë v e » dhe sot është prapë Partia jonë që i sugjeron Frontit idenë e reformës agrare dhe që e udhëheq pushtetin për realizimin e plotë të saj.

Të shikohet mirë me kujdes çdo tentativë e kundërshtarit dhe të goditet në fushën politike...

Një barrë e madhe i ngarkohet shtypit për popullarizimin e reformës agrare. Të gjitha gazetat e qarqeve duhet t'i dedikojnë vendin kryesor çështjes së reformës agrare. Agjit-propi duhet të jetë në aktivitetin më të madh gjatë kësaj kohe. E tërë Shqipëria duhet të marrë vesh dhe të ketë të qartë rëndësinë e madhe të reformës agrare.

I gjithë materiali që do të shërbejë për këtë punë duhet të bazohet në konferencat aktuale, të organizuara mirë, duke marrë citate nga kryeartikujt mbi reformën agrare, nga përpjekjet e fshatarëve për të pasur tokën e tyre, nga jeta e tyre, nga shtypja e rëndë e bejlerëve dhe e latifondistëve, nga ana tjetër parulla të përgatitura mirë e të rastit. Shfaqjet e ndryshme teatrale e muzikore, këngët e ndryshme të jenë mjete me rëndësi për të bërë sa më të gjerë popullarizimin e reformës agrare. Një rol të madh do të lu-

ajnë ekipet e organizuara mirë e të përgatitura nga Fronti, gruaja, rinia e sindikatat, të cilat do të dalin katundeve për të shpënë çdo gjë në lidhje me sa u tha më sipër.

Edhe ushtria duhet të mobilizohet për popullarizimin e reformës agrare; batalione të tëra me grupe muzikore, teatrale, sportive si dhe ekipet e agjitorëve të lëvizin nëpër krahinat e ndryshme të Shqipërisë. Ushtria duhet të dalë përpara popullit si një ushtri që merr pjesë në këtë gëzim të madh, në këtë fitore të popullit tonë, për të cilën ajo luftoi dhe dha qindra dëshmorë dhe është gati që për çështjen e popullit, për sigurimin e lumturisë së tij të luftojë edhe të vritet përsëri.

Kjo reformë është një reformë në interes direkt të ushtrisë sonë, pse në ushtrinë tonë numri dërmues janë fshatarët. Një mëngjez të bukur dhe fare të shpejtë, prindërit e ushtarit fshatar, shtëpia e tij, ai vetë do të gdhien zotër me tapi në gji të asaj cope toke kaq të dëshiruar. Paskëtaj ushtarët tanë fshatarë do të kenë tokën e tyre, në tokën e Shqipërisë Demokratike. Mbrojtja e independencës dhe e tokës shqiptare për ushtarin tonë fshatar sot është mbrojtja e independencës dhe e tokës së tij.

Prandaj organizata e Partisë në ushtri duhet ta propagandojë e ta bëjë sa më të njohur zbatimin e reformës agrare, përpara ushtarëve tanë dhe ta mobilizojë ushtrinë në masë të gjerë për ta propaganduar sa më shumë në popull.

Me nxitjen e organizatave të Partisë, Fronti duhet të marrë inisiativën dhe të organizojë mitingje nëpër qytete, krahina dhe fshatra. Këto duhet të jenë në shkallën më të lartë që mund të bëhen, të hyjnë në histori si manifestime më të mëdha të masave të gjera të popullit shqiptar për fitoren e madhe të reformës agrare.

Të fala shoqërore

KOMITETI QENDROR

I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARË

Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë

NGA UDHËZIMET E KQ TË PKSH PËR KUOTIZACIONET

5 tetor 1945

TË GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PKSH
TË GJITHË KOMITETEVE TË DIVIZIONEVE
KOMITETIT TË USHTRISË NË SHTABIN
E PËRGJ[ITSHËM]

Të dashur shokë,

Meqenëse deri më sot për arësye të luftës dhe të gjendjes të rregullt financiare problemi i kuotizacioneve s'është shtruar fare ose është lënë të veprohet sipas dëshirës së anëtarëve të Partisë, Komiteti Qendror, duke marrë parasysh përmirësimin e gjendjes ekonomike si të shokëve të ushtrisë, të punëtorëve dhe nëpunësve si dhe të zanatçinjve e të tjerë me punë private, vendosi që t'u japë një formë të prerë kuotizacioneve.

Sikurse dihet, një nga konditat e domosdoshme për të qenë anëtar partie është pagesa në rregull e kuotizacionit.

Prandaj kuotizacioni do të paguhet një herë në muaj në bazë të përqindjes mbi rrogën, për ata që marrin rrogë, në bazë të të ardhurave për të tjerët.

Përqindja mbi rrogën është kjo:

Për rrogat prej minimumit deri më 1 300 fr. shq. 2% (dy për qind).

Për rrogat prej 1 300 fr. shq. deri më 2 000 fr. shq. 4% (katër për qind).

Për rrogat prej 2 000 fr. shq. deri në maksimum 6% (gjashtë për qind).

Të gjithë anëtarët e Partisë që janë fshatarë të varfër, ose qytetarë të varfër dhe që nuk marrin rrogë duhet të paguajnë si kuotizacion minimumin 10 fr. shq., fshatarët e mesëm ose qytetarë të kësaj kategorie paguajnë 20 fr. shq. dhe fshatarët e pasur ose qytetarët e këtij lloji duhet të paguajnë 50 fr. shq. minimumi.

Asnjë anëtar partie për asnjë arësye nuk përjashtohet nga pagesa e detyrueshme e kuotizacionit përveç anëtarëve të Partisë, që janë ushtarë të thjeshtë.

Përveç kuotizacioneve duhet të organizohen fushata të ndryshme për Partinë si në anëtarët e Partisë, ashtu edhe në kandidatët, simpatizantët e miqtë e Partisë.

Në këto fushata që do të bëhen dhe që Partia jonë e shtron për të parën herë këtë çështje, duhet të japin shembullin e mirë më parë shokët e Partisë. Fushata mund të bëhet në të holla, në gjëra me vlerë dhe në pasuri të patundshme, si tokë, godina, e çdo gjë të kësaj kategorie. Të gjitha ndihmat jepen vullnetarisht nga ata që kanë dëshirë të ndihmojnë Partinë. Kjo fushatë nuk duhet të ketë një karakter periodik e të organizuar, por duhet të punohet në të gjithë për të ngjallur dëshirën e madhe për ta ndihmuar Partinë vazhdimisht e në çdo mënyrë.

KOMITETI QENDROR I PKSH

Botohet sipas kopjes që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë

PLENUMI IV I KQ TË PKSH

17 tetor 1945

Plenumi IV i KQ të PKSH u mbledh në Tiranë në tetor 1945. Ai analizoi gjendjen e brendshme dhe të jashtme të vendit, shqyrtoi çështjen e forcimit të mëtejshëm të pushtetit popullor dhe të Frontit Demokratik, lidhur me fushatën për zgjedhjet e Asamblesë Kushtetuese. Gjithashtu plenumi shqyrtoi dhe çështjen e forcimit të mëtejshëm të Partisë. Për këtë ai vendosi të thërriste kongresin e Partisë ku do të aprovohej Statuti i Partisë sonë që në atë kohë mungonte dhe të legalizohej Partia. Në plenum u vendos të ndaheshin për herë të parë taserat e Partisë për të gjithë anëtarët e saj pas një revizionimi të përgjithshëm dhe të imtë të çdo anëtar.

Mirëpo këto vendime të drejta të Plenumit IV të KQ të PKSH për forcimin e mëtejshëm të Partisë u shtrembëruan dhe u sabotuan nga grupi fraksionist i Koçi Xoxes, i cili përmbushte udhëzimet e udhëheqjes revizioniste të PKJ, së cilës nuk i interesonte në asnjë mënyrë forcimi i Partisë sonë, për këtë kongresi i Partisë nuk u mbajt dhe Partia nuk u legalizua ashtu sikurse vendosi ky plenum. Ju desh Plenumit XI të KQ të PKSH, i cili demaskoi ndërhyrjen armiqësore të revizionistëve jugosllavë në punët e brendshme të Partisë dhe të vendit tonë dhe agjentët e tyre në Partinë tonë, Koçi Xoxe e kompani, që të vinte në jetë këto vendime të shkelura të Plenumit IV të KQ të PKSH.

Rezolucioni i këtij plenumi botohet në këtë vëllim.

REZOLUCIONI I PLENUMIT IV TË KQ TË PKSH

17 tetor 1945

Plenumi IV i Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare i mbledhur në një kohë kur vendi ynë shkon drejt normalizimit të gjendjes dhe përpara zgjedhjeve për Asamblenë Kushtetuese, e cila do të hedhë themelet definitive të shtetit shqiptar¹, konstaton:

I

Fitorja mbi Gjermaninë naziste dhe satelitët e saj ishte rezultati i luftës së ashpër që bënë popujt e Evropës dhe të Amerikës me në krye Bashkimin Sovjetik, që ishte faktori kryesor i thyerjes së fashizmit. Forcimi i bllokut antifashist të popujve përparimtarë që solli me vete izolimin e Gjermanisë naziste dhe si konsekuencë thyerjen e saj, u arrit në saje të aleancës së madhe në mes të Bashkimit Sovjetik, Ingliterës dhe Amerikës, aleancë që me gjithë vështirësitë e mëdha qëndroi e pathyer sidomos pse qeveria sovjetike dhe popujt e Bashkimit Sovjetik, me politikën e tyre të drejtë, dhe me luftën e tyre heroike, mposhtën çdo manevër të armikut dhe të reaksionit ndërkombëtar.

1 Themelet e shtetit të ri shqiptar ishin hedhur që me kohë, qysh gjatë Luftës nacional-çlirimtare. Në Kongresin e Përmetit u zgjodh Këshilli i Përgjithshëm Antifashist Nacional-Çlirimtar i Shqipërisë dhe Komiteti Antifashist N.-Çl. me atributet e një qeverie provizore. Këshilli i Përgjithshëm Antifashist në tetor 1944, në mbledhjen që ai mbajti në Berat, vendosi kthimin e Komitetit Antifashist në një Qeveri Demokratike Provizore të Shqipërisë. Kurse Asambleja Kushtetuese e zgjedhur në dhjetor 1945 sanksionoi në mënyrë solemne fitoret e luftës së popullit shqiptar. Më 11 janar 1946 ajo shpalli Shqipërinë Republikë Popullore; në mars 1946 aprovoi Statutin themeltar (kushtetutën) të shtetit të ri shqiptar si dhe qeverinë definitive demokratike popullore të vendit tonë.

Pas luftës në Evropë, ku vazhdon përpjekja për vendosjen e një paqëje të drejtë, gjendja nuk është kthjelluar ende si duhet. Reaksioni ndërkombëtar që gjatë luftës pësoi disfata, tashti po rigrumbullon forcat e tija për të fituar pozitat e humbura dhe për të ndaluar vendosjen e demokracisë së vërtetë popullore. Përpjekjet nga ana e reaksionit ndërkombëtar, për të shpëtuar dhe ndihmuar mbeturinat e fashizmit janë të dukshme dhe të mëdha. Kundrejt këtyre përpjekjeve të reaksionit, Bashkimi Sovjetik dhe popujt e shtypur e përparimtarë të Evropës që me luftën e tyre arritën të vendosin në vendet e tyre pushtetin demokratik popullor, si dhe gjithë njerëzit përparimtarë të botës po zbatojnë një politikë të drejtë, e cila ka për qëllim sigurimin e paqes së drejtë, shfarosjen e mbeturinave të fashizmit, mbajtjen dhe forcimin e aleancës së madhe antifashiste të lidhur në luftë, vëllazërimin e popujve përparimtarë, forcimin e demokracisë dhe mbrojtjen e sovranitetit dhe të vetëvendosjes së popujve.

Populli ynë u hodh pa rezerva në luftën kundër fashizmit krah për krah bllokut të madh antifashist të popujve përparimtarë dhe fitoi. Ne çliruam vendin nga okupatorët dhe tradhëtarët, vendosëm pushtetin popullor. Tok me okupatorin, «Balli Kombëtar», «Legaliteti» dhe grupi i kuislingëve të tjerë, që përfaqësonin dhe grumbullonin në gjirin e tyre reaksionin e vendit tonë, pësuan një disfatë të madhe ushtarake dhe politike. Me çlirimin e Shqipërisë, pushteti ynë u përforcua, dhe bashkimi i popullit shqiptar, i realizuar gjatë luftës në Frontin Nacional-Çlirimtar, gjeti shprehjen e vërtetë dhe realizimin më të përsosur në Frontin Demokratik — organizata politike e popullit tonë, e masave të gjera përparimtare.

Mbeturinat e fashizmit dhe të reaksionit, të topitura nga fitorja jonë, qëndronin latente, pa forcë dhe ndihmë, të çorientuara dhe të çarmatosura duke pritur zhvillimin e ngjarjeve që të mëkëmben dhe të riorganizohen. Ligjet dhe reformat e mëdha të pushtetit tonë i afruan dhe i lidhën dhe më tepër rreth pushtetit masat e gjera të popullit, të cilat me besim të madh po shohin të realizohen aspiratat e tyre. Nga ana tjetër kjo ngjalli natyrisht dhe rezistencën pasive të elementit reaksionar dhe të gjithë atyre që shihnin se po prekeshin interesat e tyre. Manevra e reaksionit ndërkombëtar, qëndrimi i disfavorshëm i Ingliterës dhe i Shteteve të Bashkuara karshi qeverisë dhe popujve përparimtarë që në luftë e sipër ngritën në vendin e tyre pushtetin popullor dhe veçanërisht për vendin tonë, vonesa e njohjes së qeverisë, u dhanë zemër mbeturinave të fashizmit dhe të reaksionit në vendin tonë të manifestojnë prezencën e tyre. Rreth atyre që kanë qenë kurdoherë vegla e armikut të jashtëm dhe e armiqve të popullit, por që kanë mundur të fshehin fytyrën e tyre të vërtetë, reaksioni përpiqet të grumbullojë çifliksahibinjte, tregëtarët e mëdhenj, pseudointelektualët reaksionarë dhe të gjithë të pakënaqurit, për të

krijuar një forcë opozite kundër pushtetit dhe Frontit tonë. Kjo tentativë e reaksionit, ende e papërcaktuar mirë në konturet e saj, shpresën më të madhe e ka te reaksioni i jashtëm dhe tek manevrat e kuislingëve shqiptarë dhe shokëve të tyre që ndodhen në mërgim. Nga ana tjetër, brenda në Frontin tonë ekzistojnë akoma në mënyrë latente elementë, të cilët, nën flamurin e Frontin Demokratik dhe duke nxjerrë dobësinë e tyre përpara forcës së madhe të Frontit, përpiqen të forcojnë pozitat e tyre brenda në Front për të krijuar në momente më të përshtatshme për ta, partinë e tyre, brenda në Front ose në opozitë me Frontin.

Gjendemi, pra, përpara dy taktikave të ndryshme të reaksionit të brendshëm, i cili, i ndihmuar indirekt nga reaksioni i jashtëm, përpiqet të dobësojë pushtetin tonë dhe të çajë unitetin tonë kombëtar. Përpara zgjedhjeve të përgjithshme për Asamblenë Kushtetuese, që do të jetë vendimtare për vendin tonë, pse do të caktojë formën e regjimit dhe do të bëjë statutin themeltar të shtetit, Partia dhe populli ynë kanë sot përpara detyra të mëdha historike. Këto detyra të mëdha politike janë:

a) Duke u ruajtur nga provokacionet e jashtme, duke u përpjekur të forcojmë miqësinë dhe vëllazërimin e popullit tonë me gjithë popujt përparimtarë, duke u përpjekur të ndihmojmë forcimin e aleancës së madhe antifashiste, të vëmë gjithë forcat tona për mbrojtjen e paqes.

b) Të jemi kurdoherë në pararojë për mbrojtjen e indipendencës sonë dhe të demokracisë së vërtetë, flamurtari i së cilës është Bashkimi Sovjetik.

c) Të forcojmë unitetin politik të popullit tonë duke e bërë Frontin Demokratik një realitet të madh ku të rreshtohet i gjithë populli, ku të kenë vend të gjitha tendencat politike përparimtare që janë qind për qind për zbatimin e plotë të programit të Frontit.

d) Të forcojmë dhe të modernizojmë pushtetin tonë dhe ta bëjmë atë sa më tepër demokratik. Ky pushtet të bëhet arma më e fortë në duart e popullit dhe të zgjidhë drejt të gjitha problemet e vendit në të gjitha lëmet e aktivitetit social, ekonomik dhe kultural.

e) Zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese të marrin formën e një plebishiti të madh ku gjithë populli të marrë pjesë aktive dhe ku i gjithë populli, i madh e i vogël, të shohë qartë se vija politike e Frontit dhe organizimi ynë i shëndoshë janë e vetmja rrugë që siguron indipendencën, demokracinë dhe përparimin e vendit tonë.

f) Të kuptojmë mirë vijën tonë politike dhe ta adaptojmë si duhet këtë vijë me rrethanat e ndryshme pse kështu ne do të jemi në gjendje të kuptojmë lodrën e reaksionit, ta izolojmë këtë nga masat e popullit, të shpartallojmë grumbullimet e tij dhe të forcojmë pozitat tona.

II

Partia jonë që lindi dhe u organizua në luftë kundër okupatorit u bë faktori kryesor për organizimin e Frontit të përbashkët politik të popullit shqiptar, për ngritjen e pushtetit popullor dhe të ushtrisë popullore. Partia jonë u bë shembull heroizmi, organizimi dhe qartësie politike për gjithë popullin tonë dhe me të gjitha mungesat që ka pasur Partia e kreu detyrën e saj në këtë periudhë.

Po në nëntor 1944 në prakun e çlirimit të Shqipërisë Partia jonë u gjend përpara një situatë të re: lufta e armatosur për çlirimin e Shqipërisë, që po merrte fund, u la vendin problemeve të mëdha politike dhe ekonomike të lidhura me ngritjen e një shteti demokratik dhe me realizimin e aspiratave shekullore të popullit shqiptar.

Në këtë situatë Partia mund të mbante pozitat e saja drejtuese në Front, në ushtri dhe në pushtet vetëm duke forcur kurdoherë më tepër këto pozita, vetëm duke zhdukur në radhët e saja sektarizmin dhe oportunizmin, lëkundjet nga sektarizmi në oportunizëm që shfaqeshin në çështjet politike dhe organizative. Ajo mund t'i mbante dhe t'i forconte këto pozita, që ishin të domosdoshme për sigurimin e independencës dhe demokracisë në Shqipëri, vetëm duke zhvilluar në radhët e saja një kritikë dhe autokritikë të shëndoshë bolshevike, duke u riorganizuar mbi bazat e një centralizmi demokratik të shëndoshë, duke bërë një politikë rekrutimi në drejtimin e përmirësimit të kompozicionit social të saj, duke ngritur dhe edukuar kuadrot e saj në frymën marksiste-leniniste, duke i armatosur këta kuadro me një disiplinë të hekurit dhe të vetëdijshme, shkurt duke u forcur dhe bolshevizuar.

Nga Berati gjer më sot Partia jonë ka vajtur përpara në këtë drejtim, por përgjithësisht kthesa akoma nuk është realizuar. Është e vërtetë se në këtë kohë edukata politike marksiste e kuadrove të Partisë është përmirësuar, po megjithatë organizatat e Partisë sonë shumë herë nuk janë akoma në gjendje të mendojnë sipas metodës marksiste-leniniste dhe të veprojnë me stilin bolshevik.

Është e vërtetë se në Parti dhe në gjithë organizatat e saja është dënuar dhe luftuar sektarizmi dhe oportunizmi në çështjet politike (në pushtet, në front, në ushtri etj.) po megjithatë praktikisht lëkundjet në zbatimin e vijës politike akoma nuk janë zhdukur dhe në radhë të parë sektarizmi qëndron akoma në këmbë.

Është e vërtetë se në këtë kohë është shtuar numri i anëtarëve, të Partisë (370 për qind) është përmirësuar kompozicioni social i saj, janë forcur lidhjet e forumeve të larta me organizatat e bazës, janë shtuar kuadrot udhëheqës nga shtresat e ulta, po përgjithësisht riorganizimi i Partisë mbi bazat e një centralizmi

demokratik të shëndoshë dhe çështjet e një kritike dhe autokritike të shëndoshë bolshevike janë akoma një problem i madh për Partinë.

III

Në lidhje me bolshevizimin e Partisë dhe me legalizimin e saj si parti, Plenumi IV i Komitetit Central vendosi të thërresë kongresin e Partisë ku do të aprovohet programi dhe Statuti i Partisë dhe do të zgjidhet Komiteti i ri Qendror. Si konditë e domosdoshme për thirrjen e kongresit dhe legalizimin e Partisë Plenumi IV e pa me vend që të ndahen kartat¹ e Partisë për gjithë anëtarët e saj, pas një revizionimi dhe studimi të përgjithshëm dhe të imët të çdo anëtari; të organizohet, përveç komisionit të kuadrove dhe komisionit organizativ e të instruktorëve, edhe komisioni i kontrollit për të disiplinuar dhe për të organizuar kontrollin e Partisë mbi punën e gjithë anëtarëve të saj si dhe mbi zbatimin e drejtë të vijës politike nga ana e çdo anëtari dhe nga ana e gjithë organizatave të Partisë.

Si përgatitje për thirrjen e kongresit nga pikëpamja politike, Plenumi IV e quajti të domosdoshme të bëhet një luftë sistematike për forcimin e disiplinës dhe konspiracionit në Parti, për vijën e drejtë të Partisë kundër lëkundjeve nga sektarizmi në oportunizëm edhe viceversa, kundër lëkundjeve nga një ekstrem në një tjetër që janë dy aspekte të ndryshme të shtrembërimit të vijës politike të Partisë.

IV

Në lidhje me zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese dhe fushatën elektorale, Plenumi IV vendosi që Partia të mobilizojë gjithë forcat e saja për të shpjeguar rëndësinë e madhe historike të këtyre zgjedhjeve në popull, për t'i shpjeguar popullit ligjën elektorale si në parim ashtu edhe nga pikëpamja e procedurës praktike, për të shpënë gjithë popullin në votime, për të popullarizuar realizimet e pushtetit demokratik, për të mobilizuar gjithë popullin rreth programit të Frontit Demokratik dhe rreth kandidatëve të tij.

Këto zgjedhje duhet të bëhen një shkollë e madhe politike për

¹ Teserat.

gjithë popullin, për gjithë Frontin dhe për Partinë. Këto zgjedhje janë një provë e madhe për gjithë popullin shqiptar, për të gjitha organizatat antifashiste, për gjithë Frontin Demokratik, për çdo anëtar partie, për të gjitha organizatat e Partisë, për gjithë Partinë.

Botohet sipas broshurës:

**«Rezolucioni i Plenumit IV
të Komitetit Qendror të PKSH»**

Tiranë, 1945

PLENUMI V I KQ TË PKSH

21 shkurt 1946

Plenumi V i KQ të PKSH u mbledh në Tiranë më 21 shkurt 1946. Ai u mbledh posaçërisht për të marrë në shqyrtim shfaqjet e theksuara oportuniste në punën e Partisë dhe të shtetit tonë të ri, të rrjedhura nga qëndrimi dhe nga veprimtaria antiparti e Sejfulla Malëshovës, në atë kohë ish-anëtar i Byrosë Politike të KQ të PKSH, si dhe për të caktuar detyra të reja në lidhje me rindërtimin dhe ndërtimin socialist të vendit.

Raportin kryesor në këtë plenum e mbajti shoku Enver Hoxha.

Përpara se të mblidhej plenumi, shfaqjet e theksuara oportuniste të Sejfulla Malëshovës ishin shqyrtuar dhe ishin dënuar në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH, të datës 6-11 dhjetor 1945. Në këtë mbledhje Sejfulla Malëshova hodhi poshtë të gjitha konkluzionet e Byrosë Politike të KQ dhe vazhdoi rrugën e tij antiparti. Plenumi u solidarizua plotësisht me konkluzionet e Byrosë Politike të KQ, e dënoi rëndë oportunizmin e Sejfulla Malëshovës dhe e përjashtoi atë nga Byroja Politike dhe nga KQ i PKSH.

Në atë kohë në vendin tonë ishin nacionalizuar vetëm pasuritë e kapitalistëve të huaj dhe të tradhëtarëve të vendit, ndërsa pasuritë e kapitalistëve të tjerë ishin të panacionalizuara. Prandaj plenumi vuri si detyrë urgjente vënjen në duart e punonjësve edhe të pasurive të kapitalistëve të mëdhenj të vendit. U caktuan gjithashtu detyra konkrete për të shpejtuar rindërtimin e ekonomisë së shkatërruar.

Plenumi vuri si detyrë forcimin edhe më të madh të lidhjeve me Bashkimin Sovjetik, duke e quajtur atë garancinë e madhe për ruajtjen e pavarësisë dhe të pushtetit tonë popullor.

Plenumi V i KQ të PKSH vendosi që Kongresi I i PKSH të thirrej më 25 maj 1946. Por kongresi i Partisë nuk u mbledh në afatin e caktuar nga ky plenum, ai u shty për një kohë të pacaktuar për shkak të ndërhyrjes së udhëheqjes së revizionistëve jugosllavë, e cila me çdo mënyrë përpiqej ta mbante Partinë tonë të lidhur pas qerres së ish-Partisë Komuniste Jugosllave.

NGA KONKLuzionET DHE VENDIMET E PLENUMIT V TË KQ TË PKSH

21 shkurt 1946

I

... Plenumi konstatoi se në Byronë¹ ka pasë kundërshtime që janë bërë dita-ditës më të thella, sikundër shpjegohet dhe në konkluzionet e mbledhjes së Byrosë datë 6-11 dhjetor 1945.

Plenumi konstatoi se ai që i ka dhënë tonin kësaj vije, ai që ka formuluar dhe që ka mbrojtur deri në fund tendencat oportuniste është Sejfulla Malëshova, i cili edhe në mbledhjen e plenumit shfaqti rezervat e tija, veçanërisht përsa i përket politikës ekonomike dhe Frontit.

Plenumi vendosi me unanimitet përjashtimin e Sejfulla Malëshovës nga Komiteti Qendror.

II

Masat punonjëse dolën në krye të Luftës nacional-çlirimtare. Gjatë luftës u bë, në forma të përgjithshme, një diferencim i madh në vendin tonë: klasat sunduese u bashkuan me okupatorin. Lufta u drejtua edhe kundër tyre. Kështu lëvizja nacionale u bë edhe lëvizje kundër klasave sunduese për pushtetin popullor. Në rrethana të reja, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste, u krye revolucioni popullor, që përfundoi në çlirimin e Shqipërisë, në krijimin e një ushtrie popullore, në marrjen e pushtetit nga masat punonjëse.

Ne kemi në vendin tonë një diktaturë demokratike revolucionare të punëtorëve dhe të fshatarëve me Partinë Komuniste në krye.

Çështja është tashti që të kalojë në duart e masave punonjëse baza e pushtetit, ekonomia. Partia duhet t'i bëjë masat punonjëse,

¹ Byronë Politike të KQ të PKSH.

që kanë pushtetin në dorë, të luftojnë kundër klasave që ishin dje në fuqi, feudalëve dhe borgjezisë, të cilët kanë akoma pozita me rëndësi në duart e tyre.

Çështja është që Partia ta udhëheqë popullin për në transformimin social dhe ekonomik të vendit, ta udhëheqë për në socializëm.

Ne jemi në rrugën e socializmit, por socializmi nuk është një çështje ditësh për ne. Se sa shpejt do të mbërrijmë ne aty ajo varet nga raportet ndërmjet forcave progresive dhe reaksionare dhe nga puna jonë. Është e nevojshme të shfarosim armikun e klasës, të rindërtojmë vendin, të ngremë një ekonomi të re dhe të përparuar në dorë të shtetit të ri, të masave punonjëse, që të mund të shkojmë në socializëm.

Në zbatimin e vijës së saj Partia duhet të drejtojë punën veçanërisht në këto dy objektiva:

1. — *Rindërtimi i vendit.* Vendi është shkatërruar nga lufta, prodhimi është ulur, niveli i jetës ka rënë. Çështja për ne nuk është që të vëmë në vend vetëm çka shkatërroi lufta, por edhe të ndërtojmë një jetë më të mirë. Bashkë me rindërtimin ekonomik duhet të zhvillohet e tërë jeta jonë nga ana shoqërore, kulturele etj.

Populli ynë ka nevojë për më shumë bukë, për më shumë kulturë. E tërë puna të zhvillohet për të mirën e masave punonjëse dhe për likuidimin e klasave që kanë sunduar deri dje. E tërë puna të ketë vulën e perspektivave tona për ndërtimin e socializmit.

Partia duhet të mobilizojë të gjitha forcat e saja për rindërtimin e vendit. Detyra kryesore e Partisë është të mobilizojë masat punonjëse për një jetë më të mirë.

Të zhvillohen gara nga të katër anët e Shqipërisë për punën e rindërtimit.

Të mobilizohet populli për punë vullnetare, që është [një] faktor kryesor për rindërtimin e Shqipërisë.

Të kemi mirë të qartë se kur masat punonjëse e shohin konkretisht se puna shkon në favor të tyre, ato janë gati të bëjnë çdo sakrificë.

2. — *Çështja e kuadrove.* Pa kuadro të zot Partia nuk mund të përmbushë detyrat e saja. Duhet kuadro që të kenë në zemër çështjen e socializmit, kuadro që të dinë të luftojnë frymën e vjetër dhe të punojnë me perspektivat tona.

Edukimi i kuadrove duhet të jetë nën kujdesin më të madh të Komitetit Qendror. Kuadrot duhet të zgjidhen mirë, të edukohen dhe të kontrollohen në punë. Duhet t'u japim më tepër kulturë dhe sidomos kulturë marksiste. Të kemi të qartë se kush i kupton

më mirë ato çka na mëson Stalini, punon më mirë dhe gabon më pak.

Të jetë mirë e qartë se që t'i shërbesh mirë Partisë sot duhet të jesh i zoti për pushtetin e ri, për ekonominë tonë të re, për ushtrinë tonë, për kulturën, duhet të jesh i zoti t'i shërbesh konkretisht vendit.

Partia jonë nuk ka nevojë për ushtarë që nuk janë të zot të luftojnë.

Kush punon më shumë dhe më mirë për rindërtimin e vendit, kush është organizator i mirë, kush mejton dhe punon mirë, ai është kuadër i mirë i Partisë.

Të ngjallet inisiativa dhe emulacioni në radhët e Partisë.

Nga masat punonjëse dhe veçanërisht nga proletariati, ata që dallohen në rindërtimin e vendit për zellin e tyre, për zotësinë, për inisiativën dhe për ndërgjegjen në punë, ata duhet të mbushin radhët e Partisë sonë. Ky duhet të jetë një kriter i shëndoshë për rekrutimin në radhët e Partisë dhe për spastrimin e saj.

Populli duhet të mësohet dhe të bëhet i zoti të punojë.

* * *

Plenumi konkludoi se Partia duhet të ketë një plan pune për të gjithë sektorët e jetës. Plani duhet të mbështetet në një vijë të qartë për çdo sektor.

1. — *Ekonomia.* Minierat të jenë të gjitha të shtetit. Të orientohemi për kalimin e shpejtë të industrisë në dorë të shtetit. Të organizohemi drejt përqëndrimit të industrisë me plan. Të zhvillohen në maksimum kooperativat. Me politikën tonë me kooperativat ne duhet, nga një anë, të luftojmë spekulimin në dëm të konsumatorit dhe të prodhuesit të vogël, dhe nga ana tjetër, të shtojmë prodhimin. Të ndalohen të gjitha ato kooperativa prodhimi me tendenca monopoliste, të cilat janë në favor të pronarëve që kërkojnë të bëjnë kapitale. Shteti të shtjerë në dorë tregëtinë e jashtme dhe tregëtinë e madhe të brendshme me anë entesh speciale, të cilat të shërbejnë edhe për kontrollin dhe rregullimin e tregëtisë së vogël. Shteti të ushtrojë kontroll të rreptë mbi sektorin privat dhe ta kufizojë këtë gjithnjë më tepër.

Spektori i shtetit të mos kufizohet në çka u merret privatëve, por të zmadhohet duke krijuar miniera, industri dhe ndërmarrje të reja. Shtetëzimet të mos pakësojnë prodhimin, por ta shtojnë.

Parulla është: të prodhohet sa më tepër.

Parulla është: të përmirësohet prodhimi.

Të ruhet me kujdesin më të madh pasuria e shtetit dhe e gjithë

pasuria e vendit, pse ajo është, ose do të kalojë dita-ditës në duart e popullit.

Të zhvillohet ndjenja e kursimit.

2. — *Bujqësia.* Pasuria jonë kryesore është bujqësia, prandaj forcat tona në një pjesë të madhe do t'i dedikohen asaj. Ne synojmë të bëhemi një vend industrial-agrar. Industria jonë, së paku për një kohë, do të mbështetet në bujqësinë dhe në blegtorinë. Detyrat tona në bujqësi janë:

a) Përfundimi i shpejtë i reformës agrare pa dallavere në kurriz të bujqve dhe të fshatarëve të varfër.

b) Shtimi i prodhimit duke organizuar dhe favorizuar punën kolektive dhe kooperativat, duke bërë fushatë për shtimin e veglave të prodhimit dhe duke i vënë këto në dispozicion të fshatarëve, duke organizuar kreditin.

c) Përmirësimi dhe bonifikimi i tokave.

Ne duhet të mobilizohemi për të bërë vetë bukën. Parulla jonë është të mbjellim sa më tepër. Një garë e madhe duhet të zhvillohet në këtë drejtim.

Duhet të bëhet një politikë e drejtë për ruajtjen dhe zhvillimin e pyjeve dhe të blegtorisë.

Me politikën tonë në bujqësi të luftojmë çdo tendencë për zhvillimin e kulakëve.

3. — *Punët botore.* Fshatrat tona kanë nevojë për shtëpi, pse armiku i dogji. Krahinat tona kanë nevojë për rrugë të vogla dhe të mëdha për ekonominë dhe përparimin e tyre. Ne kemi nevojë për rrugë strategjike. Vendi ynë ka nevojë për shkolla, spitale etj.

Të rekuizohet dhe të grumbullohet i tërë materiali i konstrukcionit që është në dorë të tregëtarëve dhe të ndërmarrjeve private dhe të përdoret në bazë të një plani. Të zhvillohet në maksimum industria për lëndë konstruksioni.

Të mobilizohet populli dhe të ndihmohet nga qeveria për punë botore në krahina të ndryshme.

4. — *Financa.* Financa jonë duhet të qëllojë atje ku ka. Duhet të mbështetet në zhvillimin e ekonomisë sonë dhe të shkojë në harmoni me të. Nuk duhet harruar se nevojat e vendit tonë tani nuk mund të përballohen kurrë vetëm me buxhetin që kemi. Ato do të përballohen me një pjesë të madhe nga puna vullnetare, nga inisiativa, nga sakrificat dhe nga ndihmat e popullit dhe të kuadrove tanë.

5. — *Statistika.* Në çështjet ekonomike dhe në të gjitha çështjet tona duhen statistika të sakta. Pa statistika nuk mund të

bëhen plane të punës dhe nuk mund të kontrollohet puna. Statistika është e lidhur me rregullin dhe me saktësinë në punë.

Partia duhet të mobilizohet për rregullimin e statistikave në të gjithë vendin tonë dhe në të gjitha punët.

6. — *Kultura.* Duhet të ngrihet niveli i kulturës së popullit tonë që të mund të prodhojmë më shumë dhe më mirë, që të shkojmë më shpejt në socializëm. Ne kemi nevojë për atë kulturë që ta bëjë popullin më të zot të punojë, kemi nevojë për atë kulturë që t'i shërbejë më tepër rrugës sonë. Prandaj ne duhet të luftojmë në fushën e kulturës çdo gjë që pengon këtë. Ne duam që kultura të jetë e masave punonjëse.

Partia duhet të mobilizohet për të zhdukur analfabetizmin.

Duhet të shumëzohen shkollat fillore dhe të zgjidhet përkohësisht problemi i mësuesve duke krijuar kurse të shpejta për mësues.

Duhet t'u hapen dyert e shkollave të mesme masave punonjëse të rinisë së qytetit dhe të fshatit. Më shumë vajza në shkollë.

Të sigurohet vazhdimi i shkollës, sidomos me shkolla nate, për ata që nuk mund të lenë punën, qofshin të rinj ose të shkuar nga mosha.

Të bëhet reforma e shkollës dhe të ndryshohen programet.

Të organizohen dhe të zhvillohen në maksimum kurse për teknikë. Paralel me kurset e rregullta dhe të kategorisë së parë të marrë hov zhvillimi i kurseve të vogla dhe të shpejta në çdo vend ku punohet.

Të dërgohen jashtë, në Bashkimin Sovjetik dhe në Jugosllavi, në kurse specializimi dhe në universitete kuadrot që premtojnë më tepër.

Teatri, radioja, kinemaja t'i shërbejnë propagandës sonë dhe të zhvillohen në mënyrë që të lartësojnë nivelin kultural të masave punonjëse.

Shtëpitë e kulturës të shumëzohen, por të organizohen si qendra për të përhapur kulturën dhe jo si janë sot.

Të botohet më shumë, por në drejtim që të mësohen si të jetojnë dhe si të punojnë më mirë masat punonjëse.

Sporti dhe edukata fizike përgjithësisht të jenë në bazë të politikës sonë për edukimin e brezit të ri. Duhet që edukata fizike të jetë për të gjitha masat e rinisë, në mënyrë që nga ato të dalin punëtorë dhe luftëtarë të zot për Shqipërinë e re, për ndërtimin e socializmit.

Masat punonjëse kanë nevojë për çlodhje dhe ta gëzojnë jetën. Ne duhet të mendojmë për dëfrimin e tyre. Ky duhet t'i shërbejë lartësimit kultural dhe shëndetit të tyre. Prandaj parulla duhet të jetë sot: më pak pijetore, më pak kafene dhe më shumë klube kulture, më shumë teatro, më shumë shoqëri dhe fusha sportive.

7. — *Masat shoqërore.* E gjithë politika jonë duhet të përkrahë masat punonjëse. Në radhë të parë ajo duhet të drejtohet në mënyrë që t'u garantojë atyre punë.

Të ndalohet shfrytëzimi i punëtorëve dhe të rregullohet shpërndarja e tyre në punë sipas mundësive të tyre, veçanërisht përsa u përket grave dhe të vegjëlve.

Të organizohet enti i sigurimeve dhe të merren masa për fatkeqësitë në punë.

Të ngrihen shtëpi pushimi për masat punonjëse.

Të organizohen maternitete për gratë e popullit.

Të respektohet tetëorëshi në punë, 15 ditë pushimi në vit dhe 2 muaj pushim për gratë, një muaj para lindjes dhe një muaj pas lindjes.

T'u sigurohet një jetë e denjë invalidëve të luftës dhe të organizohen fushata për të ndihmuar krahinat më të dëmtuara nga lufta.

8. — *Shëndetësia.* Të zhvillohet një propagandë e madhe për higjienën e popullit.

Të organizohen kurse për infermierë.

Të mobilizohet kadri i shëndetësisë.

Të hapen sa më tepër ambulanca në fshat.

Shteti të organizojë shpërndarjen e materialit farmaceutik dhe të shkojmë shpejt drejt krijimit të monopolit të shtetit në këtë fushë.

*
*
*

1. — Që të mundë vendi ynë të shkojë në këtë rrugë aparati i pushtetit duhet të bëhet më tepër i masave punonjëse. Kjo është arësyeja për të cilën Partia duhet të mobilizojë tani masat për zgjedhjet lokale. Njerëzit që do të dalin në këshillat dhe në komitetet ekzekutive duhet të jenë nga gjiri i masave punonjëse, duhet të jenë për rrugën tonë, duhet të jenë të palodhshëm në punë.

Duhet spastrimi i aparatit të shtetit nga elementët sabotatorë dhe kundërshtarë.

2. — Të mos harrojmë se vendi ynë është i kërcënuar nga imperialistët. Për këtë arsye Partia duhet të jetë e mobilizuar për mbrojtjen e atdheut tonë, për mbrojtjen e shtetit tonë të ri. Ndjenja e mbrojtjes nga imperialistët e huaj dhe nga veglat e tyre të brendshme duhet të jetë e gjallë dhe të forcohet gjithmonë më tepër në popullin tonë. Gjithsecili duhet të ruajë sekretin e punës së tij, sekretin e jetës së vendit tonë. Të huajve të mos u thuhet

dhe të mos u jepet kurrëgjë. Dashuria për atdheun, për shtetin tonë të ri duhet të jetë detyra kryesore e masave punonjëse.

Ne duhet të përpiqemi për forcimin e ushtrisë sonë. Në radhë të parë ushtria duhet spastruar nga fryma e vjetër dhe të jetojë me vijën e Partisë. Ushtarët dhe oficerët tanë të kenë të qartë misionin e tyre dhe, me shpirt sulmues, të jenë gati të mbrojnë realizimet tona.

Ushtria të modernizohet në bazë të eksperiencës së Ushtrisë së Kuqe dhe të bëhet një shkollë për ushtarët dhe oficerët tanë. Disiplina të zhvillohet në maksimum.

Populli ynë duhet të kuptojë mirë se ç'rrezik janë për vendin tonë imperialistët e huaj. Për këtë arsye Partia duhet të zhvillojë urrejtjen kundrejt tyre. Nuk mund të jenë në radhët e Partisë sonë ata që nuk kuptojnë dhe nuk mobilizohen kundër këtij rreziku.

3. — Ne do t'u ruhem provokacioneve të imperialistëve dhe të veglave të tyre, por do të mbrojmë dhe do të kërkojmë të drejtat tona haptas dhe pa bërë lëshime.

Politika jonë do të orientohet nga Bashkimi Sovjetik. Partia duhet të mobilizohet që t'i bëjë të qartë popullit se çfarë ka bërë Bashkimi Sovjetik për ne.

Populli ynë duhet të kuptojë se Bashkimi Sovjetik është garancia më e madhe e independencës dhe e pushtetit tonë popullor. Politika jonë të orientohet drejt një vëllazërimi më të ngushtë dhe më konkret me Jugosllavinë Demokratike Federative...

* * *

Për të kryer detyrat e saja Partia duhet të mobilizojë të gjitha masat punonjëse. Këtë do ta bëjë me anën e Frontit, sindikatave dhe të gjitha organizatave antifashiste.

1. — *Fronti*. Programi i Frontit është të bashkojë, të organizojë dhe t'i aktivizojë masat punonjëse në vijën e Partisë. Bashkimi politik i masave të popullit duhet të bëhet me punën konkrete për ndërtimin e Shqipërisë së re në rrugën e socializmit. Në këtë punë duhet të bëhet edhe spastrimi i radhëve të Frontit, lufta kundër reaksionit.

2. — *BRASH-i*. Bashkimi dhe aktivizimi i rinisë në vijën e Partisë.

Masat e rinisë janë më larg mentalitetit të vjetër reaksionar. Prandaj Partia duhet t'i shfrytëzojë më tepër energjitë e tyre.

Organizata e BRASH-it duhet të jetë një mbështetje e madhe për shtetin tonë, për përhapjen e kulturës.

Partia duhet të kërkojë nga masat e rinisë sot punë vullnetare për rindërtimin e vendit dhe punë për ngritjen e nivelit kultural të tyre. Duhet të kërkojë kuadro për shtetin tonë dhe për të zmadhuar dhe forcuar radhët e saja.

3. — *Gruaja antifashiste*. Bashkimi dhe aktivizimi i masave të grave në vijën e Partisë.

Gjendja e vështirë e gruas sot në Shqipëri i vë përpara Partisë detyra të rënda. Me politikën e saj Partia jonë sot duhet të ketë kujdes që të gjitha punët të shërbejnë për zgjidhjen e problemeve të gruas.

Të luftohet fanatizmi. Më tepër kulturë për masat e grave. Të organizohet dhe të zhvillohet pjesëmarrja e gruas në prodhim.

4. — *Sindikatat*. Bashkimi dhe aktivizimi i punëtorëve dhe i nëpunësve në vijën e Partisë.

Klasa punëtore duhet të ketë një rol udhëheqës në shtetin tonë.

Sindikatat duhet të bëhen një mbështetje e madhe për zhvillimin e ekonomisë sonë. Sot roli i tyre është të shtojnë dhe të kontrollojnë prodhimin, të mobilizojnë punëtorët dhe nëpunësit për punë vullnetare dhe të edukojnë veçanërisht në radhët e proletariatit, kuadro të zot për ekonominë, për shtetin dhe për Partinë tonë.

* * *

Që Partia të mundë t'i kryejë me sukses këto detyra duhet të organizojë mirë radhët e saja. Të organizohen seksionet pranë Komitetit Central dhe të rregullohen të gjitha organizatat bazë dhe forumet në bazë të vijës sonë organizative.

Të zbatohet mirë principi i centralizmit demokratik.

Puna të organizohet dhe të kontrollohet kudo në bazë të një plani.

Byroja të punojë me anëtarët e tjerë të plenumit dhe me kuadrot e tjerë që tregohen të zot. Kjo frymë duhet të jetë në të gjitha organizatat.

Duhet të forcohet agjit-propaganda. Duhet të kuptohet roli i tij, që është të popullarizojë vijën e Partisë dhe të edukojë ideologjikisht anëtarët e saj.

Partia jonë duhet të spastrohet nga elementët e huaj dhe oportunistët.

Konspiracioni dhe ruajtja e Partisë nga armiqtë është detyrë e çdo anëtar.

Duhet të popullarizohet Partia dhe të zhvillohet në masat punonjëse një dashuri e madhe për të.

Duhet një stil i ri në punë. Duhet të shkunden elementët e plogët. Duhet të luftohen pikëpamjet e ngushta që kufizojnë punën. Drejtuesit nuk duhet vetëm të zbatojnë çka u thuhet, por duhet të kenë inisiativë, të krijojnë punë në vijën e Partisë. Të gjithë anëtarët e Partisë duhet të mësojnë më shumë.

III

Plenumi V vendosi që të thirret Kongresi I i Partisë më 25 maj 1946.

Gjatë kohës deri në kongres Partia duhet të ndreqë gabimet e saj.

Plenumi V vendosi që të thirret Plenumi VI më 25 prill 1946 për të caktuar modalitetet e kongresit.

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

TEZAT PËR RISHIKIMIN E PLENUMIT II TË KQ TË PKSH

Raport i mbajtur në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH¹

9 qershor 1946

Shokë të Byrosë,

Dëshiroj të shtroj përpara Byrosë një çështje që më duket me rëndësi për Partinë tonë. Do të përpiqem t'i peshoj mirë fjalët dhe kërkoj nga ana tjetër që të kuptohen drejt këto fjalë. Këto i them pse përgjegjësitë tona janë të mëdha para Partisë sonë dhe popullit, veçanërisht në këto momente, kur ne vemi për në Kongresin I, ku do të përcaktohet vija e Partisë dhe do të zgjidhet forumi i lartë udhëheqës, Komiteti Qendror. Këtë çështje me rëndësi nuk e shtroj as për të rrëzuar forume dhe as për të rrëzuar shokë, këtë gjë s'na lejohet ta bëjmë pse është në dëm të Partisë, kur këto forume dhe këta shokë janë udhëheqja e shëndoshë e saj, qoftë dhe sikur këto forume ose këta shokë mund të kenë gabuar në gjëra të vogla, po që janë të ndreqshme. Eksperienca e vlefshme e Partisë sonë na tregon se veprime të tilla të pamatura,

1 Pa ditur gjë ende për prapaskenën e Beratit, për komplotin e kurditur nga udhëheqja e PKJ kundër PKSH, për gjithë pjesëtarët e këtij komploti, shoku Enver Hoxha duke i analizuar me syrin e marksistit punimet e Plenumit II të KQ që u mbajt në Berat në nëntor 1944, kishte krijuar bindjen se në këtë plenum vija e Partisë që dënuar pa të drejtë dhe se Plenumi i Beratit ishte bërë burim i një varg dobësish që viheshin re në punën e Partisë. Për këtë arsye ai pregatiti këtë raport që ja paraqiti Byrosë Politike, me anë të të cilit kërkonte të rishikohej plenumi dhe të hidheshin poshtë vendimet e tij.

Këto kërkesa të drejta u kundërshtuan e nuk u pranuan nga Koçi Xoxe e Pandi Kristo. Ata kishin frikë se rishikimi i Plenumit të Beratit do të nxirrte në shesh punën e tyre antiparti dhe ndërhyrjen armiqësore të PKJ në punën e brendshme të PKSH. Edhe Nako Spiru nuk guxoi të zbulonte veprimtarinë e pjesëtarëve në organizimin e prapaskenës.

të bëra pa dashur ose me qëllim, e kanë dëmtuar punën tonë, e kanë penguar zhvillimin normal të saj dhe janë burimi kryesor i lëshimeve ose i të metave që janë konstatuar në punën tonë të përgjithshme. Gabime në Partinë tonë ka pasur dhe do të ketë, pse ajo është një Parti e re, pse shokët, në përgjithësi, s'e kanë akoma pjekurinë e një komunisti të regjur dhe s'e përdorin si duhet dhe sa duhet eksperiencën e madhe të Partisë Bolshevike dhe të Partisë sonë. Kjo s'duhet aspak të na dëshpërojë, pse eksperiencia nuk fitohet dhe nuk vihet në shërbim aq kollaj dhe prej kujtdo. Pikërisht për t'ja mbërritur sa më shpejt dhe mirë kësaj gjëje, unë po shtroj çështjen që do të zhvilloj më poshtë. Do të shtoj dhe një gjë tjetër: aq sa Partia duhet të jetë indulgjente për ata shokë që kryejnë punë të madhe dhe të vlefshme për Partinë, por që edhe gabojnë në punë e sipër, gabime që e ka për detyrë t'ua korrigjojë dhe të mos i lërë të majisen, aq duhet të jetë e ashpër në gjykime dhe në vendime karshi atyre njerëzve që me qëllim kërkojnë të çojnë Partinë në qorrrokak, kërkojnë të dëmtojnë Partinë. Duhet të mësohemi të jemi të matur në vendime dhe në gjykime të çështjeve, të zhvishemi nga pasionet dhe të largohemi nga miqësitë jo të shëndosha, nga simpatitë e sëmura që mund të lindin dhe që e kanë burimin në një punë jobolshevike, të luftojmë paragjykimet, pakënaqësitë dhe hatëret e mbetura, të krijuara dhe të zhvilluara në frymën mikroborgjeze, të veprojmë dhe të punojmë si komunistë, që kanë vendosur të bolshevizojnë Partinë e tyre, shokët e tyre. Që këto çështje të vihen drejt dhe të punohet drejt, ne, komunistët, kemi dy armë të forta që s'i ka kush dhe që bëjnë forcën e Partisë sonë: kritikën dhe autokritikën. Duke pasur kurdoherë parasysh interesin e Partisë, forcimin e saj, bolshevizimin e saj, Partia në çdo moment duhet të bëjë analiza të veprimtarisë së saj, qoftë dhe sikur kjo veprimtari të mos ketë qenë e gabuar. Aq më shumë, në rastet kur bëhen gabime, kjo analizë është e domosdoshme. Në një çështje Partia mund të kthehet shumë herë, në intervale të afërta ose të largëta dhe kjo s'do të thotë aspak se Partia është çoroditur, është tronditur, është dobësuar. Përkundrazi, kjo tregon se Partia jonë është e fortë saqë mund të marrë çdo analizë qoftë dhe të zorshme dhe ta studjojë e ta zgjidhë si duhet; kjo do të thotë se në Partinë tonë që ndërmerri analiza të tilla, ka një unitet të shëndoshë, unitet mendimi dhe organizimi, ekziston disiplina e hekurt dhe e ndërgjegjshme e Partisë, ekziston dashuria e madhe për Partinë dhe për shokët. Në Partinë tonë të thjeshtë dhe të kulluar, e dalë nga një luftë e ashpër, e organizuar dhe e forcuar në zjarrin e kësaj lufte, unë nuk e kam frikën e krijimit të tarafeve, të fraksioneve, në rast se ne mbajmë gjallë dhe i shtojmë dita-ditës cilësitë që përmenda më sipër dhe që bëjnë forcën e Partisë sonë, në qoftë se ne e shtojmë dhe e përmirësojmë nga eksperiencia e fituar

kombativitetin e Partisë sonë, në qoftë se ne dimë të dallojmë të mirët nga të ligjtë, gabimet e mëdha nga të voglat dhe dimë t'u gjejmë ilaçin e përshtatshëm që të dyjave. Unë jam i bindur plotësisht se Partia jonë është në gjendje të veprojë kështu, është në gjendje të ecë në këtë rrugë, që është rruga e bolshevizimit të saj, prandaj unë pa frikë dhe hapët po shtroj përpara jush çështjen që bëra fjalë më sipër.

Veprimtaria e Partisë sonë, që nga ditët e para të krijimit të saj dhe deri tani, mund të ndahet në vija të përgjithshme në dy etapa kryesore: ajo e luftës dhe ajo e çlirimit të Shqipërisë. Në mes të këtyre dy etapave qëndron një datë e rëndësishme: Mbledhja e Plenumit të Komitetit Qendror në Berat. Kjo mbledhje u zhvillua në përfundim të Luftës nacional-çlirimtare që udhëhoqi Partia jonë dhe njëkohësisht në prak të etapës së re të rindërtimit të vendit dhe të qeverisjes së tij në kondita të reja, që do të bëhej përsëri prej Partisë sonë, e cila kishte frenat e komandës në dorë. Pikërisht dëshiroj të bëj një analizë të punimeve dhe të vendimeve që u muarën në këtë mbledhje me rëndësi të Partisë, pse e quaj të domosdoshme që përpara Kongresit I ku do të përcaktohet vija e Partisë dhe do të zgjidhet Komiteti Qendror i saj, të vihen çështjet drejt, që të shkojnë punët drejt.

Ç'duhet të ishte Berati për ne dhe në ç'frymë duhej të zhvilloheshin punimet e plenumit nga një anë dhe, nga ana tjetër, si u zhvilluan ngjarjet në atë mbledhje e ç'vendime dualën andej? Këto dy gjëra do të përpiqem të analizoj për të nxjerrë konkluzionet e mia, të cilat të diskutohen prej Byrosë dhe të merren vendime të caktuara për t'i shtruar përpara Komitetit Qendror të Partisë dhe organizatës.

Plenumi i Beratit s'ishte një mbledhje e rregullt për arësyet e mëposhtme: pregatitja e punimeve të plenumit në Byro nuk ishte objektive as edhe si duhej komuniste. Çështjet në Byro nuk u shtruan në formë shoqërore dhe komuniste, por në formë të prerë dhe të vendosura jashtë Byrosë, pra jo pas një analize të thellë marksiste që mund të bëhesh prej vetë Byrosë, pa pasione dhe pa paragjykime. Çështjet u shtruan brutalisht dhe në një formë «coup d'état»¹ që nuk e lejonin as rrethanat as konditat as metodat e Partisë sonë dhe as do të ngjiste një gjë e tillë, po të ishte bërë si duhej një analizë marksiste e të gjithë veprimtarisë së Partisë deri në prakun e Mbledhjes së Plenumit në Berat. Në mbledhjen e plenumit çështjet u shtruan jo në rrugë të drejtë dhe përpara elementëve të rinj joanëtarë të plenumit, që ishin paravendosur të bëheshin anëtarë të plenumit, gjë që ka pasë konsekuenca të hidhura në zhvillimin e punës së mëvonshme, siç do ta

1 «Coup d'état» (frëngj.) — grusht shteti.

përcaktoj më vonë gjatë ekspozesë sime. Çështjet në Plenumin e Beratit janë shtruar shtrembër dhe, pra, andej dualën edhe një sërë konkluzionesh të gabuara.

Plenumi i Beratit duhej të ishte një mbledhje e domosdoshme, e rëndësishme për Partinë tonë, duhej të bënte një kthesë të madhe në punën tonë dhe në metodat e punës sonë; ai duhej të ishte vazhdimësia e veprimtarisë së lavdishme të Partisë sonë gjatë gjithë kohës së luftës, në një etapë të re plot vështirësi. Plenumi i Beratit duhej të ishte hallka e shëndoshë e këtyre dy etapave. Etapa e luftës para Beratit, ishte gjithë veprimtaria e Partisë sonë, lufta e saj heroike, organizimi dhe forcimi i saj, ishte kryengritja e përgjithshme e popullit, vepra e pavdekshme e Partisë sonë, ishte krijimi i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare që luftoi pa pushim kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, ishte rrëzimi i pushtetit të vjetër dhe hedhja e bazave të pushtetit të ri, ishte shpartallimi i reaksionit, ishte çlirimi i Shqipërisë, ishte marrja e fuqisë nga ana e Partisë sonë dhe mbajtja e kësaj fuqie në mënyrë të shëndoshë. Me një fjalë etapa e luftës, para Beratit, ishte çdo gjë, ku do të mbështetej veprimtaria e ardhshme. Plenumi i Beratit këtë etapë të shkëlqyer e errësoi, e përçmoi, e dënoi. Këtu qëndron gabimi i madh i tij dhe këtu e kanë rrënjën një sërë gabimesh të rëndësishme që janë dukur më vonë në punën tonë. Në etapën e luftës dhe para Beratit kishte gabime në punën tonë, kishte gabime organizimi, kishte sektarizëm dhe oportunistizëm, kishte lëshime dhe të meta, s'kishte stil dhe metodë aq të mirë pune, s'kishte politikë aq të drejtë kuadrosh, por Partia jonë s'kishte gabuar politikisht, vija e Partisë sonë ishte e drejtë dhe jo e gabuar siç pretendoi Sejfulla Malëshova dhe Velimir Stojniçi¹ në Plenumin e Beratit. Partia jonë ishte një Parti Komuniste, e krijuar në zjarrin e luftës dhe që luftoi me heroizëm dhe jo si thoshte Sejfulla Malëshova në Plenumin e Beratit që «ajo s'ishte as marksiste as komuniste». Partia jonë s'ishte një parti «banda kriminelësh» ku «ishin konfonduar puna politike dhe krimi» siç tha Sejfulla Malëshova në Plenumin e Beratit. Udhëheqësit e Partisë Komuniste dhe veçanërisht unë, s'kishim dalë rastësisht siç pretendoi Sejfulla Malë-

¹ Velimir Stojniçi erdhi në Shqipëri në gusht të vitit 1944 me cilësinë e kryetarit të misionit ushtarak jugosllav dhe të ndërlihdhësit midis PKJ dhe PKSH. Duke zbatuar urdhërat e udhëheqjes revizioniste jugosllave ai organizoi prapaskenën e Beratit dhe zhvilloi një veprimtari të theksuar armiqësore kundër udhëheqjes marksiste-leniniste të Partisë dhe të vijës së saj të drejtë. Në këtë kohë, kur shoku Enver Hoxha kritikoi të deleguarin e KQ të PK të Jugosllavisë, nuk ishte zbuluar ende tradhëtia e klikës së Titos. Megjithatë kjo kritikë në fakt drejtohej njëkohësisht edhe kundër vetë udhëheqjes jugosllave.

shova në Plenumin e Beratit, kur ekspozoi teorinë e tij «mbi krejtë dhe kryetarin», por nga lufta e popullit tonë. Por, mbi këto çështje, do të zgjatem më vonë. Plenumi i Beratit s'diti t'i ndante këto gjëra dhe kjo u bë me qëllime nga disa dhe pa qëllime nga disa të tjerë. Detyra e Plenumit të Beratit ishte ta analizonte në mënyrë marksiste gjithë punën tonë, por mjerisht ata që pretendojnë se marksizmin e kanë në gjak dhe e luajnë në majë të gishtërinjve si Sejfulla Malëshova, vepruan në mënyrë antimarksiste dhe antiparti. Plenumi i Beratit duhej të koriggjonte gabimet që ishin bërë, të godiste ashpër atje ku duhej dhe atje ku këto gabime ishin bërë me tendenca, sidomos të vinte drejt çështjen organizative të Partisë, çështjen e politikës së kuadrove; të vinte në dukje dhe të shërbenin si mësim të metat dhe lëshimet që ishin shfaqur në punë dhe të përcaktonte qartë vijën politike dhe organizative që duhej të zbatohet me rigorozitetin dhe pjekurinë më të madhe në etapën pas Beratit. Nga ana tjetër vepra e madhe e Partisë sonë, e cila nuk mund të kryhej në rast se vija politike dhe organizative ishin të gabuara, duhej vënë në dritë dhe ajo duhej të dominonte gjithë punimet e Plenumit të Beratit, gjithë vlerësimin e punës së Partisë. Mirëpo u bë e kundërta. Këtu mbrojt Partinë tonë, prestigjin e Partisë sonë, i cili duhet të jetë një gjë konkrete, reale, që ta shohë, ta ndjejë e të mburret dhe anëtarin më i thjeshtë i Partisë, i cili s'ka kursyer as jetën për këtë gjë. Duke thënë këto gjëra kam për qëllim të vetëm të mbrojt Partinë nga arrivistët dhe jo të mbrojt njerëzit, por edhe njerëzit janë të lidhur me Partinë e sidomos në radhë të parë, udhëheqësit e Partisë.

Në Berat u ndoq një praktikë e gabuar. U dënua vija e Partisë, u dënuan edhe njerëzit që e zbatuan këtë vijë. Plenumi i Beratit hodhi në erë më të shumtët nga ata që organizuan Partinë, që organizuan luftën, që drejtuan Partinë dhe luftën. . .

Në këtë plenum u dënua dhe Liri Gega, dhe unë them se i vetmi dënim që u dha me vend dhe që e meritonte plotësisht, ishte dënimi i Liri Gegës. Puna e Lirisë ishte një punë e sëmure dhe tarafi, plot ambicie dhe tendenca sektare. Ajo s'punonte për Partinë, por për veten e saj, për të forcuar pozitat e saja në Parti. Puna e saj ishte plot gabime të rënda, politike dhe organizative, që s'kishin të bënin aspak me vijën e Partisë, por që Sejfulla Malëshova i bëri kapital për të goditur Partinë dhe vijën e Partisë. . . Puna e Lirisë edhe pas Beratit e deri tani vë akoma më mirë në dukje, ç'është Liria dhe ku po shkon ajo. Liri Gega jo vetëm që s'duhej të ishte në Komitetin Qendror, por në rast se nuk ndërrohet rrugë, mendime dhe metodë, ajo s'do të jetë edhe e denjë të mbajë emrin e anëtares së Partisë.

Përsa më përket mua që isha, sipas konkluzioneve të Plenumit të Beratit. «njeriu që kish gabuar më shumë» qëndrova për-

sëri, jo vetëm në Byro dhe në Komitetin Qendror, por edhe Sekretar i Përgjithshëm i Partisë. Kjo ishte një anomali dhe për mua si person dhe si udhëheqës i Partisë, një pozitë false, një pozitë formale. Pas Beratit, pra, Partia s'kishte sekretar politik real dhe udhëheqja e Partisë, dua të them veçanërisht e Byrosë, me përjashtim të Nakos dhe të Koçit, ishte e re.

Si ngjau që punët arritën në këto rezultate dhe në këto konkluzione. Përgjegjësit kryesorë për mua janë dy: Velimir Stojniçi dhe Sejfulla Malëshova. Ka përgjegjësi edhe Nakua edhe Koçi, por këto përgjegjësi janë më të lehta, pse mendoj se qëllimet dhe tendencat e tyre, që u frymëzuan nga ata të dy, degjeneruan më vonë, u keqpërdorën në mënyrë jomarksiste¹. Unë s'kam qenë kurrë i bindur përta në vendos në Berat për arsyen e vetme se u hodh poshtë dhe u nënvleftësua gjithë puna e Partisë dhe jo pse u rrëzuan njerëzit... Besimi im ka qenë i madh te Partia, për të cilën kisha luftuar aq sa dhe shokët më të mirë të saj, kisha besim në këta shokë, besim dhe dashuri të shëndoshë, pse kisha luftuar tok me ta dhe i dija që ata ishin të vendosur për Partinë, sikundër isha dhe unë. Por njerëzit edhe gabojnë. Gabojnë me qëllim ose pa dashje. Këtu duhet të jemi shumë të kujdesshëm dhe të kuptojmë nuancat e këtyre gabimeve që janë vitale për Partinë tonë. Velimir Stojniçi gabo i deri në fund. E bëri me qëllim këtë gabim, që të dëmtonte Partinë tonë? S'mund të them gjë, veçse gabimi i tij na kushtoi. Velimir Stojniçi ndërhyri në mënyrë të paligjshme dhe të rrezikshme në çështjet e Partisë sonë...

Velimir Stojniçi, një kuadër i ri dhe pa eksperiencë, pasi e bëri këtë gabim të madh, më vonë u përpoq ta ndreqte në mënyrë të gabuar, pra, gabo i përsëri. Ai kuptoi se në Berat bëri një gjë që s'i lejohej kurrë, ai hodhi poshtë veprimtarinë e madhe të Partisë sonë heroike dhe uli prestigjin e udhëheqjes së Komitetit Qendror dhe këtë gabim ai u përpoq ta rregullonte jo në mënyrë marksiste. Shumë muaj pas Plenumit të Beratit ai vinte te unë dhe përpiqej të më mbushte mendjen se unë isha me të vërtetë Sekretar i Përgjithshëm, Kryeministër, udhëheqës kryesor i popullit, prandaj duhej të merrja punën në duar dhe të drejtoja efektivisht; ai zinte Koçin dhe i thoshte se «duhet të futim në KQ përsëri Liri Gegën dhe Ramadan Çitakun», ai zinte Ramadan Çitakun, sigurisht edhe Liri Gegën dhe u thoshte se «do të rregullohet puna juaj, kam folur me shokët dhe do të futeni në Komitetin Qendror». Velimir Stojniçi luante me Partinë tonë dhe me njerëzit tanë. Por kjo manevër nuk zinte vend te unë. Velimir Stojniçi

¹ Shoku Enver Hoxha ende nuk dinte gjë për rolin që kishin luajtur Koçi Xoxe e Nako Spiru në organizimin e prapaskenës së Beratit.

shkoi më tej. Ai s'i kuptonte drejt bashkëpunimin dhe lidhjet që duhej të kishim ne me partinë jugosllave, ai e kuptonte gabim independencën e partive. Çështja e Brana Peroviçit¹ me rininë tonë ishte një nga këto manifestime të gabimit në kuptimin e marrëdhënjeve të Partisë sonë me partinë jugosllave dhe kërkesa e fundit që më bëri mua Velimiri, duke më kërkuar që t'i dorëzonim çdo herë të gjitha raportet e Partisë që vinin nga organizatat që t'i këndonte dhe të merrte nga një kopje, e bënte të qartë se Velimir Stojniçi e kishte të gabuar pikëpamjen mbi marrëdhënjet në mes të dy partive dhe independencën e partive.

Velimir Stojniçi s'ishte në gjendje që atë eksperiencë sado të paktë që kishte, ta përshtatë me rrethanat dhe konditat e vendit dhe të luftës sonë. Megjithatë konditat tona me ato të Jugosllavisë, sido që në vija të përgjithshme, ishin gati të njëjtoja, ekzistonin variante dhe rrethana që s'ishin të njëjtoja... Ai fliste «me sigurinë më të madhe» dhe për gjëra që s'i dinte dhe që ne i dinim më mirë se ai, pse ishim shqiptarë dhe kishim drejtuar një luftë të tërë. Ai nënçmoi eksperiencën e Partisë sonë dhe të njerëzve të Partisë sonë...

Gabimi i Velimir Stojniçit pati konsequenca të hidhura për Partinë tonë dhe në shumë drejtime. Të fillojmë me radhë.

Çështja e Sejfulla Malëshovës: Kush ishte Sejfulla Malëshova? Sigurisht ai s'ishte as fashist as tradhëtar. Dihej se qe një komunist i vjetër, antifashist dhe patriot. Asnjëri nga ne s'dinte më tepër për këtë njeri. Ai erdhi në Shqipëri me pretendime të mëdha, shumë të mëdha. «Lufta kishte filluar dhe po zhvillohej», sepse Sejfulla Malëshova kishte punuar në Moskë e në Francë (pa pasur as lidhjen më të vogël me lëvizjen tonë); kështu dilte nga pretendimet e tij. Por ç'kishte punuar në Moskë ky njeri, jo atëherë që nuk e dinim, por as edhe tani nuk e dimë me saktësi. Ne kemi detyrë t'i provojmë vetë njerëzit; Partia Bolshevike s'të imponon kurrë njerëz. Ç'ka bëri Sejfulla Malëshova në Francë? Asgjë konkrete dhe rezultatet janë gati zero. Si duhej sjellë me këtë njeri qëkurse hyri në Shqipëri? Mendimi im është: me kujdesin më të madh, jo pse ishte i dyshimtë, s'e kam fjalën këtu, por për t'i dhënë vendin që ai do ta meritonte duke luftuar. Sejfulla Malëshova duhej të jepte prova, por duke përfutur nga qenja e tij si emigrant politik në Moskë, sikundër bëheshin punët në atë kohë, ai u bë kandidat i Plenumit të Komitetit Qendror, pas disa javësh, si erdhi

¹ Brana Peroviç, anëtare e Komitetit Qendror të Rinisë Jugosllave, delegate në Kongresin e dytë të Bashkimit të Rinisë Antifashiste Shqiptare (BRASH). Ajo u përpoq t'i imponojë Komitetit Qendror të BRASH-it pikëpamjet e udhëheqjes jugosllave.

në Shqipëri. Sejfulla Malëshova s'ishte aspak i kënaqur, «vendi i tij ishte kryesia e Partisë». Për të udhëheqja e Partisë sonë ishte një gjë «pa vlerë udhëheqjeje»; ai «ishte revolucionari i regjur e i pajisur me teorinë e madhe marksiste dhe me praktikën, gjithashtu». Jo vetëm Sejfulla Malëshova s'u përpoq kurrë dhe as i shkoi ndër mend të luftonte si duhej dhe të meritonte vendin që ju dha dhe me prova të shkonte edhe më lart, por ai qëndroi në kullën e tij të fildishtë, bënte vetëm kritika duke pritur rastin t'ja mbërrinte qëllimit të tij të paracaktuar, me metoda të tjera. Në diskutimet që u zhvilluan me Tempon rreth çështjes në se duhej goditur «Balli» në një moment të caktuar apo jo, Sejfulla Malëshova u bashkua me Tempon¹ dhe doli si njeriu i vetëm që pa se «Partia po gabonte» dhe dha «alarmin e parë», si tha ai në Berat. Por çfarë alarmi? Ai alarm është për t'u diskutuar. Do të shohim në qoftë se duhej goditur «Balli» në ato momente apo jo. Partia do të bëjë analiza edhe më të imta të këtyre çështjeve në dritën e fakteve, të cilat duhet të mblidhen dhe të studjohen me kujdes, sepse kjo është historia e Partisë sonë dhe s'mjafton pse e tha Tempua ose Sejfulla Malëshova që ajo duhet të ishte medoemos e drejtë. Por tani s'është çështja këtu. Qoftë edhe sikur të pranojmë se duhej goditur «Balli» në një moment të caktuar, kjo a do të thotë se vija politike e Partisë ishte e gabuar, a thua vallë se udhëheqja s'vlente një parë? U demaskua «Balli» si organizatë sot, në vend që të demaskohej një muaj më parë ose më pas, kjo është një çështje taktike, por jo një vijë e gabuar, pse fakti është se «Balli» u godit dhe u shpartallua dhe kjo u bë jo pse Sejfulla Malëshova dha «alarmin e parë», por sepse vija e Partisë sonë s'ishte e gabuar. Por qëllimet e Sejfullaut ishin të tjera. Dhe ato u dukën në Berat, u dukën edhe pas Beratit. Aktet e Sejfulla Malëshovës s'kanë qenë sporadike, por konsekuente; vija e gabuar e Sejfulla Malëshovës s'ka qenë e rastit, por një vijë e tij, një vijë oportuniste që ai e ka në gjak dhe që e ka manifestuar kurdoherë, derisa me të vërtetë u bë alarmante për Partinë tonë.

Plenumi i Beratit për Sejfulla Malëshovën ishte terreni i tij, ku ai do të manevronte dhe manevroi. Ç'i kishte dhënë Sejfullaut luftës dhe Partisë deri në Berat? Mund të themi fare pak, për të mos thënë aspak. Në Berat ai doli mbi të gjithë, «njeriu që bënte ligjin, njeriu i pagabueshëm», «njeriu që i kish parashikuar të gjitha gabimet e mëdha të Partisë», «njeriu që dha alarmin, por

1 Në korrik të vitit 1943, Vukmanoviç Tempo, një nga udhëheqësit kryesorë të PKJ, i cili kishte ardhur në Shqipëri me mision të posaçëm për të krijuar të ashtuquajturin Shtab Ballkanik, akuzoi PKSH për qëndrimin oportunist ndaj «Ballit Kombëtar». Me akuzat e Tempos u bashkua edhe Sejfulla Malëshova.

s'ju dëgjua» dhe tani i erdhi koha të godasë majtas e djathtas Partinë dhe udhëheqësit pa përjashtim e me sigurinë më të madhe të përcaktonte «vijën e re».

Cilat ishin shkurtimisht tezat e Sejfulla Malëshovës që shtroi në Plenumin e Beratit?

«Politika e Partisë për Frontin ka qenë e gabuar; në të vërtetë nuk ka pasur një vijë në lidhje me Frontin.

Qëndrimi i Partisë ndaj «Ballit Kombëtar» pas daljes së tij, për të mos e goditur atë si organizatë, ka qenë oportunist. Partia ka pritur që diferencimi në «Ballin Kombëtar» të bëhej në mënyrë spontane. Kjo ishte një taktikë oportuniste.

Pas Konferencës së dytë Nacional-Çlirimtare të Labinotit ne e goditëm «Ballin» me armë. U hodhëm kështu nga oportunizmi në sektarizëm e viceversa. Unë (Sejfulla Malëshova — *Red.*) kam mbrojtur tezën që «Balli» vetëm duhet demaskuar dhe jo luftuar me armë. Unë dhe Tempoja kemi kundërshtuar të merrshin masa të rrepta kundrejt Doktorit (Ymer Dishnicës — *Red.*) dhe Mustafa Gjinishit, lidhur me Mukjen. E kemi quajtur gabim të rëndë që pas Mukjes nuk vajtëm të takoheshim dhe të bisedonim me «Ballin», ashtu si ishte vendosur në Mukje.

Në Parti, në ushtri dhe në popull ka pasur tendenca terroriste. Kjo tregon dobësitë e politikës së Partisë dhe mungesën e lidhjes së saj me masat. Kështu në Parti u dukën simptoma të degjenerimit dhe në qoftë se s'marrim masa, ajo do të degjenerojë në një bandë kriminelësh. Rrënjët e gabimeve nuk duhet t'i kërkojmë gjetkë, por në vetë Partinë tonë. Po të ishte ajo një Parti komuniste e vërtetë, kjo nuk do të ndodhte. Një nga arësyet kryesore të gabimeve është kompozicioni social i Partisë, e cila ka dalë nga borgjezia e vogël. Arësyeja e dytë kryesore janë traditat politike të vendit tonë, tradita puçiste dhe terroriste. Partia s'është edukuar me frymë marksiste-leniniste. Kua-drot kanë ardhur nga shkolla borgjeze dhe s'janë pajisur me teorinë marksiste-leniniste. Libra marksiste-leniniste janë kënduar, por kjo nuk mjafton, duhet punuar me metodë dhe stil marksist-leninist. A mund të quhet marksiste-leniniste ajo që është shkruar në shtypin tonë për Enverin si një faktor kryesor i Luftës nacional-çlirimtare? Ne, pra, s'kemi pasur as Parti as udhëheqje marksiste-leniniste.

Në partitë komuniste duhet të ketë një politikë të krerëve dhe të kryetarit të partisë. Si është shtruar dhe është zgjidhur kjo në Partinë tonë? Edhe këtu kemi gabuar, sepse s'kemi menduar si marksistë. Krerët dhe kryetari nuk bëhen me dekrete, ata dalin nga lufta. Të marrim punën e Enverit si kryetar të Partisë. Në Partinë tonë nuk kemi pasur dhe nuk mund të kishim një kryetar, sepse s'ka pasur një parti marksiste-leniniste

dhe një vijë të drejtë. Nuk është mjaft të kesh një sekretar të përgjithshëm, duhet të kesh kryetar. Ky do të dilte kur Partia jonë do të forcohej. Në Helmës¹ u vendos që të popullarizohej Enveri. A ishte ky mendimi i Partisë? Partia nuk mund ta thoshte fjalën e saj. Kështu politika e krerëve dhe e kryetarit u shtrua dhe u zgjidh keq.

Fronti Nacional-Çlirimtar duhet të zgjerohet me njerëz që kanë autoritet dhe besimin e popullit. Kufi për zgjerimin e Frontit nuk ka. Këtu mund të vijnë edhe disa njerëz si Cen Elezi, pse duhet t'i shkëputim ata nga reaksioni dhe të mobilizojmë masat. Edhe në punën e gjyqeve nuk duhet të jemi të ashpër, sepse kemi qenë në pozita të gabuara.

Komiteti Qendror nuk e ka pasur të qartë rolin e këshillave nacional-çlirimtare si organe të pushtetit popullor. U bë në Labinot Statuti i këshillave, por nuk e dinte njeri ç'domethënë. Meqë kemi pushtetin në dorë, do të bëhen transformime ekonomiko-sociale, por ato do të kenë karakter demokratiko-borgjez. Sot ne kemi një qeveri dhe këshillat nacional-çlirimtare dhe mbi këto themele duhet të ngremë një shtet, prandaj duhet të mejtohem mirë.

Sukseset tona ushtarake s'kanë shkuar paralel me ato politike. Këshillat nacional-çlirimtare dhe terrenin i kemi të dobët. Ushtria s'është e lidhur si duhet me pushtetin. Ka tendenca që ajo të shkëputet. Kjo vjen ngaqë puna politike e Partisë në ushtri është e dobët. Me rritjen e ushtrisë puna jonë komplikohet edhe më tepër.

Koçi Xoxe dhe Nako Spiru, si anëtarë të Byrosë Politike, duhej të bënin më tepër për të ndryshuar situatën në Parti. Megjithëse gjendja nuk mund të ndryshohej pa ndërhyrjen e Komitetit Qendror të PK Jugosllave, ata duhej të jepnin alarmin e tretë. Alarmin e parë e dha Tempoja, të dytin e dhashë unë. (Sejfulla Malëshova — Red.).

Rreziku më i madh për Partinë ka qenë dhe është sektarizmi. Por kjo s'do të thotë që s'ka pasur dhe s'ka tendenca oportuniste. Zjarrin më të madh duhet ta drejtojmë kundër sektarizmit.

Ky plenum shënon vetëm fillimin e kthesës në Partinë tonë. Kthesa duhet të bëhet në gjithë organizatat e Partisë, në gjithë lëvizjen, në Frontin, në këshillat, në ushtri.

Sejfulla Malëshova në Berat u bë anëtar i Komitetit Qendror dhe anëtar i Byrosë Politike.

¹ Në Plenumin I të KQ të PKSH, maj 1944.

Sejfullau, pra, i cili nxori konkluzionet e Plenumit të Beratit (mania e tij ka qenë kurdoherë të nxjerrë konkluzionet dhe kjo gjë bëhej prej tij me qëllim) e dënoi vijën e Partisë dhe e quajti të gabuar.

Tani bëhet pyetje: A ishte e gabuar vija e Partisë para Beratit? Unë mendoj se jo. Mund të ketë pasur dhe ka pasur raste, ku taktika ka qenë e gabuar, por kjo është korrigjuar. Në qoftë se ka pasur raste, ku taktika ka qenë e gabuar për një çast, kjo sipas mendimit tim, nuk rridhte se vija e Partisë kishte qenë e gabuar, por se metoda dhe stili i punës kishin defekte të mëdha, sepse çështjet organizative të Partisë nuk ishin një gjë e përsosur, dhe sepse rrethanat e luftës (kjo ka qenë arsyeja kryesore) nuk na lejonin me pasë lidhje të shëndosha me tërë organizatat. Një punë e tillë, e zhvilluar në konditat që i dimë të gjithë dhe po të mbahet parasysh shkalla e eksperiencës dhe kapaciteti që kishin shokët, patjetër ka pasë sektarizëm dhe oportunizëm. Por këto s'arritën kurrë që të bëheshin një rrezik i madh, që të izolohej Partia ose të likuidohej Fronti. Kjo s'ngjau. Dhe nuk ngjau se vija e Partisë s'ka qenë e gabuar. Ndryshe nuk do të ishim në këto pozita. Mukja s'ka qenë «pjella e vijës së gabuar të Partisë» sikundër u tha në Berat, por pjella e doktor Dishnicës, i cili e ka merituar plotësisht dënimin që i është dhënë. Këtu dua të bëj një parantezë: Sejfulla Malëshova ka qenë konsekuent në taktikën e tij; Mukjen ai e nxori si «rezultatit logjik të vijës së gabuar të Partisë» dhe pra, dënimin e doktor Dishnicës, të padrejtë; prandaj ai propozoi dy herë që Doktorit të hynte në Komitetin Qendror. Në punën tonë, para Plenumit të Beratit, ka pasë gabime, por të një natyre tjetër. Çështjet organizative të Partisë në përgjithësi nuk ishin shtruar drejt, kishte të meta dhe lëshime. Ndryshe është se kur i analizojmë tani ato gabime e të meta, me këtë jetë partie që kemi e me këtë eksperiencë më të madhe jemi më të gjerë e më indulgjentë për këto gabime, se sa ishim në Plenumin e Beratit. Atëhere momentet, rrethanat dhe eksperiencia jonë kanë qenë ato që dimë, megjithatë ato ishin gabime dhe të meta që Plenumi i Beratit duhej t'i shëronte dhe t'i ndreqte. Të tilla ishin: çështja e vetë Komitetit Qendror dhe çështja e Byrosë, puna e tyre si organe udhëheqëse të vërteta duhej vënë drejt, duhej ndërruar stili dhe metoda e punës; çështja e kuadrove dhe politika e kuadrove lypte një revizion të mirë dhe të shëndoshë. Rreth këtyre gjërave kryesore ka pasë edhe shumë çështje të tjera të vogla, të cilat kishin krijuar moskënaqësi që nuk shpreheshin lirisht, në mënyrë marksiste dhe si duhet të veprohet në një parti të shëndoshë. Ky qëndrim s'bënte përjashtim në të gjithë metodën dhe stilin e punës sonë. Tamam, tok me analizën e gjithë punës, Plenumi i Beratit duhej të korrigjonte edhe këto gabime, të zhdukte këto moskënaqësi, t'i vinte

punët sa të mundej më drejt për të ardhshmen. Esenca e këtyre moskënaqësive kishte baza dhe s'ishte e sëmurë, por këto u shtruan shtrembër, me mënyrat dhe qëllimet që tregova më lart dhe muarën shtrembër. Për mua faktori kryesor në shtruarjen e çështjes gabim është Velimir Stojniçi, i cili i orientoi dhe i inkurajoi punimet e plenumit në këtë drejtim ku arriti dhe Sejfulla Malëshova, i cili u vuri kapakun dhe vulën e tij gjithë punimeve të plenumit.

Pas çlirimit, Partia mori një hov të ri, shpresa të reja u ngjallën në kuadrot, besimi në Partinë forcohej, perspektivat e së ardhshmes i kishim më të qarta dhe u krijua besimi se punët do të shkonin më mirë dhe më drejt për të zgjidhur problemet e zorshme që kishim përpara me rastin e çlirimit të plotë të Shqipërisë. Çështja organizative e Partisë u vu më drejt dhe në forma më të rregullta dhe më konkrete. Çlirimi i Shqipërisë vetë ishte një faktor i madh që organizata jonë do të bëhej më koherente, më kompakte nga ana organizative, pse lidhjet dhe kontaktet do të bëheshin në rregull dhe me më shumë lehtësi se në kohën e luftës. E gjithë Partia e kuptonte përgjegjësinë e rëndë që kishte mbi supet për drejtimin e shtetit tonë; kuadrot udhëheqës, me gjithë mungesën e eksperiencës së tyre në drejtimin e aparatit të ri të shtetit dhe në zgjidhjen e problemeve vitale ekonomike të vendit në konditat e vështira të pasluftës, i realizonin detyrat e rënda. Ata kishin besim në vete, sepse ishin njerëzit e luftës. Plenumi i Beratit ndihmoi në këtë drejtim.

Mirëpo kthesa do të ishte e plotë në Parti, po të qe se Berati do të kishte qenë me të vërtetë një mbledhje plenumi ashtu si theksova më lart dhe po të mos ishin bërë gabimet që përmenda. Plenumi i Beratit la në Partinë tonë dhe në kuadrot disa pikëpamje të gabuara dhe të dëmshme që u bënë të rrezikshme deri në një pikë dhe, në rast se ne nuk i spastrojmë, puna do të pengohet.

1. U krijua një pikëpamje, si rrjedhim i punimeve të Plenumit të Beratit, se në udhëheqjen e Partisë ka njerëz që kanë gabuar rëndë dhe njerëz që s'kanë gabuar fare, pra, vjen vetëvetiu se te kush duhet të mbështetet besimi. U kritikua ashpër mënyra e punës në Komitetin Qendror dhe në Byro, si organe drejtuese gjatë gjithë kohës së luftës. Kjo duhej të na shërbente si mësim i madh edhe pas Beratit dhe të na ndalonte të përsëritnim gabime të tilla. Por çështja e Komitetit Qendror dhe sidomos e Byrosë, nuk eci si duhej. Kjo çështje u shtrua prapë gabim, sepse me kompozicionin e saj të ri dhe me të metat e saja organike dhe subjektive të atyre që formuluan kritikën në Plenumin e Beratit, do të na çonte përsëri në gabime. Byroja që u riorganizua në Berat, si thashë dhe më lart, ishte një Byro e re me

përrjashtim të Nakos, të Koçit dhe timin. Në formë dukej sikur kishte unitet mendimesh dhe harmoni në këtë Byro, por në realitet s'ishte ashtu. E para, pozita ime konsiderohej nga të tjerët formale, se unë, në sy të shokëve, isha njeriu që kisha gabuar dhe rrija atje se s'mund të bëhej ndryshe. Sejfullau nuk kishte fituar jo vetëm besimin tim, por, jam i sigurt, se as atë të Koçit dhe as të Nakos, dua të them besim në këtë pikëpamje që Sejfullau të ishte një element i shëndoshë në Byro. Ky mendim për Sejfullaun vinte, sepse ai s'kishte dhënë prova tangibles¹ të një pune konkrete.

Pandi, Bedriu, Tuku, që të tre këta, ishin të rinj në Byro. Kam qenë i vetmi që kam hezituuar për ju të tre që të vinit në Byro dhe kam hezituuar nëse do të ishit në gjendje të drejtonit me të vërtetë si anëtarë të Byrosë. Këtu nuk dua të them se ne të tjerët ishim petrita, por kishim pak më tepër eksperiencë. Tani me një Byro të tillë ishte rrezik të binim në gabime të tjera dhe s'munguam. I bëmë «kritikë» metodës së punës së vjetër në Berat, por çështja ishte që të mësonim nga kjo. Në vend që Komiteti Qendror dhe Byroja të drejtonin efektivisht gjithë punën, në vend që problemet të shtroheshin dhe të zgjidheshin efektivisht atje dhe të drejtoheshin organizatat e Partisë dhe pushteti nga një qendër efektive, në bazë të centralizmit demokratik, nuk u bë ashtu. Këtu s'është puna se çështjet nuk shtroheshin në Byro, por mënyra e punës në Byro ishte gati si ajo e vjetra, me ndryshimin që mbledhjet bëheshin më shpesh se në kohën e luftës, por stili linte shumë të dëshirohesh dhe me pak përmirësime ishte si ai para Beratit. Drejtimi efektiv u spostua, drejtimi bëhej jo nga Byroja Politike, por nga zyrat e KQ të Partisë dhe nga njerëzit që punonin atje, domethënë: nga Koçi me aparatit e kuadrove dhe nga ana tjetër nga Nakua, i cili ishte më në kontakt, në pikëpamje pune, me ta. Puna, pra, s'ishte dhe s'mund të ishte e përqëndruar në duart e Byrosë dhe të kontrollohej prej saj. Përgjegjësitë s'ishin të caktuara, kompetencat ishin të ngatërruara. Ç'thuhesh në Byro (për aq sa merreshin dhe si merreshin ato vendime) dhe ç'bënte Sejfullau? Shumë herë bënte të kundërtën. Çdo gjë ky e teorizonte dhe përpiqesh, në këtë mënyrë, të çante me supe për të dalë në krye efektivisht; por teorizimi i tij s'përputhej me realitetin dhe shumë herë ishte në kundërshtim. Konkretisht në zbatimin e vendimeve ai vazhdonte të jepte fare pak, rendimenti i tij ishte negativ. U tha, kur u bë analiza e punës në Plenumin V dhe në punimet e Byrosë para këtij plenumi, se Sejfullau kishte influencuar më shumë në tendencat e theksuara oportuniste që u dukën në

1 Tangibles (frëngj.) — të prekshme, të vërteta.

vijën tonë. Këtu s'u gabuam aspak, pse këto tendenca Sejfullau i kishte shfaqur dhe ngritur në teori që në Plenumin e Beratit, por më mirë dhe më qartë u dukën pas çlirimit. Ku i kishim sytë ne që s'e pamë këtë gjë më parë? Pikërisht sytë s'i kishim në vend, pse s'ekzistonte një Byro me unitet për mjaft kohë pas Beratit, pse unë isha në ato pozita që thashë, pse Tuk Jakova interesohej më pak nga të gjithë dhe tregonte një plogështi të çuditshme ndaj çështjeve, pse Pandi, natyra e tij dhe metoda e punës së tij, e bënë t'i shihte punët ngushtë, pa perspektivë të gjerë, pse Bedriu punonte, por fare lehtë influencohej edhe për të mirë edhe për të keq, si ngjau përsa i përket gjykimit mbi Sejfullanë. Kishte kundërshtim në Byro e sidomos për tendencat e Sejfullaut, por këto kundërshtime s'u realizuan në një koncept të shëndoshë analize të vijës. Shkaku ishte të përbërja e Byrosë. Në një shkallë më të vogël, por jemi përsëri në ujërat e Plenumit të Beratit. Besimi në shokët nuk ekziston i shëndoshë, flitet me rezerva, me paragjykime, ka ndrojtje, ka ftohtësi. Këtu gjeti përsëri shesh Sejfullau që të influencojë për gabime në vijë. Mund të mendoni ju dhe të thoni: Mirë, po pse s'i pe ti këto gjëra dhe t'i shtroje si i shtron sot? S'është e vërtetë që s'i kam parë, por ka edhe nga ato që s'i kam parë dhe që i realizoj tani, edhe më mirë akoma mund t'i realizojmë, unë dhe ju bashkë më vonë. Por është fakt sikundër thashë edhe më lart, se unë s'isha i bindur përsa i vendos në Berat. Pse s'u shfaqta haptas? Për dy arsye: E para, pse shihja që s'ishite momenti dhe e ndjej përgjegjësinë për këtë dhe e dyta, pse dhe unë jam sikundër edhe ju të gjithë, me po ato kualitete dhe me po ato të meta të trashëguara nga puna e vjetër. Por vetëm unë konstatoja fare qartë një gjë dhe këtë ja kisha shfaqur edhe Koçit edhe Nakos: unë isha i shtërnguar të lidhja duart, domethënë s'po punoja dot dhe s'po drejtoja dhe, me këtë doja t'u jepja atyre që ta kuptonin, se këtu s'drejton Byroja. Kisha folur shumë herë për dualitetin që ekzistonte parti-pushtet dhe që drejtimi i pushtetit nuk bëhej në rrugën që duhej të bëhej. Nga ana tjetër shihja korrentet që vinin e përplaseshin te unë. Kur vinte Sejfullau që me mënyrat e tija më qafej «jo pse nuk popullarizohej ai dhe pse popullarizohej Nakua» etj., kur vinte Velinir Stojniçi dhe, për t'u treguar i afruar, më thoshte se «duhej të drejtoja, pse isha sekretar e kryeministër» ose më linte të kuptoja se «Sejfullau është ambicioz ose s'është gjë» etj., unë nxirrja konkluzionet e duhura. Por shokët duhej të shihnin qartë një gjë: që vija para Plenumit të Beratit nuk ishte e gabuar dhe unë nuk kisha gabuar ashtu si u shtrua në Berat dhe nuk meritoja atë trajtim që m'u bë. Unë nuk akuzoj asnjë shok, qoftë nga të Byrosë ose të plenumit që t'u ketë munguar dashuria dhe vlerësimi i mirë ndaj meje, por atje, në Berat u godit në radhë të parë vija

e Partisë dhe unë isha nga kryesorët që u godita. Pra, efektivisht pas kësaj unë nuk mund të kisha autoritetin e duhur. Kjo është e evidente dhe këtu është arsyeja që unë s'i shtrova më përpara pikëpamjet e mia dhe këtë e bëra që këto të mos merreshin si çështje personale. Por unë kam pasur kurdoherë besim te shokët e ndërgjegjshëm dhe do të gjeja rastin e përshtatshëm për t'i shtruar këto çështje të rëndësishme. Dhe duke e pasur këtë besim të patundur te shokët, se të gjithë e duan Partinë njësoj dhe punojnë njësoj për të, do të vazhdoj të analizoj hapët të metat e tjera që trashëguam nga e kaluara dhe nga Plenumi i Beratit.

Në Berat, pra, hynë në Komitetin Qendror njerëz të rinj, të thjeshtë, të pastër, që kishin të ardhshme të mirë për Partinë. Mirëpo këta njerëz të rinj, që asistuan për herë të parë në Komitetin Qendror patjetër, përveç mësimëve të mira që muarën nga plenumi, muarën dhe ato të këqiat. Ata njerëz kujtuan se nga Berati e tëhu mbaruan gabimet, s'ishite rrezik të gabojmë më, ata që gabuan u hodhën tej, puna do të ishte e pagabueshme. Besimi koshient është i mirë, por besimi pa baza është i dëmshëm. Në punë do të shihnim në gabonim më apo jo. Shumë pak i shihnim ne të Byrosë gabimet që po bëheshin nga shokët që punonin në Komisionin e kuadrove dhe që drejtonin efektivisht për një kohë të gjatë. Jo vetëm që punët nuk shkonin dhe aq mirë, por kishte shumë të meta dhe gabime, bile këto të meta e gabime u përngjanin atyre që ne gjoja kritikua aq shumë në Plenumin e Beratit. Nga aparati i KQ të Partisë dilnin udhëzimet për Partinë dhe për pushtetin: atje zgjidheshin problemet që duhej të zgjidheshin në Byro. Kjo mund të vazhdonte pa përpjekje për një kohë të shkurtër, por jo gjatë, sepse, kur nuk drejton Byroja, të gjithë drejtojnë pas kokës; urdhërat kundërshtojnë njëri-tjetrin; gjithsecili përpiqet të mbrojë pikëpamjen e vet dhe të ngulë këmbë edhe kur pikëpamja e tij është e gabuar, ose të lëshojë terren pa qenë kurrë i bindur se këtë duhej ta bënte, por vetëm se ashtu e lypte «politika».

Në Byronë Politike të Partisë sonë dhe në mes shokësh s'ka «politikë», sepse «me ba politikë» me shokët, do të thotë të lesh të majisen çështjet, të krijohen mërira, të krijohen pikëpamje të sëmura, të krijohen tarafe, të krijohen më në fund fraksione. Burimin e këtyre gjërave, që janë në kundërshtim me parimet e Partisë sonë duhet ta zhdukim. Këto të këqia duhet t'i luftojmë pa mëshirë. Lufta kundër këtyre të këqiave nuk është dhe aq e lehtë, por është e mundshme në Partinë tonë të re dhe të dalë nga lufta e me kuadro të shëndoshë dhe të rinj që këto gjëra nuk i kanë në gjak e në traditë.

2. Një çështje tjetër është mënyra që u përdor në shtruarjen

e këtyre problemeve me rëndësi në Berat, domethënë në formën e «coup d'état». Zgjidhja e çështjeve në Plenumin V nuk u bë si në Berat, nuk u arrit me një metodë pune si ajo që përgatiti Plenumin e Beratit. Megjithatë nga shumë shokë pa të drejtë u konsiderua dhe konsiderohet njësoj si «coup d'état» e Beratit. Unë them se s'janë njësoj. Punimet e Plenumit V duhet të konsiderohen ndryshe nga gjithë Partia për arësyet që do të rreshtoj më poshtë.

Kur në punimet e Byrosë, para Plenumit V dhe në plenumin vetë u shtrua çështja e likuidimit të shfaqjeve oportuniste në vijën politike, kjo gjë u bë sepse ishte më e rëndësishmja, më kritikja, më e rrezikshmja, më tendenciozja. Por kishte edhe diçka tjetër, që duhej shtruar dhe që s'u shtrua. Ishin pikërisht këto çështje që po shtroj sot.

Plenumi i Beratit e kishte djegur shumë Partinë dhe unë nuk dëshiroja kurrën e kurrës të përsëritej ai gabim. Duhej të korrigohej, të bëhej e drejtë vija politike dhe të dënohej ashpër Sejfulla Malëshova pse e meritonte, por duhej të kritikoheshin, natyrisht, pak më ngadalë, më butë, por drejt edhe ata shokë që mund të kishin gabuar joqëllimisht, por që edhe punonin shumë. Kush punon gabon, kurse Sejfulla Malëshova s'punoi edhe gaboi. Këtë ta kuptojmë mirë. Të kuptojmë, pra, drejt ndryshimin në mes Plenumit V dhe mbledhjes së tanishme me atë të Beratit. Çfarë ishte ajo diçkaja tjetër, përveç çështjes së vijës politike që nuk u shtrua në Plenumin V? Ishte analiza e vijës organizative të Partisë, ishte gjithë drejtimi, organizimi i brendshëm i Partisë, i Frontit dhe i pushtetit. A ka pasë tendenca të gabuara serioze në punën organizative, sikundër ka pasur në atë politike? Unë mendoj se ka pasur gabime, ka pasur të meta dhe lëshime. Vetë tendencat e gabuara që u dukën në zbatimin e vijës sonë politike kanë pasur reperkusione në punën organizative. Plenumi i Beratit ka pasur reperkusionet e tij, puna e para Beratit dhe metoda e stili i vjetër kanë pasur dhe ato reperkusionet e tyre. Këtu mos kemi iluzione. Të gjithë mund të binim në këto gabime dhe të gjithë kemi rënë kush më shumë e kush më pak dhe të mos çuditemi aspak se edhe pas kësaj analize edhe pas një analize tjetër e tjetër, do të gjejmë përsëri gjurmat e këtyre gabimeve. Por sa kohë do të shkojë? Eksperiencia jonë do të jetë më e madhe, do të gabojmë më pak dhe kjo do të jetë shenja që Partia jonë shkon drejt bolshevizimit.

Gabimi i parë dhe kryesori është te Komiteti Qendror dhe te Byroja. Këto forume nuk kanë drejtuar si duhet të drejtonin dhe këto për arësyet që thashë më lart. Por këtej rrjedhin një varg gabimesh të tjera. Komisioni i kuadrove me anëtarë të plenumit dhe me Koçin në krye, përgjegjës kryesor përpara Byrosë, drejtonin efektivisht punën. Por Komisioni i kuadrove i kishte

kaluar kompetencat e veta dhe si rrjedhim ata nuk mund të ishin në gjendje si duhej, qoftë edhe sikur atje të ishin shokë me eksperiencë të madhe, të kryenin një barrë aq të rëndë sa ishte ajo e drejtimit të Komisionit të kuadrove vetë dhe të punës në përgjithësi. Ata filluan t'i marrin në duart e tyre edhe kompetencat e të tjerëve. Kjo është një e metë organizative që ka konsekuenca jo të mira në punë. Përveç kësaj puna u muar pakëz si qesim prej tyre dhe u formua pak nga pak një bindje sikur çdo gjë po drejtohej mirë dhe pa gabime. Mirëpo në realitet s'ishte ashtu. Politika e kuadrove nuk zgjidhej drejt, kuadrot tanë s'po edukoheshin si duhej, kurset s'po ecnin, gabimet në pushtet ishin të shumta, konferencat e ndryshme me kuadrot s'ishin substanciale, s'ishin konkrete sa duhej. Kuadrot e Partisë dhe të pushtetit vinin në zyrat e KQ të Partisë dhe pikërisht në Komisionin e kuadrove dhe aty merrnin udhëzime për zgjidhjen e problemeve me shumë rëndësi, bile vitale, për Partinë. Deri ku këto udhëzime ishin të frutshme dhe jepnin rezultate si duhej? Kjo është e dyshimtë për mua, sepse vetë Byroja s'ishte e qartë në këto probleme, sepse vetë Byroja nuk punonte në një mënyrë të atillë që t'i zgjidhte këto probleme dhe të udhëzonte gjithë Partinë. Shokët e Komisionit të kuadrove bënë ç'mundnin (s'mund të mohohet puna e tyre e palodhur), por në atë drejtim që kishte marrë puna, ata praktikisht do t'i bënin mangut që të dyja. Këtu e kanë burimin dhe shumë të meta të pushtetit. U krijuan një farë dualiteti parti-pushtet. S'ishte kuptuar mirë si e drejton Partia pushtetin, pse ishin konfunduar punët në krye. S'ishte i qartë roli i pushtetit, rëndësia e tij kryesore për Partinë. Ministri, qoftë sikur të ishte dhe nga komunistët më të mirë dhe më të provuar, s'kishte shumë vlefte për njerëzit e Partisë. Partinë ata s'e shikonin në pushtet, e shihnin vetëm në disa zyra. Këtej lindnin lëshime sa të duash, mospërgjegjësi në punë, mungesë respekti dhe disipline, mungesë konspiracioni, pozita të shtrembra, akra-ballëk, krijim miqësish false, arrivizëm e shumë të liga të tjera. Në mënyrën si ishte shtruar çështja, Partia e kishte të pamundur të kontrollonte punën, të bënte një politikë si duhet të kuadrove, të bënte mobilizimin e gjerë të masave, të zgjidhte si duhej problemet e mëdha që i viheshin përpara. Pra, puna ishte marrë pak si më të lartë nga Komisioni i kuadrove dhe kritikata s'para i pritnin me qejf. Por që të pranohet kritika, duhet të ketë kaluar andej dhe autokritika si prej atij që i bëhet ajo kritikë, ashtu dhe nga ai që e bën, sepse në parti mund të thuash pa frikë: s'ka kush që të mos gabojë, por ka gabime dhe gabime. Vlera e një komunisti qëndron kur ai i sheh këto gabime dhe përpiket t'i korrigojë, të korrigojë edhe shokët. Një punë e tillë, një drejtim i tillë ka krijuar disa situata jo të pëlqyera, bile të rrezikshme, në rast se nuk veprojmë shpejt.

Të marrim çështjen e rinisë. Rinia është sektori më i rëndësishëm i Partisë, ajo është burimi i kuadrove tanë dhe i kuadrove që do të ushqejnë Partinë, që do ta çojnë përpara. Është fakt i pamohueshëm që rinia, ashtu si ka qenë në luftë faktor vendimtar, ashtu është edhe tani, pse ajo ka entuziazmin, ka forcën dhe gjallërinë dhe po të edukohet mirë nga Partia, do të bëhet mbështetje e mirë për të. Rinia është inisiativa, guximi, e tanishmja e madhe dhe perspektiva e qartë për të ardhshmen. Vihet pyetja: A e ka drejtuar efektivisht rininë Partia? Unë mendoj se jo. Dhe në mënyrën që janë zhvilluar punët, s'mund ta ketë drejtuar. Me drejtue këtë sektor të gjerë dhe të rëndësishëm, s'është vetëm me mbajt lidhjet dhe me dhënë herë pas here disa udhëzime, por me i rrahë mirë në Byro problemet e rinisë, me i studjue konkretisht dhe me ja dhënë rinisë këto drejtime, këto probleme të zgjidhura si duhet, të punuara si duhet. A e kemi bërë këtë gjë? Unë them se jo. Përkundrazi, shokët e rinisë na i kanë paraqitur ne. Por mund të jetë ndonjë që të thotë se ata janë më në korrent të çështjeve të tyre. Unë them mirë, janë njerëz që shkojnë përpara, por pse të mos vihet në korrent si duhet Byroja Politike dhe Komiteti Qendror i Partisë sonë për këto gjëra? Kjo gjë duhet bërë që të shihet drejtimi, që të ndjehet lidhja, që të ndjehet kohezioni dhe respekti ndaj udhëheqjes. Ndryshe rinia ka rrezik të shkëputet. Shkëputja ka qenë një rrezik i përhershëm, por mua më duket se faji s'është aq i rinisë sa është yni. Rinia ka marrë hov në vendin tonë, kjo duhet të na gëzojë dhe ta inkurajojmë, por edhe ta drejtojmë. Por ta drejtosh, s'do të thotë ta pengosh. Këtu të kuptohemi dhe këtu të ndërrojmë mentalitet në qoftë se është rasti se ka mentalitet për të ndërruar. Unë kam konstatuar një frymë dualiteti në mes Partisë dhe rinisë, dua të them në mes disa shokëve të Partisë dhe të rinisë, flas për udhëheqjen e saj. Po pse rrjedh kjo? Për mua është çështje drejtimi. Njëri kërkon t'i imponohet tjetrit. Duhet të ketë vetëm një drejtim: Partia. S'ka kush e mohon këtë gjë. Çështja është që ta drejtojmë rininë drejt dhe efektivisht. Ka tendencë në disa shokë të Komitetit Qendror e veçanërisht të Komisionit të kuadrove, që të mos shikohet drejt çështja e rinisë, të vihen në dukje shumë gabimet e saj atje ku janë, por edhe atje ku s'janë. Kjo s'është e drejtë. Është krijuar një farë acarimi në mes shokësh të mirë të Partisë dhe të rinisë. Kjo duhet sqaruar dhe luftuar, se është shumë e dëmshme. Më të gjerë duhet të jenë njerëzit e pjekur të Partisë për gabimet e vogla të rinisë; këto gabime e kemi për detyrë të domosdoshme t'i shohim dhe t'i korrigjojmë, por për një gabim të njëllotë, një anëtar i vjetër të Partisë mund t'i sëllojmë më fort, se i mban kurrizi, kurse te i riu të kemi kujdes se është i njomë, ai ndreqet më lehtë, sepse është filiz i ri. Pastaj, më duket se shokët e Komisionit të

kuadrove duhet të analizojnë pak më qartë punën e tyre, gabimet e tyre, të cilat s'janë alarmante, por që, po t'ju vihen në dukje si duhet, do ta shohin dhe më qartë punën e rinisë dhe atëhere do të zhduken krejt ato keqkuptime dhe ajo frymë që është e huaj për Partinë. Këtu nuk dua ta laj krejt rininë për të metat që ka në punën e saj, por mendoj se ato janë më pak të dëmshme se të metat tona. Megjithatë kjo s'do të thotë që ne t'i lëmë ato pasdore.

Do të mbaroj edhe me një vërejtje tjetër që edhe kjo e ka burimin në mënyrën e mendimit e të punës së vjetër dhe në mënyrën si u shtruan dhe u zgjidhën çështjet në Berat. Dua të them për sinqeritetin dhe lirinë e plotë në shfaqjen e mendimeve. Është krijuar në shokët një frymë e sëmurë, një frikë me shfaq atë që mendon se mos merret për keq ose mos ketë konsekuenca. Do ta marr punën konkretisht këtu në Byro dhe kjo duhet të jetë model për gjithë Partinë. Duhet të ekzistojë besimi i madh në Partinë dhe në udhëheqjen, kjo është e domosdoshme. Por kjo do të jetë e tillë kur çdo gjë të zgjidhet si e zgjidhin komunistët, haptas dhe në mënyrë shoqërore dhe kur ky besim është i vendosur mirë dhe ka dalë nga analiza dhe nga arësytetime të shëndosha. A ngjet kështu zakonisht në Byronë tonë dhe pastaj në Parti? Unë them se s'ngjet tamam kështu. Ka gradacione, dikush ka më guxim, dikush ka më pak, dikush ka më tepër besim në mendimet e veta, dikush ka më pak, dikush i shtron çështjet më mirë, dikush më dobët. Në të gjithë ne ekzistojnë këto gjëra, por te kush më shumë dhe te kush më pak. Kam vënë re shumë herë te Bedriu një pasiguri në mendime dhe një drojtje në shfaqjen e mendimeve. Mua shumë herë më ka thënë për çështjen e ushtrisë, për çështjen e personelit që s'ecën, për pengesat dhe vështirësitë që hasen në këtë sektor, por këto si fakte. Unë kam përshtypjen se te Bedriu nuk mund të ishin vetëm fakte të palidhura dhe nga të cilat të mos kishte nxjerrë një konkluzion, ashtu si kishin nxjerrë edhe të tjerë. Kam pasë përshtypjen se Bedriu nuk ma shfaqte tamam mendimin e vet, por me drojtje dhe me rezerva. Përse të mos ta themi hapët? Unë nga pjesa ime dyshova për qëndrimin e Bedriut në çështjen e Sejfullaut, por s'u dëshpërova. Bedriu akoma s'e kishte parë mirë Sejfullaun dhe s'ka arritur t'i thellojë më fort këto çështje. Unë jam i sigurt për një gjë dhe që është e vërtetë për të gjithë ne, se Partinë dhe dashurinë për të s'e varim në qafën e njërit ose të tjetrit. Ne, shokët i duam, i respektojmë, i ndihmojmë kur ata janë për Partinë, por Partinë e duam më shumë se çdo gjë. Qëndrimet e Tuku dhe shfaqjet e tija kanë një karakter tjetër. Tuku është njeriu me pak pasione, kjo është një gjë e mirë, por bëhet jo e mirë kur këto pasione gjenden në formën që i ka Tuku. Tuku jep një gjykim të lehtë dhe të pamatur për çështjen e Sejfullaut. Mendimi i tij është nxjerrë pa u thelluar. Kështu qëllon edhe për shumë gjëra të tjera, si pikëpamjet e tija në

mbledhjen e fundit të plenumit për çështjet e popullarizimit dhe të legalizimit të Partisë¹. Ato janë mendime të papjekura, por Tuku mund të gjykojë më thellë. Interesimi i Tukut si drejtues i Partisë ka qenë i paktë. Tuku mund të justifikohet sa të dojë, unë nuk jam dakord me të. Është e vërtetë se punët në Byro nuk shkonin me atë ritëm që duhej, por në ato kondita, në qoftë se Tuku nuk është interesuar aq sa duhej, faji është më shumë i tij se sa i ndonjë njeriu tjetër. Sa për Pandin, ai interesohet, por për cikërrima dhe këto i sheh ngushtë, çdo gjë në një prizëm të vogël, ai nuk mund të realizojë si duhet gjerësinë e çështjes dhe është kurdoherë në pritje që të vendosin të tjerë, ta hapin të tjerë, pse druhet se mos thyhet diçka. Ai s'e ka fituar besimin në vetëvete dhe në gjykimet e tij. Këtu s'kam në mend të bëj kritikën e shokëve, por desha të ilustroja atë që thashë edhe më parë: çështjen e drojtjes dhe të frikës, me shfaq mendimin qoftë edhe sikur të jetë i gabuar. Këtu jemi në Byro dhe jo në pazar, këtu jemi në mes shokësh dhe jemi të gjithë përgjegjës përpara Komitetit Qendror. Është bërë si modë, kur bëhen kritikak ose rishikohen çështjet, dy-tri vetë hanë drunë, të tjerët kanë përshtypjen sikur janë të larë nga ato gjëra. Kështu doli në Plenumin e Beratit: tri-katër vetë e kishin «fajin», ata muarën dënimin, të tjerët s'kishin asnjë faj. Kjo s'është e drejtë dhe s'mund të jetë e drejtë as për Plenumin V. Kush po gabon? Byroja në çdo moment dhe dy-tri vetë të Byrosë, ata që punojnë më shumë. Por të kuptohemi një çikë mirë. Gabojnë edhe Pandi edhe Tuku edhe Bedriu bile edhe më tepër nga të tjerët në shumë raste. Por mos të kujtojnë dhe s'duhet t'i lëmë të flenë në gjumin e rëndë, shokët e tjerë anëtarë të KQ, dhe anëtarë të Komisionit të kuadrove, të cilët dhe ata kanë gabuar boll. Këtu nuk dua të them se në Partinë tonë s'bëhen përveçse gabime, por duhet çështjet të shikohen drejt dhe të vihen drejt.

Po të mos shtrohen çështjet drejt, vjen vetëvetiu mosbesimi në udhëheqje ose ka një besim fals dhe jo të rrënjosur mirë. Edhe shokët e mirë, kur nuk u shtrohen çështjeve drejt, mund të gabojnë në gjykimet. . . Që ka gabime në punën tonë, kjo s'ka asnjë dyshim, por ka gabime të mëdha, ka edhe të vogla. Të dyja kategoritë duhet t'i korrigjojmë dhe të përpiqemi të bëjmë sa më pak gabime, të gjitha këto analiza duhet të kenë këtë qëllim.

Në qoftë se shkojmë me këto parime, në qoftë se analizat e

punës sonë i bëjmë në këtë frymë, ne do të kemi rezultate të mëdha në punë. Mos harrojmë se jemi përpara kongresit dhe të gjitha këto çështje duhet të zgjidhen mirë dhe drejt. Një zgjidhje e tillë është gjysmëpregatitja e kongresit, do të shohim më qartë vijën që do të punohet atje, do të zgjidhet në baza më të shëndosha Komiteti Qendror që do të dalë nga kongresi, do t'i shohim më mirë dhe do t'i zbatojmë më mirë punët, me një stil dhe metodë të vërtetë bolshevike për të cilën ka aq nevojë gjithë zhvillimi i veprimtarisë së Partisë sonë. Unë çështjet i preka në përgjithësi dhe i hodha në letër pak me nxitim. Do të më falni në qoftë se ka dhe gabime, por këtu jemi, le t'i korrigjojmë, pikërisht për këtë punë jemi mbledhur dhe të dalim që këtej me rezultate të shëndosha, të drejta, komuniste.

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

*Botuar për herë të parë:
«Enver Hoxha. Vepra,
vëllimi 3». Tiranë, 1969*

1 Në Plenumin VI të KQ të PKSH që u mbledh në prill 1946 Tuk Jakova tok me Koçi Xoxen në mbështetje të pikëpamjes së udhëheqjes jugosllave u shpreh për ta mbajtur Partinë në ilegalitet, në kundërshtim me mendimin e shokut Enver Hoxha për ta legalizuar Partinë dhe për ta popullarizuar atë si udhëheqësen e vetme të të gjithë jetës së vendit.

UDHËZIME TË KQ TË PKSH MBI PREGATITJEN TEORIKE MARKSISTE-LENINISTE TË ANËTARËVE TË PARTISË

4 dhjetor 1946

RËNDËSIA E EDUKIMIT TË PARTISË ME TEORINË MARKSISTE-LENINISTE

Niveli teorik i Partisë sonë është mjaft i ulët. Kjo është një e metë mjaft e madhe dhe një pengesë serioze në kryerjen e detyrave tona. Megjithkëtë sot në Parti nuk po bëhen përpjekje të mëdha nga ana e anëtarëve dhe e kuadrove tanë në përgjithësi për të përvetësuar teorinë marksiste-leniniste.

Format e ndryshme organizative që janë ngritur, si kurse e të tjera, ashtu edhe e gjithë puna për ngritjen teorike të Partisë po japin rezultate të ngadalshme. Shokët nuk janë treguar të vullnetshëm dhe të mobilizuar krejtësisht për të studjuar sa më shumë, për t'u bërë më të zot e më të vlefshëm për Partinë.

Nga ana tjetër kontrolli i forumeve të Partisë dhe i shokëve që janë ngarkuar posaçërisht me punën teorike, ka munguar. Kjo është një tjetër e metë që na pengon mbarëvajtjen e punës në sektorin e teorisë.

Edukimi i Partisë me marksizëm-leninizmin është parë, pra, nga anëtarët e Partisë ashtu edhe nga forumet si një detyrë që u ngarkohet nga Partia përmbi punët e tjera, d.m.th. si suplementare. Prandaj gjithashtu që shokët nuk kanë studjuar dhe nuk janë përgatitur mirë, janë justifikuar duke thënë se kemi shumë punë, s'kemi kohë.

Nga të gjitha këto mund të nxjerrim si konkluzion se organizatat e Partisë nuk e ndjejnë si nevojë të domosdoshme pajisjen e anëtarëve të Partisë me teorinë marksiste-leniniste, ato nuk e kuptojnë drejt rolin dhe rëndësinë e teorisë dhe nuk e marrin këtë si një detyrë të parë, kryesore të gjithë Partisë.

Edukimi i Partisë me marksizëm-leninizëm, është një problem partie, që kërkon, për t'u kryer drejt e me rezultate konkrete, mobilizimin e angazhimin e të gjithë anëtarëve e të forumeve tona.

Është nevoja përpara së gjithash që Partia ta kuptojë drejt nevojën dhe rolin e teorisë marksiste-leniniste e të vërë të gjitha forcat për ta përvetësuar këtë.

Sot del përpara Partisë sonë si një nevojë urgjente dhe si një detyrë me shumë rëndësi ngritja e nivelit teorik të anëtarëve të saj, për ngritjen e nivelit politik të Partisë.

Kjo nevojë e madhe e ka burimin tek cilësia e Partisë sonë si pararojë revolucionare e masave punonjëse, tek detyra jonë e madhe e forcimit të vetë Partisë dhe e ngritjes së koshiençës komuniste të anëtarëve të saj dhe tek detyrat e shumta dhe të vështira që na vihen përpara në etapën e rindërtimit të vendit.

Këto caktojnë sot detyrën e rëndë të çdo anëtar të organizatës sonë që të punojë pareshtur për t'u pajisur me ideologjinë e Partisë. KQ i Partisë shtron si problem me shumë rëndësi para të gjitha organizatave edukimin e anëtarëve të Partisë e të kuadrove me marksizëm-leninizëm. Në punën tonë teorike dhe në studimin tonë nuk duhet të nisemi nga parimi që të studjojmë për të pasur disa njohuri teorike. Përkundrazi marksizëm-leninizmi është një udhëheqje për aksion dhe ne do të armatosemi me këtë për të luftuar më mirë në rrugën tonë, të kalojmë pengesat e të dërmojmë armiqtë dhe të realizojmë fitore të sigurta në rrugën tonë. Në studimin tonë të marksizëm-leninizmit ne udhëhiqemi nga qëllimet që të bëhemi më të zotët, të forcojmë koshiençën e Partisë sonë dhe t'i vlejme me punën tonë çështjes së madhe të Partisë.

1) Partia ka nevojë të madhe sot për shokë më të zot që t'i kuptojnë më mirë çështjet për të qenë në gjendje të përballojnë me guxim dhe të zgjidhin problemet e ndryshme.

Kjo do të ishte e pamundur në qoftë se anëtar i Partisë nuk ndriçohet në rrugën e tij nga mësimet dhe eksperiencia e marksizëm-leninizmit.

Për këtë ne duhet të studjojmë me të gjitha forcat dhe vazhdimisht. Ne duhet ta përvetësojmë edukatën marksiste-leniniste që të bëhemi më të zotët dhe të jemi leninistë të vërtetë në të gjithë aktivitetin tonë.

2) Ne duhet ta shohim pajisjen tonë me marksizëm-leninizmin si një mjet të domosdoshëm për forcimin e Partisë sonë, për ruajtjen e unitetit ideologjik, politik dhe organizativ të saj nga çdo frymë e huaj për Partinë tonë.

Këto janë detyra me shumë rëndësi për çdo anëtar partie. Si-

gurimi i këtyre do të thotë që Partia jonë të çelënikoset, të jetë e pathyeshme dhe të kryejë me nder barrën e saj të rëndë në udhëheqjen e klasës sonë punëtore dhe të masave të tjera të varfëra.

Vetëm të pajisur me marksizëm-leninizmin ne do të jemi në gjendje të kemi sytë gjithmonë çelët për të demaskuar dhe shfaqur në Partinë tonë çdo tendencë liberalizmi dhe oportunizmi. Partia jonë nuk pajtohet kurrsesi me këtë frymë që është vija dhe karakteristika e armiqve tanë dhe të klasës punëtore. Lufta e marksizëm-leninizmit kundër oportunizmit gjer në zhdukjen e tij të plotë, duhet të jetë një mësim i madh për ne. Ne duhet të jemi armiq të betuar të oportunizmit dhe ta luftojmë këtë në çdo dukje dhe formë, të armatosur me marksizëm-leninizmin.

Kështu të udhëhequr nga mësimet e marksizëm-leninizmit ne do të nxjerrim mësim praktikë në punën tonë të përditshme dhe do të shtojmë kujdesin për ta ruajtur Partinë nga armiqtë e tjerë që janë jashtë kësaj dhe do të tentojnë të penetrojnë në Parti.

3) Tani po ta shikojmë çështjen e teorisë lidhur ngushtë me detyrën e problemit të mëdha të Partisë në luftën e rindërtimit të vendit ne do të kuptojmë më konkretisht akoma se pa një pajisje teorike sado elementare, ne nuk do të jemi në gjendje ta kryejmë dhe ta çojmë gjer në fund zgjidhjen e problemeve tona politike, shtetërore, ekonomike dhe kulture.

Sot Partia ka një përgjegjësi shumë të rëndë mbi shpatullat e saja. Ajo udhëheq sot vendin për ngritjen e ekonomisë popullore dhe organizimin e jetës së re. Partia në vendin tonë i jep tonin zhvillimit të të gjitha punëve.

Duke kuptuar thellë rolin e Partisë në situatën e sotme ne nxjerrim detyrat e mëdha të çdo anëtar të Partisë në sektorë të ndryshëm të punës: në pushtet, në prodhim, në organizata masash, në ushtri dhe kudo gjetkë.

Anëtar i Partisë është zbatuesi direkt i vijës së Partisë, ai në punën e tij realizon praktikisht çështjet e ndryshme të vijës së Partisë.

Zgjidhja e këtyre çështjeve kërkon njohuri dhe pajisje teorike përndryshe ne do të ishim krejtësisht mekanikë në veprat tona, pa perspektivë dhe jo në gjendje të drejtojmë dhe të organizojmë punën si duhet.

Në realizimin e masave dhe në zbatimin e ligjeve s'ka pasur kujdesin dhe rigorozitetin e duhur. Në shumë punë ka të meta si p.sh. në funksionimin e aparatit të shtetit, në sektorin ekonomik të shtetit etj. Shumë çështje nuk çohen gjer në fund dhe nuk kryhen me përpikmëri detyrat nga ana e anëtarëve të Partisë.

Problemet e mëdha të Partisë siç janë reforma agrare, shtetëzimet, lufta për ngritjen e sektorit ekonomik shtetëror, shtimi i prodhimit, reforma e arësimit, ruajtja e republikës sonë nga ar-

miqtë imperialistë, lufta kundër armiqve të brendshëm dhe sabotimeve nuk kuptohen mirë sot nga ana e Partisë dhe atëherë masat e popullit nuk mund të mobilizohen qind për qind për realizimin e tyre.

Këto nuk duhen marrë si masa të thjeshta administrative. Në të gjithë aktivitetin tonë ka një qëllim dhe masat dhe realizimet nuk janë aksidentale.

Kjo duhet kuptuar mirë dhe duhet kërkuar dhe gjetur qëllimi në çdo çështje.

Masat dhe reformat tona duhet të kuptohen në esencën e tyre.

Këto kanë një bazë dhe një esencë teorike, pse bëhen faktorë për realizimin e vijës së Partisë dhe për shkuarjen tonë drejt socializmit. Këto do të përmbysin nga themelet prapambetjen tonë në ekonomi dhe kudo dhe do të dërmojnë armiqtë tanë. Kështu me luftë ne do të ndërtojmë shoqërinë e re.

Prandaj duhet mobilizimi total i Partisë dhe i popullit, më shumë organizim, disiplinë, hov dhe sakrificë në punë.

Si duket, pra, nuk është çështja se mungon vullneti dhe interesimi në punë, por shokët tanë nuk i kuptojnë thellë problemet tona, nuk i kuptojnë thellë problemet e Partisë dhe direktivat e saja.

Të metat dhe mungesat tona reflektojnë në mënyrë të qartë nivelin e ulët teorik të Partisë, mungesën e edukatës marksiste-leniniste në radhët tona.

Nga ky konfuzion ne nxjerrim se pajisja teorike është detyrë e parë dhe kryesore për çdo anëtar partie, pse kjo është baza e punës sonë. Nuk është pikëpamje marksiste kur shihet puna e teorisë si detyrë suplementare.

Kjo duhet luftuar me të gjitha forcat në Parti dhe të arrijë që çdo anëtar partie ta ndjejë thellë nevojën e teorisë, që të luajë një rol udhëheqës në punën ku e ngarkon Partia. Anëtar i Partisë duhet të studjojë dhe të përvetësojë marksizëm-leninizmin dhe të lidhë në çdo hap të aktivitetit të tij problemet teorike me punën e tij praktike.

Në lidhje me këtë çështje ne duhet të kemi gjithmonë parasysh fjalën e shokut Stalin:

«...praktika bëhet e verbër, po që se nuk e ndriçon rrugën e saj me teorinë revolucionare. Por teoria mund të bëhet një forcë shumë e madhe e lëvizjes punëtore, po që se ajo formohet në lidhje të pandarë me praktikën revolucionare...»¹.

1 J. V. Stalin. Veprat, vëll. 6, f. 92.

FORMAT ORGANIZATIVE ME ANËN E TË CILAVE TË JAPIM EDUKATËN NË PARTI.

Format e ndryshme organizative që do të ngrejme janë mjetet tona, me anën e të cilave ne do të japim edukatën në Parti.

Si mjete kryesore ne do të kemi në qark kurset e natës të kategorisë I e të II, mësimet me korrespondencë, bibliotekën e Partisë dhe konferencat në qendrat e punës. Këto të fundit për masat punonjëse. Kandidatët do të marrin pjesë në kurset e natës të kategorisë I si dëgjues. Këta duhet të shkojnë me rregull sikundër dhe anëtarët e Partisë.

Këtu nuk do të zgjatemi mbi organizimin e funksionimin e këtyre formave pse një gjë e tillë shpjegohet hollësisht në udhëzimet që i ngjiten kësaj qarkoreje.

Ajo që ka më tepër rëndësi dhe që duhet kuptuar mirë është rëndësia që kanë këto mjete për punën tonë të edukimit të Partisë.

Në lidhje me format organizative ne caktojmë, me karakter definitiv për një kohë relativisht të gjatë, kurse dhe mjetet e tjera që u shënuan më sipër. Kjo tregon se ne dalim me disa gjëra më të caktuara, të cilat duhet të na japin rezultate në punën tonë.

Këto forma duhet të ndihmojnë në zgjidhjen e një çështjeje të madhe të Partisë d.m.th. edukimin me parimet themelore të marksizëm-leninizmit të anëtarëve të saj.

Ky është një sistem studimi, të cilin duhet të shkojmë gjithmonë duke e perfeksionuar, mbasi ta kemi ngritur mbi baza të shëndosha.

Komiteti qarkor kur cakton kuadrot që do të venë në kurse duhet të ketë parasysh që këta shokë i vë në kurs për t'i përgatitur teorikisht, t'i bëjë më të zotët dhe t'i vendosë pastaj atje ku ka nevojë.

Prandaj komitetet qarkore kur caktojnë kuadrot për kurset duhet të veprojnë në bazë të këtij kriteri që të zgjidhin me të vërtetë një problem shumë të rëndësishëm, përgatitjen dhe ngritjen e kuadrit.

Kështu ne nxjerrim nga kurset rezultatet konkrete.

Për këtë është e nevojshme që të mbahen shënime në kurs rreth vullnetit, përparimit dhe zhvillimit që kanë kursistët në studim. Këto të vlejné si një pasqyrë ku komiteti qarkor do të mbështetet. Kjo çështje lidhet ngushtë me kontrollin e përgjithshëm dhe të vazhdueshëm që komiteti qarkor duhet të bëjë në të gjitha punët e teorisë, në problemet që shtrohen, në organizimin

e funksionimin e formave të ndryshme organizative me anën e të cilave do të edukojmë Partinë.

Komiteti qarkor duhet të drejtojë punën e teorisë në Parti. Kjo është një nga detyrat kryesore të komitetit qarkor, prandaj bie përgjegjësia mbi qarkorin në rast se puna e teorisë do të çalojë këtej e tutje, duke mos ju dhënë rëndësia e duhur. Komiteti qarkor duke qenë në krye të punës duhet të mobilizojë Partinë në qark për t'ju vënë punës seriozisht për ngritjen e nivelit teorik.

Megjithëse këto forma që do të ngrejme janë mbështetje kryesore në punën tonë për edukimin e Partisë, baza e ngritjes së nivelit teorik të Partisë është studimi individual. Çdo anëtar partie duhet të studjojë individualisht.

Jeta e anëtarëve të Partisë në kurset dhe në shkollat e Partisë do të jetë natyrisht shumë e shkurtër. Kurset e shkollat do t'i japin anëtarit të Partisë bazat principale të studimit. Kjo nuk është e gjitha. Ne në luftën dhe në punën tonë të përditshme kemi për t'u gjendur përpara problemeve të reja, pra, do të na duhen njohuri të reja teorike. Vetëm me studimin individual ne do t'i fitojmë këto, do të thellojmë gjithshka kemi fituar dhe do të zhvillojmë horizontin tonë më tepër.

Kurset e mjetet e tjera nuk e zgjidhin, pra, çështjen e ngritjes së nivelit ideologjik të Partisë. Përpjekja më e madhe e më serioze në Parti duhet të jetë mobilizimi i çdo anëtarit të Partisë për të studjuar nga principet që u caktuan më lart. Studimi individual do ta përcaktojë luftën që do të zhvillohet brenda Partisë për përvetësimin e teorisë. Kjo do të shënojë angazhimin për lartësimin e anëtarëve të Partisë, pse kjo është një luftë e përditshme dhe e lidhur ose më mirë brenda punës së përditshme.

Hovi që duhet të marrë studimi individual në Parti do të masë rëndësinë dhe nevojën që ndjen organizata për t'u edukuar me marksizëm-leninizmin.

Partia do t'i ndihmojë shokët në studimin individual duke rekomanduar material e programe studimi, sipas çështjeve dhe problemeve të anëtarëve të ndryshëm.

Kjo ndihmë do të vlejë që studimi individual të japë rezultate dhe forumet të kenë mundësi ta kontrollojnë këtë.

Forumet e Partisë ndodhen përpara një detyre tjetër me rëndësi: ato duhet të nxisin për studim anëtarët, të kontrollojnë dhe të ndihmojnë përpjekjet e anëtarëve për t'u lartësuar dhe të mbajnë shënime të qarta mbi gjithë zhvillimin e punës.

Studimi individual, në radhë të parë, dhe format organizative që do të ngrihen janë garanci në punën e teorisë dhe kërkojnë

mobilizimin e anëtarëve të Partisë dhe të forumeve tona për të dhënë rezultate konkrete.

Kështu duhet ta kuptojmë rëndësinë e teorisë dhe rëndësinë e forumeve organizative të punës për ngritjen teorike të anëtarëve të Partisë.

KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

UDHËZIME TË KQ TË PKSH PËR ÇËSHTJET ORGANIZATIVE TË PARTISË¹

10 shkurt 1947

KOMITETIT QENDROR TË RKSH
KOMITETEVE QARKORE TË PKSH
ORGANIZATAVE TË PKSH NË USHTRI

Të dashur shokë,

Është e qartë për të gjithë se në fazën e re, në të cilën kemi hyrë për ngritjen e një ekonomie të re popullore, Partisë sonë i dalin përpara detyra të mëdha dhe të rëndësishme.

Kryerja me sukses e këtyre detyrave varet kryesisht në forcat e Partisë dhe në forcën organizative të saj. Influenca e Partisë sonë në gjithë zhvillimin e ekonomisë së vendit, është e lidhur ngushtë me punën organizative të saj. Andaj këtu dalin si çështje organizative të Partisë nevoja e forcimit dhe e shëndoshjes së organizatave tona, nevoja e rritjes së Partisë në të gjithë vendin tonë, në të gjitha qendrat e punës, në qytete dhe në fshatra.

Prandaj kudo që prodhohet dhe punohet për rindërtimin dhe

1 Ky është dokumenti i parë, në periudhën pas çlirimit të vendit deri në Kongresin I të PKSH që përmban udhëzime pak a shumë të plota për çështjet organizative të Partisë. Në këto udhëzime nuk bëhet fjalë për zgjedhjet e organeve të Partisë, gjithashtu përmbahet edhe ndonjë gjë që nuk është plotësisht e drejtë. Sidoqoftë kjo tregon përpjekjet e KQ të Partisë për të rregulluar jetën organizative të Partisë, në mungesë të një Statuti të PKSH. Mirëpo Çoçi Xoxe, sekretar organizativ i PKSH, njëkohësisht edhe ministër i punëve të brendshme, duke ndjekur qëllime armiqësore, e kishte vënë Partinë në fakt nën kontrollin e Sigurimit të Shtetit dhe kishte vendosur në punën e brendshme të Partisë metoda policore. Kjo kishte shkaktuar shkelje dhe çrregullime të rënda në çështjet organizative, kishte sjellë mungesën e demokracisë së vërtetë në jetën e brendshme të Partisë, mungesën e udhëheqjes kolegjiale dhe ndjekjen

ndërtimin e vendit, në fabrikë, në ndërmarrje, në fshat, në kooperative, në administratë, në shkollë etj. duhet të kemi organizatën bazë të Partisë, ta kemi atë të fortë, që të jemi në gjendje të aktivizojmë masat e që të bëhet ajo faktor kryesor në organizimin dhe drejtimin e tyre në vendin e punës për realizimin e planit ekonomik të shtetit.

Nga ana tjetër, sot ne jemi në rrugën e forcimit dhe të modernizimit të ushtrisë sonë. Për kryerjen e kësaj detyre të rëndësishme është e nevojshme që ta kemi aty organizatën e Partisë sa më të fortë.

Këtu del roli i Partisë sonë si fuqia drejtuese e jetës së vendit, roli i saj si levë në aktivizimin, në mobilizimin, organizimin, në drejtimin dhe edukimin e masave punonjëse për ndërtimin e një jete të re. Në prakun e sulmit të Tetorit, në ditët e luftës botërore, Lenini, duke ju përgjegjur armiqve dhe shpifësve, ka deklaruar:

«... tek ajo [partia] ne shohim mendjen, nderin dhe ndërgjegjen e epokës sonë...»¹.

Ja këtë duhet të shohë masa punonjëse në anëtarin e Partisë, në forcën e organizatave tona, atje në vendin e punës për ndërtimin e ekonomisë socialiste.

Që të jenë organizatat tona më të afta për kryerjen e detyrave të shumta, që i bien përsipër, shikohet e nevojshme që të theksohet dhe një herë rëndësia e madhe e punës organizative si dhe rëndësia e forcimit të organizatës bazë të Partisë. Lenini dhe Stalini kanë thënë se organizata shton fuqinë e klasës punëtore njëqind herë.

Ka raste në organizatat tona që tregojnë se ka lëkundje në vijën organizative, gjë kjo që ka ardhur si konsekuencë e një moskokëçarjeje në studimin me kujdes të formave organizative dhe nga një injorim i tyre. Patjetër lëkundje të tilla kanë penguar zhvillimin e drejtë të punës së Partisë. Për të gjitha këto janë

e një politike të gabuar në kuadrot. Duke parë që gjendja organizative e Partisë nuk ishte e kënaqshme, shoku Enver Hoxha në shkurt të 1947-s shtroi përpara Byrosë Politike të KQ nevojën e analizës së gjendjes së jetës së brendshme të Partisë dhe të marrëdhënjeve parti-pushtet. Për këtë u ngarkua Koçi Xoxe që të paraqiste raport në Byronë Politike. Por ai, megjithëse e pranoi, nuk e kreu asnjëherë këtë detyrë dhe në fakt gjendja organizative e Partisë nuk u muar asnjëherë në shqyrtim as në Byronë Politike as në KQ të PKSH. Plenumi XI i KQ dhe Kongresi I i PKSH duke dënuar rëndë veprimtarinë armiqësore të grupit fraksionist të Koçi Xoxes, vendosën plotësisht normat leniniste në jetën e brendshme të Partisë.

¹ V. I. Lenin. Veprat, vëll. 25, f. 303.

përgjegjës shokët tanë, të cilët nuk kanë treguar interesin e duhur për jetën dhe zhvillimin e organizatave bazë, për studimin e formave organizative, kështu p.sh. edhe pas instruksioneve të precizuara mirë në letër nga Komiteti Qendror dhe pasi këto u punuan dhe u diskutuan në Drejtorinë politike, akoma nuk është e qartë në Divizionin VIII struktura e Partisë, nuk është e qartë se kush rekruton në Parti; kemi shembuj që tregojnë se ndryshe është vepruar në një qark dhe ndryshe në një tjetër për mbledhjet e celulës me kandidatët, për ngritjen e «bërthamë-celulës», për jetën në celulat. Ka gjithashtu shembuj, që tregojnë lëshime dhe shthurje në çështje organizative, ka anëtarë partie që mungojnë në mbledhje të celulës, pa ndonjë arsye, nuk paguajnë kuotizacionin për dy-tre muaj me radhë etj.

Me qëllim që të evitojmë raste të tilla dhe që të kemi më qartë punën tonë organizative, punën dhe rolin e Partisë në organizatat e masave si dhe për të caktuar më mirë marrëdhënjet më të drejta në mes të Partisë dhe të pushtetit, Komiteti Qendror e pa të nevojshme që të japë edhe një herë disa udhëzime të precizuara mbi këto çështje:

CELULA

Partia jonë është ndërtuar në bazë *prodhimi* dhe të *territorit*. Për ndërtimin e organizatës së Partisë në ushtri si dhe për funksionimin e organizatës bazë atje, është theksuar në letrën tonë Nr. 1711 datë 12.XII.1946.

Celulë, si organizatë bazë të Partisë, sot ne kemi në vendet e prodhimit, në administratë shtetërore, në lagje dhe në fshat, d.mth. të gjithë anëtarët e Partisë që marrin pjesë në prodhim në një fabrikë, që punojnë në një administratë, në një lagje apo në një fshat, ata bëjnë jetën e Partisë në celulën e fabrikës, të pushtetit, të lagjes apo të fshatit. Kjo është e natyrshme, pse aty ku komunisti punon, aty ka detyra, prandaj aty duhet të bëjë jetën e Partisë, e cila e mëson dhe e edukon atë për të kryer detyrat e tija.

Nuk duhet të ndodhë si p.sh. në Elbasan dhe Gjirokastër, ku me qëllim që të kemi celulë në lagje, ngrihet atje një celulë me shokë që punojnë në vende të ndryshme: një shok i lagjes me një shok të pushtetit të nënprefekturës, një shok i fabrikës ose një shok i lagjes, me një të spitalit etj. Një celulë e tillë është formale, jeta e Partisë në celula të tilla nuk është e rregullt dhe ngritja e celulave të tilla nuk është e drejtë.

Mbi celulën, si organizatë bazë e Partisë, bien detyra të mëdha dhe të rëndësishme. Ajo është zbatuesja e vijës së Partisë në jetë, asaj i bie përgjegjësia që të konkretizojë në vepër vijën e Partisë. Prandaj ajo nuk bën vetëm agitacionin në lidhje me një çështje

të pushtetit, për shembull, për zbatimin e reformës agrare, por ajo në radhë të parë mobilizon forcat e saja dhe të gjitha masat punonjëse për zgjidhjen e kësaj çështjeje, d.m.th. për zbatimin e drejtë të reformës agrare. Vetë ligji i reformës agrare është një pasqyrim i vijës së Partisë, prandaj për zbatimin e drejtë të këtij ligji celula mobilizon masat e fshatit, d.m.th. këtu ajo drejton masat për realizimin në vepër të reformës, që do të thotë në fjalë të tjera për ndarjen e drejtë të tokave fshatarëve, që përfitojnë nga reforma. Vetëm ngritja e çështjes së korrektimit të reformës agrare tregon se celula atje në fshat nuk e shpuri gjer në fund ligjin e reformës agrare, gjer në zbatimin e tij të drejtë, kjo tregon se celula u kufizua vetëm në të propaganduarit.

Në punën e saj për realizimin konkret të vijës së Partisë, celula mobilizon masat punonjëse, organizon dhe drejton këto. Këtu ajo me punën që bën lidh masat me Partinë, me vijën e saj. Për këto celula është në zemrën e masave, ajo punon për ngritjen politike dhe edukative të masave, ajo punon për formimin e koshiençës së masave, për të krijuar në ato besimin në forcat e tyre dhe në udhëheqjen e drejtë të Partisë dhe nga ana tjetër ajo duhet të jetojë me masat për të mësuar prej tyre, të ndjejë aspiratat e tyre, t'i njohë problemet dhe t'i drejtojë ato në vijën e Partisë për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Prandaj celula atje ku është në fabrikë, p.sh. ka për detyrë të punojë për ngritjen e koshiençës së punëtorisë së fabrikës që të prodhohet sa më shumë, për forcimin e disiplinës së punës, për zhvillimin e emulacionit dhe të hovit sulmues, të interesohet për konditat higjienike të fabrikës, për shëndetin e punëtorëve, të kujdeset për përmirësimin e konditave materiale duke ngritur mensa, duke punuar kopshte, të interesohet për zhvillimin kultural dhe teknik të masës së punëtorisë atje etj.

Celula ka për detyrë të punojë vazhdimisht, të ketë preokupacion të vazhdueshëm për rritjen e Partisë, për rekrutimin¹. Celula ka për detyrë të ruajë Partinë, të mos hyjnë njerëz të huaj në Parti, të ruajë nga shtrembërimet vijën e Partisë, të luftojë me durim, pa hezitim dhe në mënyrë të pamëshirshme çdo tendencë të gabuar, çfarëdo pikëpamje të huaj për Partinë. Celula ka gjithnjë e para fjalën, për të dënuar anëtarët e saj qoftë me masa edukative, qoftë me dhënjen e dënimit ekstrem, përjashtimit nga Partia.

Celula punon për ngritjen e nivelit ideologjik dhe të aktivitetit politik të anëtarit të Partisë. Në celulë anëtari i Partisë zhvillohet dhe forcohet, këtu kontrollohen gjithashtu cilësitë dhe puna e tij.

Celula ka për detyrë të marrë pjesë aktive në jetën politike

1 Është fjala për pranimet në Parti.

dhe ekonomike të vendit. Celula e fabrikës duhet të njohë mirë organizimin e prodhimit të fabrikës, të dijë mirë procesin e prodhimit dhe të punojë vazhdimisht për zotërimin e teknikës; celula në fshat të njohë mirë organizimin e kooperativave të shitblerjes, të dijë mirë ligjin e reformës agrare, ligjin e arësimit të detyrueshëm; celula e pushtetit të njohë mirë organizimin e aparatit të shtetit, të mësojë vazhdimisht që të bëhet një administratore e vlefshme dhe e disiplinuar e pushtetit. Është detyrë me rëndësi të madhe për të gjitha organizatat bazë, si dhe për forumet, të njohin ligjet e pushtetit tonë, në të cilat është konkretizuar vija e Partisë, vija politike, ekonomike dhe sociale e Partisë sonë, të njohim karakterin e thellë revolucionar të këtyre ligjeve dhe të reformave të pushtetit tonë.

Njohja e organizimit të ekonomisë sonë dhe e ligjeve të pushtetit nga organizatat tona është e domosdoshme për të siguruar pjesëmarrjen aktive në jetën politike dhe ekonomike të vendit. Është absurde të mendohet për një pjesëmarrje të tillë, në qoftë se nuk ngrihet me gjithë forcën nevoja e njohjes së organizimit të ekonomisë së vendit, e njohjes së ligjeve, e njohjes së teknikës. Celula duhet të ketë vazhdimisht në rend të ditës këtë çështje kaq të rëndësishme të Partisë sonë. Kjo çështje është e lidhur me tërë vijën tonë dhe me vigjilencën. Anëtarët e Partisë duhet të dinë mirë, se kudo që ata të punojnë duhet të vigjilojnë, duhet të dinë, të jenë të zgjuar, të jenë mjeshtër të punës që u ka ngarkuar Partia. Kur ti nuk di, kur ti nuk i përgjigjesh me punë thirrjes së Partisë për të mësuar vazhdimisht, armiku ka mundësi të bëjë punën e tij pa e kuptuar ti, pa e ndjerë ti, se ai po të saboton. Po nuk dite, nuk ke si të vigjilosh. Injoranca është shesh i lirë për punën e armikut. Po nuk dite ligjet e pushtetit, nuk di politikën e shtetit. Në fazën e ndërtimit të ekonomisë së re popullore, një gjë e tillë është shumë e dëmshme, prandaj anëtarët e Partisë duhet të jenë të zgjuar dhe të vullnetshëm, për të mësuar sa më shumë. Edhe një herë akoma duhet të mësojmë, të mësojmë vazhdimisht që të jemi vigjilentë të zgjuar, që të përmbushim detyrën tonë si anëtarë partie. Celula duhet t'i drejtojë përpjekjet e saja jo vetëm për edukimin ideologjik dhe politik të anëtarëve të saj, por njëkohësisht për ngritjen e njohurive teknike të tyre; të dijë anëtari i Partisë që punon në fabrikë mekanizmin e maqinerisë, nga punëtor i thjeshtë të bëhet maqinist i mirë dhe nesër drejtues i fabrikës, të dijë anëtari i Partisë në fshat se si mbillet më mirë për të prodhuar sa më shumë dhe si të bëhet një bujk modern etj.

Ja këto janë detyrat që u ngarkon Partia anëtarëve të saj.

Në organizatat tona ka një tendencë që në celula si dhe në vetë forumet të mos flitet fare për zhvillimin e gjendjes politike të jashtme dhe të brendshme, që në organizatë të krijohet opinioni se nuk duhet marrë me çështje politike, si p.sh. anëtari i Komi-

tetit të Partisë të Konispolit pyet me drojtje për komisionin e krijuar pranë UNO-s¹, i cili do të bëjë hetime mbi gjendjen në Greqi. Një gjë e tillë ka ardhur kryesisht nga se më parë në celulatat tona, pjesa më e madhe e kohës së mbledhjes së celulës kalonte në bisedime shpeshherë të tepruara dhe të përgjithshme për çështjet politike. As njëra as tjetra prej këtyre nuk janë të drejta; në mbledhjet e celulës flitet për ngjarjet kryesore dhe celula t'i mësojë anëtarët e saj të ndjekin vazhdimisht shtypin dhe ku ka mundësi të dëgjojnë dhe radion.

Çdo celulë ka një sekretar, i cili është përgjegjës i celulës. Ky është përgjegjës përpara komitetit të nënprefekturës për të gjitha punët e saja: për rekrutimin, për ngritjen politike dhe ideologjike të anëtarëve të saj, për agjit-propin si dhe për financën, mbasi ky do të shkruajë në taserën e anëtarësisë së Partisë pagesën e kuotizacionit.

Në celulë, që ka më shumë se pesë anëtarë, sekretari ka dhe dy ndihmës, njëri për rekrutimin dhe tjetri për agjit-propin, por, e përsërisim, ai është gjithnjë përgjegjës për të bërë punën e Partisë në bazë.

Kur celula ka më pak se pesë anëtarë partie, atëherë ka vetëm një sekretar, pa ndihmës. Celulat e ndërmarrjeve duhet të jenë të veçanta dhe jo të përziera me shokë që punojnë në një vend tjetër, p.sh. të jetë e veçantë celula në ATASH, në NTSH, në NSHN etj.

Në dikastere dhe në komitetet ekzekutive të prefekturave ku kemi celula me shumë anëtarë partie, atëherë celula ndahet në «grup-celula», sipas sektorëve të punës, në dikastere p.sh. sipas drejtorive dhe degëve. Gjithashtu dhe në fabrika në rastet kur kemi celula të tilla edhe këtu celula ndahet në «grup-celula», sipas reparteve të punës. Celula që ndahet në «grup-celula» ka një byro, e cila krijohet nga përgjegjësi i celulës plus përgjegjësit e «grup-celulave».

Celula bën mbledhjet e saja të zakonshme një herë në 15 ditë *bashkë me kandidatët* (Celula që ndahet në «grup-celula» këtu bën përjashtim: kjo mbledhet një herë në muaj dhe «grup-celulat» e saja mbledhen një herë në javë).

Përveç këtyre, për gjëra speciale celula mund të bëjë një mbledhje të jashtzakonshme. Për gjëra me karakter konspirativ, për rekrutime, përjashtime, dënime etj. celula bën mbledhjen e saj të veçantë pa kandidatë. Në mbledhjen e zakonshme, diskutohet mbi të gjitha problemet që ka celula në fabrikë, në fshat apo në pushtet, flitet mbi situatën, raportohet puna e bërë, bëhet kritika dhe autokritika duke marrë pjesë në këto probleme njësoj,

¹ Organizata e Kombeve të Bashkuara.

si anëtarët e Partisë edhe kandidatët dhe merren vendime në lidhje me detyrat që i dalin përpara celulës. Kandidatët kanë vetëm votë konsultative. Të ruhemi që këto mbledhje duke menduar se këtu janë kandidatët të mos marrin karakter formal, siç ngjet p.sh. në Peshkopi ku kandidati vjen vetëm për të njoftuar ndonjë parullë të armikut. Kjo është e dëmshme. Kandidati duhet të dijë se është kandidat partie, se bën pjesë në celulë, ku ai do të edukohet gjatë stazhit si kandidat dhe ku do të provohet devocioni i tij për komunizmin. Ta dijë ai kandidat se nesër do të bëhet anëtar partie. Është krejt e dëmshme dhe aspak e drejtë që të mos kesh kurajë, ose të mendosh se kandidatit nuk duhet t'i flitet për Partinë, si p.sh. në Vlorë ku sekretari i celulës së lagjes Varosh i dërgoi një letër instruktorit tonë për ta paralajmëruar se ai po merrte pjesë në mbledhjet e një celule, ku ishin dhe kandidatët. Ja se ç'përbante letra: «këtu janë edhe kandidatë, prandaj mos kërko që të mbahet proces, të përmendet fjala celulë...»¹ etj. Në Shkodër ku kandidati mori pjesë në mbledhjen e celulës tha: «tani e ndjej veten se jam afër Partisë, sonte jam shumë i kënaqur». Ja kjo është jeta e rregullt e stazhit të kandidatit, kjo do të thotë të bësh punë me kandidatët, do të thotë të punohet për përgatitjen e anëtarit të nesërm të Partisë.

Lidhjet në mes të komitetit të n/prefekturës dhe celulës duhet të praktikohen me *kontakte personale* dhe me raporte verbale. Vetëm për gjëra organizative celula i shkruan letër komitetit të n/prefekturës. Kontakti personal me përgjegjësin e celulës (i cili duhet të jetë më i dendur për celulat e qytetit meqenëse aty ka më tepër mundësi) dhe raportet verbale do të sigurojnë një lidhje më të ngushtë midis celulës dhe komitetit dhe një kontroll më të mirë të punës.

Nga informata të sakta dhe të dhëna në kohën e duhur, nga raporti i drejtë dhe real i gjendjes, nga njohja mirë e të gjitha problemeve të celulave të tija, komiteti i n/prefekturës do të ketë mundësi të ndërhyjë ku duhet për të ndihmuar celulat në zgjidhjen e problemeve dhe në zbatimin e mirë të detyrave të tyre në praktikë.

Kjo është metoda më praktike dhe më e drejtë e lidhjes që duhet të ekzistojë midis celulës dhe komitetit të n/prefekturës.

Përsa u përket raporteve duhet të theksojmë:

Komiteti i n/prefekturës i dërgon komitetit qarkor një herë në muaj një raport, por komiteti qarkor duhet të ketë me komitetin e n/prefekturës edhe takime me raporte verbale të shpeshta për çdo çështje me rëndësi.

¹ Pikat janë të vetë dokumentit.

Komiteti qarkor i dërgon Komitetit Central një raport të për-muajshëm, i cili duhet të përmbajë këto pika:

1. — Gjendja e qarkut
Gjendja politike dhe ekonomike
Reaksioni — Puna e Frontit
2. — Gjendja organizative
Puna e udhëheqjes — Komitetet
dhe personat
Problemet e organizatës
3. — Rinia Komuniste dhe Rinia Popullore
4. — Pushteti
5. — Sindikatat
6. — Agjit-propri
7. — Gruaja

Përveç raportit mujor komiteti qarkor i dërgon Komitetit Qendror edhe letra për gjëra të caktuara, relacione, gazetën lokale dhe material tjetër propagandistik që nxirret në qark.

Siç dihet, në vendet ku kemi më pak se tre anëtarë partie ngrihet «bërthamë-celula». Kjo tregon se Partia jonë nuk mund të lëshojë nga influenca e saj as edhe ata sektorë ku nuk ka numrin e caktuar të anëtarëve të Partisë për krijimin e organizatës bazë. Është theksuar qysh në fillim se këto duhet t'i shfrytëzojmë sa të jetë e mundur më tepër pse ngritja e «bërthamë-celulave» do të na ndihmonte mjaft për sa i përket çështjes së shtrirjes organizative. Por këtu të kemi kujdes, që duke dashur të kemi një shtrirje të gjerë të organizatës, të mos shpërndajmë celulën, siç ka bërë p.sh. Gjirokastra, e cila kishte në një krahinë një celulë me pesë anëtarë, shpërndau celulën dhe ngriti pesë «bërthamë-celula». Kjo nuk lejohet. Gjirokastra duhej të vepronte kështu: të mbante celulën me tre-katër shokë dhe në fshatrat më të largëta të ngrinte një «bërthamë-celulë».

REKRUTIMI

Megjithëqë ky problem është ngritur dhe herë të tjera, duke parë procesin e rekrutimit të kohëve të fundit është e nevojshme që të sqarohet mirë dhe të precizohet drejt çështja e rekrutimit, meqë kemi raste në organizatat tona, që tregojnë se nuk ka qenë i qartë orientimi i punës për t'i dhënë zgjidhjen e drejtë këtij problemi të rëndësishëm për Partinë tonë.

Marrim p.sh. Divizionin VIII, ku prej prillit deri në dhjetor kemi vetëm 29 të rekrutuar; në Tiranë, ku gjatë 11 muajve të vitit 1946 janë rekrutuar 66 anëtarë partie dhe vetëm gjatë një muaji, në dhjetor të 1946-s, janë rekrutuar 48; në Gjirokastrë ku gjatë tre muajve nuk është bërë asnjë rekrutim dhe nga një llogari e n/prefekturave rezulton se Delvina gjatë vitit 1946 ka pasur 26 të përjashtuar dhe 13 të rekrutuar dhe Saranda 18 të përjashtuar dhe 11 të rekrutuar. Ja ku është anomalia për rekrutim. Këtu del dhe detyra për organizatat e Partisë në terren dhe në ushtri, që të bëjnë një përpjekje për të normalizuar rekrutimin. Kur është folur për rekrutim, ka pasur rekrutim dhe kur s'është folur është lënë mënjanë, për të mos thënë është harruar. Komisari i Divizionit V me fjalë të tjera thotë këtë: «ne s'kemi pasur një qëndrim në rekrutim, kur u kemi thënë shokëve poshtë që rekrutimi është i rëndësishëm, duhet të rekrutohen, është bërë rekrutimi, kur nuk është thënë, s'ka pasur rekrutim. Tani s'dimë se si të themi». Po kështu mund të themi edhe për repartet edhe për organizatat e reparteve autonome, të cilat megjithëse përbëjnë 19,5 për qind të forcës së Partisë në ushtri ato nuk kanë rekrutuar gjithë vitin 1946 veçse 10 për qind të rekrutimit të përgjithshëm.

Ka gjithashtu shembuj, që tregojnë kriterin e dobët, të ndjekur në rekrutim. Durrësi propozon dy elementë të korruptuar, jo të lidhur me komunizmin, njëri prej tyre ka qenë milic i parë i fashizmit; Gjirokastra dy milicë, një oficer fashist ose element të kaluar nga moshja, që s'kanë asnjë të ardhshme. Me këto propozime të thuash se ka shteruar masa, se s'ka njerëz në masë!

Dobësia në rekrutim ka ardhur edhe pse organizatat tona nuk ditën të përfitojnë mjaft nga revizioni¹, nuk ditën të nxjerrin që andej një eksperiencë të gjallë të domosdoshme për stabilizimin e rekrutimit, për vënien e rekrutimit në një rrugë normale, për forcimin e kriterit.

Ka raste në Partinë tonë ku shikohet se janë preferuar për të futur në Parti elementë, që kanë qenë më pak të zënë me punë, pse këta kanë qenë më të lirë për të lëvizur sa në një vend në

¹ Revizionimi — u krye në Partinë tonë, para ndarjes për herë të parë të tesarave të Partisë, sipas vendimit të Plenumit IV të KQ të PKSH (17 tetor 1945). Ai mbaroi në korrik 1946. Në përfundim të revizionimit u përjashtuan nga Partia 1 246 anëtarë, d.m.th. 10,2 për qind e efektivit.

Si rezultat i punës armiqësore të grupit të Koçi Xoxes revizionimi në Parti nuk u krye plotësisht sipas rregullave organizative marksiste-leniniste, prandaj gjatë revizionimit u kryen shumë gabime. Në Parti mbetën elementë që nuk e meritonin, ndërsa u përjashtuan edhe njerëz padrejtësisht.

tjetrin. Janë preferuar elementë që kanë ditur të flasin pesë fjalë të bukura dhe nuk është rekrutuar ai më punëtori, se është dashur më tepër punë për t'i mësuar atij shkrim, lexim etj. Është harruar në organizatat se Partia jonë si gjithë partitë komuniste shikon më tepër kualitetin se kuantitetin; në lidhje me këtë Lenini ka thënë:

«Është më mirë që dhjetë nga ata që punojnë të mos e quajnë veten anëtarë të partisë... , se sa një llafazan të ketë të drejtën dhe mundësinë të jetë anëtar i partisë»¹.

Jo ai që është më pak i zënë me punë, por ai më punëtori duhet të hyjë në Partinë tonë.

Është theksuar sa herë se rekrutimi nuk mjafton që të ngrihet si problem në qarkor apo në komitetin e n/prefekturës, por duhet që rekrutimin ta bëjnë një problem preokupant dhe të vazhdueshëm të masës së Partisë, të celulës. Celula të njohë mirë rekrutimin si një nga çështjet më të rëndësishme të Partisë, kjo është detyra e bazës. Kjo do të thotë se anëtar i Partisë si individ duhet të njohë detyrën, që ai ka për të rritur dhe për të forcuar Partinë e tij. Kjo është një nga detyrat kryesore të komiteteve qarkore; rekrutimi nuk do të bëhet ashtu si do Partia, në qoftë se anëtar i Partisë nuk e njeh rekrutimin si detyrë të tij. Çështja e rekrutimit d.m.th. çështja e rritjes së Partisë është një ligj i vetë ekzistencës së Partisë, është lidhur me vetë qenien e Partisë. Ka pasur raste në Partinë tonë, si p.sh. në Peshkopi, ku rekrutimi është bërë nga komiteti i n/prefekturës direkt. Një gjë e tillë nga njëra anë është e gabueshme se tregon që udhëheqja nuk mbështetet në bazë për problemin e rekrutimit, i heq bazës një nga detyrat më të rëndësishme, ndërsa nga ana tjetër është më e dëmshme pse ka mundësi ose të kufizohet rekrutimi, ose, duke mos i njohur njerëzit, të hyjnë në Parti elementë jo të shëndoshë.

Dobësia në rekrutim ka ardhur dhe nga lidhja e dobët me masat e më shumë nga mosditja e shfrytëzimit të lidhjeve me masat. Shembull është Gjirokastra, një nga prefekturat ku Lufta nacional-çlirimtare ka qenë më e madhe, e cila fiton garat e 29 Nëntorit, ku rinia fiton flamurin e kongresit, grua ja del e dyta dhe në organizatë në muajt korrik, gusht, shtator nuk kemi asnjë të rekrutuar. Organizata e Tiranës, organizata më e madhe, në rekrutim vjen pas Peshkopisë, një organizatë shumë më e vogël dhe me një terren tjetër. Përveç të tjerave shkaku i një rekrutimi të tillë në organizatën e Tiranës është se këtu janë edhe dikasteret, ku është bërë një punë e dobët politike dhe s'ka pasur preokupacion për rekrutim. Në këtë ka influencuar pjesërisht

1: V. I. Lenin. Veprat, vëll. 6, f. 581.

edhe përbërja e masës së nëpunësve. Prandaj këtu duke marrë parasysh konditat speciale të dikasterëve, organizata të ketë kujdes të sjellë në Parti elementët më të mirë, teknikët më të zot, më të ndershëm, që kanë qëndrim politik të mirë, që punojnë me ndërgjegje dhe të mos i lënë mënjanë pa i edukuar dhe pa i lidhur me vijën tonë.

Nuk janë shfrytëzuar aksionet, reformat tona, nuk është parë aksioni, reforma nga ana e rritjes së organizatës së Partisë. Me një fjalë këto nuk janë shfrytëzuar nga ana politike. Shembulli i Korçës, në Maliq, aksioni më i madh i vendit tonë, ku janë rekrutuar vetëm tre anëtarë partie. Durrësi, në Jubë nuk bën asnjë rekrutim. Në të tilla raste ka pasur edhe justifikime pa vend, si «nuk është bërë rekrutimi, pse organizata ka qenë e zënë me punë», por ne tamam këtu e duam rekrutimin, të lidhur me punën dhe jo të ndarë. Tamam në punë ku ne kemi bërë mobilizimin, aktivizimin e masës shikohen njerëzit, kush dallohet, kush është për Partinë. Këtu forcohet kriteri i rekrutimit që kërkojmë ne.

E njëjta gjë ka ndodhur edhe me reformën agrare, reforma më e madhe e pushtetit tonë. Organizatat tona nuk menduan që ta rritin Partinë me fshatarë të varfër, kur këtyre u jepej toka nga pushteti, një punë e tillë nuk u bë në masat e fshatarësisë.

Ja ku është gabimi: nuk u mësuan organizatat tona, organizatat bazë, celula, se në këtë kohë kur ne me reforma ashpërsojmë dita-ditës luftën e klasave, kur ne me përpjekje kundër pengesave dhe vështirësive të ndryshme po rindërtojmë dhe ndërtojmë vendin tonë, të shohin të qartë, shumë të qartë kriterin që duhet të ndjekin në rekrutim.

Ka pasur gjithashtu raste, si p.sh. Berati që të ngrejë rekrutimin në plan: celula x e Skraparit do të rekrutojë gjatë tre muajve kaq anëtarë partie; celula y e Lushnjës kaq anëtarë partie etj. Që të ketë komiteti qarkor një perspektivë se si do të vejë rekrutimi gjatë tre muajve në këtë apo në atë n/prefekturë, kjo është e domosdoshme, por që komiteti i n/prefekturës të vihet para një plani të caktuar për rekrutim, kjo është e gabuar bile e dëmshme. Komitetet e n/prefekturave orientohen dhe ndihmohen për zgjidhjen e drejtë të çështjes së rekrutimit, por nuk mund të caktohet një plan nga lart që t'i përgjigjet gjendjes reale të terrenit të tij.

Një e metë kryesore që ka shkaktuar dobësimin në rekrutim, dhe që është në të gjitha organizatat pa përjashtim, është dhe puna e dobët dhe konsideracioni i gabuar me kandidatët dhe rininë komuniste.

Kandidatët nuk janë të njohur, akoma sot nuk njihen nga celula, me ta nuk është bërë punë, nuk është konsideruar ai kandidati i sotëm si anëtar i nesërm i Partisë, nuk është bërë pyetja për një element që kur bëhet kandidat sot nëse bëhet apo jo anëtar partie nesër. Këtu del dobësia e kriterit në vetë rekrutimin për

kandidat dhe pikëpamja jo e qartë për stazhin e kandidatit. Durrësi thotë: «kemi disa kandidatë të cilët sikur të kenë mbushur të gjashtë muajt, nesër i fut në Parti, kemi dhe disa të tjerë, ndër të cilët ka që kanë mbushur edhe vitin, por zor që të hyjnë në Parti». Gjykoj se ngre më shumë se një herë çështjen e revizionit në kandidatët, ose ngjet si në Tiranë, kandidatët qenë haruar; ngrihet çështja e rekrutimit të dobët se gjatë 11 muajve ka rekrutuar 66 dhe vetëm në dhjetor i vijnë komitetit qarkor, mbasi u pa në të gjitha qoshet, 80 propozime. Ç'tregon kjo? Asgjë tjetër përveç punës së dobët me kandidatët.

Si në kandidatët ashtu dhe në rininë komuniste nuk është bërë shumë punë që të zhvillohet në të dëshira për t'u bërë anëtarë partie. Si në kandidatët dhe në rininë është folur pak për Partinë, nuk është konsideruar rinia si rezervë e Partisë, nuk është shfrytëzuar sa duhet pjesëmarrja e rinisë në ndërtimin e vendit.

Vazhdimisht flitet për punën tonë të dobët me sindikatat, për nivelin e ulët të punëtorisë sonë, për punën e dobët edukative këtu etj. dhe nga kjo del pastaj, si p.sh. në Durrës rekrutimi [është] i dobët në masën e punëtorisë. Berati ka rekrutim më të dobët në Kuçovë. Është e gabueshme të mendosh, kjo është kryesisht për qarqe, ku ka grumbullime punëtorësh, për përmirësimin e kriterit të rekrutimit, për forcimin e kompozicionit social të organizatës së Partisë, në qoftë se nuk forcojmë punën me sindikatën.

Me vënien e disa rregullave për pranime në Parti, si stazhi prej gjashtë muajsh, çështja e garantëve dhe mosha 18 vjeç, nga të gjitha organizatat, pa përjashtim, u ngrit çështja e gjashtëmuajshit dhe ajo e garantëve si pengesë për rekrutim që shkaktojnë frikë në përgjegjësini që do të merret për të propozuarin. Në të vërtetë këto vijnë si rrjedhim i punës jo të drejtë, që është bërë për rekrutimin, që u theksua më lart dhe nga mënyra me të cilën u shtrua në organizatat tona veçanërisht çështja e garancisë. Ku është frika e garancisë? Ku është fjala për të ruajtur Partinë, me se është lidhur kjo frikë përveçse me dobësinë e punës së rekrutimit? Ja këtu duhet të dalë e qartë garancia për ruajtjen e Partisë, garancia që në Parti të hyjnë elementët e klasës, më aktivët, më të zgjuarit, më të devotshmit për çështjen e Partisë.

Nga të gjitha që përmendëm del se çështja kryesore përsa i përket rekrutimit është *orientimi*, që duhet t'i japim këtij problemi.

Me një orientim të drejtë ne do të mundemi të normalizojmë rrugën e rekrutimit dhe do të forcojmë kriterin që ndiqet në rekrutim. Po ç'do të thotë të orientosh drejt rekrutimit? Ç'duhet të kuptojmë me këtë? Ku do ta orientojmë rekrutimin sot?

Të orientosh drejt rekrutimit sot, do të thotë ta ngresh këtë çështje të lidhur ngushtë me luftën që bëjmë për rindërtimin dhe ndërtimin e vendit, do të thotë të lidhur ngushtë me luftën

për ngritjen e ekonomisë së re në vendin tonë dhe forcimin dhe modernizimin e ushtrisë.

Atje ku kërkohet që të kalohet norma, ku kërkohen sakrificat, privacione, vigjilencë, kërkohet puna me gara, ku kërkohet që të mësosh sa më shumë, që të bëhesh teknik më i mirë, bujk i përparuar, administrator i aftë, ku ka luftë kundër armikut të klasës, ku kërkohet që të bëhesh ushtar i denjë i popullit, që të mësosh armën tënde, të dish ta përdorësh më mirë nga të tjerët, që të jesh ushtar vigjilent i disiplinuar për të mbrojtur atdheun tënd, që shkon drejt socializmit, veprën e madhe të ndërtimit të masave punonjëse, këtej do të dalin njerëzit më të mirë për në Parti, më të devotshmit, ata që dallohen në punë, më të zgjuarit. Dhe të tillë njerëz ka boll në masë, por duhet punë, punë vazhdimisht për të rritur dhe forcuar Partinë tonë, duke rekrutuar me guxim njerëzit më të mirë.

Nga sa u tha del gjithashtu se rekrutimin për në Parti duhet ta marrim të lidhur ngushtë me punën që bëhet dhe me kriterin që ndiqet në rekrutimin e njerëzve nga masat e gjera të aktivizuara në organizatat popullore, Front, Rini, Grua dhe Sindikatë për në stazhin e kandidatit dhe për në Rininë Komuniste dhe pastaj nga vetë puna që bëhet me kandidatët gjatë stazhit dhe në aktivet e rinisë komuniste.

Veçanërisht është për t'u theksuar rëndësia e punës me rininë si dhe rekrutimi në masat e grave.

Vetë puna e rinisë komuniste, kontributi i saj i madh për rindërtimin dhe ndërtimin e vendit duhet të shërbejnë për ta lidhur atë sa më shumë me Partinë, për të ngjallur në të dashurinë për Partinë, dëshirën për t'i dhënë sa më shumë Partisë dhe dëshirën e madhe që të rinjtë komunistë duhet të kenë për t'u bërë anëtarë partie. Prandaj në aktivet e rinisë komuniste duhet të flasin më shumë për Partinë, të njihet nga rinia puna, detyrat dhe roli i Partisë, në mënyrë që ajo ta konsiderojë veten si pjesë të pandarë të Partisë dhe këtu ajo ta shohë veten e saj të angazhuar për kryerjen e detyrave që i përkasin.

Në lidhje me këtë duhet të kemi parasysh se rekrutimi për në Parti nga rinia komuniste në pjesën më të madhe, d.m.th. për të rinjtë më aktivë, më të zgjuar dhe më të devotshëm për Partinë do të bëhet direkt nga aktivet pa kaluar stazhin e kandidatit.

Nga ana tjetër organizatat duhet të orientojnë rekrutimin për në Parti edhe në masat e grave. Kjo është ngritur dhe herë të tjera, por megjithatë përqindja e gruas në rekrutimin e fundit vazhdon të jetë akoma fare e vogël. Edhe ato pak shoqe që kanë hyrë në Parti nuk janë rekrutuar nga një punë e veçantë e jona që bëhet me gratë, në lagje dhe në fshat, por si një rekrutim i rastësishëm, që del nga numri global i të rekrutuarve. Kjo si në të kaluarën, është si konsekuencë e punës sonë të dobët në orga-

nizatën e gruas dhe se organizatat tona nuk kanë parë në këtë organizatë ku bëhet mobilizimi dhe aktivizimi i gruas për rindërtimin dhe ndërtimin e vendit, një burim të natyrshëm për rritjen e radhëve të Partisë sonë me gratë më të mira, me gratë e varfëra dhe më aktivet.

Një tjetër shkak që ka sjellë kufizimin e rekrutimit në gruan ka qenë se duke mos marrë parasysh konditat reale, ku gjendet gruaja jonë sot, duke mos marrë parasysh gjithashtu zhvillimin e saj, nuk është vërejtur drejt çështja e rekrutimit këtu, duke kërkuar prej saj po ato kondita, që janë kërkuar nga burrat. Kjo ka qenë një minus në punën tonë të dobët në organizatën e gruas dhe së bashku, janë dhe vazhdojnë të jenë shkaqet kryesore të kufizimit të rekrutimit nga radhët e gruas.

Stazhi i kandidatëve është i domosdoshëm për dy gjëra: që kandidati të njohë vijën dhe rrugën e Partisë, të njohë Partinë, të mësojë detyrat dhe të drejtat e anëtarit të Partisë, të ngrihet politikisht dhe ideologjikisht dhe që organizata të njohë në punë kandidatin, cilësitë e tija, të njohë devocionin që tregon ky kandidat për Partinë, për komunizmin.

Është pikërisht këtu, ku celula duhet t'i japë kandidatit ndihmën më të madhe në ngritjen, edukimin dhe aktivizimin e tij, për t'u bërë anëtar partie. *Stazhi i kandidatëve është një periudhë prove serioze për ata që dëshirojnë të hyjnë në radhët e Partisë*, thuhet në Historinë e Partisë Bolshevike. Duke pasur parasysh mësimin që na jep Partia Bolshevike dhe eksperiencën që nxjerrim nga gjithë puna e bërë me kandidatët në të kaluarën, të dalë detyrë e rëndësishme para organizatave tona kujdesi i madh që duhet të tregojmë dhe puna e palodhur dhe e vazhdueshme që duhet bërë, për të mos lejuar në asnjë mënyrë që stazhi i kandidatëve të mbetet një gjë formale. *Të dalë e qartë për organizatat tona se në punën tonë për ngritjen dhe forcimin e Partisë, puna në stazhin e kandidatëve është me përgjegjësi të madhe.*

Stazhi i kandidatëve do të vazhdojë për gjashtë muaj. Vendimin për të rekrutuar një element si kandidat e merr celula, me propozimin që bën një anëtar partie. Kandidati duhet të bëjë biografinë e tij me shkrim, e cila qëndron në arshivën e komitetit të Partisë të n/prefekturës. Kandidati paguan gjithashtu një kuotizacion të përmuajshëm të cilin e cakton vetë ai, sipas dëshirës së tij. Por kur e ka caktuar një herë ai detyrohet ta paguajë rregullisht. Kuotizacioni i kandidatit, si për terrenin ashtu dhe për ushtrinë nuk duhet të jetë më i madh se i anëtarit të Partisë i rangut të tij. Kandidati merr pjesë në mbledhjet e zakonshme të celulës. *Mbledhje të veçanta me kandidatët nuk ka.*

Për praninë në Parti do të jenë këto masa: stazhi gjashtë muaj, dy garantë për shtresat e mesme dhe intelektuale dhe duhet që kandidati të ketë mbushur moshën 18 vjeç.

Kur celula bën mbledhje të veçanta për të diskutuar mbi rekrutimin e anëtarëve të rinj në Parti, në këto mbledhje duhet të marrë pjesë një anëtar i komitetit të n/prefekturës dhe një shok i komitetit qarkor, të cilët do të shikojnë si diskuton celula, si e ka kuptuar kriterin e rekrutimit dhe po qe nevoja të ndërhyjë, duke e udhëzuar në praktikë celulën për ruajtjen e kriterit të rekrutimit.

Për pranimin në Parti në organizatat e terrenit ndiqet ky proces:

Propozon celula dhe aprovon komiteti i n/prefekturës.

Për elementin e revizionuar, për ata që bëjnë pjesë dhe për ata që nuk bëjnë pjesë në stazhin për kandidatë, aprovon komiteti qarkor, ndërsa për elementin e pavlefshëm aprovon Komiteti Qendror.

Në ushtri propozon celula dhe aprovon komiteti i regjimentit.

Për celulat që janë rreth shtabit të divizionit propozon celula dhe aprovon komisioni që ngrihet pranë komisarit të divizionit. Ky komision përbëhet nga inspektori, i cili është sekretar i komisionit, nga instruktori i kuadrove dhe nga një ushtarak, nga komunistët më të mirë rreth shtabit të divizionit.

Nga masat e caktuara për pranimin në Parti do të kemi edhe përjashtime. Kjo është lidhur shumë ngushtë me sa është thënë më lart në lidhje me shtimin e radhëve të Partisë, me shtrirjen e organizatës dhe me nevojën që kemi për të futur në Parti elementë të klasës, punëtorë dhe fshatarë të varfër, që do të kontribuojnë njëkohësisht për përmirësimin e përbërjes sociale të Partisë.

Prandaj ne do të futim në Parti, pa i mbushur të gjashtë muajt [e stazhit] dhe 18 vjeç, të gjithë ata punëtorë në fabrikë, në punëtori, në ndërmarrje që japin prova të devocionit dhe të vendosmërisë së tyre për çështjen e komunizmit, për Partinë. [Pra], jo vetëm një sulmues, por të gjithë punëtorët e ndershëm, që tregojnë se janë të lidhur me punën, më të shkathët dhe më aktivë.

Duhet të futen në Parti elementët më të ndershëm dhe më të zgjuar nga shtresat më të shëndosha të fshatit, siç janë shtresat e varfëra dhe të mesme, që kanë qëndruar dhe vazhdojnë të qëndrojnë mirë, të lidhur me vijën tonë. Këtej del që konditat e gjashtë muajve, 18 vjetët dhe garantët janë për ata që duhet të provohen, që kanë nevojë për një edukim dhe ndihmë më të madhe, për t'u lidhur në mënyrë më të shëndoshë me Partinë, për shtresat më të larta, për njerëzit që nuk janë të klasës.

Por sidoqoftë kjo nuk do të thotë se e sheshuam rrugën për në Parti. Përkundrazi me rekrutimin e njerëzve të klasës së punëtorëve, të fshatarëve të varfër dhe të mesëm, të mirë dhe të vendosur, ne e forcojmë Partinë, përmirësojmë përbërjen e saj.

Çështja e forcimit të organizatave tona në Veri e ka preokupuar vazhdimisht Partinë tonë. Për këtë qëllim Partia kohët e fundit dërgoi në këto organizata një numër të konsiderueshëm anëtarësh partie. Por kjo nuk e zgjidh tërë çështjen e forcimit të organizatave tona në Veri, kjo vetëm ndihmon shumë për të zgjidhur, prandaj organizatat tona të Veriut duhet të shfrytëzojnë në maksimum këtë masë të Komitetit Central për ta rritur atje organizatën me vendës.

Për t'i dhënë çështjes së shtrirjes së Partisë zgjidhjen më të drejtë duhet që për këto organizata të dalë më qartë çështja e rekrutimit në Veri. Kriteri i rekrutimit këtu duhet t'u përgjigjet konditave të veçanta të krahinës, të merret parasysh se këtu kemi të bëjmë me një krahinë, ku lufta jonë nuk ka qenë e zhvilluar si në krahina të tjera të Shqipërisë, me mungesën e shtrirjes organizative etj. Që këtej nxjerrim konkluzionin se për rekrutim këtu nuk mund të kërkojmë po ato kondita që kërkojmë për një element p.sh. në Shqipërinë e Jugut. Kjo nuk do të thotë se për Veriun Partia ka një kriter «tjetër», kriter «special» se me një mendim të tillë për kriterin ka mundësi që të dobësohet rekrutimi.

Partia ka një kriter bazë për të gjitha organizatat e saja.

Këtu duhet që forumet drejtuese të Partisë të kenë një kujdes të veçantë për të ndjekur vazhdimisht kriterin e rekrutimit.

Organizatat të kenë parasysh që të mos na dalë si pengesë në rekrutim prapambetja e fshatarësisë në këto krahina, prandaj kjo prapambetje duhet të mobilizojë organizatat tona për një punë më të madhe që t'i mësojë elementit të rekrutuar në radhë të parë të shkruajë dhe të lexojë.

Në Shqipërinë e Veriut del e theksuar nevoja më e madhe e orientimit të rekrutimit të rinisë. Siç u tha dhe më lart, për të rinjtë e varfër, aktivë, të zgjuar, ne nuk do të presim që të mbushen 18 vjetët dhe do të ketë raste që të hyjnë në Parti të rinj komunistë nga më të mirët, direkt nga aktiviteti i Rinisë Komuniste, pa bërë stazhin e kandidatit.

Çështja e shtrirjes së organizatës, një nga çështjet më të rëndësishme të Partisë sonë, është ngritur vazhdimisht në organizatat tona. Rëndësia e kësaj çështjeje del më e theksuar për ne sot, kur na është e domosdoshme një shtrirje sa më e gjerë që të mundemi të sigurojmë mobilizimin sa më të gjerë të masave dhe aktivizimin më të madh të tyre.

Sot që Partia jonë ka detyra të mëdha dhe të shumta është e domosdoshme ngritja e organizatës bazë-celulë në të gjithë sektorët e ekonomisë në qytet dhe në fshat, në aparatet administrative të shtetit, në kurset dhe kudo që punohet për rindërtimin dhe ndërtimin e vendit, në fabrikë, në uzinë, në kooperativë, në akcion, në fshat, në shkollë etj.

Shtrirja e dobët e organizatave tona, sidomos në fshat, është ndjerë dhe vazhdimisht ndjehet jo vetëm për Shqipërinë e Veriut, por ku më shumë dhe ku më pak, pa përjashtim, në të gjitha organizatat; një nga shkaqet e moszbatimit të drejtë të reformës agrare, të arësimit të detyrueshëm si dhe të urdhërësive të tjera të pushtetit tonë, ka qenë mungesa e organizatës sonë dhe lidhja e dobët me masat. Kjo ka shkaktuar që një punë e madhe të rëndojë mbi një celulë, e cila ka qenë në pamundësi të kontrollojë një krahinë të gjerë, kështu atje nuk është kryer puna mirë, pse nuk është bërë as edhe mobilizimi i gjerë i masave në fshat.

Organizatat tona, pa përjashtim çështjen e shtrirjes duhet ta kenë gjithnjë parasysh si një nga çështjet organizative më preokupante. Në këtë drejtim ngritja e «bërthamë-celulës» duhet të shfrytëzohet në maksimum duke u interesuar vazhdimisht për jetën që zhvillohet në «bërthamë-celulë» duke i ngarkuar me besim detyrat dhe duke e ndihmuar në punë dhe më shumë nga celula, pse kështu do të rritet, do të forcohet më shumë dhe shpejt do të kthehet në celulë.

Zgjidhja e kësaj çështjeje është e lidhur në radhë të parë me rekrutimin dhe së dyti me ndarjen e forcave të organizatës, d.m.th. të efektivitetit të organizatës. Këto masa që themi për rekrutimin duhet të na sjellin një shtrirje më të mirë të organizatave. Ndarja e forcave të Partisë duhet që të bëhet me një kriter të drejtë; të mos grumbullohen forca të shumta të Partisë në një vend, ku ka mundësi të bëhet me më pak forca. Kryesisht për këtë u tërheqim vëmendjen organizatave tona, pse shënja të tilla shikohen kudo; të mos grumbullohen p.sh. katër anëtarë partie në një dyqan shteti, ku mund të qëndrojnë vetëm një anëtar bashkë me kandidatët dhe me të rinj komunistë ose me elementë të ndershëm, elementë të ndërgjegjshëm të popullit. Të kemi më shumë besim, të mos vemi me mendje se aty duhet të jenë patjetër tre-katër anëtarë partie, se ndryshe s'vete puna. Një pikëpamje e tillë nuk është e drejtë dhe na kushton, se nuk dimë të shfrytëzojmë në maksimum dhe racionalisht forcat tona. Duhet të jemi më të matur, më kursimtarë në ndarjen e forcave dhe të kemi më shumë besim në forcat tona. Në instruksionet e Partisë Bolshevike mësojmë se çdo komunist duhet të punojë për dy-tre veta, të mbledhë rreth vetes aktivin e jashtë-partisë dhe me ndihmën e tij ta udhëheqë kauzën përpara.

Duhet të edukohen anëtarët e Partisë se detyra e tyre nuk është të bëjnë vetëm atë punën e thjeshtë dhe të vogël teknike, pse kjo nuk është mjaft për anëtarët e Partisë, por të dinë të drejtojnë, të mësojnë dhe të udhëheqin të tjerë nga masa që i rrethon.

Vetëm kështu ai luan rolin e udhëheqjes që i ngarkon Partia. Por ka pasur raste që të vendosen anëtarë partie në vende ku nuk është nevoja e domosdoshme e vendosjes së tyre.

Organizatata tona duhet të kenë parasysh se anëtarët e Partisë duhet të vihet në vendet që kanë më tepër rëndësi, në punët më delikate e të zorshme, atje ku varet zgjidhja e çështjes, në vendin kyç, ku ka më tepër vështirësi, ku duhet më tepër durim, zgjuarësi dhe shkathtësi në punë, ku me punën e tij, me shembullin personal të tij, të mobilizojë dhe të udhëheqë masën për të shtuar prodhimin.

Për komunistin nuk mjafton të plotësojë normën, pse kjo është një detyrë që e kanë të gjithë punëtorët. Ai ka për detyrë ta kapërcejë normën që të jetë shembull i vullnetit dhe i disiplinës në punë.

Politika e orientimit për ndarjen e forcave që duhet të ndjekin organizatat tona është diktuar nga vetë situata e vendit tonë, nga detyrat që kemi për të ngritur ekonominë e re, për ta forcuar, për ta përmbushur planin e shtetit.

Natyrisht, qendrat ku do të shtrihet organizata e Partisë dhe ku do të vendosen anëtarët është vendi i prodhimit, atje ku punohet në fabrikë, në ndërmarrje, në kooperativat e konsumit, të punës, të shitblerjes, në fshat.

Nga shpërndarja e drejtë dhe me vend e anëtarëve të Partisë në qendra të ndryshme të punës, varen edhe sukseset në fushën e prodhimit.

Në një fabrikë duhet të ketë më shumë anëtarë partie në repartet e ndryshme të punës se sa në zyrat, sekretariatë dhe administratë, kopistë, arshivistë ose ndonjë detyrë tjetër të dorës së dytë. Vendi i komunistit në fabrikë është në punën direkte të prodhimit.

Në minierë shumica e anëtarëve të Partisë duhet të jenë nën tokë, pse atje është puna kryesore e minierës, atje nxirret lënda, për të cilën kemi nevojë dhe në zyrë të mbeten vetëm ata anëtarë partie, që janë të nevojshëm për të drejtuar administratën.

Kështu p.sh. në Kuçovë, vendi i anëtarit të Partisë është kryesisht pusi, rafineria, në Selenicë nëntoka etj.

Me një ndarje të tillë të forcave të Partisë, në sektorët më të rëndësishëm të punës dhe në vendet më të rëndësishme të një sektori, do të shtohet rendimenti në punë, do të ngrihet prodhimi, do të plotësohet plani.

Mosndarja e drejtë e forcave të organizatës duke qenë një plus në rekrutimin e dobët, ka rënduar më shumë në mungesën e një shtrirjeje më të plotë organizative. Për këtë organizatat tona duhet të jenë më të kujdesshme.

JETA NË CELULË (disiplina, kritika)

Që celula të mund të kryejë detyrat që i ngarkohen është e domosdoshme që jeta brenda për brenda asaj të jetë e gjallë në pjesëmarrjen aktive të të gjithë shokëve pa përjashtim në diskutime për të gjitha çështjet që ngrihen në Parti. Shokët e Partisë e kanë për detyrë të diskutojnë, të shfaqin mendimin e tyre mbi të gjitha problemet që ngrihen në celulë. Diskutime të tilla se si të zgjidhet një çështje më mirë, më drejt dhe më shpejt janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës, prandaj në këtë drejtim duhet të inkurajohen. Për çdo gjë që nuk vete, që ka çorganizim, ka javashllëk, anëtarët e Partisë ka për detyrë të diskutojnë, të kritikojnë në mbledhjen e celulës dhe të bëjnë propozimet e tij që puna të vejë përpara dhe kur ndodh që një anëtar partie nuk është i qartë për një çështje, ai duhet të pyesë pa drojtje në celulë se këtu është vendi dhe i pyetjeve dhe celula ka për detyrë ta sqarojë shokun me durim, një herë dhe dy herë. Anëtarët e Partisë që jeton në masë, në fabrikë, në administratë, në fshat apo në aksion, kur shikon se puna nuk shkon si duhet, kur shikon se vendimet e Partisë nuk kryhen, kur shikon se vija e Partisë nuk mbrohet, ai duhet të ngrejë zërin në celulën ku bën jetën e Partisë, të bëjë kritikën që është një e drejtë dhe njëkohësisht një detyrë e tij. Në asnjë mënyrë nuk u lejohet anëtarëve të Partisë që të qëndrojnë në pasivitet, në indiferentizëm kur është fjala për fatin e vijës, të vendimeve të Partisë. Këtu ai duhet të tregojë dashurinë dhe vendosmërinë e tij për Partinë. Ai duhet të flasë në celulë për atë që ngjet. Këtu nuk është «turpi» se «tutet mos vallë di të flasë mirë, do të dijë t'i radhisë fjalët mirë». Kur është çështja për të ruajtur interesat e Partisë, s'ka pse të ketë «turp» ose «drojtje», s'ka pse të tutemi se mos vallë do të dimë t'i rreshtojmë fjalët bukur. Ai duhet të mendojë për Partinë e tij dhe të flasë, të kritikojë dhe turpin t'ua lërë atyre që nuk duan të kritikojnë kur shikojnë se punët nuk venë mirë, që nuk qederosen kur shikojnë se tymi i Partisë nuk shkon drejt. Këto kërkon Partia për gjithë anëtarët e saj, kjo është fryma me të cilën duhet të rriten dhe të edukohen kuadrot tanë. E drejta e diskutimit, e drejta e kritikës konstruktive, e kritikës së shëndoshë, që ka për qëllim mbarëvajtjen e punës, është një e drejtë e pamohueshme e anëtarit të Partisë.

Pikërisht në pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të celulës, në diskutimet qëndron demokracia e brendshme e Partisë, d.m.th. kur vetë masat e Partisë zgjidhin çështjet, zbatojnë aktivisht vendimet e Partisë, kur me punën konkrete vërtetohet kryerja e këtyre vendimeve. Në instruksionet e Partisë Bolshevike mësojmë se demokracia jonë nuk është vetëm një demokraci elektorale, por edhe demokraci e aksionit.

Të kritikohesh nuk do të thotë të bësh «debate», pse celula nuk është vend «debatesh», apo «klub diskutimesh», që s'kanë ndonjë qëllim konstruktiv. Kjo s'është kritikë komuniste, kjo është «kritikë e degjeneruar» për kritizerët që s'e vrasin mendjen për çështjet e Partisë dhe të shtetit. Elementë të tillë të sëmurë, kritizerë klubesh, të cilët nuk i diskutojnë çështjet në celulë, por jashtë saj, me qëllim që të shkaktojnë konfuzion dhe dyshim në politikën e Partisë, letra e fundit e Komitetit Qendror i dënonte si të dëmshëm për punën e Partisë dhe të shtetit. Ku është në këta elementë merak për punën e Partisë dhe të shtetit që të vejë mbarë? Ja këtu është ana negative e këtyre kritizerëve të sëmurë, ata nuk sugjerojnë asgjë në celulë, por jashtë celulës flasin me pikëpyetje dhe pikëçuditje për transportin, për «taksat e rënda», për racionimin etj. Kjo nuk është aspak me frymën e demokracisë në Parti, ashtu siç i mëson dhe i edukon Partia anëtarët e saj, por kjo është fund e krye e sëmurë dhe e dobët. Këta elementë të sëmurë nuk është se kanë frikë t'i thonë në celulë, por ata vepronë me qëllim, ata s'duan t'i thonë në celulë, por jashtë saj, si p.sh. N. B., anëtar i celulës së Ministrisë së Arësimit flet me qëllim të keq jashtë mbledhjes së celulës mbi çështjen e vështirë ekonomike, për taksat e rënda që u janë vënë tregëtarëve të tatuuar. Ai këtu nuk i tregon në celulë, por me qëllim që të sjellë konfuzion dhe të luftojë Partinë i bisedon këto çështje me njerëz të tjerë, me të cilët ai ka afinitet. Qëndrimi i celulës së Ministrisë së Arësimit në këtë rast nuk ka qenë aspak i drejtë: jo si në të kaluarën, jo me gjysmë goje, por me tërë forcën duhet të intervenonte që të ngrihesh në celulë dhe të goditesh me ashpërsi një gjë e tillë, që nuk është e lejueshme në Partinë tonë. Në celulat tona nuk ka frikë për diskutime, për pyetje, nuk ka frikë, «dyshim» se mos vallë merren «ters» ose të interpretohet keq siç thotë në celulën e Bankës shoku Pajo Islami, i cili ngre çështjen e frikës në Parti. Pikëpamje të tilla janë të huaja. Njerëz të tillë të sëmurë i persekuton drejtësia e Partisë, ata vetë e kanë dyshimin në zemrën dhe në kokën e tyre pse ata nuk mendojnë me zemër dhe me mendje për Partinë, si komunistë. Në Partinë tonë nuk ka vend për «dyshime» dhe interpretime personale, sipas oreksit, në Parti mendohen dhe interpretohen drejt çështjet, sipas interesave të unitetit të Partisë. S'ka kuptim të thuash e dua Partinë, s'jam kursyer për Partinë, kur mendon shtrembër për Partinë. Kjo është një sharlatanizëm që nuk vlen gjë. Kjo tendencë e gabuar, e dëmshme, me qëllime të këqia, e ka burimin tërësisht në mendimet e shtrëmbra, në mendimet e liga për Partinë, që s'duan ta shohin Partinë të fortë dhe me një unitet të shëndoshë.

Një nga detyrat e anëtarit të Partisë është respektimi i disiplinës së Partisë. Ne fituam, ne ndodhemi sot në krye të push-

tetit, në krye të masave punonjëse, vetëm pse kemi një Parti të fortë dhe me një disiplinë të hekurt, një Parti monolite. Po kështu duhet ta kemi të qartë se për ta mbajtur dhe për ta forcuar këtë pushtet, për të mundur të luajmë rolin si pararojë e masave punonjëse në luftë për ndërtimin e shoqërisë socialiste, duhet të forcojmë gjithnjë e më tepër disiplinën e Partisë. Vetëm me një unitet të fortë mendimi dhe veprimi, vetëm me një nënshtrim pa kushte, të të gjithë anëtarëve disiplinës së hekurt të Partisë ne do të fitojmë në luftë me armiqtë, me pengesat dhe vështirësitë. Pikërisht në këtë unitet mendimi dhe veprimi qëndron disiplina e hekurt e Partisë. Këtu duhet të shikojmë rëndësinë e madhe dhe nevojën e një discipline të tillë dhe të kemi gjithashtu parasysh se mosrespektimi i disiplinës së Partisë, do të thotë të shkatërrohet unitetin e Partisë, do të thotë të ndihmohet me dashje ose pa dashje armiqtë e Partisë, armiqtë e klasës, armiqtë e socializmit.

Në luftën e përditshme për realizimin e vijës së Partisë, komunisti kalitet, aty forcohet disiplina, aty tregohet se interesat e Partisë janë mbi gjithshka, aty luftohet mosvigjilenca dhe çdo frymë liberale oportuniste. Disiplina e hekurt e Partisë nuk është as formale as e verbër, pse disiplina e hekurt me të tillë karakter nuk ekziston në Partinë tonë. Disiplina e hekurt nuk e mbyll shtegun e diskutimeve, por përkundrazi, në bazë të demokracisë së brendshme të Partisë, i presupozon, i inkurajon diskutimet në celulë. Por kur marrin fund diskutimet dhe merret një vendim, atëhere duhet të ketë një unitet në vendim, d.m.th. një mendim të përbashkët për të gjithë dhe një unitet veprimi, d.m.th. një veprim i përbashkët për të gjithë, për të vënë në jetë, për të zbatuar gjer në fund vijën e Partisë. Këtu s'ka vend për «opinionë», «interpretime» dhe «lëkundje». Këtu ke të bësh me unitetin e Partisë, me vetë jetën e Partisë. Pa unitet në mendim dhe veprim është absurde, krejt e gabueshme të mendosh për unitetin e Partisë, për disiplinën e hekurt të Partisë. Ajo nuk është e verbër, pse Partisë sonë nuk i nevojitet një disiplinë e tillë, përkundrazi disiplina e Partisë sonë është koshiente dhe tamam për këtë ajo e bën Partinë tonë të fortë, të aftë për të luajtur rolin e pararojës. Të jesh koshient në disiplinën e Partisë, do të thotë të jesh koshient në zbatimin e plotë të vijës së Partisë, do të thotë të jesh militant koshient për realizimin e saj në jetë.

Disiplina e hekurt është në mendim dhe në veprim e bashkuar për të gjithë anëtarët e Partisë. Ky është uniteti i Partisë, kështu e kuptojmë ne unitetin. Prandaj kështu duhet të kuptohet në organizatat tona disiplina e hekurt e Partisë.

Partia Bolshevike i mëson organizatat e saja se disiplina koshiente e partisë do të thotë ide e lartë, bindje dhe kompaktësi e të gjithë anëtarëve të partisë rreth programit të përbashkët,

rreth qëllimeve të fundit të luftës. Disiplina koshiente e partisë do të thotë bashkimi i aksioneve praktike të të gjithë anëtarëve të partisë në mbështetje të raporteve koshiente kundrejt detyrave të partisë. Partia me të drejtë kështu e kupton disiplinën e partisë.

MARRËDHËNIET PARTI-PUSHTET DHE ME ORGANIZATAT E MASAVE

Këtu ngrihet çështja se si të kuptojmë më mirë marrëdhëniet e drejta që duhet të jenë në mes të Partisë dhe të pushtetit si dhe punën në organizatat e masave: Frontin, Rininë, Gruan dhe Sindikatat.

Të kuptuarit mirë të këtyre marrëdhënieve ka mjaft rëndësi se që këtej do të dalë më i qartë roli dhe detyrat e Partisë në pushtet si dhe në organizatat popullore.

Me sa konstatohet organizatat tona nuk i kanë dhe aq të qarta këto marrëdhënie, p.sh. në organizatën e Peshkopisë ndodh që celula e komitetit ekzekutiv të marrë në shqyrtim të gjitha problemet e pushtetit (në shkallë) të qarkut, shikon si vete regjistrimi i bereqetit në Burrel, si vete regjistrimi i gjësë së gjallë në Zerqan. Celula e komitetit ekzekutiv shndërrohet këtu në një komitet qarkor të dytë. Një gjë e tillë pothuajse e ngjashme ndodh edhe në disa celula të dikastereve, ku flitet p.sh. për punën në Kuçovë, për kujdesin që tregohet atje për punën etj.

A janë këto marrëdhënie të drejta në mes të Partisë dhe pushtetit? Jo. Këto nuk janë marrëdhënie të drejta, pse celula e pushtetit në Peshkopi nuk ka detyrë, është jashtë funksioneve të saj që të shikojë punën e pushtetit në Burrel dhe në Zerqan, gjithashtu dhe ajo e dikasterit. Këto punë i shikon si parti vetë komiteti qarkor dhe si pushtet vetë komiteti ekzekutiv i prefekturës. Sikur puna në Burrel dhe në Zerqan të mos vejë mirë, ç'mund të bëjë celula e pushtetit të Peshkopisë? Pastaj në Burrel dhe në Zerqan ka Parti, ka komitet partie, ka dhe celulë, që shikojnë punët atje dhe informojnë mbi gjendjen e punës, bëjnë vërejtjet dhe propozimet e tyre në lidhje me çdo problem.

Ka dhe një rast tjetër, kur marrëdhëniet parti-pushtet jo vetëm që s'janë të drejta, por edhe më tutje akoma, janë të dëmshme, p.sh. në organizatën e Gjirokastrës, kuadroviku i komitetit të n/prefekturës së Sarandës, në zyrat e Partisë, ka mbledhur shokët e fshatrave, të cilët pothuajse të gjithë janë në pushtetet e lokaliteteve, bisedon me ta mbi çështje të ndryshme si mbyllja e këtij mulliri që është privat, hapja e atij tjetrit, që është i shtetit, për mungesën e mësuesit, për zbatimin e reformës agrare dhe për të gjitha këto ai merr shënime për t'ja shpënë pastaj pushtetit të n/prefekturës si gjëra të kryera.

Në organizatën e Tiranës celula e lagjes as që i ngre fare problemet e lagjes, që i kanë dalë para pushtetit lokal, si triskëtimin, denoncimet etj. Celula e lagjes, megjithëse sekretari i saj është përgjegjës i pushtetit, as që i njeh këto probleme si të sajat. Një tjetër rast po nga organizatat e Tiranës në fabrikën Vora-Flora, ku plani i prodhimit mbahet si një gjë sekrete, i mbyllur në zyrat e administratës, si diçka që i përket vetëm asaj dhe celula nuk di asgjë.

Nga këta shëmbuj dalin qartë dy anë ekstreme të marrëdhënieve jo të drejta parti-pushtet, njëra anë është ajo e rastit të Sarandës, ku Partia del mbi pushtetin dhe tjetra ajo e fabrikës Vora-Flora, ku Partia është në bisht, nuk di gjë mbi planin e shtetit.

Që të dyja këto janë të dëmshme për Partinë dhe pushtetin.

Kjo tregon se në organizatat tona ka lëkundje përse i përket marrëdhënieve parti-pushtet, lëkundje kjo që ka ardhur nga mosnjohja e drejtë e këtyre marrëdhënieve, nga mosnjohja e drejtë e rolit të Partisë.

Prandaj në radhë të parë duhet të kuptojmë se Partia nuk është barazi me pushtetin, por Partia është forca drejtuese e pushtetit. Partia vendimet e saj i vë në zbatim nëpërmjet pushtetit, pra, Partia nuk mund të zëvendësojë pushtetin, ajo vetë e drejton këtë në zbatimin e vendimeve. Roli i Partisë në pushtet, pra, është roli drejtues, prandaj siç është thënë vazhdimisht Partia zë në pushtet vendin drejtues. Për këtë Partia i përqendron të gjitha përpjekjet e saja në forcimin e pushtetit, në modernizimin e aparatit administrativ, në luftën kundër çdo gjëje që ndryshk pushtetin, që e bën të humbasë karakterin demokratik, në luftën kundër abuzimeve, tarafeve, ryshfetit dhe burokracisë, punon për ta bërë pushtetin sa më popullor, të zgjidhë shpejt çështjet e popullit për ta bërë atë një pushtet të ndershëm, që ta dojë populli, që t'i rritet autoriteti përpara masave popullore përditë e më tepër dhe ta bëjë të aftë, të fuqishëm, që të shkatërrojë çdo rezistencë të armikut.

Që këtej nxjerrim se pikërisht këtu qëndron detyra kryesore e Partisë sonë. Këtu duhet të përqendrojmë përpjekjet dhe tërë kujdesin tonë.

Por, për kryerjen e kësaj detyre të madhe vetëm mobilizimi i forcave të Partisë nuk mjafton. Ashtu si në luftën e çlirimit për marrjen e pushtetit, Partisë ju desh që të bëjë mobilizimin e masave të gjera popullore, ashtu edhe sot në luftën kundër armiqve, në luftën për mbajtjen dhe forcimin e pushtetit, në luftën për ndërtimin e një të ardhshme të re është konditë e domosdoshme mobilizimi sa më i gjerë i masave punonjëse, organizimi dhe udhëheqja e tyre drejt një objektivit të vetëm, arritjes së qëllimit tonë.

Në Statutin e Republikës sonë thuhet qartë se pushteti ynë buron prej popullit dhe i takon popullit. Ja këtu është shprehur karakteri popullor i pushtetit, d.m.th. vetë natyra e tij presupozon si një gjë të domosdoshme pjesëmarrjen aktive të masave në zgjidhjen e problemeve të vendit. Vetë ekzistenca e Partisë sonë në krye të këtij pushteti siguron pjesëmarrjen e gjerë të masave në zhvillimin e jetës politike dhe ekonomike të vendit.

Në organizatat e masave ne kemi mobilizuar dhe organizuar masat e gjera punonjëse. Me anën e këtyre Partia vë në lëvizje të gjitha masat punonjëse të vendit, këto janë «leva» dhe «transmisione», nëpërmjet të cilave kryhet mobilizimi dhe organizimi i masave të gjera popullore, i punëtorisë, rinisë dhe gruas. Ekzistenca e tyre është e domosdoshme. Nuk mund të mendohet ngritja e shoqërisë së re pa pjesëmarrjen aktive të masave në këtë vepër të madhe dhe si rrjedhim pa ekzistencën e këtyre organizatave. Këtu duhet të kuptojmë këtë, se kur themi ekzistenca e këtyre organizatave, duhet të dalë qartë se kjo ekzistencë ka një qëllim, d.m.th. aktivizimin e masave, futjen e masave të organizuara në prodhim. Ekzistenca e organizatave sindikale p.sh., do të thotë se kemi një organizatë të klasës punëtore, e cila grumbullon në mënyrë të organizuar, në gjirin e saj, klasën punëtore të vendit dhe e edukon me qëllim që të sigurojë pjesëmarrjen e saj në prodhim dhe në gjithë jetën politike të vendit. Këtu është organizata sindikale «levë» që ngre në këmbë tërë masën e punëtorisë. Për këtë është e domosdoshme ekzistenca e kësaj organizate, pse është i domosdoshëm aktivizimi i punëtorisë. Në rast të kundërt, në qoftë se do të ekzistonte organizatë sindikale, por kjo s'do të mund të kryente rolin e «levës» atëhere kësaj i thonë ta kesh organizatën sindikale «formale». Formalizmi këtu, kuptohet qartë se ç'rrezik krijon. Këtu del se «formalizmi» nuk ka vetëm kuptimin e mosfunksionimit të kësaj apo të asaj organizate: Front, Rini, Grua, nga ana administrative, teknike, por ka kuptim më të gjerë: të mospjesëmarrjes së masave në prodhim, të mosaktivizimit të masave. Ja këtu është rreziku që krijon formalizmi. Këtu duhet të jetë dhe kujdesi ynë më i madh.

Tani duhet ta shohim më qartë se sa larg jemi kur organizatat tona shkruajnë në raportet e tyre: «Fronti këtë muaj nuk ka ndonjë ndryshim» ose të thuash se «muajin e ardhshëm do të funksionojë më mirë se kemi caktuar sekretarin teknik» etj.

Këto «leva» dhe «transmisione» siç janë organizatat e masave duan një fuqi motorike, që t'i vërë në lëvizje, duan një orientim, duan një udhëheqje. Kjo fuqi motorike, kjo udhëheqje është Partia jonë, pse Partia jonë si parti drejtuese ka në gjirin e saj elementin më të mirë të masës, pse ajo është një shkollë që rrit dhe edukon udhëheqës të masave, pse ajo ka një eksperiencë të gjerë për të drejtuar, prandaj ka dhe të gjitha mundësitë për

t'i udhëhequr këto organizata me anën e njerëzve të saj, të cilët kanë vendet drejtuese në to.

Këtu nuk është fjala te gjetja e sekretarit teknik ose mbledhja e presidiumit, këtu është çështja se të gjithë anëtarët e Partisë duhet të dinë, se kjo është thënë sa herë, që në socializëm nuk vete vetëm partia, kjo do të thotë se ekonomia e re popullore nuk ngrihet vetëm me forcat e partisë, këtu është pika qëndrore. Partia komuniste është avangardë e klasës punëtore, ajo udhëheq tërë masat punonjëse, pra, është e kuptueshme se udhëheqja pa pasur çfarë të udhëheqë, është absurde, d.m.th. s'ka se si të shkojë partia, udhëheqja vetëm, duhet klasa punëtore, duhen masat e gjera punonjëse. Po këto masa ne i kemi të organizuara në Frontin, Sindikatën, Rininë dhe Gruan, d.m.th. se Partia mbështetet në këto organizata, i mobilizon, i aktivizon dhe i udhëheq këto në vijën e saj, për rindërtimin dhe ndërtimin e vendit. Të mendosh të shkosh pa aktivizimin e këtyre do të thotë të dënosh veten me dështim.

Ja se sa i rëndësishëm, se sa i domosdoshëm është aktivizimi i këtyre organizatave nën udhëheqjen e Partisë.

Pa kuptuar drejt rëndësinë e aktivizimit të organizatave të masave, as marrëdhëniet nuk mund të kuptohen drejt, as edhe roli i Partisë në këto organizata d.m.th. në mes të Partisë dhe të organizatave të masave.

Të sjellim shembullin e organizatës së Gjirokastrës që thotë: «organizata e gruas do të ishte aktivizuar më tepër sikur t'i qe dhënë rëndësia nga Partia» dhe asnjë fjalë më shumë. Po çdo të thotë kjo fjalë, që po përsëritet kaq shpesh nga organizatat tona? Ç'tregon kjo përveç asaj që përmendëm, se në organizatat tona në praktikë, në zgjidhjen e çështjeve, në kryerjen e detyrave nuk është kuptuar siç duhet roli i organizatave të masave.

Mungesa e një ideje të qartë për rolin e madh të organizatave të masave, për aktivizimin e domosdoshëm të tyre, duke shtuar edhe mungesën e një shtrirjeje të plotë organizative të Partisë, ka rënduar shumë mbi organizatat tona. Celula në fshat, në lagje apo në fabrikë, duke mos qenë e orientuar mirë, nga udhëheqja mbi aktivizimin e Frontit, Rinisë, Gruas etj. atje në fshat, në lagje dhe në fabrikë dhe duke mos e pasur të qartë rolin që duhet të luante ajo në lidhje me këto organizata ka humbur në punë të shumta, s'ka qenë në gjendje t'i përballojë të gjitha punët, kështu që edhe plani ka mbetur pa u kryer.

Nga të gjitha sa u përmendën më lart rezulton se këtu është fjala që të kuptojmë zhvillimin e jetës politike dhe ekonomike të vendit; nga njëra anë marrëdhëniet parti-pushtet dhe nga ana tjetër parti-organizata të masave popullore, të kuptojmë qartë të gjithë këtë mekanizëm dhe këtu të shikojmë në praktikë rolin e Partisë.

Këto marrëdhënie mund të shprehen në jetë, në punën e përditshme, kështu Partia bën që të realizohen vendimet e saj nëpërmjet pushtetit me anën e anëtarëve të saj dhe me mobilizimin dhe aktivizimin e masave punonjëse, d.m.th. të organizatave popullore. Nga aktivizimi i këtyre organizatave, nga besimi i madh që duhet të kemi ne, këtu varet ndërtimi i ekonomisë së re. Organizatat e masave, Fronti, Rinia, Gruaja dhe Sindikatat janë vetë masat e organizuara, prandaj këto janë mbështetja e Partisë, prandaj ne duhet ta ndjejmë veten të fortë sa kohë që mbështetimi në këto organizata, sa kohë që lidhjet tona me këto do të jenë të shëndosha. Nga marrëdhëniet e drejta në mes të Partisë dhe organizatave popullore, nga forcat mobilizuese të Partisë, nga roli që duhet të luajë Partia varet shkuarja jonë përpara. Për ta parë konkretisht këtë, marrim shembull një prefekturë. Këtu kemi komitetin qarkor, forcën drejtuese të gjithë jetës në qark, kemi pushtetin, komitetin ekzekutiv të prefekturës dhe organizatat e masave: Frontin, Rininë, Gruan dhe Sindikatat. Pushteti në bazë të planit të përgjithshëm të shtetit ka një plan të tij për qarkun. Plani i pushtetit duhet realizuar, pse aty janë vendimet e Partisë sonë. Në krye të komitetit ekzekutiv është vetë koka e Partisë në qark, d.m.th. komiteti qarkor, i cili ka përgjegjësinë direkte për realizimin e planit të shtetit për qarkun.

Plani shtrohet në të gjithë organizatën e Partisë, komiteti qarkor ka për detyrë të organizojë realizimin e atij në jetë. Po si do të bëhet kjo? Në radhë të parë mobilizimi total i forcave të Partisë në vendet ku janë. Forca motorike e Partisë do t'i vërë në lëvizje «levat», «transmisionet», Frontin, Rininë, Gruan dhe Sindikatat duke bërë kështu mobilizimin e të gjitha masave punonjëse. Forca motorike do të thotë parullë e Partisë, vijë e Partisë, që transmetohet në këto organizata me anën e anëtarëve të Partisë (shoku që është në krye të Frontit, Rinisë, Sindikatës dhe shoqes së Gruas, që i drejtojnë këto). Kështu Partia siguron pjesëmarrjen aktive të të gjitha masave punonjëse për realizimin e planit, p.sh. me rastin e realizimit të planit të mbjelljeve të bimëve industriale. Çdo prefekturë ka një plan të caktuar nga qeveria, se ç'sipërfaqe do të mbillet dhe çfarë bimësh. Ky plan ngrihet në organizatën e Partisë. Komiteti qarkor e studjon këtë dhe organizon tërë punën për realizimin e tij duke ndarë punën në bazë të planit të qarkut për çdo n/prefekturë. Komiteti qarkor është përgjegjës për realizimin e planit të mbjelljeve. Ky si forum më i lartë i Partisë në qark, mobilizon në radhë të parë forcat e Partisë, anëtarët, kandidatët dhe rininë komuniste dhe me anën e anëtarëve të tij, të cilët drejtojnë organizatat popullore, ngre në këmbë të gjitha masat punonjëse të qarkut. Në Front, në Rini, në Gruan, realizimi i planit të pushtetit për mbjelljen e bimëve

industriale, bëhet çështje e ditës e të gjithë organizatës ku diskutohet mbi organizimin e punës për ta realizuar sa më mirë dhe sa më shpejt planin, merren angazhime për një mobilizim sa më të gjerë të masave etj. Kështu bën komiteti i n/prefekturës për n/prefekturën, kështu edhe celula në fshat ku çështja e realizimit të planit ngrihet në detajet më të vogla dhe më konkrete, ku merren dhe angazhime individuale. Në fshat celula drejton tërë punën që plani të realizohet, për këtë ajo propagandon rëndësinë e madhe politike, ekonomike të kryerjes së planit dhe mobilizon, organizon dhe drejton masat punonjëse të fshatit për realizimin konkret të planit.

Në prefekturë, n/prefekturë, në lagje dhe në fshat pushteti drejton punën për zbatimin e planit dhe për këtë ai është përgjegjës.

Pikërisht në aktivizimin e masave, me ngritjen e ekonomisë, Partia forcon përditë e më tepër lidhjet e saja me masat, këtu ajo rritet dhe forcohet, tamam në këtë aktivizim të masave, në pjesëmarrjen direkte të tyre për realizimin e planit të shtetit qëndron forca e pushtetit tonë, karakteri i tij demokratik, prandaj Partia duke bërë përpjekjet e saja për zgjerimin sa më të madh të pjesëmarrjes së masave në prodhim, kërkon të bëjë demokratizimin sa më të madh të pushtetit. Ky është koncepti ynë mbi demokratizimin e pushtetit, mbi forcën e tij. Kjo është rëndësia politike, ekonomike e aktivizimit dhe e organizimit të masave.

Pushteti për të gjithë aktivitetin e tij është kurdoherë përgjegjës para popullit, përpara masave punonjëse, që e kanë zgjedhur.

Kjo tregon natyrën e pushtetit tonë, nga njëra anë, mbështetjen e tij në masat e popullit dhe në anën tjetër tregon se pushteti është i popullit, është në duart e tija. Nga kjo kuptohet se çështja e lidhjeve në mes të pushtetit dhe popullit është çështje jetësore për pushtetin tonë.

Këtu del kjo: Partia në krye të organizatave të masave, Front, Rini, Grua, Sindikatë, mbështet fort pushtetin për realizimin e planit.

Por nga ana tjetër, Partia si forca motorike, si forca drejtuese në pushtet mobilizon dhe drejton të gjitha përpjekjet e saja për të perfeksionuar aparatën administrativ të pushtetit, për ta bërë atë dinamik, që të jetë i aftë për të luftuar burokracinë, ta bëjë atë pushtet të ndershëm etj. Për këtë Partia mobilizon dhe organizatën e sindikatave, e cila përmbledh në gjirin e saj tërë masën e nëpunësve, me parti, pa parti, d.m.th. se problemi i organizatës sindikale atje është të perfeksionojë aparatën, ta bëjë atë dinamik, ta bëjë atë të ndershëm, që të kryhet sa më mirë dhe më shpejt plani i shtetit.

Ky është roli i Partisë aty brenda në pushtet. Shoku Stalin në lidhje me këtë thotë:

«Partia është bërthama e pushtetit. Por ajo nuk është dhe nuk mund të jetë identike me pushtetin shtetëror»¹.

Për të gjitha është përgjegjëse Partia, kjo përgjegjësi vjen nga vetë roli që ajo ka si Partia drejtuese e tërë jetës së vendit, por para ligjit, para shtetit është përgjegjës pushteti, administrata dhe drejtori.

Tani të shikojmë se si duhet të punonte organizata e Partisë në rastet që ne kemi përmendur më lart.

Për organizatën e Peshkopisë:

Celula e pushtetit: Këtu e para e punës duhet kuptuar se në bazë të principit të ndërtimit të Partisë, celula këtu si organizatë bazë është ngritur në bazë vend pune. Vendi i punës së kësaj celule është administrata e pushtetit, aty ku është ngritur kjo celulë, prandaj si e tillë celula ka për detyrë të modernizojë administratën, të luftojë tarafet, abuzimet, t'u japë udhë shkrësave, t'u japë përgjegje shpejt kërkesave të popullit, të presë mirë popullin etj. Por për të gjitha këto nuk mjaftojnë vetëm shokët e celulës, aty duhet që gjithë masa e nëpunësve të punojë, të aktivizohet në këtë drejtim, për këtë celula mobilizon organizatën e sindikatave, d.m.th. gjithë masën e nëpunësve. Celula, pra, drejton të gjitha përpjekjet në këtë pikë. Në celulën e pushtetit diskutohet mbi këto çështje, merren vendime të caktuara se si do të zgjidhen këto dhe në mobilizimin e gjithë personelit të administratës, celula vë në jetë, zbaton vendimet e marrura në lidhje me funksionimin e rregullt të administratës së shtetit.

Kjo është puna e celulës në pushtet, roli i saj këtu. Kështu duhet ta kuptojmë funksionimin e saj.

Për organizatën e Tiranës:

Celula e lagjes: Kjo si organizatë bazë e Partisë në lagje, drejton gjithë jetën e lagjes, pra, ajo duhet të jetë në krye të gjithë lagjes për zgjidhjen e të gjitha problemeve. Në lagje kemi gjithashtu pushtetin lokal si dhe organizatat e masave. Atëhere drejtuesi i celulës, që është përgjegjësi i punës në pushtet, ngre në celulë të gjitha çështjet e pushtetit për lagjen, si triskëtimin, denoncimin, gjendjen ekonomike të lagjes, shëndetësore, kulture etj. pse të gjitha këto janë çështje të Partisë, d.m.th. të celulës, organizatës bazë të saj në lagje. Celula nuk vendos të bëhet apo jo p.sh. triskëtimi, por ajo angazhohet që triskëtimi të kryhet. Nga ana tjetër ajo shikon dhe kon-

trollon nga poshtë ku nuk shkon mirë triskëtimi etj., bën propozime dhe sugjerime të nevojshme.

Për kryerjen e këtyre çështjeve mobilizohen të gjitha forcat e Partisë, anëtarët e saj, kandidatët dhe rinia komuniste dhe nëpërmjet shokut të Frontit, të Rinisë dhe të Gruas vihen në lëvizje të gjitha masat e lagjes. Të gjitha masat marrin pjesë aktive në zgjidhjen e çështjeve të lagjes. Ja kjo është puna politike e Partisë. Këtu Partia rritet dhe forcohet. Nga ana tjetër shoku i Partisë, kandidati ose i riu komunist që punon në pushtetin lokal përqëndrojnë aktivitetin e tyre në forcimin e pushtetit lokal, si aparat ekzekutues. Ja kështu celula kryen rolin e saj në lagje si drejtuese e jetës së saj.

Një gjë analoge me këtë është dhe funksionimi i celulës së fshatit. Të marrim si shembull atë të Sarandës:

Celula e fshatit: është drejtuesja e jetës së fshatit, ajo është përgjegjëse për tërë punën në fshat. Por në fshat kemi pushtetin lokal, kemi dhe organizatën e Frontit, të Rinisë dhe të Gruas. Për të gjitha problemet e fshatit, si për korrektimin e reformës agrare, për mbjelljen e bimëve industriale, për hapjen e kanaleve, për mbjelljen e pemëve për kopshtiet, për rritjen e pulave dhe të derrave, për shkollën, për kurset kundër analfabetizmit, për gjendjen shëndetësore etj., që janë problemet e pushtetit të lokalitetit, pra, të Partisë, d.m.th. të celulës, diskutohet në celulë. Në celulë merret plani i pushtetit, studjohet dhe që andej nxirren detyra të caktuara, dalin vendime se si do të veprohet për kryerjen e planit. Për këtë mobilizohen forcat e Partisë dhe nëpërmjet anëtarëve të saj celula mobilizon Frontin e fshatit, Rininë dhe Gruan, d.m.th. për kryerjen e planit mobilizohet i tërë fshati. Nga ana tjetër celula përpiqet, që me anën e anëtarëve të saj pushteti i fshatit ta bëjë punën sa më mirë, ta forcojë atë që ta godasë atë mësues që nuk çan kokën që shkolla të vazhdojë në rregull, ose të mbyllë mullirin e atij agait të fshatit dhe të hapë mullirin e shtetit etj., por këtë ta bëjë pushteti atje në fshat; në rast se ky nuk mund ta bëjë, d.m.th. se nuk e bën celula atje në fshat, atëhere çështja i raportohet komitetit ekzekutiv të n/prefekturës, ku ka Parti, ku është koka e Partisë së n/prefekturës dhe jo mënjane jashtë pushtetit. Në rastin e Sarandës, ku orientimi i Partisë është që celula të përpiqet për forcimin e pushtetit në bazë, jo vetëm se një orientim i tillë mungon, por vetë forumi favorizon një gjë të tillë. Ku është fjala, vija të forcojmë pushtetin? Këtu është dëmi, rreziku i dobësisimit të pushtetit, i zëvendësimit të pushtetit nga Partia. Kjo është e shtrembër. Nga një orientim i tillë jo i drejtë ka ardhur kryesisht dobësimi i pushtetit të lokaliteteve, anëtarët e këshillave janë kthyer

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 8, f. 41.

në pojakë fshati dhe vijnë pastaj pengesa dhe justifikime: «përbërja e këshillave bazë është e dobët, ka njerëz që nuk janë me ne» etj. Kjo është e vërtetë, por kjo nuk është e tëra, pse nuk është puna për tre-katër veta të këshillave, këtu është çështja e orientimit të celulës në fshat, për forcimin e pushtetit, për sigurimin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të të gjitha masave punonjëse të fshatit në zgjidhjen e problemeve të fshatit. Kështu forcohet pushteti. Kështu do të përmirësohet dhe kompozicioni social i këshillave, pse vetë puna do të nxjerrë njerëzit më aktivë, më të ndershëm, më besnikë të popullit, të aftë për drejtimin e punëve të shtetit në fshat.

Kështu, pra, edhe në fshat celula mobilizon të gjitha organizatat e masave; i drejton ato në tërë aktivitetin e fshatit për realizimin e planit të shtetit. Ja se në çfarë marrëdhëniesh është Partia me pushtetin dhe me organizatat e masave.

Për organizatën e Tiranës në fabrikë, përveç celulës kemi dhe administratën dhe organizatën sindikale.

Celula e fabrikës: merr në shqyrtim në mbledhjen e saj planin e shtetit, shikon sa duhet prodhuar, e bisedon këtë në celulë dhe merr angazhime të caktuara në lidhje me zbatimin e tij.

Me anën e anëtarit të saj që drejton organizatën sindikale të fabrikës, celula ngre në këtë organizatë si problem numër një të të gjithë masës punëtore, me parti, çështjen e realizimit të planit të prodhimit, diskutohet nga gjithë punëtorja e fabrikës se si do të kryhet plani, se si do të organizohet puna për kryerjen e tij sa më shpejt, se si do të bëhet më shumë kursim etj. dhe këtu merren angazhime. E gjithë kjo bëhet me frymën e Partisë, në vijën e Partisë. Celula është në krye të fabrikës; drejton aty masat punëtore për realizimin e planit të prodhimit.

Por celula ka për detyrë të forcojë dhe administratën si aparat ekzekutiv, të bëjë që të mos çalojë puna e prodhimit nga shkaku i çalimit të aparatit administrativ. Për këtë duhet theksuar se drejtori është përgjegjës zyrtar karshi shtetit. Ky është në krye të aparatit administrativ, prandaj ky drejton fabrikën dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e saj. Celula ka për detyrë të bëjë që administrata të funksionojë në rregull dhe jo ta zëvendësojë atë.

MBI DISA RREGULLA NË PARTI

Në jetën e Partisë sonë që nga krijimi i saj, në luftë dhe përpjekje për forcimin e saj u përcaktuan disa rregulla themelore, të cilat mbrojtën kompaktësinë, unitetin, pastërtinë dhe frymën revolucionare të Partisë.

Këto rregulla janë konditat e domosdoshme që duhet të respektohen nga çdo anëtar partie dhe shkelja e tyre është në kundërshtim direkt me principet bazë të Partisë.

Partia jonë me udhëzimet e saj ka kërkuar me këmbëngulje që këto ligje të përvetësoheshin nga çdo anëtar partie, pse këto janë lidhur shumë ngushtë me vetë ekzistencën e saj.

Në fakt gatishmëria dhe bindja për të vënë në jetë këto rregulla nga ana e anëtarëve të Partisë, e bën Partinë tonë të fortë, të çelniktë, e bën atë të zonjën të kapërcejë me sukses pengesat e luftës.

Por sot ka në organizatat tona raste kur këto rregulla themelore nuk respektohen me përpikmërinë që duhet të dallojë komunistët dhe ka gjithashtu raste kur tregohet dhe një farë shkujdesjeje ose lëshimi karshi këtyre mungesave të rënda.

Ka anëtarë partie që nuk frekuentojnë rregullisht celulën, që mungojnë pesë-gjashtë muaj nga jeta e Partisë, që nuk paguajnë në rregull kuotizacionin, që nuk tregojnë interesin e duhur për zbatimin e direktivave, të urdhërave të Partisë, si ruajtja e tesarave të Partisë etj.

Është e qartë për të gjithë se këto pengesa nuk pajtohen me principet e Partisë. Bërja pjesë në një nga organizatat e Partisë «është kondita e parë për të qenë anëtar partie».

Mbi këtë Partia nuk toleron asnjë lëshim dhe tërheq vëmendjen e organizatave të saja që të respektojnë me përpikmëri këtë ligj të parë themeltar të saj.

Në qoftë se një anëtar partie nuk kujdesohet që të ndjekë në rregull dhe të respektojë orarin e mbledhjeve të celulës, ose nuk merr pjesë në celulë, ai nuk mund të jetë anëtar partie, pse nuk mund të konsiderohet si i tillë ai që pa ndonjë arsye mungon në celulë, ku komunisti bën jetën e Partisë, ku ai merr vijën dhe direktivat e saja, ku do të derdhë aktivitetin e tij, ku do të mësojë të bëhet militant i vlefshëm i Partisë, ku do të perfeksionohet dhe ku Partia, nga ana e saj, do të shikojë dhe do të kontrollojë tërë punën e tij.

Të mungosh në mbledhjet e celulës për gjashtë muaj të tërë do të thotë të mos jesh në gjendje të përmbushësh detyrat që ke si anëtar partie. Prandaj organizatat tona duhet të marrin masat e nevojshme. Për këtë Partia cakton se një anëtar i tillë që mungon pa arsye, për tri herë rresht, përjashtohet nga Partia.

Gjithashtu ka raste që anëtari i Partisë të mos paguajë rregullisht kuotizacionin. Kjo është kondita tjetër për të qenë anëtar partie. Kjo ndihmë financiare, me të cilën anëtarët e Partisë mbajnë Partinë e tyre, që të përballojë nevojat e saja, e lidh anëtarin me Partinë.

Në fund të çdo muaji, çdo anëtar partie duhet të paguajë kuotizacionin e anëtarësisë. Këtë organizata duhet ta shikojë si

një problem organizativ me shumë rëndësi, prandaj të kujdeset që të plotësohet rregullisht në fund të çdo muaji, pa bërë as më të voglin lëshim.

Kuotizacioni është caktuar në një përqindje të rrogës ose mëditjes të anëtarëve të Partisë, që secili duhet ta japë pa as më të voglën pengesë çdo muaj pa lejuar që të grumbullohen muaj të tërë, sa të mos jetë në gjendje t'i paguajë ose t'i duket e vështirë.

Në organizatat e terrenit: kandidatët caktojnë sipas vullnetit të tyre sa do të paguajnë çdo muaj, por kjo nuk duhet të kalojë kuotizacionin e anëtarëve të Partisë të rangut të tyre.

Në ushtri, ushtarët, që janë anëtarë partie, do të japin një kuotizacion prej një lek në muaj dhe shokët e tjerë, të cilët marrin rrogë paguajnë kuotizacionin në bazë të rrogës që marrin. Kandidatët paguajnë vullnetarisht një shumë të caktuar, por që nuk duhet të kapërcejë sasinë e kuotizacionit të anëtarëve të Partisë të rangut të tyre.

Të rinjtë komunistë japin një kuotizacion jo më shumë se 1/2 leku në muaj.

Sidomos në fillimin e këtij viti kuotizacionet do të mund të kontrollohen më mirë pse do të regjistrohen në tesarat e anëtarësisë, për çdo muaj.

Çdo anëtar partie që pa arësye nuk paguan për tre muaj kuotizacionin, pezullohet nga pjesëmarrja në celulë derisa të merret vendimi i fundit nga forumet e Partisë.

Organizatata e Partisë duhet ta kenë të qartë se anëtari i Partisë duhet të bëjë jetën e Partisë, të bëjë pjesë në një nga organizatat e saja, të mbajë financiarisht Partinë dhe të luftojë për realizimin e vijës së saj. Këto janë kondita të domosdoshme, që do të respektohen kurdoherë nga anëtari i Partisë.

Për të metat, mungesat, gabimet, fajet e anëtarëve të Partisë celula duhet të ketë kujdesin më të madh, që të mos u kalojë përsipër. Ajo ka për detyrë të marrë masat e duhura dhe në kohën e duhur.

Kur ajo vëren të metat te një anëtar i saj, ka për detyrë t'i tërheqë vërejtjen, ta këshillojë dhe po qe nevoja të marrë masa disiplinore.

Masat që merr Partia janë: qortim, vërejtje e lehtë, vërejtje e rëndë me paralajmërim, që në rast se përsëritet faji, përjashtohet. Vërejtjet që i bëhen anëtarit të Partisë i shkruhen në biografinë e tij; si masë ekstreme për fajet të rënda i jepet dënimi më i madh «përjashtim nga Partia».

Në terren për përjashtim propozon celula, jep mendimin komiteti i n/prefekturës dhe aprovon komiteti qarkor; ndërsa në ushtri propozon celula dhe aprovon komiteti i regjimentit; por përpara se të jepet vendimi i prerë komisari i divizionit duhet

ta studjojë më parë çështjen me qëllim që të ruhet kriteri i drejtë që ndjek Partia në përjashtimet. Komisari i divizionit ka kompetencë që t'ja kthejë vendimin komitetit të regjimentit me porosi që të studjohet edhe një herë çështja, ta ndihmojë atë në caktimin më të drejtë të kriterit të përjashtimit.

Por organizatat duhet të kenë parasysh se këto dënime nuk janë as policore dhe as formale. Këto nuk jepen aq lehtë dhe pa i peshuar si duhet, secila nga këto ka rëndësinë e vet dhe rëndon mbi jetën e anëtarit të Partisë. Në Partinë tonë, të organizuar më së miri, ku çdo njeri kontrollohet dhe peshohet sa vlen, qortimi, vërejtjet e ndryshme kanë peshën e tyre dhe po të jepen pa vend, më shumë dëmtojnë, prandaj organizata duhet të gjykojë drejt, të peshojë mirë gabimin e anëtarit dhe të japë dënimin e duhur.

Duhet të kemi parasysh se Partia jonë para se t'i japë dënimin anëtarit të saj, përdor karshi tij disa masa edukative, duke e këshilluar, duke ja vënë në dukje gabimin, duke i thënë se një mungesë e tillë e dëmton Partinë, me një fjalë për çdo mungesë të tij, duke e vënë atë përpara ruajtjes së interesave të Partisë, para dashurisë që komunisti ka për Partinë e tij.

Por kur edhe anëtari të Partisë i jepet dënimi, kjo masë nuk e humbet karakterin edukativ. Dënimet duhet të kenë para së gjithash qëllim edukues për anëtarin e Partisë. Vërejtjet duhet të jenë bindëse që të mund të bëjnë te anëtari i Partisë efektin e ndreqjes së gabimit, e përmirësimit të tij. Në vërejtjen që i bën Partia anëtarit të saj ky duhet të shikojë ndihmën e Partisë për t'u ndrequr, për t'u bërë anëtar i vlefshëm. Një vërejtje e tillë nuk duhet ta dekurajojë anëtarin e Partisë, por përkundrazi ta inkurajojë atë; ai ta ndjejë veten të përtrirë dhe më të vendosur për të punuar me gjithë zemër për Partinë. Vërejtja e drejtë, bindëse i kujton anëtarit të Partisë se ai po del nga rruga e drejtë e Partisë, se ai po dëmton Partinë e tij dhe këtu ai që ka në zemër Partinë duhet të preket, të ndjejë thellë gabimin e tij dhe kjo të mos jetë vetëm një pendim, por edhe një mobilizim i anëtarit të Partisë për të hedhur tej mungesat për t'ju kushtuar më shumë çështjes së Partisë.

Vërejtja duhet të prekë sa më thellë personin e anëtarit të Partisë pse sa më shumë që ta ndjejë komunisti vërejtjen, aq më shumë vërejtja do të bëjë tek ky efektin edukativ.

Këtu del detyra për organizatat tona, që dënimet duhet t'i japin edhe kuptimin edukues, pse në ndreqjen e të metave dhe të gabimeve të anëtarit të Partisë do të shikohet rezultati pozitiv i dënimit.

Masa ekstreme, përjashtimi nga Partia, merret atëhere, kur një masë e tillë është e domosdoshme për interesat e Partisë, për ruajtjen dhe për forcimin e unitetit të saj.

Nga ana tjetër duhet t'i jepet fund një herë e mirë metodës,

me të cilën nuk i thuhet gabimet anëtarit të Partisë, por kërkohen të mbledhen dokumenta për ta përjashtuar. Kjo nuk është aspak komuniste, aspak e drejtë.

Anëtarit i Partisë korrigjohet në celulë, aty i vihen në dukje të metat, aty këshillohet dhe qortohet. Aty goditet pikësëpari, po qe nevoja dhe aty duhet të dalë dënimi për të. Të bëhet në organizatat tona metodë pune, që gabimet, gjërat jo të drejta, të ngrihen kurdoherë në celulë, ku anëtarët e celulës të diskutojnë mbi këto, të vihen në dukje konsekuencat dhe aty të dënohet çdo gjë e shtrembër. Asgjë jashtë celulës, po gjithnjë brenda saj, t'i thuhet hapur secilit të metat dhe gabimet që mund të bëhen gjatë punës. Celula është vendi ku thuhet dhe ndreqen gabimet e anëtarit të Partisë.

Ka raste që anëtarit të Partisë nuk i flitet në celulë për gabimet e tij, por i regjistronen gabimet dhe në fund i vjen propozimi, jo nga celula, por nga forumi më i lartë i tij për dënim. Kështu ngjau në celulat e dikastereve, kështu në Elbasan, në Vlorë, ku komiteti qarkor propozon përjashtimin dhe celulat nuk dinë gjë. Çështja është se kështu evitohen përpjekjet në celulë, lufta për mbrojtjen e vijës së Partisë, që do të armatosë më mirë celulën dhe do të forcojë unitetin e saj duke goditur gabimet dhe duke larguar elementët e dëmshëm. Të hiqet dorë definitivisht nga veprime të tilla, që e dobësojnë organizativisht Partinë.

Me udhëzime të vazhdueshme Komiteti Qendror ka shtruar para organizatës së Partisë se ruajtja e taserës së anëtarësisë është një detyrë nga më të mëdhatë për të gjithë anëtarët e Partisë pa përjashtim. Plot fakte tregojnë se këto detyra nuk zbatohen mirë nga shumë anëtarë. Kanë humbur mjaft tesera nga pakujdesia dhe moszbatimi i udhëzimeve të Komitetit Qendror. Tesera duhet të mbahet në një xhep të veçantë të siguruar mirë, në të cilën të mos vihet gjë tjetër, veç asaj. Të gjitha taserat, që kanë humbur deri më sot, mbaheshin në xhaketa ose portofole të pasiguruar dhe të ngatërruara me sende të tjera, që përdorehin përditë. Për t'i dhënë fund një herë e përgjithmonë kësaj pakujdesie, Komiteti Qendror porositi që taserat e anëtarësisë duhet të sigurohen konformë udhëzimeve. Humbja e taserës duhet lajmëruar menjëherë dhe të mos thuhet: «kisha turp, kisha frikë përjashtimin, ose kisha shpresë se mos e gjeja etj., prandaj nuk lajmërova». Ruajtja e taserës së Partisë duhet të bëhet edukatë në Partinë tonë. Pakujdesia për të ruajtur taserën e Partisë i jep mundësi armikut që të penetrojë në Partinë tonë. Moslajmërimi i shpejtë, kur humbet dokumenti, dëmton Partinë.

Çdo anëtar partie që humbet taserën e Partisë humbet menjëherë të drejtën e anëtarësisë së Partisë, atëherë kur kjo shkaktohet nga moszbatimi i direktivave të Komitetit Qendror dhe nga moskokëçarja që tregohet në disa raste për ruajtjen e taserës.

Me zhvillimin e situatës sonë, me zgjerimin e sektorëve të ndryshëm të shtetit, të Partisë dhe të organizatave jashtë Partisë si sindikata etj. bëhen mjaft lëvizje kuadrosh. Ngjan në praktikë që këto lëvizje bëhen shpesh dhe nuk vihet asnjë kujdes për të bërë dorëzimin e duhur të zyrave. Kjo ka si rrjedhim që shoku që fillon në detyrën e re, nuk njih sektorin, nuk njih problemet që duhet të zgjidhë, ç'duhet të bëjë.

Kur një shok transferohet duhet më parë të bëjë dorëzimin e plotë të zyrës; të dorëzojë gjithshka, të vërë në korrent zëvendësin e tij mbi të gjitha çështjet e atij sektori, mbi planin e punës, duke i dhënë opinionet e tij, mendimet dhe sugjerimet e tij. Ndryshe shokët e rinj do të detyrohen të kalojnë një kohë të gjatë, pa ditur se si të fillojnë. Kjo sjell vonesë dhe konfuzion në punë. Për këtë Komiteti Qendror porositi që shokët kur largohen nga një detyrë t'u dorëzojnë shokëve të rinj gjithshka në rregull dhe plotësisht.

Nga ana tjetër ndodh që për arësye të ndryshme një shok të mbetet në dispozicion. Ka raste që të tillë shokë të mbeten pa bërë jetën e Partisë për një kohë të gjatë. Kjo nuk është e drejtë dhe duhet të evitohet. Shoku nuk mund të vazhdojë të bëjë pjesë në celulën e vendit të punës, ku ka punuar më parë, por duhet të merret menjëherë në lidhje në vendin e banimit të tij, që të vazhdojë të bëjë jetën e Partisë përsa kohë që do të mbahet në dispozicion, ndryshe ai do të dezorientohet duke qenë larg jetës së Partisë. Kjo masë është me karakter provizor derisa të vendoset në vendin e tij të punës.

Anëtarët që transferohen nga një vend në tjetrin duhet të pajisen me letër-lidhjeje sipas udhëzimeve tona të dhëna më parë me anën e një letre të veçantë, ndërsa dokumentat duhet të dërgohen menjëherë pranë Komitetit Qendror, për t'ja përcjellë organizatës përkatëse. Ka ndodhur që shokë të mbeten pa lidhje duke mos pasur fletë-lidhjeje dhe duke mos ditur ku të drejtohen për të sqaruar gjendjen e tyre. Prandaj për këtë duhet të veprohet në rregull, të evitohet mungesa e mosbërjes jetën e Partisë.

Por shokët që nuk kanë fletë-lidhjeje duhet të interesohen edhe vetë, që të sqarojnë pozitën e tyre. Ata nuk duhet të presin muaj të tërë edhe në qoftë se organizata e tyre ka bërë një gabim të tillë, por duhet të dinë ku të drejtohen. Në këto raste të paraqiten tek sekretari i pushtetit dhe me anën e tij të vihen në kontakt me komitetin qarkor të vendit, t'i japin emrin e tyre dhe informatat e nevojshme, kështu që mund të informojnë menjëherë Komitetin Qendror për të rregulluar çështjen.

Që të evitohet çdo konfuzion në punën e financës së Partisë, po theksojmë edhe një herë se arka e Partisë duhet të mbahet në këtë mënyrë: në komitetin qarkor e mban sekretari organizativ, në komitetin e n/prefekturave e mban kuadroviçu, në celu-

lë sekretari, në ushtri, në divizion e mban inspektori, në batalion përgjegjësi i celulës d.m.th. komisar.

Është detyrë e të gjitha organizatave të Partisë, e forumeve drejtuese dhe e gjithë anëtarëve të Partisë, që të punojnë me vullnetin që na karakterizon ne komunistët, për ta forcuar Partinë tonë organizativisht, për ta rritur atë vazhdimisht me elementin më të shëndoshë të masave punonjëse të vendit, për të ngritur përherë dhe më tepër nivelin tonë ideologjik, për të forcuar unitetin e Partisë sonë, pse kështu plotësojmë detyrën tonë të shtrenjtë, duke ngritur dhe më lart flamurin e lavdishëm, flamurin e papërkulur të Lenin-Stalinit.

Të fala shoqërore
KOMITETI QENDROR I PKSH

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**UDHËZIME TË KQ TË PKSH PËR ZGJEDHJEN E
SEKRETARËVE TË CELULAVE TË PARTISË**

26 mars 1947

KOMITETEVE QARKORE TË PKSH

Komiteti Central vendosi të bëhen në të gjitha celulat zgjedhjet demokratike për sekretarët e tyre.

Kjo është një masë që ka rëndësi të madhe, pse do të kontribuojë shumë për të forcuar celulat, do të përforcojë parimin e centralizmit demokratik që ekziston në Partinë tonë, duke i bërë kështu celulat tona akoma më të afta për të kryer si duhet detyrat që u ngarkohen atyre si organizatë bazë e Partisë.

Zgjedhjet demokratike në Partinë tonë, natyrisht nuk janë një gjë e re. Që nga krijimi i saj u procedua në të tilla zgjedhje, por konditat e luftës influencuan patjetër në jetën e brendshme të Partisë.

Sot konditat kanë ndryshuar. Me zhvillimin normal të jetës së vendit duhet të normalizohet dhe jeta e brendshme e Partisë.

Organizatata bazë të Partisë, celulat, sot luajnë rolin kryesor në ndërtimin e vendit.

Për të mobilizuar tërë popullin për realizimin e planit të shtetit, duhet të kemi celula të forta, të drejtuara mirë dhe që të dinë të manovrojnë me shkathësi dhe inteligjencë për të zbatuar vijën e Partisë në terrenin praktik të tyre.

Si thuhej dhe në udhëzimet e fundit të Komitetit Central celula është hallka që lidh Partinë me masat, që rron përditë në zemrën e masave, që i ushqen ato me vijën e Partisë dhe i mobilizon ato për zbatimin e saj në jetë. E gjithë kjo punë varet kryesisht nga forca e celulës, nga zotësia e saj operative, nga zotësia e anëtarëve të saj dhe sidomos nga kompaktësia e saj, nga harmonia dhe uniteti i saj, nga disiplina e saj.

Është e ditur se që të mund celula të kryejë si duhet detyrat që i ngarkon Partia, një rol të rëndësishëm do të luajë sekretari i celulës, i cili do t'i japë tonin gjithë punës së celulës me drejti-

min e tij të shëndoshë, do të influencojë në të gjithë celulën për të vënë në jetë vijën e Partisë, ai do t'i edukojë me frymën e devocionit për punë të gjithë anëtarët e celulës, duke fituar kështu besimin dhe dashurinë e tyre. Këtej del se zgjedhja me vend e sekretarit të celulës, të cilit i besohet një punë e madhe në jetën e Partisë, do të luajë një rol me rëndësi për mbarëvajtjen e punës.

Nga ana tjetër duke u bërë zgjedhjet demokratike, celula vihet përballë një përgjegjësie të madhe, ajo do të kalojë një provë që do ta forcojë akoma më shumë dhe do ta bëjë më të aftë të përballojë detyrat që i vihen sot përpara.

Zgjedhja demokratike e sekretarëve të celulave, si u tha më lart, do të forcojë parimin e centralizmit demokratik që ekziston në Partinë tonë, gjë kjo që është e lidhur ngushtë me forcimin e kritikës dhe të autokritikës në celulat tona, duke u shërbyer kështu celulave tona për të shtuar gjithnjë dhe më tepër aktivitetin e tyre revolucionar. Kjo masë nga njëra anë do të evitohet dhe disa gjëra jo të pëlqyeshme që ndodhin në disa celula tona, si arrogancën, autoritetin formal, frikën që të kritikohet sekretari, besimin qorr dhe moskontrollin mbi sekretarin nga ana e celulës. Po nga ana tjetër do të sjellë forcimin më të madh të disiplinës së anëtarëve të celulës, në gjithë punën e tyre, besimin dhe autoritetin të sekretarit të celulës, të cilin e kanë zgjedhur vetë dhe njëkohësisht kjo do të forcojë ndjenjën e përgjegjësisë të vetë sekretarit të celulës, duke forcuar kështu raportet reciproke në mes të anëtarëve të celulës dhe sekretarit. Një gjë e tillë do ta pastrojë mirë atmosferën nga ngjarje jo të mira, do të forcohet harmonia në punë, kompaktësia ideologjike dhe organizative, uniteti i shëndoshë i celulës.

Kështu do të forcohet akoma më tepër disiplina koshiente e anëtarëve të celulës në të gjithë punën e tyre, do të zhvillohet në të gjithë anëtarët e celulës detyra e kontrollit në të gjithë punën e përditshme të celulës dhe të sekretarit, do të ngjallet në një shkallë të lartë ndjenja e përgjegjësisë në të gjithë anëtarët për çdo punë të celulës dhe sidomos tek sekretari, i cili duhet ta kryejë me ndërgjegje përgjegjësinë që i ngarkon atij celula.

Tani kuptohet që zgjedhja e sekretarëve të celulave është e lidhur ngushtë me mbarëvajtjen e punës, d.m.th. të celulës. Në goftë se do të zgjedhim atë që duhet, atë që shikon më drejt dhe i dhimbset më shumë puna e Partisë, atë që e ha meraku, kur çalon puna e Partisë, atë që vë mbi të gjitha interesin dhe punën e Partisë, atë që do të drejtojë më mirë celulën, patjetër do të korrim sukses, pse në krye të celulës do të kemi njeriun që meriton, më aktiv dhe më të përshtatshëm për këtë detyrë. Ja, të tillë njerëz të nxjerrim në krye të celulave, që të sigurojnë mbarëvajtjen e celulës dhe të punës, ta zgjedhim me bindje të plotë se do ta kryejë këtë detyrë.

Të mos e shikosh kështu personin që do të dalë në krye të celulës do të thotë të dënosh celulën me një dorë drejtuese të dobët, pa forca të shëndosha, që të mbajë barrën e detyrave të mëdha që i ngarkohen celulës. Komiteti Qendror kërkon që kjo masë të kuptohet drejt nga të gjithë anëtarët e Partisë, që të shikojnë dhe të vënë në krye të celulave të tyre anëtarin më të mirë, atë që është më i sprovuar në luftë dhe në punë, jo atë që flet vetëm bukur, por atë që dhe punon më shumë dhe më mirë.

Komiteti Central kërkon që kjo masë e rëndësishme e Partisë sonë t'i preokupojë seriozisht të gjitha organizatat tona, të gjithë anëtarët e Partisë. Jo vetëm që nuk mund të pranohet, por është dhe krejt i dëmshëm indiferentizmi para kësaj mase që po merr Partia jonë për forcimin e radhëve të saja. Këtu kërkohej një preokupacion i pastërt, i sinqertë, që i ka rrënjët e tija në interesin dhe dëshirën që të forcojmë celulën për të kryer mirë detyrat e mëdha, që i dalin përpara.

Të gjithë të flasin, të thonë mendimin e tyre, cilin duan në krye të celulës, që u mbushet syri se do ta kryejë me nder këtë detyrë dhe të thonë se ky është i denjë për të drejtuar.

Për zgjedhjen e sekretarëve të celulave do të bëhet një fushatë në Parti, do të bëhen mbledhje posaçërisht për këtë problem, ku do të diskutohet gjerësisht për këtë çështje që të dalë e qartë pse bëhen këto zgjedhje. Mbas disa ditë intervali, që do të bëhen me të vetmin qëllim që shokët të kenë kohë që të mendojnë, që të preokupohet anëtari i celulës për të zgjedhur atë më të mirin për sekretar celule, celula bën mbledhjen e saj të veçantë, në të cilën do të procedohet në zgjedhjen e sekretarit. Këtu bëhen propozime nga çdo anëtar i celulës për elementin që mendojnë të dalë në krye dhe që meriton një barrë të tillë; për secilin nga të propozuarit duhet të jepet motivacioni se për çfarë meritash propozohet që t'i ngarkohet përgjegjësia e celulës, diskutohet, shfaqin opinionin e tyre të gjithë anëtarët dhe mbas këtij procesi, ku do të krijohet një opinion i qartë kush duhet të dalë si drejtues i celulës, me shumicën e votave të hapëta del sekretari i celulës.

Në këto mbledhje duhet të asistojë dhe i deleguari i komitetit të n/prefekturës për të ndjekur mënyrën e procedimit dhe kriterin e zgjedhjeve. Gjithashtu atje ku ka mundësi, sidomos në qytete duhet të asistojnë edhe të deleguar të komitetit qarkor për të ndjekur së afërmi zbatimin e kësaj mase të rëndësishme të Komitetit Qendror. Pjesëmarrja e të deleguarve në këto mbledhje nuk duhet të influencojë aspak për zgjedhjen e sekretarit, pse të drejtë vote ka vetëm celula, d.m.th. anëtarët e saj.

Komiteti Qendror kërkon nga të gjithë anëtarët e Partisë që kjo masë të kuptohet mirë, të shikohet si një masë me rëndësi të madhe për jetën e Partisë sonë, për forcimin e organizatave tona bazë dhe të Partisë në përgjithësi.

KOMITETI QENDROR I PKSH

Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

UDHËZIME TË KQ TË PKSH MBI PROPAGANDËN, AGJITACIONIN DHE PUNËN KULTURALE ME MASAT

14 prill 1947

GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PKSH

Të dashur shokë,

Në konditat e tanishme, kur para Partisë dalin kaq shumë probleme, agjitacioni dhe propaganda duhet të forcohen. Me këtë organizim të dobët dhe me këto mënyra pune, është e pamundur që agjitacioni e propaganda jonë të kryejnë plotësisht detyrat që u ngarkohen.

Agjitacioni e propaganda jonë sot nuk janë efikase, shpeshherë mjaft të errëta dhe të përgjithshme. Nga ana tjetër, anëtarët e Partisë dhe forumet nuk kuptojnë rëndësinë që kanë agjitacioni e propaganda për zbatimin e vijës së Partisë. Organizimi i shtetit dhe ngritja e një aparati të gjerë për kulturën e arësimin e masave kërkon që problemi i agjitacionit e i propagandës të ngrihet para organizatës së Partisë si një çështje me rëndësi.

Në kondita të reja duhet të përshtatim forma të reja për propagandën e agjitacionin e Partisë. Sot del nevoja të përqendrojmë ndër organet e propagandës të gjithë punën politike, kulturele e arësimore d.m.th. gjithshka lidhet me ideologjinë e Partisë. Në Shqipërinë e re janë krijuar konditat për një veprimtari politike e kulturele-arësimore të gjerë, por puna është se këto duhen organizuar e drejtuar nga Partia që të shërbejnë për edukimin e masave në rrugën e Partisë dhe të mos lejohet që të përdoren nga elementë të huaj për ideologjinë e Partisë. Prandaj duhet që Partia me anë të organeve të propagandës të drejtojë të gjitha institucionet kulturele dhe të gjithë jetën politike, ideologjike. Kjo është e mundur atëhere kur organizatat e Partisë të kenë kuptuar se puna politike, ideologjike me masat është një nga detyrat më të mëdha për realizimin e vijës së Partisë.

Puna duhet filluar nga forcimi i seksioneve të agjitacionit

e të propagandës pranë komiteteve të prefekturave, të n/prefekturave më të mëdha dhe organizimit më të mirë të organeve të propagandës pranë organizatave të masave, sindikata, rini, grua. Ato duhet të jenë të plota me njerëz të zot dhe me një përgatitje teoretike minimale për konditat e Partisë sonë. Pa krijuar aparatet e nevojshëm pranë komiteteve të Partisë është e pamundur që propaganda e agjitacioni i Partisë të kryejnë mirë punën. Prandaj në vijë të parë duhet të ngrihen e të forcohen seksionet e agjitacionit e të propagandës pranë komiteteve qarkore të Partisë, si edhe pranë komiteteve të n/prefekturave më të mëdha. Në seksionet e agjitacionit e të propagandës në prefekturat krijohen këta sektorë pune:

1. — SEKTORI I SHTYPIT E I AGJITACIONIT

Përgjegjësi i këtij sektori ndjek me vëmendje shtypin në qarkun e vet dhe shtypin e qendrës; kujdeset që në shtyp të dalin gjërat drejt dhe interesohet sa lexohet dhe si shpërndahet shtypi ynë. Nga ana tjetër kujdeset për agjitacionin e Partisë, për mënyrat e format e agjitacionit (mbledhje, konferenca, meetingje etj.), drejton aktivet e agjitorëve.

2. — SEKTORI I TEORISË

Përgjegjësi i këtij sektori drejton të gjitha format që ka krijuar Partia në qark për edukimin e anëtarëve të Partisë e të kuadrove. Kujdeset që në Parti dhe rreth Partisë të mos bëhen shtrëmbërime e deviacione nga vija e përgjithshme e Partisë, nga mësimet e marksizëm-leninizmit. Ky organizon dhe ndihmon forumin e Partisë në luftën kundër shtrëmbërimeve e deviacioneve dhe kundër influencave të ideologjisë borgjeze e mikroborgjeze qofshin këto në anëtarët e Partisë ose në organet e sektorët e ndryshëm të punës rreth Partisë. Ai kujdeset edhe për punën edukative në organizatat e masave.

3. — SEKTORI I KULTURËS

Përgjegjësi i këtij sektori ka për detyrë të zhvillojë dhe të organizojë të gjithë jetën kulturale të vendit: teatër, orkestra, grupe korale, letrare etj. Ai ka nën kontrollin e tij dhe drejton të gjitha institucionet kulturale në qarkun e vet: shtëpi kulture, biblioteka, muzeume, klube, shtëpi leximi, kinema, qendra turistike etj.

Përgjegjësi i sektorit kultural duhet të kujdeset që në artet dhe kulturën, kudo, të jetë e fortë ideologjia e Partisë dhe të luftohen influencat e huaja imperialiste.

4. — SEKTORI I ARËSIMIT

Përgjegjësi i këtij sektori është njëkohësisht përgjegjës i arësimit në komitetin ekzekutiv të prefekturës. Ky ka për detyrë të interesohet për edukimin politik-ideologjik të mësuesve, të bëjë të fortë në shkollat ideologjinë e Partisë dhe të organizojë luftën kundër analfabetizmit. Ai organizon propagandën antifetare në shkollat e kudo edhe luftën kundër fanatizmit e zakoneve të këqia. Si përgjegjës i seksionit të arësimit në komitetin ekzekutiv të prefekturës ai duhet të zbatojë udhëzimet që i vijnë nga Ministria e Arësimit dhe politikën e shtetit për arësimin e popullit.

5. — SEKTORI I SINDIKATAVE

Përgjegjësi i këtij sektori është njëkohësisht përgjegjës i kulturës në këshillin sindikal të prefekturës. Duke qenë se Partia duhet të tregojë një kujdes të madh për punën politiko-ideologjike e kulturale-arësimore në sindikatat është vendosur që në seksionin e agjit-propit të bëjë pjesë dhe përgjegjësi i kulturës në sindikata. Atje ai merr më mirë vijën e Partisë e kështu duke pasur ndihmën direkte të sektorëve të ndryshëm të seksionit të agjit-propit do të organizojë më mirë punën politiko-ideologjike e kulturale-arësimore në sindikatat.

6. — SEKTORI TEKNIK

Përgjegjësi i këtij sektori merret me të gjitha çështjet teknike, me shpërndarjen e shtypit, të librave e të materialit të ndryshëm.

Organet e propagandës veprojnë nën udhëheqjen direkte të forumit të Partisë, lidhjet në mes organeve më të larta me ato më të ulta bëhen nëpërmjet forumeve të Partisë, por kjo nuk do të thotë se ato nuk mund të veprojnë e të konsultohen drejtpërdrejt për çështje të një karakteri sekondar e instruktiv në lidhje me udhëzimet e dhëna nga forumi.

Seksionet e agjit-propit pranë komiteteve të prefekturave, punën për realizimin në masë të të gjitha çështjeve që i përkasin

qarkut të tyre, e transmetojnë në organizatat e masave. Për këtë arësye është e domosdoshme të krijohen lidhje të mira midis seksionit të agjit-propit me organet e propagandës që kanë organizatat e masave. Seksionet e agjit-propit mbikëqyrin veprimtarinë e tyre për problemet e përgjithshme dhe i ndihmojnë ato për të zgjidhur problemet e tyre të veçanta.

Seksionet e agjit-propit pranë komiteteve të n/prefekturave, sot për sot duhet të ngrihen në n/prefektura më të mëdha ku puna e agjitacionit dhe e propagandës paraqitet më e gjerë dhe ku është e domosdoshme dhe e mundur të jetë një organ i veçantë, joformal, për drejtimin e agjitacionit dhe të propagandës së Partisë. Seksionet e agjit-propit në n/prefektura përbëhen prej tre sektorëve: sektorit të shtypit e agjitacionit, sektorit të teorisë dhe sektorit kulturalo-arësimor. Në një formë më të ulët ato kanë po të njëjtat funksione dhe detyra si ato në prefekturë.

Ndërsa në celulat dhe në byrotë e celulave të mëdha, sipas letrës së fundit të Komitetit Qendror, sekretari i celulës ose i byrosë është përgjegjës për gjithë punën e tyre si dhe për agjit-propin; por në këtë sektor ai ka një ndihmës që kujdeset në terrenin e vet të veprimtarisë, për të gjitha ato probleme që thahet më lart për gjithë sektorët e agjit-propit.

Pranë seksioneve të agjit-propit në n/prefektura ose aty ku nuk ka seksione pranë komiteteve të n/prefekturave krijohet aktiviteti i agjitorëve dhe pranë seksioneve të agjit-propit në prefektura krijohet aktiviteti i konferencierëve. Seksionet e agjit-propit organizojnë gjithashtu ekipe propagandistike ndër fshatrat.

1. — AKTIVET E AGJITATORËVE

Aktivet e agjitorëve kanë rolin që të forcojnë dhe të zhvillojnë agjitacionin e Partisë ndër masat.

Në aktivet e agjitorëve hyjnë anëtarë udhëheqës të Partisë, sekretarët e celulave, përgjithësisht anëtarë, ose kandidatë partie që shquhen në punën e tyre me masat si dhe shokë që udhëheqin punën në institucionet e ndryshme shtetërore, kulture, ekonomike etj. Në aktivet e agjitorëve të Partisë mund të shtohen gjithashtu edhe të rinjtë komunistë që janë agjitorë të dalluar në masat e rinisë popullore. Aktiviteti i agjitorëve mbledhet kohë pas kohe me vendim të forumit të Partisë ose të përgjegjës të agjit-propit në forum. Për aktivet e agjitorëve kujdeset sho-

ku i ngarkuar me sektorin e shtypit e të agjitacionit në seksionin e agjit-propit pranë qarkorit të Partisë ose pranë komitetit të n/prefekturës.

Por mbledhjet e aktivitetit në n/prefekturë mund t'i drejtojë përgjegjësi i agjit-propit në forum dhe në disa raste, vetë sekretari i komitetit të n/prefekturës. Në mbledhje flitet mbi ndonjë detyrë aktuale të Partisë ose mbi disa probleme ku duhet të orientohet propaganda e Partisë.

Në aktivet e agjitorëve edukohen dhe formohen agjitorët e Partisë. Agjitorët e Partisë duhet të jenë shokët më të mirë që me fjalët dhe veprat e tyre dinë të udhëheqin masat, t'i edukojnë politikisht, t'i mobilizojnë për realizimin e vijës së Partisë. Sot mund të themi se Partia jonë nuk ka akoma agjitorë të zot që të kryejnë rolin e tyre si duhet. Por Partia duhet të punojë seriozisht për të krijuar sa më shpejt agjitorë dhe propagandistë të zot.

2. — AKTIVI I KONFERENCIERËVE

Aktivet e konferencierëve krijohen me shokë të ngritur (rreth 7-10 vetë) që referojnë në kurset teorike dhe në bibliotekat e Partisë. Aktiviteti i konferencierëve udhëhiqet nga përgjegjësi i sektorit të teorisë. Këtu bëhet plani i konferencave për bibliotekën e Partisë dhe pregatiten referatet për kurset teorike. Është e nevojshme që konferencat të shkruhen e të kontrollohen nga përgjegjësi i sektorit të teorisë ose nga vetë përgjegjësi i seksionit të agjit-propit. Aktiviteti i konferencierëve mund të pregatisë konferenca edhe për publikun mbi çështje të ndryshme politike, kulture etj.

3. — EKIPET E PROPAGANDËS

Me vendim të komitetit qarkor të Partisë ose të komitetit të n/prefekturës organizohen ekipe të propagandës që përbëhen prej agjitorëve dhe propagandistëve të Partisë, të rinisë, të gruas, të grupeve teatrale, korale etj. Këto ekipe dërgohen për një kohë të caktuar e me një program të caktuar në ato vende ku influenza jonë është e dobët ose kur duhet të organizohet një fushatë e gjerë propagande si p.sh. mbjelljet e pranverës, të korrurat etj.

Për të vënë në vijë të drejtë agjitacionin e propagandën e Partisë duhet që forumet dhe anëtarët e Partisë të ndjekin me shumë kujdes «Bashkimin». Shtypi ynë do të japë materialin e nevojshëm për agjitorët e propagandistët e Partisë. Artikujt me rëndësi duhet të punohen nga organizatat e Partisë dhe të merren

menjëherë masa për zbatimin e tyre. Nga ana tjetër agjitorët e propagandistët e Partisë dhe të gjitha organet e propagandës duhet të përdorin të gjitha mjetet për t'ja bërë [shtypin] të njohur e të kuptueshëm masave të popullit. Artikujt e udhëheqësve p.sh. anëtarë të Komitetit Qendror duhet të punohen, të studjohen e t'i shpjegohen mirë popullit. Artikujt me rëndësi janë udhëzime të përditshme që Partia u dërgon anëtarëve e forumeve të saj me anë të shtypit. Bile duhet të mësojmë edhe popullin që të mendojë kështu edhe nuk mund të pranohet që anëtarët e Partisë e forumet të rrinë larg problemeve politike të vendit dhe të mos interesohen për shtypin e qendrës. Kjo duhet vënë si detyrë me rëndësi për të gjithë Partinë tonë.

Në fund ngrejmë edhe problemin e kuadrove për agjitacionin e propagandën e Partisë. Është bërë zakon të thuhet se nuk kemi kuadro për këtë sektor pune me kaq rëndësi. Përgjithësisht është treguar mjaft frikë në vendosjen e kuadrove për propagandë dhe shpeshherë është ndjekur një kriter i gabuar duke vënë anëtarë partie jo shumë të fortë e të lidhur me Partinë. Nuk është punuar si duhet për të përgatitur kuadrot për propagandën e Partisë. Përgjithësisht është bërë një punë e rastit. Kuadrot që duhet të vendosen me punë për agjitacionin e propagandën e Partisë duhet të jenë elementë të aftë të lidhur shumë me Partinë. Duhet të kemi më shumë kujdes e guxim se në Partinë tonë gjenden njerëz të tillë. Aktivitetet e agjitorëve e të konferencierëve duhet të bëhen një shkollë e mirë për kuadrot e agjitacionit e të propagandës.

Organizimi më i mirë i agjitacionit e i propagandës së Partisë që vihet sot si problem me rëndësi para Partisë sonë duhet të sjellë një forcim të dukshëm të punës politiko-ideologjike të Partisë dhe një lidhje më të ngushtë të Partisë me masat. Komiteti Qendror i Partisë kërkon nga forumet dhe anëtarët e Partisë që të forcohet puna politiko-ideologjike në Parti e me masat e popullit. Partia duhet të udhëheqë me sukses luftën politike dhe luftën në frontin ideologjik. Jo vetëm jashtë Partisë, por edhe brenda në Parti duhet të luftohet kundër influencave borgjeze

e mikroborgjeze për të rrënjosur thellë ideologjinë tonë marksiste-leniniste.

Për këtë qëllim Komiteti Qendror vendosi të merren këto masa:

1. — Të organizohen e të plotësohen seksionet e agjit-propit kudo në prefekturat, në n/prefekturat më të mëdha dhe të caktohen mirë funksionet e tyre.

2. — Të forcohen aktivitetet e agjitorëve e të organizohen aktivitetet e konferencierëve.

3. — T'u vihet si detyrë e parë anëtarëve të Partisë të lexojnë shtypin e qendrës, botimet e ndryshme dhe të studjojnë për ngritjen e tyre teorike.

4. — Të ushtrohet një kontroll më i madh në institucionet kulturele dhe në artet për të forcuar ideologjinë tonë.

5. — Të kihet më shumë kujdes për kuadrin e agjitacionit dhe të propagandës.

6. — Në raportet që i dërgohen Komitetit Qendror të shkruhet me hollësi dhe për pikat e caktuara për të gjithë sektorët e agjit-propit.

KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**LETËR E KQ TË PKSH DËRGUAR ORGANIZATAVE TË
PARTISË NË TERREN DHE NË USHTRI NË LIDHJE ME
OPORTUNIZMIN E SEJFULLA MALËSHOVËS DHE ME
DËNIMIN E KËTIJ OPORTUNIZMI NGA KQ I PARTISË**

10 maj 1947

GJITHË ORGANIZATAVE TË PKSH NË TERREN DHE NË USHTRI

*Mbi qëndrimin që duhet të mbajë Partia ndaj Sejfulla
Malëshovës*

Plenumi V i Komitetit Qendror të Partisë, i mbajtur më datën 21 shkurt 1946 përjashtoi Sejfulla Malëshovën nga Byroja dhe nga Komiteti Qendror i Partisë për arsye të pikëpamjeve të tija politike dhe ekonomike të gabuara. Pikëpamjet politike të Sejfulla Malëshovës ishin thellësisht oportuniste, qoftë në politikën e jashtme të Partisë sonë, qoftë në politikën e brendshme. Këto pikëpamje ishin në kundërshtim me vijën e drejtë të Partisë sonë.

1. — Në politikën e jashtme, Sejfulla Malëshova mbronte një politikë të gjerë dhe liberale, kryesisht oportuniste, në lidhje me marrëdhënjet që duhej të kishte shteti ynë me shtetet imperialiste anglo-amerikane si dhe me ato shtete të tjera, ku situata e jashtme dhe e brendshme e tyre ishte dhe qëndron akoma e errët. Sejfulla Malëshova, marrëdhënjet e shtetit tonë me shtetet imperialiste të lartpërmendura, i vinte në një plan me marrëdhënjet që vendi ynë duhej të kishte dhe ka me shtetet thellësisht demokratike dhe aleatë e miq besnikë të popullit tonë. Sejfulla Malëshova thoshte: «për politikën e jashtme ne duhet të orientohemi nga Bashkimi Sovjetik, por zyrtarisht, ne, aleatët duhet t'i vëmë në një plan».

Qëllimet dhe tendencat e reaksionit anglo-amerikan, të cilat u manifestuan gjatë gjithë zhvillimit të luftës, qëllime dhe tendenca që Partia jonë ua vuri në dukje gjithë anëtarëve të saj me qëllim që këta të ishin të qartë në vijën politike në kuadrin e

aleancës antifashiste, u shfaqën në mënyrë brutale dhe agresive, pas mbarimit të luftës, kundër Bashkimit Sovjetik, faktorit të madh të fitores, kundër demokracive përparimtare të dala nga lufta dhe veçanërisht kundër vendit tonë, ku populli kishte vendosur një regjim të tillë. Sejfulla Malëshova nuk ka dashur ta kuptonte këtë rrezik dhe këto shfaqje të imperialistëve anglo-amerikanë. Më vonë, kur u goditën nga Partia pikëpamjet e tija të gabuara, ai ka thënë: «Gabimi im personal ka qenë se unë mendoja që këto çështje (qëndrimet agresive të imperialistëve anglo-amerikanë kundër Bashkimit Sovjetik etj.) nuk do të dilnin kaq shpejt dhe kaq të ashpra».

Do të ishte gabimi më i rëndë po të mendohej që në një situatë të tillë Partia jonë të vinte në një plan mbrojtësit e demokracisë së vërtetë, të paqes dhe të sigurimit botëror, me imperialistët anglo-amerikanë, mbrojtësit e fashizmit dhe të mbeturinave të tija, nxitësit e një lufte të tretë botërore. Në një gabim të tillë ra Sejfulla Malëshova. Sejfulla Malëshova, konsekuent në vijën e tij të gabuar, shkonte edhe më tej. Ai thoshte: «Në lidhje me situatën e jashtme është një detyrë imperative që demokracisë formale duhet t'i bëjmë edhe ndonjë koncesion. Karshi demokracive të Perëndimit duhet të jemi të matur, duhet të bëjmë disa koncesione për të mbajtur pozitat tona. Gjithashtu koncesione mund t'u bëjmë edhe në fushën ekonomike etj.». Këto pikëpamje Sejfulla Malëshova u përpoq që Partia t'i pranonte dhe t'i zbatonte, por Partia i hodhi poshtë. Kur qeveria amerikane i vuri qeverisë sonë si kusht njohjen e traktateve të vjetra që kishin lidhur Zogu me Shtetet e Bashkuara, Sejfulla Malëshova mbronte pikëpamjen se duhej pranuar kondita e amerikanëve për njohjen e qeverisë sonë. Pranimi i një kushti të tillë do të thoshte shkelje e sovranitetit të vendit dhe të popullit tonë dhe çelja e derës për koncesione të tjera anglo-amerikane. Partia s'pranoi kurrsesi një kusht të tillë për popullin dhe vendin tonë. Sejfulla Malëshova detyrohet të pohojë më vonë pikëpamjen politike të tij të gabuar duke thënë: «Unë, personalisht, kam qenë për njohjen e qeverisë, e cila do të forconte pozitat tona, por nuk duhej ta konsideroja të domosdoshme njohjen e qeverisë dhe se kjo do të vinte vetëm me koncesionet që do t'i linim imperializmit anglo-amerikan». Pikëpamjet e Sejfulla Malëshovës kanë qenë po kaq oportuniste edhe ndaj marrëdhënjeve me Italinë, me të cilën ai shihte mundësira marrëdhënjesh tregëtare që në ato momente kur ne kishim dalë nga një luftë me të dhe kur situata e brendshme në Itali ishte dhe qëndron gjithmonë e errët. Sikur Partia jonë të kishte ndjekur pikëpamjet krejtësisht të gabuara të Sejfulla Malëshovës, ajo do të humbiste pozitat drejtuese, do të vendosej në vatrën tona influenca e egër e imperializmit dhe populli ynë do të hynte në një robëri të rëndë, të përgjakshme. Vendi ynë do

të bëhej një Greqi e dytë ku do të sundonin kuislingët dhe kriminelët e luftës.

2. — Sejfulla Malëshova, kurdoherë konsekuent në pikëpamjet e tija oportuniste në politikën e jashtme, kishte po këto qëndrime edhe në politikën e brendshme të Partisë sonë. Ai ishte për një front shumë të gjerë, ku lehtësisht mund të maskoheshin dhe të vepronin të organizuar armiqtë e popullit tonë dhe ku diferencimi dhe lufta kundër këtyre elementëve armiq do të bëhej shumë e vështirë. Ai ishte për një politikë të butë kundër këtyre elementëve armiq. Megjithëse predikonte gjoja një luftë me ta, ai nga ana tjetër u jepte këtyre mundësitë ta bënin luftën kundër nesh me mjete gati të barabarta, qoftë ideologjike, qoftë ekonomike. Sejfulla Malëshova mbronte pikëpamjen e një politike të ëmbëlsuar me klerin reaksionar katolik, pikërisht kur ky po pregatitej të na godiste. «Gabimi më i madh që unë kam bërë, ka thënë Sejfulla Malëshova përpara Plenumit V të Partisë, ishte çështja me katolikët. Unë mendoja se kleri ishte kundër nesh, porse ne mund të përfitonim nga ai dhe nga ana tjetër e kishim frikë atë se ai kishte lidhje me masat. Kur më tha shoku Enver se arkipeshkvi thotë se «s'ka asnjë katolik që të jetë me Enverin» unë e nënvlerësoja armiqësinë e tyre dhe s'mejtoja dot komplete etj. që ata po organizonin dhe e dyta unë e vlerësoja shumë forcën e tyre, por tani u pa që ata nuk kanë qenë aq të fortë». Nga ky pohim i Sejfulla Malëshovës nuk del vetëm mbivlerësimi i forcës së klerit reaksionar, por del dhe mosbesimi në forcën e Partisë dhe të popullit tonë. Sejfulla Malëshova ishte mbrojtësi i pikëpamjes që në Asamblenë Kushtetuese të vinin një numër i konsiderueshëm «nacionalistësh» që jo vetëm s'kishin dhënë prova të mjafta për besnikëri ndaj popullit, por që kishin filluar që në atë kohë të kritikonin, gjoja si pjesëtarë të Frontit. Një pjesë e këtyre deputetëve «nacionalistë» sot ndodhen në burg për veprimtari kundër pushtetit të popullit¹. Sejfulla Malëshova, gjoja nën pretekstin e mbrojtjes së intelektualëve përparimtarë, inkurajonte dhe shtynte përpara të gjithë ata intelektualë reaksionarë dhe armiq të pushtetit tonë. Kështu e kuptonte Sejfulla Malëshova politikën e brendshme të Partisë sonë dhe ishte i bindur se kjo ishte rruga më e drejtë. Politika ekonomike e Partisë sonë, sipas pikëpamjes së Sejfulla Malëshovës, duhej gjoja të synonte në mëkëmbjen e sektorit të shtetit, por kjo duhej të bëhej në një luftë të vazhdueshme dhe të gjatë me sektorin privat ndaj të

¹ Është fjala për grupin e deputetëve tradhëtarë të kryesuar nga Shefqet Beja që, të nxitur dhe të përkrahur nga imperialistët amerikanë e anglezë, punuan për përmbysjen me forcë të pushtetit popullor. Ata u zbuluan e u gjykuan nga gjyqi i popullit dhe muarën dënimin e merituar.

cilit duhej të tregoheshim gjerësisht liberalë dhe t'i linim fushë të gjerë veprimi dhe zhvillimi. Në artikullin: «Politika jonë ekonomike», botuar në gazetën «Bashkimi» më 25 dhjetor 1944, Sejfulla Malëshova shkruan: «Është një detyrë e madhe aktuale, një nga detyrat kryesore që sektorët e ekonomisë sonë që kanë ekzistuar gjer më sot, të hyjnë në aktivitet, të ngjallen dhe të lulëzojnë në bazë të inisiativës së plotë private». Një model konfuzioni dhe pikëpamjesh politike dhe ekonomike të gabuara dhe antimarksiste janë opinionet e shfaqura prej Sejfulla Malëshovës në Plenumin IV të Partisë dhe që i shënojmë më poshtë, tekstualisht të nxjerra nga procesverbalet e Plenumit IV të Komitetit Qendror.

Ja si mendon Sejfulla Malëshova: «Industria jonë ka qenë në luftë me industrialët e jashtëm, prandaj ne mund t'i bëjmë me vete industrialët. Kjo varet nga një politikë e drejtë ekonomike që duhet të bëjmë. Ne duhet të forcohem: fshatarët dhe punëtorët u bënë me ne gjatë luftës, por nuk i kemi qind për qind me ne. Me punën tonë duhet t'i bëjmë me vete si këta ashtu dhe industrialët dhe gjithë shtresat e tjera. Me politikën tonë ekonomike ne duhet të nxitim punën private, inisiativën private. Industrialët janë me të vërtetë të fortë, por ne kemi minierat, bankën, pushtetin. Gjithashtu kemi në dorë tregëtinë e jashtme, monopolin. Ne duhet të forcohem ekonomikisht, por, siç do forcohem ne, do forcohen dhe ata. Kjo është në favorin tonë nga pikëpamja ekonomike. Kjo politikë e gjerë sjell me vete që në formë të zbrapsemi, por në lidhje me situatën e jashtme, kjo është një detyrë imperative. Pra, ne duhet të ndihmojmë zhvillimin e ekonomisë private, nuk duhet të trembemi etj. etj.»

Në lidhje me përkrahjen e inisiativës private dhe të sektorit privat, Sejfulla Malëshova s'mungon t'u hapë atyre dhe kredi në Bankën e Shtetit. Ja ç'thoshte Sejfulla Malëshova në fjalimin e mbajtur përpara autoriteteve me rastin e inaugurimit të Bankës së Shtetit më 22 janar 1945: «...Ajo (banka) do të bëhet një armë e fortë për të siguruar independencën tonë ekonomike. Ajo do të bëhet një faktor i madh për të ngjallur inisiativën private në tregëti dhe në industri». Por megjithkëtë zemërgjerësi që tregonte Sejfulla Malëshova ndaj inisiativës private dhe sektorit privat, përsëri kritikon pushtetin tonë, që nuk ka ditur të bëjë si duhet këtë politikë kaq zemërgjerë. Ja ç'thotë Sejfulla Malëshova në referatin që ka mbajtur në Kongresin e Frontit më 5 gusht 1945: «...U përpoqme të ngjallim dhe të aktivizojmë në bazë të inisiativës private sektorët e ekonomisë sonë që kanë ekzistuar edhe përpara, por në këtë drejtim është bërë shumë pak, ca nga pazotësia jonë dhe ca nga vullneti i keq i një pjese me rëndësi të tregëtarëve dhe të industrialëve». Me fjalë më të thjeshta Sejfulla Malëshovës i vjen keq që Partia s'ka qenë aq dorëlëshuar ndaj

tregëtarëve dhe industrialëve dhe këta të fundit s'kanë ditur të përfitojnë sa duhet.

Vetëm kështu e shikonte Sejfulla Malëshova politikën ekonomike që duhej të ndiqte Partia jonë. Kjo politikë ekonomike e mbrojtur prej Sejfulla Malëshovës, do të thoshte dobësimi i pozitave tona politike dhe ekonomike, dobësimi i sektorit të shtetit, krijimi me duart tona i një terreni përlshjeje dhe lufte të ashpër, kundër pozitave të forta të Partisë sonë, të krijuara me kaq gjak dhe sakrificë nga populli ynë. Politika e predikuar prej Sejfulla Malëshovës do të thoshte tërheqje në të gjithë frontin nga pozitat e shëndosha që kishte fituar Partia jonë. Sikur Partia jonë të kishte ndjekur pikëpamjet krejtësisht armiqësore, antimarksiste të Sejfulla Malëshovës në politikën e brendshme dhe në atë ekonomike, populli ynë dhe vendi ynë do të hynte nën thundrën e tmerrshme të kapitalistëve të huaj e të brendshëm, gjaku i popullit do të shërbente edhe këtë herë për të forcuar bejlerët, feudalët, industrialët, tregëtarët dhe gjithë gjakpirësit e popullit tonë. Kjo do të ishte vetëvrasje për Partinë tonë dhe krimi më i tmerrshëm ndaj popullit shqiptar. Në rast se do të ndiqej rruga e Sejfulla Malëshovës, do të ishte i pamundur realizimi i reformave të mëdha me karakter ekonomik dhe social që bëri me sukses Partia jonë. Reforma agrare që kreu me sukses Partia jonë, po të bëhej sipas pikëpamjes së Sejfulla Malëshovës do të favorizonte në shkallën më të gjerë kulakët. Po Partia jonë i shqelmoi të tilla pikëpamje armiqësore, i flaku tej dhe i demaskoi pa mëshirë. Partia jonë shkon e vendosur në rrugën e vërtetë të popullit, ashtu si e mësojnë mësuesit e mëdhenj të saj: Marksi-Engelsi-Lenini-Stalini dhe prandaj Partia jonë udhëheq vendin tonë me siguri dhe me sukses drejt socializmit.

Pikëpamjet e Sejfulla Malëshovës ishin të huaja për Partinë tonë; këto ishin devijim nga vija e Partisë, këto donin të thoshin dobësim i Partisë sonë, dobësim i luftës së klasave dhe mëkëmbje e reaksionit. Për këtë gjë Sejfulla Malëshova mori një dënim të rëndë dhe plotësisht të merituar.

Si kurdoherë Partia jonë i dha Sejfulla Malëshovës mundësi të punonte, të kuptonte gabimin e rëndë ku kishte rënë, ta ndreqte këtë gabim dhe të ecte në vijën e drejtë të Partisë. Sejfulla Malëshovës, duke qenë kurdoherë anëtar partie, ju ngarkua drejtimi i dikasterit të arësimit, dikaster shumë i rëndësishëm. Mirëpo Sejfulla Malëshova s'e mori aspak me seriozitetin e duhur këtë detyrë. Kontributi i tij jo vetëm ka qenë zero, por me qëndrimin e tij, ai ishte bërë një pengesë për punën. Cilat qenë arsëyet e një shtate të tillë? Arsëyet janë këto: Sejfulla Malëshova s'ka qenë i bindur për gabimin e rëndë që kishte bërë, ai s'ishte i ndërgjegjshëm për dëmin që i kishte bërë Partisë, dhe si konsekuencë, dënimin që kishte marrë, e quante të pavend. Me qëndrimin e tij

krejt pasiv në një detyrë aq të rëndësishme dhe me qëndrimet e tija oportuniste ndaj shumë elementëve jashtë Partisë dhe ndaj disa elementëve të sëmurë brenda në Parti, ai përpigjej të krijonte një situatë, ku të mendohej se «këtij njeriu i ishte bërë një padrejtësi» dhe se «ky njeri kishte një zotësi». Kjo konkretisht do të thotë të mundohesh të krijosh një rreth mbështetjeje që të aprovojë pikëpamjet e tua të shtrembra.

Nga ana tjetër gjithë aktiviteti i Sejfulla Malëshovës, në rast se mund ta quajmë këtë aktivitet, është karakterizuar prej një dembellëku të pashoq në punë, gjë krejt e huaj për një anëtar partie. Por Sejfulla Malëshova, me gjithë dembellëkun e tij të madh, nuk ka përtuar asnjëherë të punojë për të lënë përshtypjen dhe të krijojë opinionin se ai «zotron» teorinë marksiste-leniniste dhe pra, është i aftë të drejtojë. Gjithë puna e tij tregon qartë se Sejfulla Malëshova, jo vetëm që s'ka qenë në asnjë moment i lidhur me luftën, me jetën, me praktikën, por në punët që i qenë ngarkuar, ai ka vepruar në kundërshtim të hapët me ato që na mëson shkenca e Partisë sonë, marksizëm-leninizmi. Vetëm naivët dhe armiqtë e Partisë mund të bien në kurthin e iluzioneve që kërkon të krijojë Sejfulla Malëshova rreth personit të tij, por jo Partia jonë Komuniste.

Patjetër, dhe kësaj shtate të dytë që krijoi Sejfulla Malëshova, i pakorrigjuar në gabimet e tija, duhej t'i jepej fund dhe të merreshin masa. Sejfulla Malëshova u shkarkua nga funksioni si ministër i arësimit dhe paskëtaj qenja e tij si anëtar i Partisë sonë Komuniste varet nga qëndrimi i tij dhe nga realizimi që ai do të bëjë për gabimet e mëdha të tij dhe sa ai është kapablë të japë për Partinë. Partia jonë, si çdo anëtar tjetër të saj që gabon, i jep mundësitë të korrigjohet, të bëhet i vlefshëm për të dhe të meritojë përngahera nderin e madh të jetë anëtar i Partisë. Sejfulla Malëshova duhet të japë prova dhe prova të shëndosha që të mund ta meritojë plotësisht këtë gjë.

Anëtarët e Partisë duhet të sqarohen drejt për këtë çështje dhe pikërisht sikundër e paraqesim më lart. Nga ana tjetër reaksioni mund ta përdorë këtë situatë për të luftuar Partinë tonë.

Në qoftë se ndonjë anëtar partie i lëkundshëm ose i sëmurë do të përpigjej të përfitojë nga kjo gjë për të mbjellë mjegull, duhet të merren masa të shpejta për ta sqaruar dhe, në rast se vazhdon në një pikëpamje të tillë, të gabuar, të merren masa më të rënda dhe kështu të likuidohet çdo orvatje që synon, qoftë edhe një grimë, dobësimin e unitetit dhe të forcës së Partisë sonë.

Çdo parullë e reaksionit duhet të luftohet dhe të demaskohet me qëndrimin zyrtar: «Sejfulla Malëshova u pushua nga detyra e ministrit, pse ai ka treguar paaftësi dhe neglizhencë të madhe në detyrë dhe ai që s'punon dhe s'kryen detyrën në shtetin tonë, ai shkarkohet nga detyra dhe vihet atje ku ai meriton».

Partia jonë nuk dobësohet aspak duke dënuar rëndë Sejfulla Malëshovën që shtrembëron vijën e Partisë, që devijon nga vija e Partisë, përkundrazi Partia jonë forcohet. Kjo duhet t'u shërbejë shokëve të Partisë si mësim, se si ata duhet të jenë vigjilentë për mbrojtjen e Partisë, për mbrojtjen e drejtë të vijës së saj, të realizojnë metodat që përdor Partia jonë për ndreqjen e gabimeve dhe të shtrembërimeve që mund t'i bëhen vijës së Partisë, për masat e matura dhe të drejta që merr Partia kundër atyre që gabojnë, që përsëritin gabimin, që s'duan më në fund të korrigjohen, ose që hidhen në kampin e armiqve të Partisë.

Për Byronë Politike të Komitetit Qendror
të PKSH

Enver Hoxha

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

LETËR E KQ TË PKSH DREJTUAR GJITHË ORGANIZATAVE TË PARTISË MBI RUAJTJEN E SEKRETIT

1 qershor 1947

GJITHË ORGANIZATAVE TË PKSH

Ruajtja e sekreteve të Partisë është detyrë e të gjithë anëtarëve të Partisë. Kjo është e lidhur ngushtë me vetë ekzistencën e Partisë, me forcimin e saj, me unitetin e saj. Ruajtja e sekreteve të Partisë, çështja e konspiracionit nuk ngrihet sot për herë të parë në Partinë tonë. Partia jonë nuk mund të arrijë suksese pa një konspiracion të shëndoshë, pa një kujdesje të veçantë për ruajtjen e sekreteve të saj, pse armiku shumë kollaj mund ta dëmtonte. Gjatë luftës shokët tanë kanë ditur t'i ruajnë sekretet e Partisë, kanë ditur t'i mbrojnë më së miri dhe ta ruajnë Partinë tonë nga sulmet e armikut. Prandaj dhe sot që Partia ka fituar, armiqtë e saj nuk duhen nënvleftësuar. Ata rrojnë akoma dhe përpiqen me çdo kusht të dinë sekretet e Partisë dhe të shtetit tonë për të na dëmtuar. Për këtë edhe një herë u vihet detyrë të gjitha organizatave të Partisë, gjithë anëtarëve të saj që të forcojnë konspiracionin në mënyrë që të bëhet traditë në gjithë Partinë tonë.

Por shihet se në këtë drejtim bëhen mjaft lëshime, tregohet pakujdesi në ruajtjen e dokumentave të Partisë, të pushtetit, pakujdesi në ruajtjen e sekreteve të ushtrisë. Kjo është dobësi dhe duhet të luftohet me forcë. Të vepros në këtë mënyrë do të thotë të nënvleftësosh armikun e klasës, i cili përpiqet dhe përdor çdo mjet për ta dëmtuar Partinë dhe shtetin tonë. Për të mësuar organizimin e Partisë sonë, forcën e saj, për të zbuluar sekretet e shtetit tonë, për të mësuar forcën dhe organizimin e ushtrisë sonë, armiku përdor metodat më të poshtra dhe këtë shokët nuk duhet ta harrojnë, nuk duhet ta marrin si një gjë të lehtë. Prandaj para anëtarëve të Partisë dhe forumeve të saj bije detyra kryesore të ruhen sekretet, të shkunden nga liberalizmi dhe demobilizimi se tani çdo gjë shkon në rregull, se ne jemi të fortë. Anëtarët e Partisë duhet të kenë sytë hapur, të jenë vigjilentë për t'u ruajtur

nga armiku. Për këtë gjithë anëtarët e Partisë, gjithë funksionarët e shtetit të edukohen, të ruajnë me kujdesin më të madh sekretet e Partisë dhe të shtetit. Kjo të bëhet edukatë edhe për të gjithë popullin, se kështu tregohet dashuria dhe vendosmëria për ruajtjen e Partisë dhe të shtetit. Kemi shembuj jo të mirë të organizatave tona si të terrenit dhe të ushtrisë, gjithashtu nga funksionarët e shtetit që nuk kanë treguar kujdes për ruajtjen e dokumentave të Partisë dhe të shtetit. Ka raste që arshivat dhe kartotekat janë të pasiguruara mirë, shkresa dhe letra të ndryshme, që paraqitin forcën dhe shtrirjen e organizatës, gjenden mbi tavolinë, bloqe shënimesh humbasin në rrugë, zyra të pasiguruara mirë dhe që hapen me çdo çelës. Ka raste që dokumentat e anëtarëve të Partisë kanë humbur. Nga pakujdesia në një seksion politik të ushtrisë humbasin 17 copë dokumenta të anëtarëve të Partisë. Një komisar kompanie në një repart kishte lënë të hedhur pa kujdes dy dosje me qarkore dhe udhëzime të Komitetit Qendror. Ka raste që korrespondenca me Komitetin Qendror nuk sigurohet, po hapet në rrugë ose dhe humbet ndonjë dokument.

Në shumë zyra të shokëve tanë në pushtet është gjetur material partie: letra, qarkore të Komitetit Central, karakteristika, shënime nga mbledhjet e organizatës, të vjetra dhe të reja. Ky material jo vetëm që mbahej në zyrat e pushtetit, në kundërshtim me udhëzimet e Komitetit Central, por nuk ishte treguar asnjë kujdes për ta siguruar. Ishte lënë mbi tavolinë ose sirtar pa çelës. Pa dyshim një gjë e tillë ndodh edhe në shokët e prefekturave e të n/prefekturave që dokumentat e Partisë i mbajnë në zyrat e tyre. Veç këtyre rasteve, dokumenta dhe shënime të Partisë, janë lënë nga shokët tanë nëpër shtëpitë e tyre, në dollape dhe sirtare. Atëhere ku është kujdesi për ruajtjen e Partisë, ku qëndron vigjilenca? Kjo mungesë dhe pakujdesi e treguar nga anëtarët e dobëson Partinë. Komiteti Central vazhdimisht e ka ngritur çështjen e konspiracionit, e ruajtjes së sekreteve të Partisë dhe shtetit, bile është theksuar që jo vetëm anëtarët e Partisë, por gjithë funksionarët e shtetit, gjithë ushtarakët dhe vetë populli të mësohen, t'u bëhet edukatë që të ruajnë sekretet e shtetit, se kështu e mbrojnë shtetin, e ruajnë këtë. Praktika na tregon se akoma konspiracioni, kujdesi për të ruajtur Partinë dhe shtetin nuk është kuptuar nga shokët tanë, prandaj të ngrihet mirë para gjithë organizatave të Partisë dhe të goditet ky lëshim, kjo mungesë preokupacioni për të ruajtur Partinë, pa hezitim, menjëherë dhe fort.

Me këtë rast Komiteti Central shtron si detyrë para gjithë organizatave të Partisë, që të mblidhet gjithë materiali i Partisë që mbajnë me vete anëtarët në zyrat ose shtëpitë e tyre si: rezolucione të Partisë, letra, qarkore të forumeve të Partisë, procesverbale dhe shënime të mbledhjeve, të konferencave të Partisë

dhe çdo gjë që ka të bëjë me jetën e brendshme të Partisë dhe materiale të këtilla ka që nga koha e luftës; këto t'i dorëzojnë menjëherë në celulat përkatëse. Komiteti qarkor për terrenin dhe seksionet politike për divizionin duhet ta grumbullojnë gjithë këtë material dhe ta vendosin në vende të siguruara bashkë me dokumentat e tjera që kanë. Nga ana tjetër, këtej e tutje duhet t'u bëhet rregull, që, kur shokëve u jepen letra dhe qarkore për t'u punuar në organizatë, me t'i mbaruar së punuari duhet t'i dorëzojnë menjëherë në celulën përkatëse të Partisë, në mënyrë që asnjë dokument i Partisë të mos mbetet andej e këndeje, të ngatërrohet me shkresa të tjera dhe të humbasë. Forumet e Partisë janë përgjegjës për këtë. Shënimet personale që mban zakonisht anëtarë i Partisë në mbledhjet e ndryshme të organizatës, duhet t'i ruajë mirë dhe me asnjë mënyrë të mos i lërë të pasiguruara. Kujdes i veçantë duhet të tregohet në ruajtjen e dokumentave në zyrat e Partisë, kujdes në ruajtjen e vetë zyrave të Partisë. Ka zyra partie që nuk kanë asnjë roje, ka raste që në këto zyra hyjnë lirishit elementë që s'janë anëtarë partie. Në zyrat e Partisë hyjnë vetëm anëtarët [e Partisë] dhe ata që kanë punë. Në lidhje me ruajtjen e sekreteve të shtetit janë lëshuar direktiva [edhe] nga ana e Kryeministrit. Këto direktiva duhet të punohen në të gjitha dikasteret dhe zyrat e pushtetit me të gjithë nëpunësit në mbledhjet e sindikatave. Të ngrihet me forcë në çdo celulë kjo çështje në mënyrë që të kuptohet rëndësia nga të gjithë anëtarët. Në çdo celulë të bëhet kritikë për neglizhencën dhe pakujdesinë e treguar në këtë drejtim. Për këtë çështje komitetet qarkore të bëjnë kontrollë të vazhdueshme se si i ruajnë dhe i mbajnë dokumentat, si i sigurojnë këto.

Theksojmë dhe një herë që këto çrregullime dhe lëshime duhet të marrin fund. Nuk ecet në këtë mënyrë. Çdo neglizhencë dhe pakujdesi në këtë drejtim duhet të goditet menjëherë. Asnjë lëshim nuk duhet të bëhet. Anëtarët e Partisë duhet të kuptojnë se ruajtja e sekretit, çështja e konspiracionit është detyrë për ruajtjen e Partisë dhe të shtetit kundër spiunëve, provokatorëve dhe agjentëve të huaj që përpiqen me çdo kusht të na dëmtojnë.

KOMITETI QENDROR I PKSH

Botohet për herë të parë sipas kopjes së shaptilografuar që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

UDHËZIME TË KQ TË PKSH MBI MASAT POLITIKE TË PARTISË NË FSHAT NË LIDHJE ME GRUMBULLIMIN E DRITHIT

14 qershor 1947

GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PKSH

Me qëllim që t'i sigurohet buka popullit, pushteti ynë mori masën e shpallur me anë të urdhëresës së Ministrisë së Tregëtisë¹. Për rëndësinë e këtij problemi preokupant, siç është sigurimi i bukës, dhe për përgjegjësinë që bie mbi organizatën e Partisë për këtë problem, ju është shkruar dhe me tonën Nr. 209 Res. datë 2.VI.1947.

Komiteti Qendror, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të kësaj çështjeje, me anë të kësaj letre insiston që çështja e korrjes dhe e grumbullimit të grurit të kuptohet drejt dhe mirë duke e lidhur këtë me situatën ekonomike të vendit tonë dhe ç'do të thotë një masë e tillë për masat e fshatarësisë. Këtu është fjala që or-

¹ Është fjala për urdhëresën e Ministrisë së Tregëtisë Nr. 21 dt. 29 maj 1947. Me këtë urdhëresë prodhuesit e drithit detyroheshin t'i shitnin shtetit gjithë tepricat e grurit, të thekrës dhe miellrat e tyre, duke mbajtur për vete vetëm 17 kg. drithë në muaj për frymë dhe vetëm për tre muaj (korrik-gusht-shtator).

Shteti merrte përsipër që t'u kthente prapë prodhuesve sasinë e tërhequr në masën që nevojitej për plotësimin e nevojave ushqimore të familjes. Kjo urdhëresë u zëvendësua më vonë me urdhëresën Nr. 1 të Kryeministrisë të dt. 2 korrik 1947, me anë të së cilës prodhuesit e drithit detyroheshin gjithashtu t'i shitnin shtetit gjithë tepricat e drithit, duke mbajtur për nevojat familjare të tyre vetëm 250 kg. grurë, misër ose thekër për frymë në vit.

Partia dhe qeveria i merrnin këto masa me qëllim që t'i siguronin bukën popullit, gjë që në atë kohë ishte një problem shumë preokupant për vendin tonë. Në ato kushte një masë e tillë nga ana e Partisë dhe qeverisë sonë ishte plotësisht e drejtë.

ganizatata tona të kuptojnë më mirë se një masë e tillë për masat fshatare është mjaft e rëndë prej vetë faktit se kjo merret pas regjistrimit dhe grumbullimit të fundit të bereqetit, se ne po vëmë dorë dhe po administrojmë pasurinë e tij kryesore, d.m.th. grurin dhe së fundi sepse ne po disiplinojmë konsumin e tij.

Një gjë e tillë ju theksohet me qëllim që masa e marrur të mos kuptohet si një masë e thjeshtë administrative dhe e shkëputur nga të gjitha efektet e saj në masat fshatare, por të kuptohet kjo si një masë e madhe për të cilën organizatat e Partisë duhet të mobilizohen për një punë të madhe politike.

Qëndrimi i masave të fshatarësisë në kohën e regjistrimit të fundit të bereqetit, me disa përjashtime, ka qenë i mirë; kjo tregon lidhjen e këtyre masave me pushtetin, tregon se në saje të punës së organizatave të Partisë, të cilat ju përgjegjën thirrjes së Komitetit Qendror për një punë të madhe, masat fshatare e kuptuan rëndësinë e masës që u muar dhe pse bëhej kjo dhe këtë ata e aprovuan. Vetë fakti i regjistrimit dhe i grumbullimit e tregon këtë. Kjo është një anë mjaft pozitive dhe mjaft e rëndësishme përsa u përket lidhjeve të pushtetit tonë me masat fshatare si dhe punës së organizatave tona.

Por organizatat tona nuk duhet të dehen nga një gjë e tillë dhe ta konsiderojnë masën e marrur si diçka të lehtë duke e dobësuar kështu punën që duhet bërë, për ta ngritur këtë mirë dhe drejt në masat e fshatarësisë. Këtu duhet të mobilizohen të gjitha forcat e Partisë dhe të organizatave të masave, të mobilizohet i gjithë agjitacioni dhe propaganda jonë për të shpjeguar sa më qartë rëndësinë e kësaj mase në masat fshatare.

Organizatata tona të dinë ta realizojnë mirë domosdoshmërinë e një mase të tillë duke pasur parasysh situatën tonë ekonomike, kapacitetin prodhues të vendit tonë, sigurimin e bukës qytetit dhe zonave fshatare që nuk sigurojnë dot bukën e vitit dhe për këtë nevojën e disiplinimit të shitjes së bereqetit dhe të administrimit të tij nga ana e organeve të shtetit.

Prandaj organizatat tona duhet ta kenë të qartë që kjo masë është e rëndë, pse kjo rëndon në fshatarin që e prodhon grurin, por ata duhet të kenë të qartë gjithashtu se një masë e tillë, që bëhet për të siguruar bukën e popullit, është edhe e domosdoshme. Pikërisht këtu të dalë e qartë nga ana tjetër se organizatat tona duhet të bëjnë një punë të fortë dhe të vazhdueshme, që të shpjegohet mirë karakteri ekonomik e politik i kësaj mase, duke e lidhur këtë me të gjitha përpjekjet e pushtetit tonë në favor të masave punonjëse të vendit.

Për këto, kjo masë e pushtetit dhe puna politike që duhet bërë; të ngrihen në të gjitha organizatat e Partisë si një detyrë e rëndësishme partie, për të cilën kërkohet një mobilizim total i të gjitha forcave të Partisë në fshat dhe i organizatave të masave. Mbi

organizatat e Partisë qëndron një përgjegjësi e madhe, ato duhet të jenë të mobilizuara për një punë të organizuar dhe ta shfrytëzojnë këtë masë për të forcuar edhe më tepër lidhjet e pushtetit me masat fshatare. Tamam këtu ku fshatarit nga masa e pushtetit, po i hiqet mundësia për të disponuar lirisht prodhimin e tij, organizatat tona duhet të kuptojnë se një masë e tillë është e rëndë për fshatarin, këtu ato duhet të shikojnë punën e madhe që duhet bërë në mënyrë që fshatari ta aprovojë këtë masë, ta sjellë grurin pa fshehur e ta aprovojë këtë masë duke e kuptuar se pse bëhet, pse e bën pushteti këtë. Organizatat e Partisë duhet ta kuptojnë se këtu do të ketë raste fshehjeje prej vetë faktit se fshatarit jo vetëm që i merret gruri, por për më tepër atij i lihet për nevojat e tija vetëm për tre muaj dhe i racionuar, prandaj këtu lypset një punë intensive dhe e palodhur duke menduar nga ana tjetër, se në këtë masë duhet ta shpiem deri në fund. Por nga ana tjetër, shokët tanë në këtë situatë të fshatarit të shikojnë që t'i forcojnë lidhjet tona me masat e fshatarësisë, t'i mobilizojnë masat fshatare për një luftë të ashpër kundër reaksionit, kundër parullave të tija armiqësore, i cili kërkon që masa e pushtetit të mos realizohet dhe që tenton si gjithnjë të largojë fshatarët nga mbjelljet duke thënë që ja, është e kotë të mbjellësh, qeveria po ta merr grurin etj. Organizatat tona duhet të kenë gjithashtu parasysh punën armiqësore të elementëve të goditur nga reformat tona, të cilët kërkojnë që të na luftojnë në mënyra të ndryshme në forcimin e ekonomisë sonë nacionale, që kërkojnë edhe këtë rast ta shfrytëzojnë duke hedhur parulla që t'i nxisin fshatarët për një rezistencë karshi masave tona, të vazhdojnë, në lidhje me situatën aktuale, të kërkojnë të krijojnë opinionin e mosbesimit në qëndrueshmërinë e situatës, se qeveria po e mbledh grurin se do të ketë luftë dhe së fundi të futë në fshatarët mosbesim në angazhimin që merr shteti për t'u kthyer fshatarëve sasinë e grurit që u takon me të njëjtin çmim që ata ja kanë shitur shtetit.

Prandaj vihet [detyra] për të gjitha organizatat e Partisë që përveç punës politike që duhet të bëhet, duhet që ata të studjojnë mirë urdhëresën e Ministrisë së Tregëtisë, ta kuptojnë mirë atë dhe të dinë ta shpjegojnë drejt dhe qartë në masat e fshatarësisë. Organizatat tona me shpjegimin e urdhëresës së ministrisë duhet të ngrejë njëkohësisht edhe përgjegjësinë e pushtetit në të gjitha angazhimet që ai ka marrë dhe të dalë këtu puna armiqësore e reaksionit dhe qëllimet e tij të poshtra.

Paralelisht me rëndësinë e madhe të masës dhe me punën e madhe që duhet bërë, në organizatat tona të ngrihet gjithashtu dhe organizimi i punës për korrjen, shirjen dhe grumbullimin e grurit. Vetë eksperiencia e vitit të kaluar duhet t'u shërbejë organizatave tona për t'u hequr atyre vëmendjen për preokupacionin

që duhet të tregohet në përmbushjen e kësaj përgjegjësie të madhe që bie mbi to. Organizatat e Partisë duhet të jenë të mobilizuara, të bëjnë me anën e organizatës së Frontit, të rinisë, të gruas mobilizimin e të gjitha masave fshatare, të organizohet puna kolektive dhe puna me gara për kryerjen sa më të shpejtë të korrjes, shirjes dhe grumbullimit të grurit. Për këtë, porositen veçanërisht komitetet qarkore, të kenë kujdes që të udhëzojnë konkretisht organizatat, të ndihmojnë dhe të kontrollojnë vazhdimisht të gjithë punën se në radhë të parë ata janë direkt përgjegjës.

Të merren të gjitha masat e duhura për të siguruar një informacion të gjerë, preciz dhe të shpejtë në mënyrë që vetë komiteti qarkor të jetë në krye të gjithë punës për të ndërhyrë me vend dhe në kohë atje ku paraqitet e nevojshme.

Të merren të gjitha masat që me një organizim të mirë të punës, të evitohet çfarëdo shpërdorimi e pakujdesie gjatë punës së korrjeve, të transportit, të shirjes e të grumbullimit të grurit. Organizatat tona të kujdesen gjithashtu për shfrytëzimin në maksimum dhe funksionimin në rregull të maqinave shirëse.

Për çdo mungesë nuk ka asnjë justifikim, këtu ka punë me përgjegjësi të madhe ku nuk mund të lejohet që për justifikim neglizhence dhe mungesë kontrolli të gjenden pretekste të pavend si Elbasani «jo nuk qenë në rregull listat, jo u bë gabim nga filani» etj. Kjo është një çështje e madhe, është çështja për të siguruar fitoren në «frontin e bukës» andaj kërkohet që organizatat tona ta marrin seriozisht këtë çështje kaq të rëndësishme për Partinë tonë dhe për shtetin.

Çështja e realizimit sa më shpejt e planit të ministrisë për korrjet dhe shirjet të mbahet në organizatat e Partisë si një çështje e ditës me rëndësi të madhe për ekonominë tonë, për sigurimin e bukës populit tonë.

KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

UDHËZIME TË KQ TË PKSH MBI PUNËN E PARTISË PËR FORCIMIN E KOOPERATIVAVE TË NDRYSHME

15 qershor 1947

GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PKSH

Përgjithësisht në sektorin kooperativist shikohen të meta, mungesa të ndryshme dhe gabime të mëdha që formojnë një shmangie flagrante nga vija e Partisë sonë në këtë sektor të ekonomisë.

Të gjitha këto kanë ardhur si konsekuencë e mungesës së një preokupacioni që është treguar nga ana e organizatave tona në këtë sektor të rëndësishëm të ekonomisë, që përbën një bazë të fuqishme në ndërtimin e ekonomisë socialiste në vendin tonë. Mund të thuhet se çështja e organizimit dhe e zhvillimit të kooperativave është lënë si një çështje e shkëputur nga të gjitha çështjet e tjera të Partisë, organizatat nuk kanë treguar interesin e duhur për forcimin e kooperativave, ato nuk kanë menduar sa duhet për funksionimin sa më të mirë të kooperativave në mënyrë që të jenë në gjendje këto të luajnë rolin e tyre si organizata ekonomike, për rritjen e prodhimit, për grumbullimin e shpërndarjen e tij, për furnizimin e konsumatorëve në rregull dhe me çmime më të arësyeshme.

Për grumbullimin dhe shpërndarjen e prodhimeve, kooperativat duhet të luajnë një rol të madh; në lidhje me këtë shoku Enver në mesazhin e tij të 1 Majit ka thënë:

«Grumbullimi dhe shpërndarja e drejtë dhe e shpejtë e mallrave duhet të jetë një problem me rëndësi që duhet të preokupojë, si organet shtetërore, ashtu dhe ato kooperativiste»¹.

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 4, f. 45.

Nga vetë roli i kooperativave si organizata ekonomike të masave del se pesha e tyre në jetën dhe në zhvillimin e ekonomisë së vendit është mjaft e madhe. Organizatat tona këtë duhet ta kenë të qartë. Një gjë e tillë nuk është e para herë që thuhet, por kjo duhet të ngrihet me forcë të madhe në të gjithë Partinë pse interesimi që po tregohet sot për kooperativat të le të kuptosh se kjo çështje akoma nuk është kuptuar mirë nga shokët tanë. Nuk është kuptuar mirë në organizatat tona se sektori kooperativist, vija e Partisë këtu, është pjesë e pandarë e tërë vijës së Partisë në politikën ekonomike. Nuk është e qartë gjithashtu se realizimi i vijës së Partisë në sektorin kooperativist varet direkt nga puna e organizatës së Partisë, nga mobilizimi i saj i madh për forcimin dhe zhvillimin e këtij sektori. Mungesa e preokupacionit që konstatohet sot, pikërisht këtu e ka burimin e saj.

Në të gjitha llojet e kooperativave shikohet që puna e Partisë s'ka qenë e mirë, ka munguar një kujdes i veçantë që duhet të tregonin organizatat tona për ngritjen e organizatës bazë të Partisë në kooperativat. Ka munguar gjithashtu dhe një punë politike, edukative dhe kulturele në masën e organizuar në këto kooperativa. Organizatat tona këtu nuk kanë pasur parasysh se organizimi i masave në kooperativa është një hap i rëndësishëm për të gjithë zhvillimin dhe përparimin e vendit tonë dhe për këtë kërkohet një punë e madhe dhe e vazhdueshme me masat e popullit për t'i lidhur këto me këtë formë të avancuar të organizimit të ekonomisë. Këtu nga ana e organizatave tona nuk është njohur mirë përgjegjësia e madhe që bie mbi to për përforcimin e kooperativave.

Vetëm kështu mund të shpjegohet mungesa e interesimit në organizatat e Partisë për të luftuar të gjitha dobësitë dhe për forcimin e këtij sektori.

Në kooperativat e artizanatit kemi gjëra që nuk venë mirë, aty shikojmë një tendencë që është krejtësisht në kundërshtim me vijën e Partisë dhe me politikën e shtetit. Ka pasur elementë jo të shëndoshë në këto kooperativa, të cilët i kanë dhënë frymën e tyre, në mungesë të punës së Partisë, të gjithë punës në këto kooperativa. Siç dihet, këtu kemi pasur të zhvilluar tendencën monopoliste, tendencën që të mos punojmë shumë se kështu do të mbushim tregjet e pastaj do të mbetemi pa punë, tendencë që të fitohet sa më shumë duke vajtur edhe në spekulim të hapët, gjë kjo që diskrediton kooperativën, që do të thotë vetë vijën e Partisë. Vetë caktimi i normës dhe i mënyrës së shpërblimit ka qenë i gabuar pse favorizonte zhvillimin e tendencës që të realizojmë sa më shumë fitime, pa u kujdesur që të bëhet malli sa më i mirë, kështu që kooperativa ka larguar klientelën duke rrezikuar në këtë mënyrë ekzistencën e saj; një mënyrë e tillë shpërblimi

ka qenë e gabuar edhe sepse nuk çmonte drejt punën e mirë duke mos inkurajuar kështu kualifikimin në punë, gjëra këto që përbëjnë një shmangie të plotë nga vija e Partisë.

Kooperativat e shitblerjes siç punojnë sot nuk janë duke e luajtur rolin e tyre. Gjer tani ato kanë shërbyer vetëm për të shpënë në fshat produkte industriale, ndërsa anën tjetër të funksionit të tyre që të grumbullojnë produktet e fshatit dhe të jenë në gjendje që të furnizojnë qytetin me këto produkte rregullisht dhe me çmim më të mirë ato nuk po e kryejnë. Rolin që duhet të luajnë ato për një shkëmbim direkt të produkteve të qytetit me ato të fshatit, pa ndërmjetës, pa spekulatorë, këtë nuk po e bëjnë; anëtarët e këtyre kooperativave nuk e ndiejnë veten të angazhuar që të shpien produktet e tyre në kooperativë. Edhe me anëtarët e kooperativës së punës, të cilët kanë pranuar të bashkojnë pronat e tyre kryesore dhe të punojnë në kolektivitet, ngjet që prodhimet e tyre personale t'i shpien vetë në treg për t'i shitur në pazar duke dashur që të realizojnë një fitim më të madh. Këtu organizatat tona duhet të shohin se që të bindësh fshatarin të shesë dhe të blejë në mënyrë të organizuar duhet bërë një punë e fortë politike dhe edukative se kjo nuk bëhet as vetëvetiu as me dekret. Andaj për këto kooperativa çështja ngrihet që të bëhet një punë e madhe nga ana e organizatave të Partisë në mënyrë që kooperativat të luajnë tamam rolin e tyre të shkëmbimit dhe paralelisht me këtë të zgjerojnë edhe më shumë rrjetin e tyre në fshatrat tona.

Në kooperativat e konsumit, megjithëse si kooperativa janë më të vjetra dhe me eksperiencë në punë, kemi tendenca të gabuara çorganizimi dhe tamam nga këto rezulton që edhe këto kooperativa të mos e luajnë si duhet rolin e tyre të furnizimit të qytetit. Pikësëpari lidhjet e tyre me kooperativat e shitblerjes as që ekzistojnë, kjo është dobësia më e madhe në marrëdhëniet që duhet të vendosen në mes të këtyre dy lloj kooperativave. Sot kooperativat e konsumit kryesisht mbahen me gjërat e racionuara të furnizuara nga shteti; në lidhje me këtë shoku Enver ka thënë:

«Kooperativat duhet të bëhen ndihmëset kryesore të organeve shtetërore për grumbullimin dhe shpërndarjen e sidomos për ato sende që s'ka mundësi t'i mbledhë shteti»¹.

Këtë, kooperativat tona të konsumit ose nuk e bëjnë fare ose e bëjnë në një shkallë mjaft të kufizuar. Ka pasur pasta jaste të gabuara si në Elbasan, ku kooperativa të blejë në marrë-

¹ Enver Hoxha, Vepra, vëll. 4, f. 45.

veshje me privatët të gjitha prodhimet e fshatarit dhe të pranojë që duke mbajtur një fitim të aprovuar nga marrëveshja me privatët, t'ua shesë atyre duke lejuar dhe favorizuar në këtë mënyrë spekulimin në dëm të popullit. Në Vlorë ka ndodhur që kooperativa për të eliminuar gjoja privatët ka blerë produktin e fshatarit (djathin) me një çmim më të lartë duke mos llogaritur se kjo rëndon mbi masat e popullit konsumator. Ka ndodhur gjithashtu që nga mungesa e organizimit të mirë të punës të bëhen shpenzime të kota që janë llogaritur në çmimin e artikullit duke rënduar kështu mbi konsumatorin.

Kooperativat e shitblerjes, të artizanatit dhe të konsumit kanë për detyrë të furnizojnë tregun me sa më shumë prodhime dhe çmime sa më të ulta që do të jetë e mundur, në mënyrë që të përmirësohet standardi i jetës së masave tona punonjëse.

Kooperativat e konsumit dhe të shitblerjes kanë gjithashtu për detyrë që të ndihmojnë shtetin në shpërndarjen (shitjen) e artikujve industriale, edhe këtë këto kooperativa nuk po e bëjnë ashtu si duhet. Sikur të llogaritim xhiron e kohës së fundit të kooperativave dhe ta krahasojmë këtë me atë të sektorit privat, kemi këtë rezultat: ndërsa xhironja e kooperativave për shitjen e produkteve industriale është rritur 50 për qind, për të njëjtën kohë xhironja e sektorit privat, megjithëse më i vogël se ai kooperativist, është rritur 100 për qind.

Në kooperativat e punës¹, puna është më e mirë dhe vetë rezultati i të mbjellave e tregoi këtë. Por në këto kooperativa ka pasur shumë mundësi për një organizim më të mirë të punës, për një punë politike, edukative dhe kulturele të organizuar. Në këtë drejtim në këto kooperativa është bërë shumë pak. Kjo ka ardhur pse organizatat tona nuk kanë treguar interesim të veçantë për të forcuar punën tonë këtu. Sot vetëm në 1/3 e kooperativave të punës kemi organizata bazë të Partisë, kjo tregon punën e dobët tonën. Për ne, ngritja e bazës së Partisë në kooperativa është një çështje mjaft preokupante, për të cilën organizatat tona duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë. Këtu janë të gjitha mundësitë për një punë të tillë. Vetë fakti se kemi të bëjmë me një masë fshatarësh që kanë pranuar të hyjnë në kooperativë d.m.th. një masë që është më e lidhur me vijën tonë, favorizon për rritjen e Partisë këtu. Si në këto kooperativa të punës ashtu dhe në ato të artizanatit Partia po rritet në një mënyrë shumë të kufizuar. Në organizatat tona duhet të kuptohet se ngritja e organizatës bazë të Partisë është konditë e domosdoshme për forcimin dhe zhvillimin e këtij sektori.

Është e vërtetë, që kuadrot tanë në këto kooperativa janë të ulët dhe pa eksperiencë, është gjithashtu e vërtetë se këta nuk

¹ Kooperativat bujqësore.

kanë qenë të mjaftueshëm dhe se ndihma nga qendra, deri-diku, u ka munguar; por në radhë të parë për të gjitha sa u përmendën më lart është përgjegjëse organizata e Partisë në qark veçanërisht komiteti qarkor, mbi të cilin bie përgjegjësia kryesore. Është përgjegjësia e komitetit qarkor që të ndihmojë kuadrot tanë të kooperativave për ngritjen e tyre teorike duke i porositur që të studjojnë sa më shumë mbi kooperativat në mënyrë që të bëhen kuadro të aftë për drejtimin e punës. Sot kuadrot tanë janë kufizuar vetëm në studimin e statuteve dhe të rregulloreve të kooperativave pa u thelluar që të mësojnë sa më shumë nga zhvillimi i kooperativave në Bashkimin Sovjetik, për të cilin ka material të mjaftueshëm për të studjuar.

Për të gjitha këto të meta dhe gabime, Komiteti Qendror, me anë të kësaj letre, u tërheq vëmendjen organizatave dhe porosit që këto të evitohen dhe të goditen, pse diskreditojnë sektorin kooperativist duke dëmtuar rëndë vijën e Partisë në këtë sektor.

Për këtë është e domosdoshme që pikësëpari vetë komitetet qarkore të tregojnë një preokupacion më të madh për punën në kooperativa dhe çështja e kooperativave të ngrihet në të gjitha organizatat e Partisë, si një çështje e rëndësishme partie. Organizatat tona të kuptojnë mirë se mjeti më i fuqishëm, propaganda më e fortë për të shtyrë masat që të organizohen në kooperativa janë vetë kooperativat, prandaj forcimi i këtyre kooperativave të merret i lidhur ngushtë me të gjithë punën tonë për zhvillimin e sektorit kooperativist në vendin tonë, për këtë kërkohet një punë politike e madhe dhe e vazhdueshme. Organizatat tona duhet ta kuptojnë gjithashtu se këtu kemi të bëjmë me vijën e Partisë në kooperativat, me jetën ekonomike të masave, prandaj përgjegjësia është e madhe dhe nuk mund të lejohet në asnjë mënyrë që në këto kooperativa të ketë terren të lirë për tendenca të gabuara, që këtu të ketë çorganizim e pakujdesi. Prandaj në këtë sektor duhet që të ketë kontroll të fortë dhe të vazhdueshëm. Të forcohet organizimi dhe këshillat e kooperativave me një ndihmë më të madhe nga ana e organizatës së Partisë duke nxjerrë në krye elementin më punëtor, më të ndërgjegjshëm dhe më të ndershëm. Komitetet qarkore duhet të interesohen direkt për forcimin e punës së kooperativave. Me këtë forumet tona të kuptojnë mirë se çështja e kooperativave nuk është një çështje e shkëputur nga tërësia e problemeve të qarkut, por përkundrazi kjo është një nga çështjet më të rëndësishme të Partisë.

Të orientohen organizatat tona për ngritjen e bazave të Partisë në kooperativat. Ngritja e bazës së Partisë është e domosdoshme për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sektorit kooperativist. Duke parë rritjen shumë të kufizuar të Partisë në kooperativa, Komiteti Qendror në mënyrë të veçantë u heq vë-

mendjen organizatave të Partisë që të preokupohen më shumë për këtë çështje të rëndësishme.

Më lart u përmendën të metat dhe gabimet që janë sot në kooperativat dhe cili është shkaku i këtyre. Të gjitha organizatat e Partisë duhet të jenë të bindura se në këtë mënyrë, puna nuk vete mirë, sektori kooperativist as që do të forcohet dhe as që do të zhvillohet, me gjithë dëshirën tonë të madhe që të kemi sa më shumë kooperativa dhe t'i kemi këto të forta.

Këtu, para së gjithash, është fjala që organizatat tona, e veçanërisht komitetet qarkore, ta kuptojnë mirë se forcimi dhe zhvillimi i sektorit kooperativist është i domosdoshëm për ndërtimin e ekonomisë socialiste në vendin tonë dhe lidhur me këtë të kuptojnë mirë se kjo do të thotë realizimi i vijës së Partisë dhe se për këtë duhet punë e madhe dhe me përgjegjësi.

Kur është çështja kështu, atëhere të nxjerrësh pretekste dhe justifikime me qëllim shfajësimi, kjo nuk është as e mirë as e drejtë. Për të gjitha mungesat që ekzistojnë sot në kooperativat kanë përgjegjësi forumet e Partisë që drejtojnë tërë jetën politike, ekonomike dhe kulturele të qarkut, janë përgjegjëse organizatat tona dhe të gjithë shokët pa përjashtim, që kanë të bëjnë me këtë sektor të ekonomisë.

Armiqtë e rrugës sonë s'kanë pushuar së foluri keq për sektorin kooperativist. Ata duke përfituar nga çalimi në organizimin e punës së kooperativave janë përpjekur që të diskreditojnë me qëllimin e tyre prej armiku sektorin kooperativist duke luftuar kështu politikën tonë ekonomike. Ata luftën e tyre kundër sektorit kooperativist e kanë lidhur me luftën e tyre kundër forcimit ekonomik të vendit tonë, kundër ndërtimit të ekonomisë së re popullore. Këtë organizatat tona duhet ta dinë dhe ta kenë mirë të qartë.

Për të gjitha këto Komiteti Qendror vë përpara përgjegjësisë komitetet qarkore, të gjitha organizatat e Partisë si dhe të gjithë shokët që janë lidhur në punën e tyre me sektorin kooperativist dhe kërkon prej tyre një punë më të madhe për forcimin e zhvillimin e këtij sektori të ekonomisë sonë, që të jetë ky në gjendje të luajë rolin e tij e të bëhet një ndihmës i fuqishëm i sektorit ekonomik të shtetit, se kështu do të ndërtojmë ekonominë e re në vendin tonë, kështu do të forcojmë gjithnjë më shumë pozitën tonë, kështu do të vemi përpara në ndërtimin e shoqërisë së re socialiste.

KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

**UDHËZIME TË KQ TË PKSH PËR FORCIMIN E VIGJILENCËS
DHE TË LUFTËS KUNDËR PUNËS ARMIQËSORE
TË MISIONEVE ANGLO-AMERIKANE DHE TË ARMIKUT
TË KLASËS NË VENDIN TONË**

17 qershor 1947

**GJITHË KOMITETEVE QARKORE TË PKSH
GJITHË ORGANIZATAVE TË PKSH NË USHTRI**

Kohët e fundit janë marrë masa kundër disa deputetëve për arësye të veprimtarisë së tyre kundër Republikës sonë Popullore.

Qëllimi i tyre ishte që të rrëzonin me forcë pushtetin tonë popullor, të likuidonin të gjitha fitoret e Luftës nacional-çlirimtare dhe të merrnin në duart e tyre fuqinë shtetërore.

Në platformën e politikës së tyre, këta vunë bashkëpunimin e tyre me gjithë reaksionin brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Në këtë punë armiqësore kundër vendit dhe popullit tonë, këta mbështeteshin në klasat e privilegjuara të kohës së vjetër, në intelektualët reaksionarë, në njerëzit e «Ballit» dhe të «Legalitetit», në klerin e njerëzit e tij, sidomos në klerin katolik, dhe në të arratisurit politikë, kriminelë lufte.

Njëkohësisht këta mbështeteshin edhe në përkrahjen e shëndoshë të imperialistëve anglo-amerikanë, të cilët i nxitën dhe i ndihmuan, jo vetëm me qëndrimin dhe politikën e tyre kundër vendit tonë, por edhe duke bashkëpunuar direkt dhe duke i subvencionuar me të holla, me anë të agjentëve të tyre si dhe të misioneve zyrtare të tyre, që ishin akredituar pranë qeverisë sonë.

Me ndihmën e këtyre misioneve dhe UNRRA-s¹ këta u lidhën

¹ UNRRA (United Nations Relief Reconstruction Administration) Administrata e Kombeve të Bashkuara për Ndihmë e Rimëkëmbje u krijua me akordin Konstitucional, i cili u nënshkrua në qershor 1943 nga 44 shtetet aleate. Imperialistët amerikano-anglezë që dominonin në këtë organizatë e përdorën atë si maskë për të organizuar një punë agjenturale dhe diver-

menjëherë me organizatën e «Ballit» dhe me krerët e saj në Itali: Mithat Frashërin dhe Ali Këlcyrën, me «Legalitetin» e Bazin, me kuislingët dhe kriminelët e luftës si Mehdi Frashëri etj. në Itali dhe Greqi. Këta armiq të popullit dhe të vendit ranë gjithashtu në marrëveshje edhe me monarko-fashistët grekë.

Nga ana tjetër misionet anglo-amerikane dhe agjentët e tyre u prematuan këtyre intervenimin me forca të armatosura për të përmbysur pushtetin tonë popullor. Ky zbarkim, sipas planeve të tyre të përbashkëta, do të kombinohej edhe me veprimin e bandave të kriminelëve të luftës në Shqipëri dhe në Greqi.

Ky aktivitet i kombinuar në mes të këtyre armiqve të popullit tonë dhe të misioneve anglo-amerikane shpjegohet nga fakti se këta nuk mund të pajtohen me situatën e krijuar në vendin tonë mbas fitores mbi fashizmin dhe marrjes së pushtetit në duart e popullit. Këta janë armiq gjer në fund të kësaj situatë, prandaj edhe veprojnë në një mënyrë të tillë të kombinuar për ta përmbysur këtë.

Këta nuk pajtohen me situatën e sotme të vendit tonë për arësye kryesore se populli ynë nën udhëheqjen e Partisë sonë, me luftën çlirimtare kundër okupatorit fashist dhe shërbëtorëve të tij, tradhëtarë të atdheut dhe popullit, ka bërë njëkohësisht një revolucion të madh shoqëror, duke hapur kështu rrugën për të shkuar më tej, në ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Me Luftën nacional-çlirimtare populli ynë jo vetëm që çliroi vendin nga okupatorët fashistë, por me reformat e mëdha goditi për vdekje dhe klasat e privilegjuara: bejlerët, agallarët, tregëtarët e mëdhenj, të cilët për më tepër u diskredituan gjatë kësaj lufte pse u vunë në shërbim të hapur të okupatorëve dhe luftuan përkrah tyre kundër luftës çlirimtare që bënte populli ynë. Në udhëheqjen e Partisë sonë Komuniste populli ynë gjatë zhvillimit të luftës, zgjidhi dhe çështjen kryesore të kësaj lëvizjeje popullore: çështjen e pushtetit. Ai ngrii pushtetin e tij të ri, pushtetin popullor duke krijuar kështu, me këtë pushtet në duart e tija konditat e duhura për të hedhur themelet e shëndosha të një demokracie të re në vendin tonë. Njëkohësisht, populli ynë me Luftën e tij nacional-çlirimtare që bëri, me demokracinë e re dhe Republikën Popullore që ngrii, fitoi besimin dhe simpatinë e të gjitha vendeve demokratike... në radhë të parë të Bashkimit Sovjetik, i cili

sioni kundër regjimit në vendet e demokracisë popullore dhe kundër lëvizjes revolucionare, demokratike e çlirimtare në vendet e tjera të Evropës.

Në Shqipëri përfaqësuesit e UNRRA-s erdhën në vitin 1945. Ata zhvilluan këtu një punë të hapur armiqësore, spiunazhi e diversioni, duke u munduar që të organizonin reaksionin e brendshëm kundër regjimit demokratik popullor.

për këtë arësye i ka dhënë dhe vazhdimisht i jep popullit tonë përkrahje morale, ekonomike dhe diplomatike.

Pikërisht kundër kësaj situatë luftojnë me të gjitha forcat e tyre reaksioni i brendshëm dhe i jashtëm i vendit tonë, armiqtë e brendshëm, klasat e privilegjuara, për shkak të pozitave të tyre politike, ekonomike të humbura dhe imperializmi anglo-amerikan për shkak se në vendin tonë nuk ka terren për qëllimet e tyre imperialiste dhe për më tepër se rruga në të cilën vendi ynë ka hyrë definitivisht është kundër imperializmit deri në fund dhe kundër qëllimeve dhe tentativave të tija për një skllavërim politik dhe ekonomik. Prandaj të gjithë këta kanë kurdisur vazhdimisht manevra të ndryshme, jo vetëm për të luftuar zhvillimin progresiv të vendit tonë, por për ta kthyer atë prapa.

Por populli ynë në saje të politikës së drejtë të Partisë dhe të qeverisë, në saje të ndihmës shumë të vlefshme të Bashkimit Sovjetik dhe të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, ka ditur të mbajë qëndrimin e duhur karshi të gjitha manevrave të armiqve. Populli ynë ka fituar me luftë pozita të forta dhe është i bindur për t'i forcur këto gjithnjë dhe më tepër. Populli ynë nën udhëheqjen e Partisë sonë ka hyrë definitivisht në rrugën e socializmit dhe është i vendosur për këtë rrugë.

Ja ku është terreni i luftës së klasave, ja ku është armiku ynë i brendshëm dhe i jashtëm.

Këtu shikohet që ata jo vetëm nuk pajtohen me këtë situatë, por janë armiq të rreptë të kësaj situatë.

Po atëhere si ndodh dhe si shpjegohet që elementë të tillë, armiq të kësaj situatë, të ishin në Front?

Lufta jonë nacional-çlirimtare që përfshiu masat e gjera popullore, tërhoqi dhe një pjesë të borgjezisë liberale të vendit tonë, e cila aprovonte rezistencën kundër fashizmit, por në të vërtetë me qëllim që të ruante interesat e saj, mbante rezerva në këtë luftë: kjo duke evituar çdo komprometim të hapur me armikun dhe njëkohësisht duke qëndruar pjesëtare e Frontit, donte të merrte pozita të forta dhe të gjera në pushtet dhe në analizë të fundit të rivendikonte tërë pushtetin në duart e saja.

Që këtej del e qartë se këta ishin futur në Front me qëllime të caktuara.

Por me mbarimin e luftës, këta njerëz nuk arritën të realizojnë qëllimet e tyre dhe me marrjen e pushtetit në duart e popullit këta humbën përgjithmonë pozitat e tyre politike.

Konsekuentë gjer në fund të qëllimit të tyre, këta fillojnë të veprojnë hapët kundër pushtetit tonë popullor.

Kjo veprimtari e tyre lidhet nga ana tjetër me parimet dhe tendencat politike të tyre që përputhen plotësisht me vijën e

«Ballit», me punën e vijën e «Bashkimit»¹ dhe të klikave të vjetra që kanë sunduar në vendin tonë, të cilat kanë shtypur popullin, e kanë konsideruar Shqipërinë plaçkë të tregut të imperialistëve dhe ekzistencën e saj vetëm si kombinim diplomatik të imperialistëve të mëdhenj; pajtohet plotësisht me parimin e mospërfilljes, e mosbesimit dhe të përçmimit të forcave të popullit.

Pasues besnikë të kësaj politike këta hidhen dhe fuzionohen me reaksionin e çdo ngjyre, mbështeten kryesisht në «Ballin» nga ku udhëzohen e ku disa prej tyre bëjnë pjesë, nënshtrohen dhe shiten tek të huajt me të vetmin qëllim që të godasin popullin për të rifituar pozitat e tyre të humbura.

Nga ana tjetër në gjithë punën e tyre, në fazat e ndryshme, në qëndrimet e tyre legale karshi gjithë vijës sonë politike, në parullat e tyre, në punën e tyre ilegale, del e qartë një lidhje e vazhdueshme me politikën, qëndrimet e parullat që anglo-amerikanët kanë mbajtur karshi vendit tonë, bile e tërë puna e tyre, në të gjitha aspektet e saj është lidhur ngushtë me vijën politike anglo-amerikane.

Që në Berat² ku ne dualëm me një qeveri provizore, me një organizatë politike që garantonte unitetin politik të popullit tonë dhe me një ushtri të fortë, të madhe dhe të organizuar, këta panë se pozitat e tyre ishin mjaft të dobëta dhe se, mbas falimentimit politik dhe ushtarak të organizatave që kishin bashkëpunuar me okupatorin, kishte humbur çdo mundësi për kombinime të ndryshme politike, për marrje postesh, për marrjen e fuqisë në duart e tyre. Këto qëllime që nuk mundën të realizoheshin në mënyrë legale i shtynë këta të formojnë një opozitë. Në këtë veprimtari të tyre ata inkurajoheshin dhe nxiteshin edhe prej agjentëve dhe misionëve anglo-amerikane. Ata mbështeteshin gjithashtu edhe në politikën e përgjithshme të vendeve imperialiste karshi Bashkimit Sovjetik dhe të gjitha vendeve përparimtare si dhe në parullat e tyre, që ishin kundër situatës sonë, «se ata nuk mund të toleronin një gjendje të tillë as në Shqipëri as në Ballkan». Që atëhere ata dolën me parullat e tyre «ata që bënë luftën muarën grada», «për të qeverisur duhen njerëz me kokë» dhe në këtë mënyrë predikonin nevojën e domosdoshme të një opozite të formimit të partive të tjera, të një politike të jashtme më të drejtë d.m.th. të drejtuar nga anglo-amerikanët dhe të një politike të brendshme më të arësyeshme karshi elementëve të «Ballit», kuislingëve etj.

1 Shih në këtë vëllim shënimin 2, f. 160.

2 Është fjala për Mbledhjen e dytë të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist në Berat më 20 tetor 1944, ku u vendos kthimi i Komitetit Antifashist në Qeveri Demokratike të Shqipërisë.

Mbas çlirimit, të inkurajuar nga qëndrimi i qeverive anglo-amerikane dhe nga puna e agjentëve të tyre në vendin tonë, aktiviteti i tyre fillon të rritet dhe të grumbullojë rreth vetes reaksionarë të çdo ngjyre.

Që këtu fillon dhe një herë qëndrimi i hapët kundër politikës sonë të jashtme dhe të brendshme si dhe kundër politikës sonë ekonomike. Fillojnë të punojnë për të mbjellë konfuzion dhe pasiguri në stabilitetin e situatës, për të orientuar popullin tonë nga imperialistët anglo-amerikanë dhe duke kërkuar që të ulin ndjenjën e patriotizmit për mbrojtjen e atdheut, duan të përgatitin terrenin për një ndryshim të shpejtë të situatës d.m.th. për një okupacion të ri me anë të zbarkimit të forcave të armatosura anglo-amerikane.

Në politikën tonë të jashtme që drejtohej nga Bashkimi Sovjetik... ata shihnin rrezikun më të madh të tyre, prandaj e ngrihin këtë si një «gabim fatal për qenien tonë, për ekzistencën e Shqipërisë, mbasi kjo pengonte marrëdhëniet me vendet e Perëndimit».

Kjo ishte pasoja e parullave dhe e direktivave të imperializmit anglo-amerikan si dhe drejtimi i politikës së «Ballit»... Prové e qartë është memorandum i që organizata tradhëtare e «Bashkimit Shqiptar» me Sami Qeribashin e Gjergj Kokoshin i dërguan anglezëve po me këtë frymë e me këtë përmbajtje...

Po këtë qëndrim ata mbajnë edhe përsa u përket marrëdhënieve tona me Bashkimin Sovjetik dhe predikojnë dhe luftojnë për të ndërruar rrugë, për t'u afruar me anglo-amerikanët «se andej kemi mjaft për të përfutur, ndryshe do të kishim pasoja të hidhura» me një fjalë ata donin të rrëzonin krejt këtë vijë politike, të largonin vendin tonë nga Bashkimi Sovjetik e ta hidhnin në prehërin e anglo-amerikanëve atje ku kishin rënë vetë e ku siguronin interesat e tyre.

Prandaj ata janë munduar të minojnë miqësinë me Bashkimin Sovjetik... kanë punuar për të ngjallur ndjenjat shoviniste, kanë reklamuar një demokraci të tipit të Perëndimit në vend të demokracisë sonë të re, të cilën ata e paraqitnin si një diktaturë të egër komuniste, kanë reklamuar një demokraci të përkrahur dhe të ndihmuar nga propaganda e parullat e agjentëve të misioneve anglo-amerikane.

Në lidhje me politikën tonë të brendshme, merakun më të madh i tyre ka qenë të shikonin se deri ku do të ishim të ashpër karshi «Ballit» dhe organizatave të tjera tradhëtare dhe po këtë pritnin të dinin dhe anglo-amerikanët.

Që në fillim, menjëherë pas çlirimit, ata filluan të flisnin për një politikë të gjerë, të butë, për një falje të përgjithshme, me parullat e tyre: «u bë ç'u bë, t'i lëmë mënjatë, të bashkohemi, të vëllazërohemi», «të mos gjakosemi» etj. të gjitha këto me

qëllim që të ruanin nga goditjet tona të drejta armiqte e popullit, kriminelët e luftës, njerëzit e «Ballit» e të gjithë reaksionit. Ata nuk e aprovuan kurrë qëndrimin tonë të drejtë dhe të ashpër karshi të gjithë tradhëtarëve të vendit tonë, ata u mobilizuan me të gjitha fuqitë e tyre për të krijuar opinionin, i cili të dezaproonte vendimet e gjyqeve tona popullore që goditnin me vend armiqte e popullit. Ata flisnin vazhdimisht në të katër anët për dënimet e merituar që u jepeshin kriminelëve të luftës, i ngrihin këto si shumë të ashpra, si shumë të rënda. Këto parulla të tyre shoqëroheshin dhe inkurajoheshin gjithnjë nga deklaratat e reaksionit anglo-amerikan se «në Shqipëri ka një diktaturë të egër» etj.

Duke dashur të godisnin kryesisht Partinë tonë, ata ishin në sulm me parullat e tyre se «këtu nuk ka liri, s'ka demokraci, por një diktaturë komuniste, terror, shtypje» dhe me këtë ngjyrë kërkonin të shpjegonin të gjitha goditjet tona të drejta kundër reaksionit. Kështu flet memorandum i «Bashkimit Shqiptar» drejtuar anglo-amerikanëve, kështu flet letra e Muharrem Bajraktarit drejtuar kryetarit të misionit anglez gjeneral Hoxhson, kështu flasin armiqte e jashtëm, monarko-fashistët grekë. Kështu kishte folur gjatë luftës «Balli», pikërisht kështu flasin edhe këta dhe anglo-amerikanët. Natyrisht, duke sulmuar Partinë tonë, duke sulmuar goditjet që ne u jepnim drejtësisht të gjithë armiqve të popullit, këta luftonin demokracinë e re, pushtetin e popullit.

Në lidhje me një qëndrim të tillë armiqësor kundër politikës sonë të jashtme dhe të brendshme, sigurisht që po i tillë ishte dhe qëndrimi i atyre karshi politikës sonë ekonomike. Këta donin një politikë të gjerë ekonomike, «ku inisiativën private jo vetëm ta linin të zhvillohej lirisht», por edhe «ta inkurajonin dhe ta ndihmonin se nga lulëzimi i saj do të përmirësohej e tërë gjendja e vendit tonë», «duhej të përkrahej dhe të ndihmohej dhe me anë të Bankës së Shtetit» jo vetëm inisiativa private, por çdo tentativë e industrialistëve tanë, e tregëtarëve tanë që kishin për qëllim të zhvillonin prodhimin e të industrializonin vendin tonë. Me një fjalë këta ishin për ruajtjen e rritjen e sektorit privat, për rritjen dhe zhvillimin e kapitalizmit në Shqipëri. Këta nuk i panë kurrë me sy të mirë, po përkundrazi i kanë luftuar me tërë forcat e tyre të gjitha reformat tona ekonomike.

Por me reformat tona nuk ishin dakord edhe disa njerëz të tjerë të Frontit nga ata më entuziastët, bile dhe disa anëtarë partie kapitullantë, që ishin zhytur në oportunizëm dhe që predikonin një politikë ekonomike më të gjerë, një qëndrim më të butë karshi borgjezisë sonë. Po kështu mendon dhe flet Sejfulla Malëshova për vijën tonë ekonomike dhe kështu mendonin dhe flisnin dhe disa shokë të tjerë rreth tij.

Duke ndjekur këtë vijë, këta insistonin dhe këshillonin që

të krijoheshin lidhje tregëtare me Italinë, këta ishin për krijimin e marrëdhënieve dhe të shkëmbimeve të gjera ekonomike më tepër me vendet kapitaliste të Perëndimit. Këta vazhdimisht kanë luftuar çdo tentativë për forcimin e sektorit ekonomik të shtetit, kanë kundërshtuar tatimet e jashtëzakonshme, shtetëzimet, shpronësimet, politikën tonë financiare dhe veçanërisht reformën agrare.

Ata ruanin çifligarët ashtu si ruanin tregëtarët e mëdhenj, kanë folur për pamundësinë e zbatimit të reformës për mungesë teknikësh, për mospasjen e nevojës për reformë; për formën drastike¹ të saj, për kotësinë e saj «pse nuk do të njihej qeveria dhe do të ndryshonte situata». Ata janë përpjekur që reforma agrare të mos aplikohet, por të mbetet formale dhe për këtë jo vetëm që kanë folur, por kanë organizuar sabotimin e saj dhe për më tepër kanë përdorur dhe kërcënime, frikësime e goditje kundër bujqve të varfër. Nga ana tjetër vetë misionet zyrtare anglo-amerikane kanë punuar me të gjitha mjetet e tyre për ta luftuar dhe kanë organizuar sabotime si në Fier dhe në Lushnjë.

Në ushtrinë, që lindi nga lufta e popullit tonë, ata shihnin rrezikun e parë dhe për këtë ata që në fillim dhe vazhdimisht kanë folur për demobilizimin e saj dhe së bashku me anglo-amerikanët ngrinin çështjen e kotësisë së saj e mospasjes rrezik në Shqipëri dhe gjoja e dëmit që kjo i sillte financës së shtetit dhe tërë ekonomisë së vendit tonë. Ngrinin çështjen e pazotësisë së oficerëve tanë të luftës, të pamundësisë së tyre për t'u bërë të aftë dhe denigrinin me një fjalë kuadro tanë, por njëkohësisht ata kanë punuar për të dobësuar unitetin e saj e për ta minuar nga brenda me parullat e tyre dhe duke provokuar dezertime.

Po këtë qëndrim mbanin edhe karshi aparatit të shtetit tonë, e akuzonin këtë për zgjerimin e tij, për inkopetencën e pazotësinë e kuadrove tanë. Duke goditur gjerësinë e aparatit tonë shtetëror, duke dashur të ulin vlerën e kuadrove tanë, ata goditnin këshillat popullore të gjera dhe të zgjedhura nga populli, goditnin thelbin dhe karakterin popullor të pushtetit tonë. Nga ana tjetër ata ngrinin çështjen kryesore të tyre «marrjen e drejtimit të shtetit» pse «në pushtet duheshin njerëz me kokë, njerëz me eksperiencë që janë mësuar dhe dinë të qeverisin». Po kështu fliste dhe Tajar Zavalani nga radioja e Londrës më 1945 në lidhje me politikën e kuadrove të rinj duke e quajtur të kotë dhe të dëmshme. Po këtë tha Gjergj Kokoshi në mbledhjen III të KP Antifashist se «sot kemi nevojë për njerëzit e paqes, për ata që dinë të administrojnë dhe të drejtojnë shtetin, ata që bënë luftën qenë për luftë, por sot punët shtrohen ndryshe».

1 Drastike — violente, dhunuese.

Dhe me të vërtetë ata kërkonin që punët të merrnin rrugën që ata donin t'i jepnin, por pushteti i popullit i goditi rëndë dhe drejt dhe nuk lejoi që fatet e tij të merreshin nëpër këmbë nga armiqtë e tij.

Frontin ata as nuk e kuptuan kurrë, as donin ta kuptonin. Frontin ku ishte realizuar bashkimi politik i popullit tonë e ku mobilizoheshin forcat e popullit për ndërtimin e Shqipërisë së re, ata e luftonin si vijë dhe si organizatë; por nga ana tjetër ishin infiltruar në të për të luftuar nga pozita të forta, që nga brenda, bashkimin e popullit, vijën tonë politike dhe ekonomike, pushtetin tonë popullor.

Aktiviteti i tyre i hapur dhe puna e tyre kundër pushtetit popullor në forma të organizuara del në dukje sidomos mbas çlirimit të vendit tonë.

Që gjatë luftës kur «Balli» dhe «Legaliteti» u shpartalluan dhe kërret e tyre u arratisën bashkë me okupatorin gjerman, këta bien në marrëveshje me ta, për të vazhduar punën e tyre kriminale, kundër interesave të atdheut dhe të popullit.

Por sidomos pas çlirimit puna e tyre merr më hov, duke u mbështetur në qëndrimet armiqësore të anglo-amerikanëve, në mosnjohjen e qeverisë, në punën që vetë misionet anglo-amerikane bënin për të përmbysur me forcë pushtetin popullor në vendin tonë.

Dhe pikërisht në maj-qershor 1945 anglo-amerikanët duan të bëjnë tentativën për të zbarkuar forca të armatosura të tyre në Shqipëri me anë të ML-it¹, UNRRA-s dhe të kombinojnë këto veprime me bandat e kriminelëve të luftës që ndodheshin në vendin tonë.

Megjithëse kjo tentativë dështoi, në saje të qëndrimit dhe të politikës së drejtë të qeverisë sonë, ata ripërsëritën tentativat e tyre në shtator të 1946-s me lëvizjen e armatosur që bënë në Shkodër.

Njëkohësisht po me këto qëllime anglo-amerikanët kishin krijuar një rrjetë të tërë sipunazhi në vendin tonë me njerëzit më të korruptuar dhe të predispozuar për këtë punë prej shumë

1 M. L. (Military Liaison) — mision ushtarak anglez, i përbërë prej spiunëve të imperializmit, erdhi në Shqipëri që nga fundi i vitit 1944 duke u paraqitur si ndonjë organizatë që do të sillte dhe do të shpërndante në Shqipëri ndihma për popullsinë, derisa të fillonte nga puna UNRRA. Qeveria jonë e hodhi poshtë kërkesën e M.L. për të zbarkuar në Shqipëri 1500-1700 oficerë dhe teknikë anglezë gjoja për shpërndarjen e ndihmave. M.L. anglez kishte për qëllim të pushtonte vendin tonë me anë të forcës së armatosur, duke organizuar kryengritje kundërrevolucionare për të përmbysur regjimin e demokracisë popullore në Shqipëri.

kohësh: ... njerëz të shtresave bejlero-agallarë-tregëtarë që kanë studjuar sidomos në Itali dhe Gjermani. Armiku këtu përfitoi nga kompozicioni social dhe nga edukata e tyre e dobët: intelektualë të kalbur, njerëz prej shtresave të goditura.

Në këto kondita këta ishin në lidhje me misionet anglo-amerikane, nga të cilat merrnin të holla dhe filluan të organizohen. Në fillim të 1945-s del organizimi i parë i «Ballit», mbasandaj grupet e klerit katolik etj. dhe më vonë më 1946 grupi i tekniko-intelektualëve¹ të Maliqit që organizohet dhe drejtohet nga misioni zyrtar amerikan dhe grupi i deputetëve.

Të gjitha këto grupe lidhen me bandat e kriminelëve të luftës për të bërë aksione me armë kundër pushtetit, si p.sh. tentativën në Shkodër që u tha më lart, bëjnë goditje tek-tuk kundër njerëzve të pushtetit dhe të Frontit në fshatrat e Veriut, duan të organizojnë atentate kundër udhëheqësve të vendit tonë e sidomos të Partisë sonë.

Për të turbulluar situatën dhe për të krijuar një psikozë pasigurie dhe frike, bien në marrëveshje me bandat e kriminelëve të luftës në Greqi dhe me monarko-fashistët grekë për të bërë provokacione në kufi; ndërsa me parullat e tyre propagandojnë ndërrimin e shpejtë të situatës, ndërhyrjen e shpejtë të anglo-amerikanëve, flasin për forcën e madhe të anglo-amerikanëve dhe për paevitueshmërinë e një lufte të tretë kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve përparimtare demokratike.

Nga ana tjetër hapin parulla alarmante mbi një konfuzion përçarjeje dhe divergjencë në qeveri si dhe për grindje të pazgjidshme të mëdha që gjoja arrijnë deri në akte violente midis udhëheqësve tanë.

Kështu del edhe një herë i qartë kombinimi i studjuar dhe i organizuar i punës së tyre me atë të anglo-amerikanëve dhe bashkëpunimi i ngushtë për qëndrime të njëjta midis tyre dhe imperialistëve anglo-amerikanë.

Puna e tyre është një vepër tradhëtie kundër atdheut dhe Republikës Popullore, është një punë kriminale kundër popullit që diktohet nga një armiqësi e madhe dhe e thellë kundër tij.

¹ Grupi i tekniko-intelektualëve — grup spiunësh dhe sabotatorësh i organizuar drejtpërsëdrejti nga misioni ushtarak amerikan në Shqipëri dhe personalisht nga agjenti i shërbimit të fshehtë amerikan H. Fulc. Në të bënë pjesë elementë teknikë të korruptuar të borgjezisë, mbeturina të «Ballit Kombëtar», njerëz të lidhur me pushtuesit fashistë dhe reaksionin gjatë Luftës nacional-çlirimtare. Ky grup nën drejtimin e amerikanëve zhvilloi sabotime në Maliq, Kuçovë, Rubik e gjetkë. Në vitin 1946 kjo organizatë reaksionare u zbulua dhe krerët e saj u arrestuan, u gjyquan dhe muarën dënimin e merituar.

Nga të gjitha këto që u theksuan më lart del se puna armiqësore e këtyre njerëzve nuk është gjë e rastit, përkundrazi, kjo është e lidhur me gjithë zhvillimin e vendit tonë, me rrugën tonë për në socializëm.

Konsekuentë në vijën e tyre armiqësore ata janë përpjekur me të gjitha forcat dhe mënyrat e ndryshme që të na pengojnë dhe të na luftojnë në rrugën tonë për ndërtimin e një ekonomie popullore sepse e dinë se kështu do të forcohen pozitave tona të brendshme e të jashtme.

Me anë të pushtetit tonë ne i goditëm rëndë ata, me reformat e ligjet e ndryshme ne i shpronësuam, gjithshka patën ata e shtetëzuam, e tërë pasuria e tyre kaloi në duart e popullit, prandaj veprimtarinë e tyre armiqësore e kanë drejtuar kundër pushtetit tonë popullor. Ne i goditëm ata si klasë shfrytëzuese dhe e privilegjuar, konsekuentë në vijën tonë revolucionare, për ndërtimin e shoqërisë së re socialiste në vendin tonë. Por ata si njerëz ne nuk i zhdukëm. Në kohën kur ne i jemi përveshur punës së madhe për ndërtimin e ekonomisë së re popullore, kur ne dita-ditës bëhemi më të fortë ata e bëjnë gjithnjë më të ashpër rezistencën e tyre për vdekje duke u hyrë lloj-lloj aventurave me qëllim që të na pengojnë ne në rrugën tonë të lavdishme. Me forcimin tonë ata bëhen më të egër, shikoni qëndrimin e tyre në burg, ata varin veten, si Kol Kuçali, bien nga dritaret, si Babai i Krujës, sepse e dinë punën e tyre armiqësore, shikojnë se planet e tyre u zbuluan dhe dështuan në ndërmarrjen e tyre të poshtër për të rrëzuar pushtetin. Një qëndrim i tillë tregon se ata janë të tërbuar nga goditja jonë e fortë, tregon armiqësinë e tyre të madhe, kjo tregon edhe vendosmërinë që të mos tregojnë rreth aktivitetit të tyre armiqësor.

Ndërtimi i ekonomisë sonë nacionale, që për karakterin e saj të ri social, nuk njeh shfrytëzimin e privilegjet e këtyre njerëzve, por përkundrazi i godet definitivisht për vdekje, ndërtimi i kësaj ekonomie, që në saje të forcave krijuese të masave punonjëse të vendit tonë, në saje të forcave tona materiale... nuk njeh nënshtrimin ekonomik dhe politik të imperializmit anglo-amerikan, shpjegon interesimin e madh që tregon imperializmi në veprimtarinë e armiqve tanë të brendshëm, qëndrimin armiqësor të tij kundrejt vendit tonë, shpjegon inkurajimin pa masë, udhëzimet, ndihmat e premtimet, që ai u ka dhënë ngahera armiqve tanë.

Organizatave tona duhet ta shohin të qartë këtë situatë; forcimi ynë, forcimi i pozitave tona ekonomike dhe politike, vazhdimi i rrugës sonë me vendosmëri drejt socializmit dhe orientimi i vendit tonë drejt Bashkimit Sovjetik... dhe të gjitha vendeve demokratike dhe përparimtare shkakton egërsimin e armiqve tanë të brendshëm, të cilët të udhëzuar dhe të mbështetur nga imperializmi tentojnë të përmbysin situatën e re të vendit tonë. Për

këtë ata na luftojnë ne, për këtë ata përpigën që të rrëzojnë pushtetin e ri për të ngritur pushtetin e tyre që të rifitojnë të gjitha sa kanë humbur, privilegjet e tyre, tokat dhe fabrikat e tyre dhe ta bëjnë vendin tonë pre të imperializmit.

Organizatave tona duhet të shohin këtu gishtin e imperialistëve, të cilët kërkojnë ta kenë vendin tonë të varur politikisht dhe ekonomikisht ashtu si ka qenë dikur nën Italinë fashiste dhe të krijojnë në vendin tonë një bazë për qëllimet e tyre imperialiste, ashtu siç kanë bërë në Greqi e kudo gjetkë ku ata kanë ndërhyrë duke u mbështetur në njerëzit e goditur nga reformat tona, në mbeturinat e fashizmit dhe në inteligjencien e kalbur dhe të korruptuar të vendit tonë, e cila ka qenë e predispozuar nga e kaluara e saj dhe nga edukata e saj për një punë të tillë si ata të Maliqit dhe sot Neki Radovicka, Selaudin Toto, Kol Kuçali, Beqir Çela, agjentë të tyre prej shumë vjetësh.

Organizatave tona duhet të shohin gjithashtu se nga Italia dhe Greqia, ku sundojnë qeveri të ngritura dhe të mbajtura nga imperializmi si është qeveria fashiste e Greqisë dhe ajo e përngjashme [me të], demokristiane e Italisë, reaksioni ynë i brendshëm ka inkurajim dhe ngushëllim në punët e tija, pikërisht këtej ne duhet të shikojmë rrezikun më të madh për ekzistencën tonë.

Organizatave tona duhet të dinë se me qëllim që të përmbysin pushtetin tonë, të gjitha grupet kanë qenë të lidhura me bandat e të arratisurve dhe kanë kërkuar që të krijojnë dhe të tjera; armiq të vendit tonë duke dashur që të krijojnë opinionin për një gjendje jostabël, kanë hedhur vazhdimisht parullën për një luftë të shpejtë, për një ndërhyrje të paevitueshme nga ana e anglo-amerikanëve për divergjenca në qeveri, parulla këto, që për shkak të mungesës së punës sonë dhe të gjendjes së ulët të masave, kanë zënë vend në masat e popullit. Armiqtë janë përpjekur që të krijojnë një psikozë alarmante me elementë teknikë duke dashur që të ngjallin në ta frikën e arrestimit me qëllim që t'i hedhin këta në pasivitet dhe t'i largojnë nga puna që u ka besuar pushteti ynë.

Për të gjitha këto, organizatat tona duhet të çmojnë dhe të realizojnë mirë situatën. Organizatave tona në lidhje me këtë situatë u del si detyrë një mobilizim i madh për një luftë të ashpër dhe të pamëshirshme kundër armiqve tanë të brendshëm dhe të përkrahësve të jashtëm imperialistë. Të mobilizohen për një luftë gjer në shfarosjen e plotë të kriminelëve të arratisur që formojnë mbështetjen e brendshme të armatosur për reaksionin e vendit tonë. Të mobilizohen për një punë të madhe politike, për sqarimin e shëndoshë të masave, të jenë ato në sulm për sqarimin e situatës dhe për goditjen e pamëshirshme të reaksionit dhe të gjitha parullave që ai hedh për qëllimet e tij armiqësore.

Të luftohen të gjitha parullat e armikut që kërkojnë të kri-

jojnë pasiguri në qëndrimin e situatës së sotme dhe psikozën e frikës së arrestimit. Këto parulla tendencioze, njëkohësisht kanë për qëllim të diskreditojnë pushtetin tonë, drejtësinë e tij.

Të theksohet se asnjëherë nuk janë goditur njerëz të ndershëm, se çdo gjyq, çdo proces ka nxjerrë në shesh tradhëtarë të popullit dhe këta janë goditur dhe do të goditen sa më rëndë. Pushteti ynë, pushteti i popullit nuk mbjell terror, e lufton bile me tërë forcat e tija, por drejtësia e tij godet fajtorët. Për më tepër organet tona u kanë sinjalizuar shumë njerëzve që të ndreqin rrugën e tyre dhe shumë kanë qenë ata që kanë përfutuar, por shumë të tjerë kanë vazhduar me besimin gjer në fund dhe kanë merituar dënimin që u është dhënë.

Kohët e fundit qeveria mori masën për lirim të burgosurve dhe 400 të internuarve; kjo tregon drejtësinë e madhe të pushtetit dhe njëkohësisht forcën tonë të madhe si dhe stabilitetin e situatës sonë të brendshme.

Prandaj duhet të luftohen të gjitha parullat dhe të popullarizohet kjo masë e drejtë që merr pushteti ynë.

Të dalë e qartë në masat punonjëse të vendit se vepra armiqësore e këtyre njerëzve armiq kundër Republikës sonë Popullore, rrezikon mirëqenien e tyre, avenirin e tyre, të ngrihet me forcë në masa se fati i tyre është i lidhur ngushtë me pushtetin e sotshëm dhe se lufta kundër këtyre armiqve për forcimin e pushtetit të tyre, për forcimin e ekonomisë së re do të thotë luftë për atdheun e tyre, luftë për të ardhshmen e tyre.

Organizatave tona duhet të dinë se kurdoherë armiku goditjen e tij kryesore e ka drejtuar kundër Partisë sonë, me qëllim që të izolojë atë dhe që të mundë kështu edhe të prishë unitetin politik të popullit; prandaj forcimi i punës sonë me Frontin, që do të thotë forcimi i organizatës së Frontit, është një detyrë e madhe dhe e rëndësishme.

Organizatave tona duhet të kenë gjithashtu të qartë se masat që u muarën karshi këtyre elementëve, që deri dje ishin në Frontin Demokratik, nuk e dobësojnë aspak Frontin dhe as që e tronditin si organizatë politike të masave të gjera të popullit. Fronti ynë qëndron më i fortë duke goditur të tillë njerëz dhe duke u pastruar nga armiqtë e popullit. Fronti, si organizatë e masave që lindi në luftë, do të shkojë duke u forcuar e zgjeruar dhe duke rritur rolin e tij për mobilizimin dhe edukimin e masave, për ndërtimin e vendit dhe për një jetë më të mirë.

Ajo që duhet theksuar më shumë është nevoja e një pune më të madhe, më të gjerë dhe më të shëndoshë në organizatat e Frontit. Një punë politike e gjallë dhe e vazhdueshme me të cilën të edukohen masat me vijën tonë, t'u forcohet besimi në pushtetin tonë, t'u zhvillohet ndjenja e patriotizmit, e dashurisë dhe e devocionit për Republikën Popullore dhe të urrejnë imperializmin

dhe armiqtë e popullit. Të punohet për të rritur besimin në forcat tona, në aleancën me Jugosllavinë dhe në miqësinë e shëndoshë dhe të sigurtë me Bashkimin Sovjetik, mbrojtës i paqes, i demokracisë dhe i independencës së popujve nga agresorët imperialistë dhe veçanërisht i vendit tonë. Ai na është ndodhur mbrojtës kudo që na është paraqitur një nevojë e tillë.

Nuk lejohet moskockëçarja dhe nënçmimi i punës së armikut, siç ndodh sot me këtë naivitet që tregojnë shokët tanë. Puna e armikut duhet të çmohet seriozisht dhe për këtë duhet vigjilencë, një vigjilencë e vazhdueshme dhe revolucionare, siç porosit Komiteti Qendror në letrën e tij të dhjetorit të vitit të kaluar, që të jetë një armë e fuqishme dhe si e tillë të mbahet nga çdo anëtar. Kemi raste jo të mira jo vetëm në anëtarët e thjeshtë të Partisë, por edhe në forumet udhëheqëse të Partisë në terren dhe në ushtri, që nuk e njohin mirë gjendjen e qarkut dhe të repartit të tyre, që nuk kanë ditur ta realizojnë mirë këtë situatë, të çmojnë si duhet punën e armikut, t'ja sinjalizojnë vazhdimisht organizatës dhe ta mbajnë atë gjithnjë të mobilizuar për një punë të madhe politike në masat, për të goditur me forcë armikun dhe të gjithë punën e tij armiqësore. Raste të tilla nuk duhet të ngjasin, pse këto janë një rrezik për tërë punën tonë. Këtë organizatat tona duhet ta kuptojnë drejt dhe seriozisht.

Organizatata tona duhet të dinë ku ta kërkojnë armikun: armiku duhet kërkuar atje ku nuk shkojnë punët, ku pengohet dhe nuk zbatohet plani. Këtu ka armik, por ka dhe njerëz që bëjnë punë armiku, por inkohientë. Organizatat e Partisë duhet të punojnë mirë që t'i njohin këta elementë, të godasin pa mëshirë ata që duan të na pengojnë në rrugën e zhvillimit të vendit tonë dhe t'ua sinjalizojnë me kohë punën e tyre elementëve që kanë vepruar me inkohiencë, në mënyrë që të kryejnë me ndershmeri detyrën që u ka besuar shteti.

Organizatata dhe çdo anëtar partie të realizojnë situatën aktuale, përpjekjet e armikut, rrezikun e punës së tij shkatërrimtare dhe të jenë të qartë për luftën e ashpër dhe të shumanshme që duhet të bëjnë, pse ndërtimi i ekonomisë sonë dhe realizimi i punëve tona me plan, kanë hasur dhe do të hasin në pengesa dhe kundërshtime nga ana e armiqve, si sabotazhe etj. Të ndihet dhe të çmohet ashpërsimi i luftës së klasave që zhvillohet para nesh dhe të përballohet kjo drejt, me gjallëri dhe me vendosmëri.

Nga ana tjetër organizatat e Partisë duhet të shikojnë mirë situatën e qarkut të tyre, të jenë vigjilente, të diktojnë në kohë çdo gjë dhe të ndërhyjnë në vend për të ndrequr gabimet, për të ndrequr njerëzit që gabojnë, për të shpëtuar njerëzit e ndershëm duke u treguar rrugën e gabuar dhe duke i vënë në atë të drejtën.

Është e qartë se masat policore do të përdoren kundër atyre që vazhdojnë me besim deri në fund në rrugën e armikut.

Por kjo kërkon një punë të shëndoshë politike, të organizuar më së miri dhe një zgjuarësi të veçantë nga ana e organizatave tona, pse ato i japin tonin gjithë punës në qarkun e tyre.

VDEKJE FASHIZMIT — LIRI POPULLIT

KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

KOMUNIKATË

E KQ TË PKSH ME ANËN E SË CILËS SOLIDARIZOHET ME KOMUNIKATËN E KONSULTËS SË BYROSË INFORMATIVE QË U MBAJT NË VARSHAVË

24 tetor 1947

Plenumi i zgjeruar i Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare në mbledhjen e tij të mbajtur më datën 24 tetor 1947, pasi mori në shqyrtim situatën ndërkombëtare dhe Komunikatën e Konsultës Informative të disa partive komuniste që u mbajt në Poloni aty nga fundi i shtatorit 1947, mori vendime dhe lëshon këtë komunikatë:

Populli shqiptar u hodh me heroizmin më të madh në luftë kundër fashizmit robërues, për çlirimin e atdheut, për sigurimin e independencës dhe të sovranitetit të tij dhe për vendosjen e një regjimi më të vërtetë demokratik në vendin tonë, ku populli të merrte fuqinë në duart e veta dhe të vetëdrejtonte fatet e tij. Këtij qëllimi të madh, populli ynë, ja arriti plotësisht në saje të heroizmit, të vetëmohimit, të sakrificave dhe në saje të politikës së drejtë dhe tejpamëse të Frontit Nacional-Çlirimtar të udhëhequr nga Partia Komuniste Shqiptare. Në luftën e madhe të çlirimit, flamurtari i lavdishëm i së cilës ishte Bashkimi Sovjetik, i cili ishte faktori më i madh vendimtar i fitores mbi Gjermaninë naziste dhe satelitët e tij, populli shqiptar u radhit me vendosmërinë më të madhe në blokun antifashist dhe vuri në balancën e luftës, pa rezerva, të gjitha forcat e tija morale dhe materiale për shfarosjen e fashizmit, për forcimin e rendit demokratik në Evropë, për zhdukjen e mundësisë të një agresioni tjetër nga ana e Gjermanisë dhe imperialistëve të tjerë robërues si dhe për vendosjen e një bashkëpunimi të gjithanshëm dhe të vazhdueshëm me të gjitha kombet e Evropës. Këto ishin qëllimet e larta të njerëzimit progresist që ushqente Bashkimi Sovjetik dhe të gjitha vendet demokratike në luftën e madhe kundër fashizmit.

Qëllime të ndryshme nga këto, ushqenin Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britania e Madhe në Luftën e dytë botërore. Qëllimet e këtyre ish-in të eliminonin konkurrentët në tregjet, Gjermaninë dhe Japoninë dhe të forconin situatën e tyre dominuese mbi botën.

Në periudhën e pas Luftës së dytë botërore, diferencimi i më sipërm mbi qëllimet e luftës u bë edhe më i thellë. U formuan dy vija të kundërta politike. Nga një anë politika e drejtë dhe konsekuente e Bashkimit Sovjetik dhe e vendeve demokratike që synon në forcimin e demokracisë dhe shembjen e imperializmit dhe nga ana tjetër politika e Shteteve të Bashkuara dhe e Britanisë së Madhe, e cila synon të forcojë imperializmin dhe të shembë demokracinë. Kështu kanë dalë në shesh dy kampe: kampi imperialist dhe antidemokratik i cili ka për qëllim të vendosë supremacinë botërore të imperializmit amerikan dhe të shkatërrojë demokracinë dhe nga ana tjetër kampi antiimperialist dhe demokratik qëllimi kryesor i të cilit është të minojë imperializmin, të përforcojë demokracinë dhe të zhdukë mbeturinat e fashizmit.

Kampi imperialist dhe antidemokratik, me në krye imperializmin amerikan dhe me aleatët e tij britanikë, francezë dhe socialistët e krahut të djathtë, tradhëtarë të klasës punëtore, kanë shpërthyer një luftë të ashpër kundër Bashkimit Sovjetik dhe demokracive të reja në Evropë, për arsye se Bashkimi Sovjetik dhe demokracitë e reja në Evropë janë bërë një pengesë e madhe për realizimin e planeve imperialiste të luftës për supremacinë botërore dhe për shkatërrimin e lëvizjes demokratike. Kjo veprimtari agresive e kampit imperialist dhe e forcës së tij drejtuese, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zhvillohet në drejtimin e masave ushtarake-strategjike, të ekspansionit ekonomik dhe të luftës ideologjike. Doktrina Truman, plani Marshall kanë vetëm një qëllim: robërimin e popujve të Evropës dhe vendosjen e hegjemonisë së imperializmit skllavërues amerikan. Kampi imperialist i udhëhequr nga imperializmi amerikan, kërcënon botën me frikën e një lufte të tretë botërore, duke vënë përpara njerëzve, që u mungon eksperiencia në punën politike dhe me nerva të dobët, politikën e dollarit, të bombës atomike, kërcënime të drejtëpërdrejta me anë të forcës, shantazhe, mashtrime, falsifikime e të tjera mjete taktike, të denja për një arsenal banditësh.

Populli ynë i vogël, përparimtar dhe paqedashës, në rrugën e tij vendimtare, për ndërtimin e atdheut të tij, për forcimin dhe zhvillimin e demokracisë së tij popullore, për sigurimin e independencës dhe forcimin e sovranitetit të tij kombëtar i ka provuar të gjitha metodat kërcënuese dhe briganteske të imperialistëve anglo-amerikanë. Ata kanë përdorur kundër vendit tonë, kundër demokracisë sonë të re, kundër sovranitetit të popullit tonë të gjitha shantazhet, kërcënimet, mashtrimet, me qëllim që të robë-

ronin popullin tonë. Imperialistët anglo-amerikanë kanë mohuar padrejtësisht të drejtat tona të fituara me gjak, ata kanë akuzuar vendin tonë të vogël si një vend agresor dhe që kërcënon paqen, ata janë përpjekur të copëtojnë Shqipërinë, ata kanë krijuar incidente apostafat për të na luftuar në arenën ndërkombëtare, ata kanë ndërhyrë haptazi në punët e brendshme të vendit tonë duke dashur të riorganizojnë banditët fashistë për të rrëzuar Republikën dhe pushtetin tonë popullor. Por të gjitha manevrat e reaksionit anglo-amerikan kanë dështuar dhe populli ynë i vogël, me nerva të fortë dhe me besim të patundur në forcat e tija të gjalla, në rrugën e tij të drejtë, përparimtare dhe paqësore, në besnikërinë e pafund ndaj miqve dhe aleatëve të tij të fuqishëm, Bashkimit Sovjetik, Jugosllavisë së re dhe gjithë vendeve të tjera demokratike të Evropës, u ka bërë ballë me sukses të gjitha manevrave të kampit imperialist skllavërues dhe ka dalë fitues. Populli ynë me vendosmërinë më të madhe do të vazhdojë të ecë në këtë rrugë krah për krah me Bashkimin e madh Sovjetik dhe me të gjitha vendet demokratike të Evropës, pse në ta ai sheh mbrojtësit e tij dhe të gjithë njerëzimit nga kërcënimi që i bëhet botës nga ana e imperializmit amerikan dhe satelitëve të tij, anglezë, francezë dhe socialistëve të krahut të djathtë në Evropë dhe në botë.

Partia jonë Komuniste që ka rolin drejtues në Frontin Demokratik, do të qëndrojë si kurdoherë në ballin e luftës për mbrojtjen e indipendencës, të sovranitetit, të demokracisë në vendin tonë. Kurrë Partia jonë nuk do të lejojë të cënohen të drejtat e popullit tonë dhe ajo do të jetë kurdoherë flamurtarja e pamposhtur dhe heroike e indipendencës kombëtare dhe e sovranitetit të vendit tonë. Populli ynë heroik, i grumbulluar si një trup i vetëm rreth Frontit Demokratik, nuk u trembet kërcënimeve dhe shantazheve të kampit imperialist dhe antidemokratik dhe do të luftojë me ashpërsinë më të madhe kundër tentativave të atyre që dëshirojnë skllavërimin ekonomik dhe politik të vendit tonë. Populli ynë është i mobilizuar i tëri për të ndërtuar jetën e tij më të mirë, për të mbrojtur dhe zhvilluar fitoret e tija, për të mbrojtur nderin dhe indipendencën kombëtare, për të mbrojtur pushtetin popullor. Populli ynë do të jetë i pamëshirshëm kundër orvatjeve të imperializmit dhe të hyzmeqarëve të tij, monarko-fashistëve grekë, neofashistëve italianë, fqinjë të rrezikshëm dhe të agjentëve të brendshëm, mbeturina të fashizmit në vendin tonë që do të kërkojnë të dëmtojnë veprën e madhe të popullit shqiptar. Të lehurat dhe britmat e imperialistëve dhe mbeturinave të tradhëtisë në vendin tonë, të cilët janë të destinuar të falimentojnë në orvatjet e tyre, nuk e frikësojnë, as e lëkundin popullin tonë në rrugën e tij të drejtë dhe vendimtare. Partia jonë Komuniste dhe Fronti Demokratik do të grumbullojnë të gjitha forcat demokratike dhe patriotike të popullit dhe do të

përbushin me nder detyrat për të realizuar qëllimet e shenjta të popullit tonë. Populli ynë do të vërë të gjitha forcat e tija pa rezerva në balancën e kampit të pathyeshëm antiimperialist dhe demokratik dhe do të koordinojë përpjekjet e tija me të për të bërë të dështojnë planet e luftës dhe të skllavërimit të kampit imperialist dhe antidemokratik të udhëhequra nga imperializmi amerikan. Populli ynë është me mish e me shpirt dhe përsëhendet politikën e drejtë, konsekuente dhe shpëtimtare të Bashkimit Sovjetik, kampion i paqes dhe i drejtësisë, garancia më e madhe për triumfin e demokracisë së vërtetë dhe të paqes së shëndoshë e të vazhdueshme.

Partia jonë Komuniste dhe Komiteti Central i saj, koshientë si kurdoherë për detyrat e mëdha që i vihen përpara në këto momente, për të mbrojtur jetën e popullit të tij, fitoret e mëdha që i kushtuan kaq gjak dhe sakrifica, për të mbrojtur paqen dhe demokracinë, aprovon plotësisht dhe brohorit vendimet e Konsultës të disa partive komuniste që u mbajt në Poloni. Plenumi i Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare aprovon plotësisht deklaratën dhe Rezolucionin e Konsultës në fjalë dhe ajo do të jetë në çdo moment gati të shkëmbejë eksperiencën e vet dhe në rast nevojë të koordinojë veprimet e saj me ato të partive komuniste motra.

Komiteti Central i Partisë sonë Komuniste do të kërkojë në momentin e duhur që Partia jonë Komuniste të bëhet pjesëtare e Byrosë Informative.

KOMITETI CENTRAL I PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas kopjes së
daktilografuar që gjendet në
Arkivin Qendror të Partisë*

*Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi», Nr. 881,
26 tetor 1947*

**LETËR E KQ TË PKSH DREJTUAR GJITHË ORGANIZATAVE
TË PARTISË NË TERREN MBI EDUKIMIN IDEOLOGJIK
KULTURAL DHE ARËSIMOR TË BREZIT TË RI**

19 nëntor 1947

GJITHË KOMITETEVE TË PKSH NË TERREN

Kujdesi për zhvillimin kultural të masave, veçanërisht të brezit të ri, duhet të jetë një nga çështjet preokupante për Partinë.

Problemi i arësimit nuk duhet të mbetet vetëm problem i arësimitarëve dhe i seksioneve të arësimit, por në radhë të parë një problem i rëndësishëm për vetë Partinë. Nga njëra anë është çështja të sigurohen me të gjitha përpjekjet mundësitë për arësim sa më të gjerë, d.m.th. të jenë të ngritura kudo shkollat dhe të jenë pajisur këto me mjetet e nevojshme dhe nga ana tjetër kuadri i nevojshëm të jetë kudo në krye të detyrës.

Me ngritjen e shkollave të reja simbas planit të këtij viti sigurohet me një mënyrë ndoshta pak të shtrënguar mundësia për realizimin thuajse 100 për qind të detyrimit shkollor.

Por Komiteti Central nuk është informuar nga ju deri ku është realizuar ky plan për ngritjen e shkollave të reja. Sa syresh janë të ngritura, sa janë në gjysmë të punimeve, sa kanë mungesa të ndryshme (dyer, penxhere, etj.) dhe sa kanë mungesa orendish (banka, dërrasa të zeza etj.)

Gjithashtu nuk është informuar nëse ka mungesa të ndryshme në tekste ose në defterë e kaleme etj. dhe nga ana tjetër nëse është i plotësuar kudo kuadri i nevojshëm.

Për këtë, me të marrë këtë letër, sekretarët politikë ngarkohen menjëherë të informojnë Komitetin Central për këto çështje të rëndësishme me statistika ekzakte.

Ndërkaq duhet të ndërhyhet me të tërë forcën për të rregulluar sa më shpejt tërë mungesat e tjera që mund të keni lidhur me këto probleme. Sidomos duhet të bëni që të ngrihet në një shkallë sa më të gjerë kujdesi i organizatave të masave, i tërë

popullit për këto çështje. Shkollat janë të popullit, janë fëmijët e tij që mësojnë në to, që edukohen, për t'u bërë nesër më të vlefshëm për familjet e tyre dhe për atdheun, prandaj duhet tërë populli të preokupohet për [shkollat].

Duhet bërë që ky kujdes të jetë natyrisht i madh tashti për të siguruar sa më mirë mundësitë që fëmijët të mund të ndjekin shkollën etj., por ky kujdes të vazhdojë edhe për më pas, të interesohet populli se si shkon shkolla në fshatin e tij, si po mësohen fëmijët e tij, si punon mësuesi etj. Me fjalë të tjera të krijohej kjo që fshatari ose punëtori në qytet, shkollën në vendbanimin e tij ta konsiderojë si të tijën.

Nga ana tjetër është çështja që në shkollat tona të jepet arësimi me baza të shëndosha e me frymën tonë, të zbatohet reforma e arësimit.

Këtu duhet një përpjekje e madhe, një punë e dendur dhe e vazhdueshme nga ana e Partisë. Duhet pasur parasysh edhe këto dy gjëra:

1. — Përbërja sociale e arsimtarëve është jo e mirë dhe heterogjene, ka elementë të shtresave të prekura (për vetë arësimin se në të kaluarën arësimi ishte privilegj i disave) dhe sidomos elementë intelektualë të dalë nga shkolla borgjeze, me baza të shtrembra ideologjike dhe me plot mentalitete reaksionare, elementë jo me frymën tonë, bile shpesh edhe kundërshtarë të hapët, prandaj jo të dhënë për të realizuar programin e shkollës mbi bazat e reformës arësimore ose më mirë [janë] të predispozuar për ta shtrembëruar atë kurdoherë (siç ka ndodhur në shumë raste).

2. — Një numër i madh arësimitarësh s'i kanë bazat e nevojshme për të shpjeguar si duhet mësimet, pse janë me pak shkollë (786 vetë pa dokumenta shkollorë, 129 vetëm me filllore, 473 të dalë nga kurset e ndryshme etj.) ose ka edhe nga ata që mund të kenë shkollë, shumica nuk e kanë të plotë ose disa kanë kryer normalen, të tjerë gjimnaze, të tjerë teknike, tregëtare, shkolla të huaja, ngandonjëherë edhe fetare (medrese) etj. Pra, del e madhe detyra e Partisë për të bërë një punë të gjerë edukative me arësimitarët që të mund të japin mirë e me frymën tonë mësimin në shkollat.

Duam të theksojmë se kujdesi i treguar deri tashti nga Partia ose edhe nga seksionet e arësimit, vetëm për plotësimin e detyrimit shkollor, për frekuentimin e rregullt nga nxënësit, për plotësimin thjeshtësisht të programit të vitit [shkollor] etj., nuk është e gjitha.

Partia sidomos, por edhe seksionet e arësimit me inspektorët e tyre duhet të kontrollojnë mirë edhe si zbatohet ky program sa jepet në bazë të reformës, si zbatohet ky program në bazat tona ideologjike etj.

Kjo ka rëndësi të madhe për vetë faktin *se ne nuk duam vetëm t'i japim kulturë brezit të ri, por t'i japim një kulturë të shëndoshë e me baza marksiste-leniniste.*

Prandaj duhet shikuar si detyrë shumë e rëndësishme për Partinë, për celulat dhe forumet, çështja e edukimit politik, e edukimit me frymën tonë të të gjithë arësimitarëve — mësuesve dhe profesorëve — edukues këta të brezit të ri në vendin tonë.

Në mbledhjet e ndryshme me arësimitarët, në konferencat e ndryshme politike etj. të kihet gjithmonë parasysh [edukimi politik]. Mbështetje le të jetë tërë materiali që u dërgohet nga ana e Komisionit të agjit-propit pranë Komitetit Central, leksionet e ndryshme etj. sidomos një rol të rëndësishëm duhet të luajë në këtë drejtim sindikata e arësimitarëve. Partia duhet të dijë ta përdorë mirë këtë organizatë për të zhvilluar një punë të gjerë për edukimin politik të këtyre njerëzve që janë të organizuar në të.

Në këtë drejtim të mos kënaqemi vetëm me bërjen e sa më tepër mbledhjeve etj., por në mbledhje të shëndosha të bëhet një punë intensive për të dhënë rezultate sa më të mira në kuptimin e drejtë të çështjeve, në skjarimin politik dhe në luftimin e mentaliteteve të vjetra në arësimitarët.

Kujdesi për këtë punë duhet të tregohet nga vetë forumi i Partisë.

Veçanërisht seminarët e arësimitarëve, formë kjo apostafat për edukimin e tyre, duhet të mblidhen në rregull dhe të drejtohen nga shokë të mirë në mënyrë që t'i shërbejnë sa më tepër qëllimit për të cilin janë krijuar.

Gjithashtu puna individuale me ta (me mësuesit), kontakti i dendur etj., do të influencojë në kuptimin më të mirë të vijës [së Partisë] nga ana e tyre.

Rëndësi duhet t'i jepet gjithashtu luftës ideologjike në shkollë gjatë zhvillimit të mësimeve.

Në asnjë mënyrë s'duhet të lejohen shtrembërime e deviacione, por të goditen këto në vend, të ndreqen menjëherë. Këtu rolin kryesor do ta luajë organizata e Rinisë Popullore.

Njëherit është çështja që masa e rinisë të jetë e përgatitur për të mos lejuar shtrembërimet e deviacionet d.m.th. që organizata e rinisë në shkollat t'i japë rëndësi organizimit të *rrethëve të ndryshme të studimit, ku të mësohen kryesisht gjëra me karakter teorik dhe nga ana tjetër në format e ndryshme të organizimit që ka rinia në shkollë ku marrin pjesë dhe profesorët etj., të goditen pikëpamjet e shtrembra të atyre profesorëve që i shfaqin, të diskutohet fryma që duhet të kenë etj.*

Gjithashtu organizata e rinisë duhet të godasë shtrembërimet dhe aty për aty në klasë gjatë shpjegimit. Nuk është çështja të priset rregulli dhe disiplina në shkollë, bile e kundërta, por në

forma të ndryshme të ndërhyhet për të mos lejuar profesorin që të shpjegojë gjërat shtrembër e jo me frymën tonë.

Partia duhet të dijë ta përdorë mirë për këtë qëllim organizatën e rinisë në shkollat.

Duam t'ju heqim vëmendjen dhe për një çështje tjetër të rëndësishme së cilës i është kushtuar pak kujdes qoftë nga Partia si dhe nga pushteti. Ka mjaft fëmijë jetimë, të cilët sillen rrugëve dhe ngandonjëherë mbeten në mëshirën e ndonjë familjeje që i përdor si mos më keq. Prandaj duhet që me kujdesin e Partisë e të pushtetit këta fëmijë kudo që janë të mblidhen dhe të dërgohen nëpër «shtëpitë e fëmijëve», ku të mund të edukohen e të bëhen edhe ata njerëz të vlefshëm për të nesërmen.

Për të gjitha këto gjëra që shtruan më lart përveç që duhet të na informoni vazhdimisht, por tashti me të marrë këtë letër duhet të na bëni sa më shpejt një relacion të hollësishëm mbi të gjitha këto çështje.

KOMITETI QENDROR I PKSH

Botohet për herë të parë sipas kopjes së shaptillogruar që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

UDHËZIME TË KQ TË PKSH MBI MASAT POLITIKE NË LIDHJE ME ZGJEDHJET E KËSHILLAVE POPULLORE

9 janar 1948

GJITHË KOMITETEVE TË PKSH

I

Vendimi i Presidiumit të Kuvendit Popullor që më 15 shkurt 1948 të zhvillohen zgjedhjet për pushtetin lokal në të gjithë vendin tonë përbën një ngjarje të shënuar për historinë e masave tona popullore.

Zgjedhjet e afërme për pushtetin lokal janë një zhvillim i mëtejshëm i demokracisë sonë të vërtetë popullore dhe një zhvillim më i madh i pushtetit tonë, zhvillim ky që do të sjellë forcimin e tij më të madh.

Për Partinë tonë, për historinë e saj, këto zgjedhje përbëjnë gjithashtu një ngjarje shumë me rëndësi, sepse Partia jonë është frymëzuesja dhe realizuesja e këtyre fitoreve të popullit tonë.

Që në fillim, kur Partia dha sinjalin e luftës kundër fashizmit, ajo u tregoi masave tona popullore se çështja kryesore e Luftës n.-çl. ishte çështja e marrjes së pushtetit. Kështu lufta për çlirimin e vendit nga okupatori dhe tradhëtarët ishte njëkohësisht edhe lufta për pushtetin popullor.

Në Luftën n.-çl., që ishte një revolucion popullor, nga që udhëhoqej prej Partisë sonë Komuniste dhe nga qëllimi i saj për lirinë dhe demokracinë popullore, feudalët, agallarët, kapitalistët e mëdhenj, bajraktarët, pseudonacionalistët dhe pseudodemokratët, oficerë të lartë të Zogut, panë rrezikun e pozitave të tyre. Prandaj të gjithë këta u bashkuan me fashizmin, në të cilin shikonin sigurimin e pozitave të tyre.

Kështu u bë diferencimi: masat e gjëra popullore të bashkuara në Frontin N.-Çl. udhëhoqja e të cilit ishte Partia jonë, dhe armiqtë e popullit, të cilët të bashkuar me okupatorin fashist luftuan kundër popullit.

Në luftën për liri dhe demokraci të vërtetë popullore, këta armiq bashkëpunëtorë të okupatorit u gjakosën me popullin, këta muarën vulën e tradhëtisë.

Kështu populli ynë, duke luftuar kundër okupatorit luftonte edhe për rrëzimin e sistemit të shfrytëzimit dhe të varfërimit dhe për ngritjen e një sistemi të ri shoqëror, ai luftonte për pushtetin e tij, për pushtetin popullor.

Që këtej del se lufta për ndërtimin e pushtetit popullor është përmbajtja kryesore e Luftës n.-çl., kështu pushteti popullor lindi në L[uftën] n[acional]-ç[lirimtare].

Që në luftë u ngritën këshillat n.-çl. kudo në zonat e çliruara dhe në ato të okupuara, megjithëse në kondita të vështira lufte, populli ynë zgjidhte lirisht përfaqësuesit e tij.

Mbi gërmadhat e pushtetit të vjetër të shfrytëzimit u ngrit pushteti popullor.

Marrja e pushtetit në duart e masave të gjëra popullore është fitorja e madhe e popullit tonë, e Partisë sonë.

Pushteti i ri që u ngrit në vendin tonë është thellësisht popullor dhe demokratik si në formë ashtu edhe në përmbajtje.

Me këtë pushtet në duart e tija, populli ynë me anë reformash goditi rëndë bazat ku mbështeteshin klasat shfrytëzuese, ngriti sektorin ekonomik të shtetit dhe atë kooperativist duke hedhur bazat e para të pushtetit popullor dhe duke siguruar ndërtimin e shoqërisë socialiste në vendin tonë.

Pushteti ynë është popullor dhe demokratik pse buron nga populli dhe i përket popullit, është pushteti i shumicës dërmuese, pse ka krijuar konditat e domosdoshme për sigurimin e pjesëmarrjes së gjerë të masave në pushtet, pse vetë format e tija, vetë ligji i zgjedhjeve u garanton masave të gjëra punonjëse të drejtat për të marrë pjesë në pushtet dhe e inkurajon këtë pjesëmarrje.

I tillë është pushteti ynë. Kjo shpjegon forcën e tij, fuqinë e madhe të shtetit tonë.

Me zgjedhjet e reja për pushtetin tonë lokal, ne kërkojmë forcimin e tij më të madh, me qëllim që ta bëjmë atë një armë më të fuqishme në duart e masave tona popullore, për zhvillimin më të madh të ekonomisë në lokalitetet, për zhvillimin e arësimit, të kulturës dhe të gjithë jetës së lokalitetit.

II

Zgjedhjet e reja të këshillave të lokaliteteve duhet të jenë problemi kryesor i organizatave të Partisë e të Rinisë Komuniste në këtë kohë deri në mbarimin e tyre. Të gjithë anëtarët e Partisë, kandidatët dhe të rinjtë komunistë duhet të mobilizohen dhe të jenë në krye të këtyre zgjedhjeve kaq të rëndësishme.

Për zgjedhjet e reja të këshillave të lokaliteteve duhet të organizohet një fushatë e madhe elektorale nga ana e Frontit dhe të gjitha organizatave të Frontit, Sindikatave, Rinisë dhe Gruas [të cilat] duhet të marrin pjesë në këtë fushatë që organizon Fronti Demokratik.

Në këtë fushatë elektorale për zgjedhjet e këshillave popullore të lokaliteteve duhet të organizohet dhe të zhvillohet një agjitacion dhe propagandë e gjerë në masat e popullit që t'i përgatisë këto politikisht dhe t'i mobilizojë këto për zgjedhjet.

Detyrat e agjitacionit dhe të propagandës në këtë fushatë të rëndësishme janë:

1) T'u shpjegohet masave dhe të sqarohen këto mbi rëndësinë e pushtetit lokal, mbi detyrat dhe kompetencat e këshillave popullore të lokaliteteve, qyteteve dhe rretheve. Konkretisht për këtë gjë anëtarët e Partisë, kandidatët dhe të rinjtë komunistë duhet t'u shpjegojnë masave ligjin e këshillave popullore të aprovuar nga Kuvendi Popullor në sesionin e tij të korrikut 1947. Nga ky shpjegim i ligjit të këshillave popullore duhet të dalë i qartë karakteri thellësisht popullor i pushtetit tonë. Për të forcuar më mirë këtë gjë, agjitacioni dhe propaganda jonë duhet të demaskojnë para masave karakterin reaksionar të organeve administrative lokale të regjimeve të kaluara antipopullore. Këtu duhet të dalë e qartë se ndërsa komuna, bashkia, n/prefektura dhe prefektura në regjimet antipopullore të së kaluarës (si dhe sot në vendet kapitaliste) ishin organe të emëruara nga lart, që përfaqësonin interesin dhe vullnetin e klasave feudaló-borgjeze dhe që kishin për detyrë të organizonin shtypjen dhe përçarjen e masave popullore të qytetit dhe të fshatit, këshillat tona popullore të lokaliteteve janë organe që përfaqësojnë interesat dhe vullnetin e masave popullore, organe të pushtetit të tyre shtetëror, të cilat kanë për detyrë të udhëheqin popullin në luftë kundër armiqve të tij dhe të organizojnë pjesëmarrjen e tij në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të vendit. Agjitorët dhe propagandistët e Partisë duhet të ngjallin bisedime në masat e popullit rreth akteve të poshtra të organizatave të vjetra administrative të regjimeve antipopullore në të kaluarën.

2) T'u shpjegohet masave dhe të sqarohen këto mbi rëndësinë e zgjedhjeve të pushtetit lokal dhe mbi karakterin e tyre demokratik. Këtu duhet të dalë e qartë se zgjedhjet e reja të pushtetit lokal janë rezultat i Statutit të Republikës sonë Popullore dhe se ato do të forcojnë dhe do të ndërtojnë në baza të shëndosha pushtetin tonë popullor. Në lidhje me karakterin demokratik të zgjedhjeve duhet t'u shpjegohet masave ligji mbi zgjedhjet e këshillave popullore. Këtu duhet të theksohen mirë të drejtat që kanë sot masat popullore që të zgjedhin dhe të zgjidhen lirisht, të drejta që i kanë fituar me Luftën n.-çl. dhe që u janë garantuar me Statutin e Republikës Popullore. Në shpjegimin e karakterit demokratik të zgjedhjeve të pushtetit lokal agjitacioni dhe propaganda jonë duhet të vënë në dukje mirë se karakteri thellësisht demokratik i zgjedhjeve tona është rezultat i demokracisë popullore që ekziston në vendin tonë, kurse në vendet kapitaliste po-

pulli nuk i gëzon aspak këto të drejta, por mashtrohet dhe shtypet prej klikave reaksionare borgjeze. Këtu duhet të bëhen njëkohësisht krahasime me zgjedhjet që bëheshin në vendin tonë gjatë regjimeve të kaluara antipopullore ku populli shtypej dhe mashtrohej prej klikave antipopullore që kishin fuqinë në dorë.

3) Një nga detyrat më të rëndësishme të organizatave tona në punën politike me masat gjatë fushatës elektorale, është sqarimi i tyre mbi çështjen se kush duhet të zgjidhet në këshillat popullore të lokaliteteve. Këtu agjitacioni dhe propaganda jonë duhet të ngrejë me forcë dhe t'i bindin masat se ata që meritojnë të zgjidhen në këshillat popullore duhet të jenë njerëzit që kanë luftuar gjatë Luftës n.-çl., njerëzit e ndershëm, aktivë, të vullnetshëm dhe të aftë që të kenë dhënë djeh dhe sot prova besnikërie ndaj popullit. Në këshillat popullore duhet të zgjidhen sulmuesit, punëtorët dhe fshatarët që dallohen në punë, njerëzit nga radhët e shtresave punonjëse, të rinj që kanë qenë në aksione vullnetare, ushtarë të kthyer prej radhëve të ushtrisë, gra punëto-re aktiviste më të mira të Frontit. Shpjegimi i çështjes se kush duhet të zgjidhet në këshillat popullore nuk është një punë e lehtë që mund të bëhet me disa parulla të përgjithshme, por kërkon një punë të shëndoshë politike me masat. Kjo çështje duhet konsideruar si pikë centrale e gjithë fushatës elektorale. Këtu është terreni ku do të zhvillohet lufta jonë politike kundër armiqve të pushtetit, bejlerëve, agallarëve, klikave reaksionare dhe dallave-raxhinjve të çdo kallëpi që do të përpiqen të futen në pushtet, për të fituar kështu pozita për qëllimet e tyre armiqësore. Organizatat e Partisë dhe të rinisë komuniste, të gjithë shokët komunistë duhet të zhvillojnë një luftë të fortë dhe të organizuar për demaskimin e këtyre elementëve kundërshtarë të pushtetit tonë popullor, për dërmimin e influencës dhe punës së tyre reaksionare. Nga ana tjetër duhet të ngrihet qartë para masave të popullit se të zgjedhurit në këshillat popullore është një nder i madh.

4) Detyra tjetër me rëndësi e organizatave tona në fushatën e zgjedhjeve të këshillave popullore është mobilizimi i masave të popullit për votimet. Këtu duhet bërë një punë e madhe për ta ngritur çështjen e votimit si një detyrë patriotike në mënyrë që të mos mbetet asnjë njeri (që ka të drejtën e votës) pa votuar. Veçanërisht duhet të bëhet një punë e organizuar për mobilizimin e masave të grave në votimet duke thyer çdo pengesë fanatizmi, supersticioni, zakoni të keq ose punë të armikut. Në lidhje me këtë, organizata e gruas ka një detyrë kryesore, por problemi i pjesëmarrjes së grave në votimet duhet të jetë një problem i organizatave të Partisë, të Rinisë Komuniste dhe gjithë organizatave të tjera, sidomos në krahinat ku është më i theksuar fanatizmi dhe prapambetja politike e masave.

Këto janë detyrat kryesore të organizatave të Partisë e të

Rinisë Komuniste në fushatën elektorale për zgjedhjet e këshillave popullore të lokaliteteve. Por për realizimin e këtyre detyrave duhet të bëhet një mobilizim total i organizatave të Frontit, Sindikatave, Rinisë dhe Gruas.

Fushata elektorale për zgjedhjet e këshillave popullore të lokaliteteve duhet të kuptohet mirë prej organizatave të Partisë e të Rinisë Komuniste, prej çdo anëtarit të Partisë dhe të riu komunist. Ajo nuk duhet të merret si një gjë e thjeshtë, e lehtë dhe e zakonshme, si një gjë manifestive, por duhet të kuptohet si fushata më e rëndësishme nga do të dalë pushteti lokal e ku duhet të goditen elementi reaksionar, armiq të Frontit dhe të pushtetit, të goditet influenca dhe puna e tyre. Prandaj fushata elektorale duhet të bëhet edhe një fushatë lufte politike e masave të popullit, e organizatave të Frontit, kundër reaksionit për dërmimin e influencës së tij. Anëtarët e Partisë, kandidatët dhe të rinjtë komunistë duhet të jenë në krye të kësaj lufte dhe ta udhëheqin atë drejt një fitoreje të plotë të kandidatëve të Frontit Demokratik.

III

Për organizimin dhe zhvillimin e fushatës elektorale duhet të fillohet menjëherë. Komitetet e Partisë në qytete, sektorë dhe rrethe duhet të bëjnë mbledhje të tyre të posaçme, të studjojnë problemin e organizimit të fushatës elektorale në juridiksionin e tyre përkatës, të hartojnë një plan pune konkret për fushatën dhe të merren masat e duhura për realizimin e tij nga ana e organizatave bazë të Partisë.

Theksojmë se çdo organizatë popullore duhet të ketë planin e punës të saj, por këto plane të jenë të koordinuara midis tyre dhe gjithë fushata elektorale duhet të jetë e centralizuar nën drejtimin unik të komiteteve të Partisë.

Fushata do të bëhet nga ana e Frontit, i cili do të organizojë dhe do ta drejtojë të gjithë fushatën elektorale.

Organizatave e masave, sindikatave, rinia popullore dhe gruaja shqiptare do të marrin pjesë në mbledhjet e Frontit. Këto organizata do të bëjnë mbledhjet e tyre speciale për të caktuar detyrat që i dalin secilës në këtë fushatë të Frontit Demokratik.

Bashkëngjitur me këtë po ju dërgojmë një skicë të planit që do ta konkretizon në terrenin e veprimtarisë suaj.

KOMITETI QENDROR I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

*Botohet sipas origjinalit që
gjendet në Arkivin Qendror
të Partisë*

VENDIM I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PKSH MBI SHTETËZIMIN E KOPEVE TË MËDHA

21 prill 1948

Byroja e KQ në mbledhjen e datës 21.IV.48 mori në bisedim çështjen e blegtorisë duke dëgjuar mendimin e Min[istrisë] së Bujqësisë nga ana e shokut Haki Toska dhe vendosi që të bëhet shtetëzimi i kopeve të mëdha, i atyre që nuk i mbajnë dhe kanë burime të tjera dhe aty-këtu në elementë agallarë reaksionarë, me emra të caktuar dhe jo reformë e bagëtive.

Me këtë shtetëzim goditet elementi kapitalist shfrytëzues në blegtori në qytet dhe në fshat, krijohet një ekonomi e shëndoshë në dorë të shtetit me mbi 100 000 kokë bagëti, ku do të organizohen kolektiva shtetërore si një mjet i fuqishëm për furnizimin e qyteteve.

Shtetëzimi në këtë mënyrë në një anë godet elementë të caktuar që pengonin zhvillimin e blegtorisë dhe ishin një rrezik për ekonominë e shtetit dhe për planin e shtetit dhe në anën tjetër nuk prek aspak fshatarësinë mbarë, duke hequr një herë dhe përgjithmonë frikën e një reforme blegtorale të përgjithshme, gjë që pengonte në rritjen dhe përmirësimin e blegtorisë, që është vija e shtetit tonë d.m.th. blegtoria të rritet në numër dhe në kualitet.

Me vetë këtë masë dhe me një propagandë dhe agjitacion të gjerë që do të zhvillojë Partia do të largohet çdo dyshim nga fshatari në çështjen e bagëtisë dhe të kuptojnë ata se jo vetëm që nuk ekziston rrezik për shtetëzimin e bagëtive, por është politika e shtetit për zhvillimin e saj sa më të madh dhe shteti do të ndihmojë fuqimisht për këtë.

Edhe në qytete kur ka mundësi nga ana e zanatçinjve ose e nëpunësve duhet të përkrahët mbajtja e bagëtive bashkë me atë të pulave, lepurave, derrave në një sasi që ata do të mund të mbajnë nga 1 kokë deri në 50 ose edhe më tepër kur kanë mundësitë e mbajtjes.

Shtetëzimi i këtyre kategorive pronarësh të hapë para ma-

save të fshatit perspektiva të zhvillimit të bagëtive, të përparimit të tyre si në numër ashtu edhe në atë të produkteve blegtorale. Partia duhet të angazhohet në fshat me këtë barrë kaq të rëndësishme duke e bërë këtë problem për gjithë masat e fshatit.

Detyrë kryesore që Byroja e KQ u cakton organeve të Partisë është administrimi dhe shfrytëzimi i mirë me çdo kusht i këtyre kopeve dhe brenda mundësive përmirësimi i furnizimit me mish e me bulmet i popullatës së qytetit si efekt i vetë kësaj mase.

Çështja që duhet të na preokupojë dhe që është kryesorja është ajo që të luftojmë çdo gjë që do të tentojë armiku të ngjallë në fshatarët mbi të ardhshmen e bagëtive dhe të forcojmë besimin e patundur të fshatarit mbi bagëtinë dhe nevojën e zhvillimit e të përmirësimit të saj duke bërë sqarimin e nevojshëm dhe mobilizimin më të madh që mund të bëhet.

*Botohet sipas origjinalit që
gjenet në Arkivin Qendror
të Partisë*

KOMUNIKATË

E KQ TË PKSH ME TË CILËN SOLIDARIZOHET ME REZOLUTËN E BYROSË INFORMATIVE «MBI GJENDJEN NË PKJ» KU DËNOHET RRUGA TRADHËTARE E UDHËHEQJES SË PKJ

29 qershor 1948

Plenumi i Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare në mbledhjen e tij të jashtzakonshme, pasi mori në studim Rezolucionin e Byrosë Informative të partive komuniste dhe punëtore motra, «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave», deklaroi sa më poshtë:

1) Komiteti Central i Partisë Komuniste Shqiptare unanimisht solidarizohet plotësisht me Rezolucionin e Byrosë Informative të partive komuniste «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave» dhe dënon rreptësisht tradhëtinë e hapët të udhëheqësve të Partisë Komuniste Jugosllave, të cilët kanë tradhëtuar marksizëm-leninizmin, kanë tradhëtuar kampin e socializmit dhe janë në luftë të hapët dhe të pandershme me atdheun e lavdishëm të socializmit, me Partinë e lavdishme të Lenin-Stalinit, me kampin demokratik dhe antiimperialist. Udhëheqësit e Partisë Komuniste Jugosllave, tradhëtarë, trockistë, kanë tradhëtuar kauzën e shenjtë të popullit heroik dhe vëlla jugosllav, të cilin kërkojnë ta çojnë në rrugën e greminës.

2) Komiteti Central i Partisë Komuniste Shqiptare ka qenë vazhdimisht në konflikt me Komitetin Central të Partisë Komuniste Jugosllave, i cili është përpjekur t'i imponojë vendit tonë dhe Partisë sonë metodat dhe politikën e tij tradhëtare, armiqësore, trockiste. Komiteti Central i Partisë Komuniste Jugosllave, me në krye Titon, kanë shtrembëruar të gjitha marrëdhëniet politike dhe ekonomike me vendin tonë, marrëdhëniet që lindën në shenjë e një vëllazërimi të madh të farkëtuar nga popujt e Shqipërisë dhe Jugosllavisë në luftën më të përgjakshme që ka parë bota. Udhëheqësit e Komitetit Central të Partisë Komuniste Ju-

gosllave, përpqeshin që atdheun e heronjve të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare, që derdhën gjakun pa kursyer për çlirimin e popujve vëllezër të Jugosllavisë, në Mal të Zi, në Bosnje, në Hercegovinë, në Kosovë, në Metohi e gjetkë, ta shndërronin në një koloni të tyre. Udhëheqësit trockistë të Partisë Komuniste Jugosllave, me politikën e tyre armiqësore dhe antimarksiste, u përpoqën të zhduknin independencën e vendit tonë dhe të Partisë sonë, goditën për shumë herë unitetin e udhëheqjes së Partisë sonë, pse kjo nuk ishte dakord me qëllimet e tyre antimarksiste, antishqiptare, dhe u rezistonte me burrëri kërcënimeve e shantazheve të tyre. Udhëheqësit tradhëtarë të Partisë Komuniste Jugosllave, duke u përpjekur të zhduknin independencën e Partisë sonë, duke goditur unitetin e udhëheqjes së Partisë sonë, duke dashur të impononin metodat e tyre antimarksiste në Partinë tonë, ata synonin t'i impononin popullit tonë një politikë kriminale, që kishte për qëllim mjerimin e popullit tonë, shembjen e demokracisë sonë popullore, shfrytëzimin kapitalist të popullit dhe të vendit tonë. Gjatë pesë muajve të fundit, konflikti në mes Komitetit Central të Partisë sonë dhe Komitetit Central të Partisë Komuniste Jugosllave kishte arritur kulmin. Komiteti Central i Partisë sonë u rezistoi heroikisht metodave fashiste të udhëheqësve tradhëtarë të Komitetit Central të Partisë Komuniste Jugosllave, u rezistoi kërcënimeve, shantazheve të tyre dhe triumfoi mbi këta antimarksistë me damkë.

3) Populli ynë heroik dhe Partia Komuniste Shqiptare do t'u jenë mirënjohës përjetë Partisë së lavdishme Bolshevike të Lenin-Stalinit dhe shokut të dashur dhe mësuesit tonë të lavdishëm, Stalin, që shpëtuan përsëri popullin tonë dhe Partinë tonë nga ndërhyrja antimarksiste e udhëheqjes së Partisë Komuniste Jugosllave. Në saje të luftës së lavdishme të Bashkimit Sovjetik dhe të Stalinit të madh, populli ynë u çlirua nga robëria e rëndë e fashizmit gjakatar, fitoi lirinë, vendi ynë u bë independent dhe sovran. Në saje të ndihmës së drejtë të Bashkimit Sovjetik, i cili në asnjë moment nuk na e ka kursyer, populli ynë nën udhëheqjen e Partisë sonë po ndërton socializmin. Në momentin më të rëndë të konfliktit të egër që ekzistonte në mes të Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare dhe udhëheqësve të Partisë Komuniste Jugosllave, konflikti i shkaktuar nga udhëheqësit antimarksistë jugosllavë, ndihma e Partisë Bolshevike të Bashkimit Sovjetik, e shokëve të shtrenjtë Stalin e Mollotov, që ju dha Partisë sonë dhe gjithë partive të tjera motra komuniste, ishte shpëtimtare për popullin tonë e Partinë tonë Komuniste.

4) Në këto momente të rënda dhe fatkeqe të popujve vëllezër të Jugosllavisë, populli shqiptar dhe Partia Komuniste Shqiptare, ruajnë shtrenjtë në zemër, dashurinë dhe besnikërinë që ushejnë për popujt vëllezër të Jugosllavisë. Aleanca në mes të

popullit shqiptar dhe popujve të Jugosllavisë u farkëtua me gjakun e bijve tanë më të mirë... Populli shqiptar do të jetë besnik i kësaj aleance dhe fjalën e tij ai ua ka dhënë popujve vëllezër të Jugosllavisë dhe jo udhëheqësve antipopullorë dhe antimarksistë që sundojnë sot mbi Jugosllavinë, që shkaktojnë fatkeqësi të mëdha për popullin jugosllav dhe që kanë bërë një politikë të egër antishqiptare.

Populli Shqiptar dhe Partia Komuniste Shqiptare janë të bindur se popujt e Jugosllavisë dhe elementët e shëndoshë të Partisë Komuniste Jugosllave, besnikë të marksizëm-leninizmit nuk do të lejojnë kurrë që një grup antimarksistësh të shkelin gjakun e popujve të Jugosllavisë dhe ta shndërrojnë Republikën Popullore të Jugosllavisë në një koloni të imperializmit.

5) Populli shqiptar dhe Partia Komuniste Shqiptare si një trup i vetëm janë të rreshtuar në kampin demokratik dhe anti-imperialist në krye të të cilit qëndron i pamposhtur shpëtimtari i popujve, mbrojtësi i lirisë, i demokracisë së vërtetë, mbrojtësi i paqes së vazhdueshme dhe të drejtë, Bashkimi i lavdishëm Sovjetik. Për politikën e drejtë të kampit të socializmit, populli shqiptar me në krye Partinë Komuniste të tij do të luftojë me vendosmërinë më të madhe kundër luftëdashësve imperialistë amerikanë, anglezë dhe satelitëve të tyre dhe kundër gjithë veglave të imperializmit skllavërues, nën çdo maskë që ata do të përpiqen të fshehin veprat e tyre antipopullore, antimarksiste, kundër kampit të socializmit, kundër Partisë së lavdishme Bolshevike të Lenin-Stalinit, kundër atdheut të madh dhe të fuqishëm të socializmit, Bashkimit Sovjetik.

6) Plenumi i Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare vendosi që Rezolucioni i Byrosë Informative «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave», të punohet dhe të komentohet në gjithë organizatat e Partisë dhe në masat e gjera punonjëse të vendit tonë.

KOMITETI CENTRAL I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

Botohet sipas gazetës

«Bashkimi», Nr. 1094,

1 korrik 1948

PLENUMI XI I KQ TË PKSH

13-24 shtator 1948

Plenumi XI i KQ të PKSH zhvilloi punimet e tij nga 13 deri më 24 shtator 1948 nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha. Plenumi dëgjoji dhe aprovoi raportin e shokut Enver Hoxha «Mbi gjendjen e Partisë sonë». Plenumi i bëri një analizë të përgjithshme vijës politike dhe organizative të Partisë që nga koha e themelimit të saj. Gjatë kohës së luftës vija politike dhe në përgjithësi ajo organizative ka qenë e drejtë. Pas çlirimit të vendit, për shkak të ndërhyrjes brutale të udhëheqjes revizioniste jugosllave në punët e brendshme të Partisë dhe të vendit tonë si dhe të punës armiqësore të grupit të Koçi Xoxes, vija organizative bëhet në përgjithësi jo e drejtë.

Plenumi dënoi prapaskenën e Beratit dhe punimet e Plenumit II të KQ të Partisë duke theksuar se që këtu fillon ndërhyrja e hapur antimarksiste e revizionistëve jugosllavë në punët e brendshme të Partisë dhe të shtetit tonë, se këtu fillon periudha e një sërë gabimesh të rënda politike dhe organizative të bëra nga Sejfulla Malëshova, Koçi Xoxe, Pandi Kristo etj., të cilët nën ndikimin dhe me ndërhyrjen direkte të delegatit të KQ të PKJ organizuan prapaskenën e Beratit dhe në këtë mënyrë në formë grupazhi goditën Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë dhe futën në Parti forma organizative dhe metoda pune antimarksiste.

Plenumi XI i KQ të Partisë dënoi gjithashtu punimet dhe vendimet e Plenumit VIII të KQ të Partisë, këtë pikë më të zezë të historisë së Partisë sonë, siç e ka quajtur shoku Enver Hoxha, plenum ky që adoptoi një vijë politike dhe ekonomike krejtësisht të gabuar, antishqiptare dhe anti-sovjetike, ku u shkelën rëndë parimet marksiste-leniniste të ndërtimit dhe të jetës së Partisë, ku u goditën pa të drejtë shumë shokë besnikë e të vendosur për çështjen e Partisë dhe ku Partia u fut në një rrugë të shtrembër antimarksiste.

Duke analizuar marrëdhënjet e Partisë dhe të shtetit tonë me ato të partisë dhe të RFPJ, Plenumi XI i KQ të Partisë nga analiza e thellë e këtyre marrëdhënjeve nxori fare qartë qëllimet e vërteta antimarksiste, antishqiptare dhe nacional-shoviniste të revizionistëve jugosllavë që donin ta kthenin vendin tonë në një republikë të shtatë të Jugosllavisë.

Një vëmendje të veçantë Plenumi XI i KQ të Partisë i kushtoi analizës së vijës organizative të Partisë nga ku doli se nën ndikimin dhe me ndërhyrjen direkte të revizionistëve jugosllavë ishin bërë shtrembë-

rime dhe gabime shumë të rënda, për të cilat përgjegjësia binte mbi Koçi Xoxen, ish-sekretar organizativ, që ishte dhe përcues i vijës jugosllave në vendin tonë.

Plenumi XI i KQ të Partisë u dha fund gjithë këtyre shtrembërimëve dhe gabimeve në vijën politike dhe organizative të Partisë. Ai shënoi fillimin e një kthese me rëndësi të madhe në jetën e Partisë sonë.

Plenumi ripohoi qëndrimin e patundur për të ndjekur edhe në të ardhshmen politikën e miqësisë dhe të bashkëpunimit të ngushtë e vëllazëror me Bashkimin Sovjetik dhe me Partinë Bolshevike dhe gjithë lëvizjen revolucionare punëtoje demokratike dhe antiimperialiste në botë. Ai shtroi para Partisë detyrën që të studjohej përvoja e ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik dhe të zbatohej ajo në mënyrë krijuese në kushtet e Shqipërisë.

Plenumi gjithashtu vendosi të legalizohej Partia, të thirrej kongresi I i saj dhe për të ngritur nivelin ideo-politik të Partisë të vihej në bazë të arësimit të Partisë Historia e PK (b) të BS e të fillonte botimi i përditshëm i gazetës «Zëri i Popullit», organ i KQ të Partisë.

Për forcimin ekonomik të vendit plenumi vendosi që të vihen të gjitha forcat e Partisë dhe të popullit për realizimin e tejkalimit e detyrave të planit ekonomik të shtetit në bazë të korigjimeve që ju bënë atij sipas orientimit që dha ky plenum.

Plenumi XI i KQ të Partisë vendosi të hiqet nga qarkullimi Rezolucioni antimarksist i Plenumit VIII si dhe të gjitha materialet që kanë të bëjnë me të. Ai rehabilitoi shokun Nako Spiru si militant i Partisë. Dënoi me masa të ndryshme ndëshkimore Koçi Xoxen, Pandi Kriston dhe shokë të tjerë që kishin gabuar. Plenumi vendosi gjithashtu që të gjithë ata që ishin ngritur në vende drejtuese në Parti e shtet në frymën e Plenumit VIII të riktheheshin në vendet që kishin pasur më parë, kurse ata shokë që ishin ndëshkuar padrejtësisht u shkarkuan nga dënimet dhe u rikthyen në vendet e mëparshme.

REZOLUCIONI I PLENUMIT XI TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

24 shtator 1948

Më 13 deri më 24 shtator u zhvilluan punimet e Plenumit XI të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare nën kryesinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha. Në seancat e plenumit merrnin pjesë anëtarët e kandidatët e Komitetit Qendror si edhe shoku Mehmet Shehu, si kandidat i Komitetit Qendror i zgjedhur në Konferencën e Vendit të Partisë, e mbajtur në Labinot më 1943, dhe shoqja Liri Belishova¹ si kandidate e Komitetit Qendror e kooptuar në Plenumin e Beratit më 1944, dhe të dy këta të dënuar padrejtësisht nga Plenumi VIII i Komitetit Qendror, i cili i kishte përjashtuar, të parin nga Komiteti Qendror dhe të dytën nga Komiteti Qendror dhe nga Partia.

Plenumi XI dëgjoi, shqyrtoi dhe aprovoi raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë në lidhje me gjendjen e Partisë sonë. Si raporti i shokut Enver Hoxha, ashtu edhe të gjitha punimet e plenumit u zhvilluan nën dritën e letrave të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave dhe të Rezolutës së Byrosë Informativë «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave». Duke pasur parasysh vendimet e Plenumit IX të Komitetit Qendror të Partisë sonë, ku u pranuan unanimisht dhe vendosmërisht letrat historike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bolshevike dhe Rezolucioni i Byrosë

¹ Liri Belishova, siç e tregoi veprimtaria e saj e mëvonshme, ishte e molepsur me një ambicie të sëmurë mikroborgjeze dhe me një ndjenjë të theksuar karrierizmi. Ajo prapa shpinës së KQ, siç ka qenë e predispozuar edhe tjetër herë, u lidh me grupin e Hrushovit. E përpunuar në Moskë nga ky grup, ajo u vu në opozitë me vijën e Partisë duke mbrojtur vijën antimarksiste të udhëheqjes revizioniste sovjetike. Për këto Plenumi XVIII i KQ (shtator 1960) e përjashtoi atë nga Plenumi i KQ, ndërsa organizata bazë e përjashtoi edhe nga Partia.

Informative dhe duke marrë parasysh se grupi nationalist trockist i Titos ka tradhëtuar marksizëm-leninizmin dhe është hedhur në pozitë nacionaliste borgjeze, është hedhur në kampin imperialist, e ka vënë veten dhe Partinë Komuniste Jugosllave jashtë familjes së partive komuniste dhe punëtoje motra, jashtë kampit të socializmit; mbasi udhëheqësit e Partisë Komuniste Jugosllave kanë ndjekur dhe ndjekin, në lidhje me problemet themelore të politikës së brendshme dhe të jashtme, një vijë të gabuar që përbën largimin nga marksizëm-leninizmi; mbasi udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave ka ndjekur dhe ndjek një politikë armiqësore kundër Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste Bolshevike të lavdishme të Bashkimit Sovjetik; mbasi me politikën e tyre të brendshme grupi trockist i Titos ka devijuar nga pozitë e klasës punëtoje dhe është larguar nga teoria marksiste-leniniste e klasave dhe e luftës së klasave; mbasi grupi trockist i Titos bën revizionimin e teorisë marksiste-leniniste mbi partinë e proletariatit duke mos e konsideruar partinë komuniste si forcën kryesore dhe drejtuese të vendit, por përkundrazi duke dashur ta likuidojë këtë në frontin popullor; mbasi udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave ka krijuar një regjim sektar, burokratik dhe policor në parti që është vdekjeprurës për jetën dhe zhvillimin e Partisë Komuniste Jugosllave; mbasi udhëheqësit e Partisë Komuniste Jugosllave të prekur nga një ambicie e megalomani e pakufishme, nuk kanë pranuar kritikën e drejtë dhe bolshevike të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bolshevike të URSS-it dhe mbajtën një qëndrim armiqësor lidhur me rrugën antiparti të mohimit të të gjitha gabimeve të tyre, duke mos pranuar të merrnin pjesë në mbledhjen e Informbyrosë për të analizuar gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave; mbasi udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave e vuri veten jashtë dhe kundër kampit unik të socializmit në botë dhe kundër Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik, duke shpërthyer një fushatë shpifjesh kundër Partisë Bolshevike, kundër Bashkimit Sovjetik, vendeve të demokracive popullore dhe partive komuniste dhe punëtoje motra, për të armiqësuar popujt e Jugosllavisë me popujt e Bashkimit Sovjetik, të vendeve të demokracive popullore dhe të kampit të socializmit në botë; mbasi udhëheqja jugosllave e ka vënë Jugosllavinë në rrugën e degjenerimit në një republikë borgjeze; duke marrë parasysh se marrëdhëniet speciale dhe të ngushta që kanë ekzistuar midis Partisë sonë Komuniste dhe Partisë Komuniste Jugosllave qysh prej kohësh kanë bërë që në Partinë tonë të reflektohen drejtpërsëdrejti shumë gabime të rënda të udhëheqjes jugosllave; duke marrë parasysh zhvillimin e gjendjes ndërkombëtare kur kontraktat midis kampit demokratik e antiimperialist me Bashkimin Sovjetik në krye dhe kampit imperialist dhe antidemokratik

me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye po ashpërsohen çdo ditë e më tepër; duke marrë parasysh ashpërsimin e kontradiktave midis të gjithë kampit monolit socialist në botë me në krye Bashkimin Sovjetik nga një anë dhe grupit fraksionist të Titos nga ana tjetër,

Plenumi XI konsideron:

1. — Se letrat e dërguara Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik, kanë një rëndësi të madhe historike për jetën e Partisë Komuniste Jugosllave, për partitë komuniste e punëtoresh motra, për kampin e socializmit dhe për Partinë tonë, sepse:

a) Ato i heqin maskën tradhëtisë ndaj marksizëm-leninizmit të bërë nga ana e grupit trockist nacionalist të Titos.

b) Ato janë mbrojtja besnike e marksizëm-leninizmit dhe zbulojnë e demaskojnë fraksionin trockist nacionalist të grupit Tito në gjirin e Partisë Komuniste Jugosllave dhe në gjirin e kampit unik të socializmit.

c) Ato janë dritë e madhe marksiste-leniniste-staliniane që u ndriçojnë rrugën të gjitha partive komuniste për të parë dhe ndrequr gabimet e tyre; veçanërisht për Partinë tonë ato janë shpëtimtare, pse në dritën e tyre Partia jonë po bën kthesën e domosdoshme duke ndrequr sa më shpejt gabimet e rënda që kemi bërë nën influencën e udhëheqjes së Partisë Komuniste Jugosllave, duke dalë nga kthetrat e grupit trockist të Titos dhe duke u vënë vendosmërisht në rrugën e marksizëm-leninizmit që udhëheq me lavdi Partia Komuniste Bolshevike e Bashkimit Sovjetik.

c) Ato janë ndihma e paçmueshme që i jep Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit Partisë Komuniste Jugosllave, të gjitha partive komuniste dhe punëtoresh dhe veçanërisht Partisë sonë.

2. — Se është nevoja e domosdoshme dhe urgjente që Partia jonë të bëjë kthesën historike duke analizuar gjerësisht dhe në mënyrë marksiste të gjithë aktivitetin e saj nën dritën e letrave të Partisë Bolshevike dhe të Rezolutës së Informbyrosë, duke zbuluar të gjitha gabimet e bëra, duke i dënuar ashpër këto gabime në bazë të një kritike dhe autokritike të guximshme bolshevike që nga udhëheqja e Partisë e deri në organizatat bazë, të analizojë dhe të gjejë shkaqet e vërteta të gabimeve tona, të përcaktojë kjartë vijën që duhet të ndjekë Partia e vendi për të shkuar më me vendosmëri drejt socializmit dhe të mobilizohet plotësisht për realizimin e kësaj vije.

Duke shqyrtuar raportin e hollësishëm të paraqitur nga shoku Enver Hoxha mbi të gjithë aktivitetin e Partisë sonë dhe

mbi gjendjen e brendshme të saj nën dritën e letrave të shokëve Stalin dhe Mollotov drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave, në emër të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bolshevike të URSS-it dhe në prizmin e Rezolutës së Byrosë Informative të partive komuniste dhe punëtoresh motra «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave»,

Plenumi XI konstaton:

1. — Partia jonë e ka udhëhequr drejt klasën punëtoresh e të gjithë popullin tonë, si në Luftën nacional-çlirimtare ashtu edhe në luftën për rindërtimin e vendit mbas çlirimit. Në saje të luftës heroike të Ushtrisë Sovjetike, në saje të ndihmës që na ka dhënë dhe na jep Bashkimi Sovjetik dhe në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë, populli ynë ka korrur fitore të mëdha: ne fituam independencën, lirinë, duke çliruar vendin nga okupatorët dhe tradhëtarët: vendosëm pushtetin popullor, ngritëm një ushtri popullore dhe moderne, kryem një sërë reformash të mëdha e të drejta ekonomiko-shoqërore, po ndërtojmë ekonominë tonë dhe po ecim me siguri në rrugën drejt socializmit.

2. — Vija politike e Partisë sonë gjatë Luftës nacional-çlirimtare ka qenë e drejtë dhe vija organizative në përgjithësi ka qenë e drejtë. Disa gabime që janë bërë gjatë luftës si p.sh. Mukja, nuk mund të konsiderohen si vijë e Partisë, por si gabime të disa udhëheqësve dhe që Partia këto gabime i ka goditur pa mëshirë dhe në kohën e duhur. Pas çlirimit të vendit fillon etapa e ndërhyrjes direkte të udhëheqjes jugosllave në punët e Partisë e të vendit tonë, vija organizative e Partisë zhvillohet në drejtim të vijës organizative jugosllave, transformohet nga një vijë në përgjithësi e drejtë në një vijë në përgjithësi jo të drejtë, ndërsa vija politike mbetet në përgjithësi e drejtë deri aty nga fundi i vitit 1947, kur ndërhyrja jugosllave u shfaq në format më brutale dhe vija jonë politike u dëmtua për një kohë rëndë. Megjithatë, në politikën e jashtme orientimi ynë ka qenë kurdoherë i drejtë, ka qenë orientimi ndaj Bashkimit Sovjetik, sado që në kohët e fundit janë dukur në disa udhëheqës të Partisë shfaqje të anti-sovjetizmit.

3. — Partia jonë në punën e saj, gjatë luftës ka hasur në pengesat e brendshme, siç ka qenë veprimtaria antiparti e fraksionistëve dhe e grupazheve dhe veprimtaria e gabuar e disa udhëheqësve të veçantë. Pas çlirimit të vendit pengesa kryesore në rrugën e Partisë sonë ka qenë veprimtaria e udhëheqjes jugosllave, e ndërhyrjes së saj në punët e Partisë sonë, ka qenë influenca e udhëheqjes jugosllave në udhëheqjen e Partisë sonë.

Plenumi XI i Komitetit Qendror të Partisë sonë konstaton se

Plenumi II i Komitetit Qendror që u mbajt në Berat në muajin nëntor 1944 ka qenë fillimi i ndërhyrjes së egër, armiqësore, arbitrare dhe të paligjshme nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave, në punët e brendshme të Partisë sonë dhe të shtetit tonë, ka qenë fillimi i një sërë gabimesh të rëndësishme politike dhe organizative nga ana e disa shokëve udhëheqës kryesorë të Partisë, Koçi Xoxe...

Plenumi II i Komitetit Qendror u thirr:

1. — Për të bërë bilancin e forcave të Partisë sonë që udhëhoqi popullin në fitore, të riorizonte organizimin e Partisë dhe t'i vinte përpara Partisë në etapën e re të çlirimit detyrat e mëdha të qeverisjes së shtetit tonë të lirë, të forcimit të mëtejshëm të pushtetit popullor, të rindërtimit të vendit dhe ngritjes e zhvillimit të ekonomisë popullore.

2. — Të bënte analizën marksiste të fitores dhe të gabimeve që mund të ishin bërë gjatë luftës dhe të armatoste Partinë kundër vështirësive që do të haste në etapat e reja.

Qëllimet e drejta të Plenumit II u shtrembëruan në rrugën antimarksiste, antiparti dhe antishqiptare. Realizimi i këtyre qëllimeve të këqija dhe të rrezikshme u arrit pas një pune konspirative, në prapaskenë, në formë grupazhi, të organizuar fshehurazi nga Komiteti Qendror dhe nga Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, kundër të cilit bëhej kjo gjë dhe kundër vijës së drejtë gjatë gjithë kohës së luftës që kishte zbatuar Partia jonë. Një akt i tillë i dënueshëm nga rregullat e Partisë sonë, kryesohej nga delegati i jashtëzakonshëm i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave i mbështetur nga Sejfulla Malëshova, shërbëtor i borgjezisë dhe nga Koçi Xoxe, Pandi Kristo etj. të influencuar rëndë nga delegati i KQ të PKJ. Për t'ja mbërritur qëllimeve të tij të poshtra delegati i KQ të PKJ drejtoi goditjen kundër Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë sonë...

Cilat ishin qëllimet e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave... në Plenumin e Beratit:

a) Të zhdukte independencën e Partisë sonë dhe të shtetit tonë të ri dhe Partia jonë dhe shteti ynë t'u nënshtroheshin pa rezerva direktivave të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave dhe të shtetit jugosllav.

b) Të krijonte idenë absolute se lufta e Partisë dhe e popullit tonë i detyrohej Partisë Komuniste Jugosllave dhe Komitetit Qendror të saj.

c) Të godiste rëndë dhe të diskreditonte Komitetin Qendror të Partisë dhe Sekretarin e Përgjithshëm të saj që kishin drejtuar luftën dhe çuar popullin në fitore, që kishin zbatuar një vijë të

drejtë gjatë gjithë kohës së luftës, që kishin luftuar dhe mbrojtur rrugën marksiste-leniniste përsa i përket independencës së Partisë dhe të shtetit.

d) Të akuzonin Partinë tonë dhe udhëheqjen e saj në mënyrën më shpifarake, se gjoja vija e saj politike gjatë luftës ka qenë e gabuar, në pozita oportuniste karshi «Ballit Kombëtar», në pozita sektare etj.

Për t'ja mbërritur këtij qëllimi Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave influencoi një pjesë të udhëheqjes së Partisë sonë, e cila duke marrë si pretekst disa moskënaqësi personale dhe disa gabime e lëshime, që ishin vërtetuar gjatë kohës së luftës dhe që mund të zgjidheshin fare lehtë brenda rregullave të caktuara të Partisë, ra në pozitë e gabuara të Komitetit Central të Jugosllavisë.

→ Përfundimet e Plenumit II kanë qenë shumë negative për Partinë tonë:

a) U godit vija e drejtë e Partisë sonë.

b) U godit Komiteti Qendror i Partisë sonë dhe uniteti i tij.

c) U godit Sekretari i Përgjithshëm i Partisë sonë shoku Enver Hoxha, u godit njëkohësisht dhe pozita e tij në udhëheqjen e Partisë.

d) U pregatit terreni për nënshttrimin e Partisë dhe të udhëheqjes së saj në urdhërat e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave.

e) U futën në Partinë tonë format organizative antimarksiste-leniniste të udhëheqjes së Partisë Komuniste Jugosllave, metodat ushtarake në Parti, metodat puçiste, pikëpamjet oportuniste në vijën e Partisë, që ishin në gjak të udhëheqësve jugosllavë dhe që Sejfulla Malëshova do t'i mbronte veçanërisht derisa ai u hodh jashtë Partisë. U shkel centralizmi demokratik në Partinë tonë dhe u mbyt kritika dhe autokritika, u nxitën dhe u favorizuan pikëpamjet mikroborgjeze si ambicia, kryelartësia, arbitrarizmi, arroganca etj.

Gabimet e mëdha politike dhe organizative të Plenumit II patën si rezultat imediat që në etapën e rëndësishme të çlirimit të Shqipërisë Partia jonë kishte në krye një udhëheqje jomonolite, ku mungonte uniteti dhe besimi... Pozitat e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë ishin të minuara dhe mungonte besimi karshi tij. Një gjendje e tillë krijoi në udhëheqësit kryesorë të Byrosë tendencat e rrezikshme për të zënë de facto vendin e Sekretarit të Përgjithshëm, ose për të luajtur rolin e Sekretarit të Përgjithshëm. Në një terren të tillë të sëmure zunë vend dhe zhvilloheshin ambicia, karrierizmi, meritë personale, kritikë në planin personal, mosbesimi dhe në radhë të parë mosbesimi karshi Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë. Në një terren të tillë të sëmure mundi

oportunisti Sejfulla Malëshova të dëmtonte Partinë... Në një terren të tillë të sëmure Koçi Xoxe monopolizoi punët në duart e tija, duke nënvleftësuar dhe neglizhuar rolin e parë udhëheqës të Sekretarit të Përgjithshëm. Në një terren të tillë të sëmure u nënvleftësuan dhe u harruan meritat dhe roli i anëtarëve të tjerë të Byrosë dhe të Komitetit Qendror. Në Byro dhe në Komitetin Qendror s'kishte unitet, Komiteti Qendror dhe Byroja nuk e luanin rolin e vërtetë të tyre. Partia s'kishte drejtim unik, s'kishte në Parti centralizëm demokratik, s'kishte disiplinë të hekurt, s'kishte kritikë dhe autokritikë të shëndoshë bolshevike.

Në këtë periudhë Komiteti Qendror i Jugosllavisë me anën e delegatit të tij punoi pa u lodhur që të mbante gjallë një situatë të tillë, të favorshme për të dhe të rrezikshme për Partinë tonë.

Për ta çuar në rrugën e drejtë marksiste-leniniste udhëheqjen e Partisë sonë të çoroditur, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë shoku Enver Hoxha, paraqiti në muajin qershor 1946 përpara Byrosë Politike tezat e tija mbi revizionimin e Beratit. Përmbajtja e tezave të shokut Enver Hoxha që kishin për qëllim të ndreqnin sa më parë gabimet e bëra në Plenumin II [në mënyrë të përmbledhur] ishin këto:

1. Mosmarrëveshjet dhe grindjet në Byro dhe puna armiqësore e Sejfulla Malëshovës e kishin burimin në Plenumin II.

2. Puna e delegatit të Komitetit Qendror të Jugosllavisë ishte armiqësore.

3. Në Plenumin II u godit vija e drejtë e Partisë sonë, u godit udhëheqja dhe Sekretari i Përgjithshëm i Partisë.

4. Në Byronë tonë mungonte uniteti, kritika dhe autokritika.

5. Si rrjedhim i Plenumit të Beratit ka dalë çështja e spositimit në drejtimin e Partisë dhe është shfaqur dualizmi parti-pushtet.

6. Janë vërtetuar gabime organizative që duhet të ndreqen sa më parë.

Këto teza të drejta nuk u pranuan as nga Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo dhe as nga shoku Nako Spiru, në mes të të cilëve ka ekzistuar një grindje shumë e sëmure dhe jomarksiste. Këta tre shokë qëndruan në pozitat e vjetra të Plenumit II të Beratit dhe s'patën kurajën e duhur bolshevike të bënin kritikën dhe autokritikën e gabimeve të tyre politike dhe organizative të Plenumit II si dhe të bënin autokritikën e tyre përpara Byrosë Politike dhe Sekretarit të Përgjithshëm për punën e tyre të sëmure në prapaskenën e Plenumit II të Beratit. Një gjë e tillë shkaktoi që kritika të kalonte në planin personal dhe tezat e revizionimit të Beratit të mos kenë asnjë rezultat.

Shoku Nako Spiru bëri kthesë, ai u afrua më me besim drejt Sekretarit të Përgjithshëm dhe sido që shumë gjëra ai i shihte akoma në planin personal me një ambicie të sëmure, me disa

pikëpamje të gabuara në vijën e kuadrit dhe me një dozë pesimizmi, ai nuk do të gabonte më në vijën politike të Partisë. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo vazhduan më me kurajë vijën e gabuar, duke mos pasur besimin e duhur të Sekretari i Përgjithshëm, duke mos e kuptuar dhe përdorur si duhet armën e kritikës dhe të autokritikës dhe luftën e kontradiktave brenda në Parti, të cilën ata e kanë pas konsideruar kurdoherë në planin personal dhe të organizuar prej Nako Spirut kundër tyre. Kjo gjë ka bërë që këta të dy të gabojnë rëndë në vijën politike dhe organizative në Plenumin VIII të Komitetit Qendror.

Marrëdhëniet ekonomike dhe politike me Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë dhe me Partinë Komuniste të Jugosllavisë

Që në formimin e Partisë dhe deri në Plenumin VIII të Komitetit Qendror marrëdhëniet në mes të Partisë dhe të shtetit tonë, dhe Partisë Komuniste Jugosllave dhe shtetit jugosllav, janë shikuar nga ana jonë me besimin më të madh si marrëdhënie të drejta brenda kampit të socializmit dhe të demokracive popullore dhe kurdoherë nën prizmin e drejtë dhe tejpamës të politikës së Bashkimit Sovjetik, koka dhe zemra e kampit të socializmit në botë dhe shpëtimtari i popujve tanë nga robëria e rëndë e fashizmit. Por qëllimet e udhëheqjes jugosllave kanë qenë keq-bërëse karshi vendit tonë dhe marrëdhëniet në mes dy vendeve tona u shtrembëruan prej tyre me rrugë antimarksiste dhe anti-shqiptare.

1. — Vendi ynë i shkatërruar nga lufta dhe i varfër mund të rindërtohej dhe të ngrinte një ekonomi socialiste duke u ndihmuar nga Bashkimi Sovjetik në radhë të parë dhe demokracitë popullore në mes të të cilave [ishte dhe] Jugosllavia Federative, fqinja jonë. Kjo ndihmë na u dha nga Bashkimi Sovjetik nëpërmjet Jugosllavisë dhe kjo ndihmë do të realizohej pas nënshkrimit të Traktatit të miqësisë dhe të ndihmës reciproke që u nënshkrua më 9 korrik 1946 në mes Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë. Ky traktat ishte i drejtë. Si rrjedhim i këtij traktati u nënshkrua në mes të dy republikave tona konventa ekonomike që përcaktonte mënyrën e bashkëpunimit ekonomik dhe ndihmën që na akordohej nga Jugosllavia. Komiteti ynë Qendror i pranoi me besim të madh konventën ekonomike dhe format e kreditit dhe të bashkëpunimit, por ai ka kërkuar që të përcaktohen format e këtij krediti dhe ka kundërshtuar në praktikë zbatimin e protokolleve të unifikimit të çmimeve, të parifikimit të monedhës dhe të bashkimit doganor. Këto dhe protokollin për koordinimin e

planeve që u shtrembëruan në rrugën antimarksiste nga udhëheqja e partisë jugosllave përbënin armën për zhdukjen e independencës ekonomike dhe politike të vendit tonë, [që ishte] pikësynimi i grupit trockist të Titos.

Nën maskën e këtij krediti qëllimet e politikës së Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave kanë qenë antimarksiste, imperialiste, shfrytëzuese, koloniale në kurriz të popullit tonë.

[Këto qëllime ishin:]

a) Ekonomia jonë duhej të zhvillohej vetëm nën prizmin e ekonomisë jugosllave, e kondicionuar dhe e varur nga ajo.

b) Shfrytëzimi i pasurisë së nëntokës së vendit tonë duhej të shërbente për të furnizuar me material të parë Jugosllavinë dhe kështu të mos kishte asnjë perspektivë dhe mundësi industrializimi dhe elektrifikimi për vendin tonë.

c) Bujqësia jonë të mbetej pas dhe njëkohësisht të prodhonte ato kultura industriale, të cilat duhej të shërbenin si lëndë e parë për industrinë jugosllave.

d) Shqipëria të ishte në mëshirë të Jugosllavisë dhe të furnizohej me bukë dhe me artikuj të fabrikuar nga jashtë aq sa dëshironte Jugosllavia dhe me ato çmime që dëshironte ajo.

e) Që ky sistem shfrytëzues kapitalist dhe kolonial të ishte i plotë, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave u përpoq të izolonte vendin tonë politikisht dhe ekonomikisht nga Bashkimi Sovjetik dhe nga demokracitë e tjera popullore.

Viti 1947, që ishte viti i zbatimit në jetë të marrëdhënieve ekonomike me Republikën Popullore Federative Jugosllave ka qenë i karakterizuar me përpjekje dhe me luftë në mes të Komitetit Qendror të Partisë sonë që luftonte për mbrojtjen e independencës ekonomike dhe politike të vendit tonë kundër pikëpamjeve antimarksiste, antishqiptare, antisovjetike të grupit nacionalist të Titos që përpiqej të vendoste në vendin tonë regjimin kolonial. Lufta e drejtë e Komitetit Qendror të Partisë sonë u zhvillua në këto rrethana:

a) Përpjekjet e jashtzakonshme të Partisë sonë dhe të popullit tonë për të realizuar planin ekonomik të shtetit për vitin 1947 me forcat e tija dhe në luftë me sabotatorët dhe trockistët jugosllavë, në luftë me qeverinë e Republikës Federative të Jugosllavisë, e cila nuk mbante premtimin dhe shkelte marrëveshjen për realizimin e kreditit të dy miliardëve të akorduar shtetit tonë, kredit që u përdor prej grupit trockist të Titos për t'i bërë shantazhe dhe presione udhëheqjes së Partisë sonë dhe për ta diskredituar udhëheqjen e Partisë sonë përpara Partisë dhe popullit shqiptar.

Ky kredit nuk u realizua dhe ajo pjesë që u realizua s'erdhi kurrë në kohën e duhur.

b) Planin ekonomik i shtetit për vitin 1947 u realizua në një përqindje të kënaqshme nga entuziazmi dhe heroizmi i masave të Partisë dhe të popullit dhe nga ndihma e paçmueshme e këshilltarëve sovjetikë, të cilët i mësuan kuadrot tanë të kapërcenë vështirësitë, të luftojnë për popullin, të luftojnë për mbrojtjen e vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë; kështu ne fituam eksperiencë të shohim drejt dhe të luftojmë kundër sabotatorëve trockistë dhe kolonizatorëve jugosllavë.

c) Grupi trockist i Titos në këtë luftë parimesh me Komitetin tonë Qendror, në pamundësi të fitonte, filloi kërcënimin direkt karshi Komitetit Qendror të Partisë sonë, duke i bërë akuzën e parë se gjoja vija e Partisë sonë po shtrembërohej dhe në të kristalizohej një vijë e dytë. Byroja Politike e Partisë sonë, sido që mungonte uniteti, sido që disa shokë hezitonin në vendimet që merrte Byroja, e hodhi poshtë këtë akuzë të padrejtë të KQ të Partisë Komuniste Jugosllave.

Në krye të kësaj lufte parimore kundër tendencave shfrytëzuese koloniale të grupit të Titos ka qenë shoku Enver Hoxha, shoku Nako Spiru dhe mjaft shokë të tjerë të Byrosë dhe të Komitetit Qendror.

Në një situatë të tillë udhëheqja trockiste jugosllave pregatiti goditjen e poshtër kundër vijës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, kundër udhëheqësit të Partisë shokut Enver Hoxha dhe kundër shokut Nako Spiru.

Format e goditjes së grupit trockist të Titos dhe akuzat karshi Komitetit Qendror të Partisë sonë ishin këto:

1. — Partia jonë akuzohej haptazi pse luftonte për forcimin e marrëdhënieve të shumanshme dhe për shtimin e dashurisë për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Bolshevike dhe për shokun Stalin. Antisovjetizmi i pafrenuar i grupit trockist të Titos dhe i delegatëve të tij në Shqipëri u shfaq me brutalitetin më të egër në të gjithë sektorët, kundër këshilltarëve civilë dhe ushtarakë sovjetikë, kundër sistemit sovjetik, kundër marrëdhënieve ekonomike me Bashkimin Sovjetik. Trockistët jugosllavë akuzuan haptazi shokun Enver Hoxha se pas ardhjes së tij nga Moska ai e ndryshoi politikën karshi Jugosllavisë.

2. — Grupi trockist i Titos akuzoi Partinë tonë se kishte lejuar krijimin e një fronti antijugosllav në vendin tonë dhe si rrjedhim akuzonin qeverinë tonë se ajo bënte një politikë në lidhje me Jugosllavinë në kundërshtim diametral me aspiratat e popullit shqiptar. Ata akuzonin qeverinë tonë se kjo bënte një politikë shkapëputjeje nga Jugosllavia, politikë që kishte shkaktuar që marrëdhëniet në mes të popujve shqiptar dhe jugosllavë të ishin përtokë. Ata akuzonin qeverinë shqiptare se kishte hartuar një projektplan pesëvjeçar ireal dhe autarkik që e çonte ekonominë tonë në shkapëputje me ekonominë jugosllave. Ata e

akuzonin qeverinë tonë dhe Partinë tonë se në lëmin kultural orientohej drejt kulturës borgjeze perëndimore.

Grupi trockist i Titos akuzonte haptazi shokun Nako Spiru si bashkëpunëtor me armikun.

Qëllimet që kërkonte të arrinte udhëheqja tradhëtare e Partisë Komuniste Jugosllave me këtë akuzë të poshtër që i bënte Komitetit Qëndror të Partisë sonë ishin këto:

1. — Ta bënte vendin tonë një koloni të Jugosllavisë, ta vinte nën urdhërat e direktivat e Beogradit dhe t'i zhdukte independencën.

2. — Ta bënte Shqipërinë krejtësisht të varur politikisht dhe ekonomikisht nga Jugosllavia dhe ta shkëpuste nga kampi i socializmit, ta armiqësonte me Bashkimin Sovjetik, kokën e kampit demokratik dhe forcën më të madhe të tij, ta tërhiqte Partinë tonë dhe popullin tonë, në rrugën antimarksiste, antisovjetike.

3. — Nën presionin e shantazheve ekonomike dhe politike, nën forma të provokacioneve me karakter ndërkombëtar, nën presionin e frikshëm se gjoja Shqipëria kërcënohej nga imperialistët dhe monarko-fashistët grekë dhe se Bashkimi Sovjetik gjoja do ta sakrifikonte Shqipërinë përpara këtij rreziku iminent të pretenduar prej tyre, udhëheqësit trockistë jugosllavë kërkonin të shpejtonin në rrugën antimarksiste-leniniste dhe kundër vullnetit të popullit tonë bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, që kështu ta lidhnin vendin tonë në qerren e tradhëtisë së tyre.

4. — Për t'ua arritur këtyre qëllimeve grupi nacionalist i Titos duhej të mposhte vullnetin dhe pikëpamjet e drejta të Komitetit Qëndror të Partisë sonë dhe të shokut Enver Hoxha, në të cilin ata shihnin një pengesë të madhe. Grupi i Titos kërkonte të eliminonte bashkë me shokun Enver Hoxha dhe shokët Nako Spiru, Mehmet Shehu etj. që ishin solidarë dhe luftonin për vijën e drejtë politike të Partisë sonë dhe që udhëheqësit trockistë jugosllavë i konsideronin si një pengesë të madhe.

5. — Për t'ua arritur qëllimeve të tyre të poshtera djallëzore, grupi i Titos dhe përfaqësuesit e tyre zyrtarë në Shqipëri i bënin hesapet me situatën shumë të sëmurë dhe të ndeme që ekzistonte në Byronë Politike të Komitetit Qëndror të Partisë sonë, situatë që u detyrohej në radhë të parë intrigave të tyre të poshtera. Ata krijuan në Byronë tonë një psikozë të rëndë lufte dhe kërcënimesh, ata nxitën pasionet dhe mëritë, ata forcuan dyshimet dhe mosbesimin e Koçi Xoxes dhe të Pandi Kristos kundër shokëve Enver Hoxha, Nako Spiru etj., dhe këta të dy, Koçi Xoxe e Pandi Kristo, të influencuar jashtëzakonisht nga jugosllavët, ranë në gabimin e rëndë, ranë në kurthin e ngritur prej grupit nacionalist të Titos dhe u bënë luftëtarët më të

zjarhtë për mbrojtjen e kësaj vije armiqësore, antishqiptare, antisovjetike të jugosllavëve. Nga një situatë e tillë e krijuar dhe në rrethana shumë të vështira për të, të krijuara nga jugosllavët dhe nga Byroja Politike e Partisë sonë, shoku Nako Spiru nuk mundi të rezistonte ashtu si duhet të rezistojnë komunistët në situata të vështira. Nako Spiru ra viktimë e intrigës së madhe të jugosllavëve, ai vrau veten, gabim i rëndë nga ana e tij dhe i palejueshëm për komunistët. Vetëvrasja e Nako Spirut e dëmtoi rëndë Partinë dhe ajo ndihmoi pa dashje tezën armiqësore të jugosllavëve. Përpara këtyre presioneve dhe shantazheve, përpara këtyre evenimenteve tragjike që ngjisinin për herë të parë në kokën e Partisë sonë rezistenca e Byrosë Politike, e Komitetit Qëndror të Partisë sonë dhe e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë u përkul përpara vullnetit të grupit trockist të Titos.

Në këto rrethana Komiteti Qëndror i Partisë u mbledh në Plenumin VIII dhe aprovoi punën armiqësore të grupit trockist të Titos karshi Partisë sonë, vendit tonë dhe Bashkimin Sovjetik.

1. — Komiteti Central i Partisë sonë pranoi në bllok dhe pa diskutim akuzën e poshtër të jugosllavëve që i bënte Komitetit Qëndror të Partisë sonë dhe si rrjedhim u godit me ashpërsinë më të madhe vija e drejtë me të cilën ishte mobilizuar Partia dhe kishte korrur fitore.

2. — E gjithë lufta në Komitetin Qëndror të Partisë sonë në rrugën antimarksiste dhe në ato pozita ku dëshironin udhëheqësit trockistë jugosllavë, u drejtua jo në baza marksiste-leniniste por e dominuar nga pasionet kundër Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë dhe shokëve Nako Spiru, Mehmet Shehu, Fadil Paçrami etj.

3. — Shoku Nako Spiru që kishte gabuar në Plenumin II të Beratit, si dhe shokët e tjerë, por që më vonë mbrojti me vendosmëri të madhe interesat e popullit dhe të Partisë u akuzua aq rëndë saqë të kualifikohej si spiun. Disa të meta dhe gabime të tij të ndreqshme në një situatë të shëndoshë, disa mosmarrëveshje personale dhe pakënaqësi që ai shfaqte, kritikën që ai bënte mbi punën dhe mbi njerëzit, të gjitha këto u zmadhuan jashtëzakonisht dhe u ngritën në planin politik me forcë të madhe nga Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo. Mbrojtja e shëndoshë e interesave të popullit dhe të Partisë që kishte bërë Nako Spiru u kthyen kundër tij dhe u bënë akuza të rënda për të.

4. — U akuzuan rëndë shokët Mehmet Shehu etj., si bashkëpunëtorë të ngushtë të Nako Spirut, u akuzuan sikur i kishin bërë varrin Partisë, kishin goditur vijën e Partisë...

5. — Sekretari i Përgjithshëm i Partisë shoku Enver Hoxha, që kishte mbrojtur dhe luftuar për vijën e drejtë të Partisë u akuzua se kishte gabuar rëndë, se kishte lejuar Nako Spirun me shokë të godisnin Partinë dhe vijën e drejtë të saj, se ai ishte qind për qind nën influencën e Nako Spirut. Rezistenca dhe luf-

ta e shokut Enver Hoxha kundër grupit të Titos që synonte të zhdukte independencën e Partisë dhe të vendit u kthyen kundër tij. Për të dytën herë Sekretari i Përgjithshëm i Partisë po goditej prej udhëheqjes trockiste jugosllave.

6. — Koçi Xoxe që i dha tonin analizës së Plenumit VIII formuloi në këtë plenum tezën e ekzistencës së një fraksioni të rrezikshëm me të gjitha tiparet në kokën e Partisë që do të thotë: Nako Spiru dhe shokët e tjerë kishin organizuar një fraksion të rrezikshëm kundër Partisë, nën hundën e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë. Nuk u përcaktua se Sekretari i Përgjithshëm i Partisë shoku Enver Hoxha ishte fraksionist, por ajo kuptohej vetëvetiu, në krye të fraksionit të pretenduar ishte Sekretari i Përgjithshëm i Partisë.

7. — Para dhe pas analizës u pregatit dhe u mobilizua Partia që të pranonte tezat e gabuara të Plenumit VIII me fjalime para Shkollës së Partisë dhe gjithë Partisë duke dhënë alarme për një situatë false në Parti dhe duke mbjellë pikëpamje të rrezikshme antisovjetike, të cilat do të shfaqeshin në forma të ndryshme pas analizës së Plenumit VIII.

Rezultatet e Plenumit VIII të Komitetit Central

Rezolucioni i Plenumit VIII të Komitetit Central e orientoi Partinë në rrugën e gabuar dhe për një kohë vija e Partisë u shtrembërua dhe kthesën e madhe në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, Partia jonë ja detyron letrave të Partisë Bolshevike. . .

[Këto letra hodhën dritë në këto drejtime:]

1. Vija politike dhe ekonomike e adoptuar në Plenumin VIII ishte krejtësisht e gabuar, antishqiptare, antimarksiste dhe antisovjetike.

2. Akuzat e grupit trockist të Titos ishin shpifje, shantazhe dhe kishin për qëllim kolonizimin e Shqipërisë me metoda fashiste, imperialiste.

3. Plenumi VIII dhe rezolucioni i tij e çonin Partinë dhe popullin tonë në pozitë antisovjetike dhe në rrugën e solidarizimit me grupin trockist të Titos.

4. Ekzistenca e një fraksioni në kokën e Partisë ishte një bllof shumë i rrezikshëm.

5. Plenumi VIII dhe rezolucioni i tij goditën unitetin e Partisë, centralizmin demokratik, demokracinë e brendshme të Partisë, mbytën kritikën dhe autokritikën, forcuan metodat ushtarake në udhëheqje, forcuan kontrollin e organeve të sigurimit mbi Partinë, shkelën parimet organizative të Partisë dhe e shtynin shtetin tonë në rrugën e një shteti policor. Organet e Sigu-

rimit të Shtetit, arma shumë e vlefshme dhe e dashur e Partisë sonë, u çuan në një rrugë të shtrembër dhe të dëmshme.

6. Plenumi VIII dhe rezolucioni i tij akuzuan rëndë, për fajë që s'i kishte bërë, shokun Enver Hoxha, e diskredituan atë në syrin e Partisë, tronditën pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm. Kjo ishte etapa e parë e dëshiruar prej grupit trockist të Titos.

7. Plenumi VIII dhe rezolucioni i tij krijuan në Parti një psikozë jomarksiste karshi intelektualëve komunistë, të cilët shiheshin të dyshimtë sikur këta ishin kundër klasës punëtore dhe kështu Partia orientohej në rrugën sektare në politikën mbi kuadrin.

8. Nga një punë e tillë armiqësore e Komitetit Qendror të Jugosllavisë, Partia jonë humbi një shok të mirë udhëheqës, Nako Spirun, i cili me gjithë të metat e tija dhe gabimet që do t'i ndreqeshin, do t'i jepte shërbime të mëdha vendit dhe Partisë sonë.

9. Plenumi VIII dhe rezolucioni i tij ishin një fitore për trockistët jugosllavë, të cilët e bënë Komitetin Qendror të Partisë sonë të pranojë forma organizimi të tilla ekonomike që çonin në likuidimin e qeverisë sonë dhe në vendosjen e një qeverie tranzitore nën drejtimin e trockistëve jugosllavë.

10. Plenumi VIII dhe rezolucioni i tij e bënë Komitetin Qendror të Partisë sonë të pranojë unifikimin e Ushtrisë Shqiptare me atë jugosllave dhe të fillohen në praktikë veprimet në këtë drejtim.

11. Fitorja e jugosllavëve nuk do të vazhdonte shumë kohë, se Komiteti Qendror i Partisë sonë filloi të dyshojë mbi qëllimet armiqësore të udhëheqësve trockistë jugosllavë. Shoku Koçi Xoxe që në atë kohë filloi kthesën e tij dhe ai u solidarizua me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë dhe me Byronë Politike për të rifilluar rezistencën kundër qëllimeve të grupit trockist të Titos. Kjo rezistencë nga Byroja Politike dhe Komiteti Qendror vajti kurdoherë duke u shtuar dhe mori me të vërtetë formën e ashpër dhe të drejtë me ardhjen e letrave të Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik.

12. Në këto dallgë të mëdha, Partia jonë dhe populli ynë nuk e humbën për asnjë moment orientimin mbi aleancën me popujt vëllezër të Jugosllavisë. Partia jonë dhe populli ynë ditën të ndajnë popujt e Jugosllavisë nga grupi fraksionist trockist i Titos.

Partia jonë dhe populli ynë do ta ruajnë dhe do ta forcojnë dita-ditës më shumë aleancën dhe vëllazërimin me popujt e

1 Koçi Xoxe për të mbuluar veprimet e tij armiqësore e për të ruajtur pozitën e tija në Parti bëri sikur u solidarizua me Sekretarin e Përgjithshëm, shokun Enver Hoxha.

Jugosllavisë, me të cilët na bashkoi lufta dhe gjaku i derdhur së toku, për lirinë, independencën dhe demokracinë e vërtetë.

Në këto momente të rënda që kalojnë popujt e Jugosllavisë dhe shokët marksistë internacionalistë jugosllavë, duhet të jenë të sigurtë për besnikërinë e madhe të Partisë dhe të popullit tonë karshi tyre dhe në të mirën e tyre, në të mirën tonë, në të mirën e kampit të socializmit dhe, për të mbrojtur parimet e marksizëm-leninizmit, ne do të forcojmë luftën dita-ditës më shumë kundër grupit fraksionist trockist të Titos, shërbëtor të imperializmit.

Plenumi XI konstaton:

Si konsekuencë e paevitueshme e marrëdhënieve tona me Jugosllavinë, e influencës direkte të udhëheqjes trockiste jugosllave mbi udhëheqjen e Partisë sonë dhe besimit të tepruar të udhëheqjes sonë në udhëheqjen e Partisë Komuniste Jugosllave, janë vërtetuar gabime të mëdha organizative.

1. — Megjithëse në jetën e saj, Partia jonë ka pasur një vijë dhe një orientim të drejtë, pas Plenumit VIII, vija politike e Partisë në këtë drejtim është dëmtuar nga shfaqje antisovjetike të influencuara nga udhëheqja jugosllave.

a) Shfaqjet antisovjetike kanë qenë të dukshme në Drejtorinë politike të Ushtrisë, e cila ka qenë nën influencën e madhe të jugosllavëve dhe e orientuar në punë nga ana e tyre. Orientimi i Drejtorisë politike të Ushtrisë nën influencën e trockistëve jugosllavë kishte për qëllim zhdukjen e independencës së ushtrisë dhe të vendit tonë, nënvleftësimin e rolit të Ushtrisë Sovjetike dhe rolit të Bashkimit Sovjetik, largimin e këshilltarëve sovjetikë. Drejtoria politike e Ushtrisë sonë ka qenë në përpjekje me Shtatmadhorinë, e cila orientohej drejt në çështjet politike-ushtarake dhe mbronte vijën e drejtë të Partisë në sektorin ushtarak. Përgjegjësia kryesore për gabimet e rënda siç ishin shfaqjet e antisovjetizmit në sektorin ushtarak i bien, në radhë të parë shokut Kristo Themelko, anëtar i Byrosë Politike dhe shef i Drejtorisë politike dhe pastaj shokut Pullumb Dishnica, nëndrejtor i Drejtorisë politike.

b) Nga ana e Komisionit të Kontrollit të Shtetit tonë është firmuar së bashku me një komision të kontrollit i dërguar prej udhëheqjes jugosllave, për të kontrolluar shoqëritë e përbashkëta, një dokument me rëndësi antishqiptar, antimarksist, antisovjetik. Përgjegjësia për këtë gabim të rëndë i bie Pandi Kristos dhe rëndohet më tepër, pse këtë gjë Pandi Kristo e bëri pa aprovimin e Byrosë Politike.

c) Nën presionin e shantazheve ekonomike të bëra nga ju-

gosllavët Byroja Politike e Partisë sonë, pa qenë aspak e bindur, pranoi sugjerimin jugosllav për largimin e këshilltarëve civilë sovjetikë nga vendi ynë, duke pranuar vetëm qëndrimin e teknikëve civilë sovjetikë. Është për t'u shënuar se Byroja Politike me shokun Enver Hoxha në krye nuk pranuan, me gjithë presionet e grupit të Titos, të largoheshin këshilltarët ushtarakë sovjetikë nga vendi ynë. Duhet shënuar gjithashtu se këto shfaqje antisovjetike nuk e kanë prekur aspak Partinë tonë dhe popullin tonë, të cilët kurdoherë janë orientuar nga Bashkimi Sovjetik dhe kanë shtuar dashurinë për Partinë Bolshevike dhe për shokun tonë të madh Stalin.

2. — Nga të gjitha gabimet e vërtetuara në Partinë tonë ato më të rëndat dhe që kanë dëmtuar më tepër Partinë janë vërtetuar në vijën organizative të Partisë sonë, vijë që ka qenë gati e njëjlojtë me vijën organizative të Partisë Komuniste Jugosllave. Për këto gabime të rënda në çështjen e kuadrit dhe në vijën organizative Koçi Xoxe ka një përgjegjësi të madhe.

a) Gabimi i madh ka qenë fakti që sekretari organizativ i Partisë ka qenë njëkohësisht dhe ministër i brendshëm dhe kjo formë organizative antimarksiste ka dëmtuar vijën organizative të Partisë. Sekretari organizativ i Partisë u vu në pozita të privileguara, centralizoi punën në duart e tija dhe u spostua roli drejtues i Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë dhe Partia u vu në fakt nën kontrollin e Sigurimit të Shtetit. Kjo formë organizative ka bërë që në Parti të dobësohet vigjilenca revolucionare që ajo të zëvendësohet me informacionin policor, ka krijuar frikën në anëtarët e Partisë, ka dëmtuar demokracinë e brendshme në Parti dhe ka mbytur kritikën dhe autokritikën, janë futur metodat ushtarake në udhëheqje, ka cënuar principin themelor mbi të cilin ndërtohet Partia, centralizmin demokratik, ka nxitur megalomaninë dhe ndjenjën e privilegjit në shumë shokë të Sigurimit të Shtetit, organet e të cilit kanë mbërritur të kontrollojnë organet e Partisë dhe anëtarët e saj. Kjo formë organizative ka bërë që në Partinë tonë të shfaqet burókracia, të duken shfaqje arrivizmi dhe servilizmi.

b) Në Partinë tonë nuk janë bërë kurdoherë zgjedhjet demokratike të organeve drejtuese që nga poshtë-lart dhe sidomos mbas çlirimit të vendit zgjedhjet janë zëvendësuar me emërimet dhe kooptime. Kooptime janë bërë edhe në Komitetin Qendror.

c) Komiteti Qendror nuk ka funksionuar si organi kryesor drejtues dhe është nënvleftësuar roli i tij nga ana e Byrosë Politike.

d) Organet drejtuese të Partisë nuk kanë dhënë llogari rregullisht para organizatës për aktivitetin e tyre dhe kur kjo është bërë ka munguar kritika dhe autokritika e shëndoshë.

e) Disiplina në Partinë tonë nuk ka qenë e hekurt dhe ko-

shiente, por më tepër mekanike dhe kjo ngjiste se mungonte demokracia e brendshme, kritika dhe autokritika bolshevike.

f) Në shumë raste merreshin nëpër këmbë të drejtat e anëtarit të Partisë, të cilit nuk i dëgjohej zëri nga përgjegjësi dhe nuk inkurajohej dhe mësohej sa duhej në punë.

3. — Në Partinë tonë nuk i është dhënë një rëndësi e duhur punës kolektive, sidomos në udhëheqjen e Partisë. Kjo ka bërë që në udhëheqje të bëhet një punë personale dhe jo e drejtë. Një metodë pune e tillë në Byronë Politike dhe në Komitetin Qendror ka shkaktuar që puna organizative e Partisë t'i shpëtojë kontrollit të shëndoshë të Byrosë Politike, të Komitetit Qendror dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë dhe të zgjidhet çështja e kuadrit në mënyrë personale. Një punë e tillë në Byronë Politike ka pasur refleksat e saj dhe poshtë në Parti. ↘

4. — Në politikën e kuadrove janë vërtetuar dhe gabime, si mungesa e një pune të shëndoshë për edukimin e kuadrove, mosshpërndarja me një kriter të shëndoshë e kuadrove, mostrajtimi i mirë i kuadrit dhe është praktikuar një politikë e ngushtë e njohjeve personale për caktimin e kuadrove në funksione të ndryshme.

5. — Në udhëheqjen e Partisë sonë ka munguar uniteti i shëndoshë përpara Plenumit VIII dhe pas Plenumit VIII. Para Plenumit VIII për këtë mungesë uniteti, kanë faj shokët Nako Spiru, Koçi Xoxe, Pandi Kristo dhe pas Plenumit VIII faji rëndon mbi shokët Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo, të cilët duke qenë luftëtarë të zjarrtë për mbrojtjen e pikëpamjeve jugosllave, izoluan dhe ulën rolin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë dhe dolën si shpëtimtarë të situatës, si shpëtimtarë të Partisë nga fraksioni në kokë të Partisë, i cili nuk ka ekzistuar në Parti.

6. — Në Partinë tonë ka munguar një punë e shëndoshë sistematike për ngritjen e nivelit ideologjik të anëtarëve të Partisë. Nuk është kuptuar sa duhet se

«Pa teori revolucionare nuk mund të ketë as lëvizje revolucionare»¹,

siç na mëson Lenini. Nuk është përfitur sa duhet nga eksperiencia e Partisë Bolshevike për punën ideo-politike. Puna e agjitacionit dhe e propagandës ka qenë mjaft e dobët sidomos në fshat.

7. — Përsa i përket luftës së klasave, Partia jonë e ka pasur kurdoherë të qartë dhe tek ne lufta e klasave është ashpërsuar çdo ditë e më tepër dhe se rruga e tranzicionit nga kapitalizmi në socializëm kalon nëpërmjet një ashpërsimi të paevitueshëm të luftës së klasave, ashpërsim i cili vjen duke u shtuar dhe jo

¹ V.I. Lenin. Veprat, vëll. 5, f. 434.

duke u pakësuar¹. Megjithatë tek ne janë vërtetuar disa gabime, të influencuara direkt nga trockistët jugosllavë, si p.sh. në çështjen e kooperativave fshatare të punës ne jemi bazuar në sistemin kooperativist të gabuar jugosllav. Kështu ka ndodhur që në kooperativat fshatare të punës, puna bëhet kolektive, porse ndarja e fitimeve nuk bëhet plotësisht në bazë të punës, por vetëm 60 për qind në bazë të punës dhe 40 për qind në bazë të tokës, gjë që nuk është aspak e drejtë nga ana parimore dhe i le rast spekulimit dhe lindjes së kapitalizmit në gjirin e kooperativave. Ne nuk e kemi nacionalizuar tokën me ligj, sido që efektivisht me ligj është ndaluar shitja dhe blerja e tokës. Nga ana tjetër duhet shënuar se në sistemin e tatimeve mbi ekonomitë bujqësore deri në këto kohët e fundit, proporcioni nuk ka qenë i drejtë, sepse rëndonte më tepër fshatarin e varfër se sa atë të pasur duke i lënë kështu shteg privilegji pasurimit të fshatarit të pasur dhe spekulimit në fshat.

8. — Në çështjen e rolit drejtues të Partisë, Partia jonë nuk ka gabuar në parim dhe e ka konsideruar Partinë kurdoherë si avangardën e proletariatit dhe si forcën kryesore të vendit dhe të Frontit Demokratik. Përsa i përket Frontit Partia jonë e ka konsideruar kurdoherë si organizatën e gjerë të masave punëtore, fshatare dhe intelektuale patriote nën drejtimin e Partisë. Por ne duhet të njohim gabimin se këtë princip të madh, me format organizative të huara nga organizimi i frontit në Jugosllavi, e kemi errësuar. Ne kemi gabuar duke mbajtur Partinë në gjendjen e gjysmëilegalitetit, nuk kemi dalë haptazi me flamurin e Partisë; vendimet e Partisë nuk publikoheshin, ne kemi fshehur nga populli titullin e anëtarit të Partisë dhe i kemi fshehur zyrat e Partisë nën zyrat e Frontit.

9. — Është për t'u shënuar gjithashtu se edhe pas letrave

¹ Partia e ka shikuar gjithnjë luftën e klasave si një forcë kryesore lëvizëse të shoqërisë gjatë gjithë periudhës kalimtare nga kapitalizmi në socializëm, si një fenomen objektiv që lidhet me praninë e klasave shfrytëzuese apo të mbeturinave të tyre, me ekzistencën e imperializmit dhe të agjentëve të imperializmit, me ekzistencën e sektorit të gjerë të prodhuesve të vegjël, me ekzistencën e mbeturinave borgjeze e mikroborgjeze në ndërgjegjen e njerëzve.

Teza, sipas së cilës lufta e klasave gjatë periudhës kalimtare nga kapitalizmi në socializëm ashpërsohet është saktësuar më pas nga përvoja e zhvillimit të ndërtimit socialist në vendin tonë dhe në vendet e tjera. Kjo përvojë vërteton se lufta e klasave zhvillohet me zigzage, herë ulet, herë ngrihet, herë zbutet, herë ashpërsohet në përputhje me rezistencën që bëjnë armiqtë e klasës si brenda dhe jashtë vendit, por asnjëherë nuk ndërpritet e nuk shuhet.

të Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik dhe Rezolucionit të Byrosë Informative, është dashur një përpjekje e madhe dhe e gjatë nga ana e Byrosë Politike, për t'ua bërë të kuptueshme këto letra historike shokëve të Byrosë, që kishin gabuar dhe që qëndronin në pozitat e vjetra përsa u përket gabimeve të vërtetuara brenda në Parti. Gjithashtu edhe pas shtruarjes së këtyre letrave dhe të Rezolutës së Informbyrosë nga ana e Komitetit Qendror gjithë Partisë sonë, shumë shokë të Partisë dhe sidomos udhëheqës nuk e kanë kuptuar si duhet situatën, ata kanë vazhduar në pikëpamjet e gabuara të Plenumit VIII dhe kanë vazhduar dhe vazhdojnë të bëjnë gabime.

10. — Goditja e padrejtë që i është bërë në shumë raste Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë ka dëmtuar rëndë udhëheqjen dhe Partinë dhe kjo ka sjellë si rezultat pikëpamjen krejtësisht të gabuar të rolit unik të drejtimin të Partisë sonë. U krijua opinioni në Parti se kjo ka dy udhëheqës, shokun Enver Hoxha dhe Koçi Xoxen dhe i pari drejton shtetin, i dyti drejton Partinë. Një pikëpamje e tillë është antiparti. Partinë tonë e drejton Komiteti Qendror dhe në krye të Partisë nuk ka dy udhëheqës, por një udhëheqës, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë. Të gjithë të tjerët janë sekretarë të Partisë ose anëtarë të Komitetit Qendror dhe të Byrosë dhe të gjithë tok bëjnë drejtimin unik të Partisë: Komitetin Qendror...

Duke marrë parasysh të gjitha konstatimet dhe konsideracionet e mësipërme, gjendjen në të cilën jeton dhe vepron si dhe objektivat që duhet të mbërrijë Partia jonë në gjendjen e sotme dhe në të ardhshmen,

Plenumi XI vendosi:

1. — Të mobilizohen të gjitha organizatat e Partisë për t'u shpjeguar gjerë masave punonjëse rolin e vërtetë si dje në luftë dhe sot në paqe të Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike dhe Stalinit të madh.

a) Të edukohen të gjithë anëtarët e Partisë dhe organizatat e Frontit Demokratik, i gjithë populli shqiptar me frymën e besnikërisë ndaj Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike e shokut Stalin, sepse ata janë shpëtimtarët e njerëzimit nga skllavëria fashiste, mbrojtësit e paqes dhe të demokracisë, koka drejtuese e kampit demokratik, antiimperialist dhe shpëtimtarët e vendit tonë...

b) Të përvetësojmë sa më tepër eksperiencën e Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Bolshevike, në të gjitha drejtimet e Partisë e të vendit tonë, ta aplikojmë atë eksperiencë në konditat tona, të ndjekim me besnikëri mësimet e udhëheqësit e të më-

suesit të madh të proletarietit ndërkombëtar, mikut më të shtrenjtë të Partisë dhe të popullit tonë, Josif Visarionoviq Stalinit.

2. — Të mobilizohen të gjitha organizatat e Partisë për t'u shpjeguar masave punonjëse zhvillimin e gjendjes ndërkombëtare, për të shtuar vazhdimisht urrejtjen kundrejt armikut të njerëzimit, armikut më të madh të vendit tonë, kundër imperializmit anglo-amerikan, pasardhësit besnik të Hitlerit që përpiqet të skllavërojë botën me anën e një lufte të re botërore.

3. — Të mobilizohen të gjitha organizatat e Partisë për t'u skjaruar sa më mirë masave punonjëse tradhëtinë ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj kampit unik socialist, ndaj çështjes së internacionalizmit proletar nga ana e udhëheqjes trockiste nacionaliste të Partisë Komuniste jugosllave me Titon në krye; t'u skjarohen masave qëllimet grabitqare dhe veprimtaria djallëzore dhe e poshtër ndaj vendit tonë nga ana e udhëheqjes tradhëtare jugosllave, përpjekjet e Partisë sonë kundër politikës së Titos si edhe ndihmën shpëtimtare që na ka dhënë Partia Bolshevike dhe vetë Stalini i madh për të dalë nga kthetrat e grupit trockist të Titos për ta vënë Partinë e vendin tonë në rrugën e vërtetë, në rrugën e Partisë Bolshevike të Bashkimit Sovjetik.

4. — Për të zhdukur prapambetjen politike dhe ideologjike të Partisë sonë duhet të bëhet një punë sistematike nga të gjitha organet dhe organizatat e Partisë për përvetësimin e bazave të marksizëm-leninizmit, për përforcimin e ndërgjegjes komuniste të anëtarëve të Partisë, për njohjen e ligjeve të zhvillimit ekonomik-shoqëror.

a) Të përforcohen e të perfeksionohen kurset e Partisë që ekzistojnë dhe të çelen edhe kurse të tjera. Të zgjerohet dhe të perfeksionohet Shkolla e Partisë.

b) Të forcohet puna edukative ideo-politike për të gjitha organizatat e Partisë me anë të studimit sistematik të pandërprerë të Historisë së Partisë Bolshevike, të bazave të marksizëm-leninizmit, të Statutit dhe të programit të Partisë, të ligjeve themelore të kalimit prej kapitalizmit në socializëm në vendin tonë. Të përdoret metoda e studimit individual si një metodë frytdhënëse në përvetësimin e teorisë marksiste-leniniste nga kuadrot e avancuar të Partisë duke filluar që nga anëtarët e Byrosë Politike e të Komitetit Qendror të Partisë.

c) Byroja Politike të organizojë studimin shkencor të realitetit të vendit tonë nga pikëpamja marksiste-leniniste për të skjaruar më mirë Partinë mbi gjendjen dhe zhvillimin e luftës së klasave në vendin tonë, mbi spostimin e forcave të klasave dhe mbi konditat konkrete të kalimit të vendit tonë nga kapitalizmi në socializëm.

c) Të fillohet puna për nxjerrjen e Historisë së Partisë sonë nga një komision që do të caktojë Byroja Politike.

d) Të rifillohet botimi i përditshëm i «Zërit të Popullit», organ i Komitetit Qendror të Partisë.

e) Arësimi popullor të bazojë gjithë punën e vet në teorinë marksiste-leniniste dhe të shkohet me shpejtësi drejt likuidimit të të gjitha teksteve të vjetra e drejt zëvendësimit të tyre me tekste të reja të bazuara në eksperiencën e Bashkimit Sovjetik dhe në konditat tona; të intensifikohet lufta kundër konceptioneve borgjeze dhe antimarksiste ndër shkollat e vendit.

5. — Të legalizohet menjëherë Partia jonë Komuniste si parti udhëheqëse e klasës punëtore, si forca e vetme drejtuese e të gjithë aktivitetit të vendit tonë dhe që e drejton vendin për në socializëm.

6. — Të vendosen sa më shpejt parimet marksiste-leniniste në strukturën dhe në jetën e brendshme të Partisë, këto parime të zbatohen me rigorozitet dhe të luftohet hezitimi kundër çdo tentative që synon në shkeljen e këtyre parimeve.

a) Të ndahet funksioni i sekretarit organizativ të Partisë nga funksioni i ministrit të brendshëm. Funksioni i ministrit të brendshëm të konsiderohet si një funksion shtetëror që kontrollohet dhe udhëhiqet nga Partia dhe jo si një funksion i organizatës së Partisë që të kontrollojë Partinë, siç ka qenë praktikuar deri më sot.

b) Të zbatohet principi i centralizmit demokratik si principi kryesor mbi të cilin ndërtohet Partia, i cili konsiston në zgjedhshmërinë e të gjitha organeve drejtuese të Partisë prej poshtë lart, në dhënien llogari nga koha në kohë prej organeve drejtuese para organizatave që i kanë zgjedhur e që ata drejtojnë, mbi të gjithë aktivitetin e tyre, në ruajtjen e disiplinës së hekurt të Partisë me nënshtrimin e pakicës ndaj shumicës dhe në detyrimin e organeve inferiore për t'ju bindur pa kondita organeve superiore.

c) Të zhduken menjëherë shfaqjet jomarksiste, por burokratike, policore dhe vdekjeprurëse për Partinë në jetën e brendshme të Partisë, duke u vendosur demokracia e brendshme në të gjitha organizatat e Partisë, ku të respektohen plotësisht të gjitha detyrat dhe të drejtat e anëtarit të Partisë në bazë të Statutit të Partisë, ku të gjitha çështjet e Partisë të zgjidhen në bazë të kritikës dhe autokritikës bolshevike nga poshtë-lart dhe lart-poshtë, ku anëtari i Partisë ta ndjejë veten si në shtëpinë e vet dhe të mos ndjejë asnjë druajtje për të kritikuar cilindo funksionar të Partisë, ku të mos ushtrohet asnjë represion moral mbi anëtarin e Partisë kur ky kritikon drejt, ku të çelmoset disiplina e ndërgjegjshme dhe jomekanike, në bazë të demokracisë së brendshme nga e cila ajo buron.

c) Të zhduket metoda primitive e zgjidhjes së çështjeve të Partisë nën prizmin personal, duke u nisur nga pozita jo marksiste dhe dëmprurëse për jetën e Partisë, duke u nisur nga paragjykime e prapamendime mikroborgjeze. Të vendoset metoda marksiste në zgjidhjen e të gjitha çështjeve të Partisë, në bazë të parimeve marksiste të Partisë, në bazë të kritikës dhe autokritikës së shëndoshë, në bazë të centralizmit demokratik. Vlerësimi i veprimtarisë së anëtarit të Partisë të bëhet në bazë të fakteve, si ai ka mbrojtur ose e ka dëmtuar vijën e Partisë me veprimtarinë e tij dhe jo në bazë të paragjykimeve personale, prapanike, mikroborgjeze.

d) Të bëhet kongresi I i Partisë, siç u vendos në Plenumin X në të cilin do të marrin pjesë delegatë nga të gjitha organizatat e Partisë të zgjedhur demokratikisht. Kongresi do të shqyrtojë të gjithë aktivitetin e Komitetit Qendror e gjendjen e brendshme të Partisë, do të aprovojë Statutin e programin e Partisë, do të caktojë vijën politike dhe organizative të Partisë për periudhën e ardhshme dhe do të zgjedhë Komitetin Qendror të ri. Pas Kongresit menjëherë do të bëhen zgjedhjet e përgjithshme të të gjitha organeve drejtuese në Parti përveç Komitetit Qendror që do të zgjidhet në Kongresin I.

e) Të forcohet vigjilenca revolucionare, për të ruajtur Partinë nga veprimtaria e armiqve të jashtëm ose të brendshëm të Partisë. Informacioni në Parti të mos transformohet në një informacion policor, por të jetë një informacion i shëndoshë marksist që t'i vlejë Partisë për të njohur se si zbatohet vija e saj. Vigjilenca revolucionare duhet të kuptohet si një detyrë e çdo anëtari të Partisë për të ruajtur zbatimin e vijës së Partisë dhe të principeve marksiste në jetën dhe veprimtarinë e Partisë. Të jesh vigjilent do të thotë të zbulosh punën armike në shtrembërimin e vijës dhe principeve të Partisë.

f) Të përforcohen lidhjet e Partisë me masat e gjera punonjëse, anëtari i Partisë duhet të mësojë si të dëgjojë zërin e punëtorit dhe të fshatarit punonjës, të kuptojë gjendjen dhe nevojat e tyre dhe t'u përgjigjet me kohë. Për të përforcuar lidhjet me masat punonjëse organizatat e Partisë duhet të drejtojnë më me vendosmëri luftën e klasave, ato duhet të kuptojnë mirë se në periudhën tranzitore prej kapitalizmit në socializëm është e paevitueshme dhe e domosdoshme lufta e klasave meqë armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm të demokracive popullore dhe të socializmit nuk do t'i ndalojnë për asnjë çast përpjekjet dhe orvatjet e tyre për të penguar zhvillimin e vendit tonë drejt socializmit, për të përmbysur pushtetin tonë popullor dhe për të vendosur regjimin e tyre kapitalist. Organizatat e Partisë, çdo anëtar partie duhet të jetë në krye të kësaj lufte, të luajë rolin e vet drejtues, anëtari i Partisë duhet të zhvishet nga të gjitha

të metat personale, mbeturinat mikroborgjeze që mund të jenë akoma në personin e tij, si ambicia, egoizmi, fodullëku etj. Anëtarin e Partisë duhet të fitojë simpatinë e masave, t'i mësojë dhe të mësojë prej tyre e t'i drejtojë ato në vijën që përcakton Partia.

g) Të vendoset uniteti marksist në udhëheqjen e Partisë, uniteti i cili të bazohet në parimin e zgjidhjes së çështjeve të Partisë në bazë të kritikës dhe autokritikës së shëndoshë dhe jo në baza të kalburave të pozitave personale. Të forcohet metoda kolektive e udhëheqjes në Parti dhe të luftohet metoda primitive dhe dëmprurëse e udhëheqjes individuale. Të bëhet një ndarje më e mirë pune dhe të aktivizohen të gjithë anëtarët e kandidatët e Komitetit Qendror. Komiteti Qendror duhet të mbledhet rregullisht për të shqyrtuar punët e Byrosë Politike, të mbledhen rregullisht konferencat e Partisë dhe aktivet e Partisë gjithashtu shihet e nevojshme. Metoda e aktiveve duhet të përdoret drejt, aktivet të bëhen efektive ku të gjykohen konkretisht punët e Partisë dhe jo të transformohen në mitingje për të aprovuar solemnisht raportet që jep udhëheqja. Të gjitha çështjet me rëndësi të Partisë duhet më parë të gjykohen nga anëtarët e forumit dhe [pastaj] të aprovohen nga forumet. Bashkë me udhëheqjen kolektive duhet të forcohet dhe ndjenja e përgjegjësisë personale e çdo udhëheqësi. Komiteti Qendror duhet të informojë rregullisht Partinë mbi vendimet e marrura me anë letrash të posaçme dhe të publikohen vendimet e Partisë.

7. — E gjithë Partia duhet të organizohet në punën e saj praktike për të mobilizuar masat e gjera punonjëse për zbatimin e tejkalimit e planit të shtetit, me qëllim që të forcohet potenciali ekonomik i vendit tonë dhe të ngrihet standardi i jetesës së masave punonjëse. Anëtarët e Partisë duhet të jenë të parët që të hidhen në sulm për realizimin e planit, ata duhet të jenë shembull për të gjithë në përmbushjen e detyrave të tyre.

8. — Organizatat e Partisë duhet të mobilizohen për të forcuar bashkimin e masave të gjera punonjëse në Frontin Demokratik si organizatë e masave punëtoare, fshatare e intelektuale patriotike nën udhëheqjen e Partisë. Organizatat e Partisë duhet të punojnë për forcimin e aleancës midis klasës punëtoare dhe fshatarësisë së varfër dhe të mesme në luftën për realizimin e planit të shtetit, për shkatërrimin e klasave shfrytëzuese, për të shkuar në socializëm. Organizatat e Partisë duhet të mobilizohen për të forcuar organizatat e sindikatave, të rinisë, të gruas:

a) Të kuptohet drejt dhe mirë se me një punë sa më të shëndoshë të Partisë në organizatat sindikale, aq më të fuqishme dhe më të afta do të jenë këto për forcimin e vazhdueshëm të klasës sonë punëtoare në rolin e saj si mbështetja dhe forca kryesore e Partisë, si baza e Pushtetit tonë Popullor dhe si udhëheqësja e masave punonjëse të vendit. Organizatat sindi-

kale të bëhen shkolla e komunizmit për edukimin e klasës punëtoare me parimet marksiste-leniniste. Ato të bëhen organizatat e fuqishme të klasës punëtoare për mobilizimin e saj më të gjerë për planin e shtetit, për jetën e re, për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

b) Të shihet dhe të çmohet drejt e mirë lufta dhe puna e rinisë, të inkurajohen cilësitë e mira të saja të fituara në Luftën nacional-çlirimtare dhe sot në punë nën drejtimin e Partisë sonë. Të shihet rinia si pjesa më e afërt, më e vendosur dhe më e dashur për Partinë që kërkon një vëmendje të madhe dhe një punë të kujdesshme të Partisë. Të tregohet një kujdes i veçantë për edukimin e përgjithshëm të rinisë mbi bazën e marksizëm-leninizmit dhe një vëmendje e madhe për jetën dhe dëfrimet e saj. Të inkurajohet rinia për mobilizim më të madh për planin e shtetit. Të punohet me perspektivën e unifikimit të dy organizatave, për forcimin e organizatës së Rinisë Popullore.

c) Detyra e organizatave të Partisë me gruan është ta aktivizojë dhe ta rritë vazhdimisht pjesëmarrjen e saj në prodhim dhe në jetën politike, kulturele të vendit, të forcojë rolin e saj në pushtet, industri, bujqësi etj. Të punohet pa u lodhur që gratë të shkëputen nga mbeturinat e së kaluarës, zakonet prapanike që pengojnë përparimin e tyre: të luftohet me ashpërsi për likuidimin e analfabetizmit. T'i kushtohet një kujdes i madh ngritjes kulturele të nënave. Të shëndoshen radhët e Partisë me aktivistet më të mira të organizatës së gruas dhe të tregohet shumë kujdes për lartësimin e grave në Parti.

9. — Duhet të forcohet kujdesi dhe dashuria e Partisë dhe e popullit ndaj ushtrisë sonë, e cila është roja besnike e interesave të popullit. Të zhvillohet dhe të forcohet ushtria, duke u bazuar në eksperiencën e madhe të Ushtrisë së lavdishme Sovjetike dhe të edukohet politikisht dhe ideologjikisht në bazë të shkencës së marksizëm-leninizmit.

10. — Duhet të zhvillohet më tepër dhe në mënyrë më sistematike puna e agjitacionit dhe e propagandës për të zhvilluar ndërgjegjen e masave punonjëse.

11. — Të shikohen të gjitha ligjet dhe urdhëresat dhe literatura në përdorim për të zhdukur çdo gjë që reflekton influencën e eksperiencës së udhëheqjes trockiste jugosllave dhe të bazohen në eksperiencën sovjetike e në konditat tona.

12. — Të hiqet nga qarkullimi Rezolucioni i Plenumit VIII të Komitetit Qendror si një rezolucion i gabuar, antimarksist, antisovjetik, antishqiptar si dhe çdo material që ka të bëjë me këtë rezolucion.

13. — Shoku Nako Spiru të konsiderohet si viktimë e intrigave të poshtira të udhëheqjes trockiste nacionaliste jugosllave

dhe që ka mbrojtur vijën e Partisë kundër qëllimeve të poshtra të grupit trockist të Titos dhe që e ka dashur Bashkimin Sovjetik.

Duke analizuar imtësisht situatën brenda në Partinë tonë, rrezikun e madh nga ku ka kaluar Partia jonë nga armiqësia e udhëheqjes jugosllave dhe nga prapambetja ideologjike dhe mbeturinat mikroborgjeze në njerëzit e Partisë sonë; duke analizuar gabimet e rënda që janë vërtetuar në Partinë tonë, duke kërkuar dhe gjetur shkaqet e këtyre gabimeve dhe njëkohësisht duke gjetur mënyrën e drejtë për t'i korrigjuar këto gabime, mbasi përcaktoi mirë përgjegjësinë kolektive dhe individuale për gabimet e bëra dhe mbasi caktoi detyrat që i dalin përpara Partisë për të realizuar kthesën e domosdoshme dhe shpëtimtare, Plenumi XI vendosi dhe mori këto masa që kanë një karakter edukativ:

a) Për arsye se ka qenë më i predispozuar dhe i influencuar në veprimtarinë e tij nga udhëheqja tradhëtare e Partisë Komuniste Jugosllave; për arsye se ka gabuar rëndë në vijën politike dhe organizative në Plenumin II të Komitetit Qendror në Berat dhe në Plenumin VIII dhe me gabimet e tij ka dëmtuar rëndë Partinë, se duke i kuptuar me zor gabimet e tij, autokritika e tij para Komitetit Qendror nuk ka qenë ashtu e plotë dhe e hapët siç duhet të jetë autokritika e një udhëheqësi kryesor të Partisë, por duke marrë parasysh edhe shërbimet e mira që i ka bërë Partisë në të kaluarën, shoku Koçi Xoxe shkarkohet nga detyra si sekretar organizativ i Partisë duke mbetur anëtar i Byrosë Politike të Komitetit Qendror¹.

b) Për arsye se ka qenë shumë i influencuar në veprimtarinë e tij nga udhëheqja tradhëtare e Partisë Komuniste Jugosllave dhe se në veprimtarinë e tij ka bërë gabime të rënda që

1 Në Plenumin XI të KQ të PKSH Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo nuk u përjashtuan nga Komiteti Qendror, sepse akoma nuk ishte njohur thellë veprimtaria armiqësore, krimet e tyre në kurriz të popullit e të Partisë. Plenumi u jepte atyre mundësinë që të thelloheshin në njohjen e fajeve, të bënin autokritikë komuniste dhe të futeshin në rrugën e përmirësimit.

Mirëpo pas plenumit aktivet dhe organizatat e Partisë nxuarën në shesh një numër të madh faktesh të reja që vërtetonin veprimtarinë e tyre kriminale. Nga ana tjetër Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo në vend që të njihnin hapur fajet e tyre të rënda, mbajtën një qëndrim për-buzës, armiqësor kundrejt kritikave të shumta të komunistëve. Kongresi I i PKSH, duke marrë parasysh gjithë këto rrethana dhe vullnetin e Partisë i përjashtoi ata nga Partia. Koçi Xoxe e Pandi Kristo u gjykuan si armiq të popullit nga Gjykata e Lartë e RPSH dhe muarën ndëshkimet e merituar.

kanë dëmtuar rëndë Partinë, se gabimet e tij i ka kuptuar me shumë zor dhe akoma nuk paraqitet i kjartë në të kuptuarit e tyre, se autokritika e tij para Komitetit Qendror nuk ka qenë e shëndoshë dhe e kjartë, se kontributi i tij si anëtar i Byrosë Politike nuk ka qenë i mjaftueshëm, Pandi Kristo hiqet nga Byroja Politike dhe mbetet anëtar i Komitetit Qendror.

c) Për arsye se ka qenë një nga më të influencuarit nga udhëheqja antimarksiste jugosllave, se ka zbatuar pa rezerva direktivat e udhëheqjes jugosllave në sektorin e ushtrisë, se ka bërë gabime që e kanë dëmtuar vijën e Partisë në ushtri, porse ka bërë para Komitetit Qendror një autokritikë të ndershme dhe të shëndoshë dhe i ka kuptuar mirë gabimet e tij, shokut Kristo Themelko¹ i hiqet vërejtje e rëndë me shënim në biografi.

ç) Për arsye se ka qenë një nga më të influencuarit nga politika e udhëheqjes antimarksiste jugosllave në sektorin e ushtrisë, se ka bërë gabime që e kanë dëmtuar vijën e Partisë në ushtri, porse ka bërë para Komitetit Qendror autokritikë, Pullumb Dishnicës² i hiqet vërejtje e rëndë me shënim në biografi.

d) Për arsye se si kandidat i Byrosë Politike i kooptuar me rastin dhe në frymën e Plenumit VIII ka qenë i javashëm në kuptimin e letrave të Partisë Bolshevike dhe të gabimeve të brendshme dhe se kritika dhe autokritika e tij para Komitetit Qendror ka qenë e ngurtë dhe hezituese, Xhoxhi Blushi³ shkarkohet si kandidat i Byrosë Politike dhe mbetet anëtar i Komitetit Qendror.

dh) Për të korrigjuar vendimet e padrejta të Plenumit VIII dhe vetëm për arsye se janë ngritur në funksione në një situatë të sëmurë, me rastin dhe frymën e Plenumit VIII, por që nuk kanë bërë ndonjë gabim ose faj, të gjithë ata shokë, kandidatë dhe anëtarë të Komitetit Qendror që u ngritën në funksione, të ulen në funksionet e mëparshme që kanë pasur në Komitetin Qendror dhe të gjithë ata shokë që erdhën me kooptime si kandidatë ose anëtarë të rinj të Komitetit Qendror me rastin dhe frymën e Plenumit VIII, porse nuk kanë bërë ndonjë gabim ose faj përjashtohen nga Komiteti Qendror.

1 Kristo Themelko i pranoi gabimet e veta dhe bëri autokritikë përpara Partisë pasi u zbulua plotësisht tradhëtia e udhëheqjes së PK të Jugosllavisë në qershor 1948.

2 Pullumb Dishnica në Kongresin I të PKSH nuk u zgjodh anëtar i Plenumit të KQ. Më vonë ai e vazhdoi veprimtarinë e tij armiqësore dhe antiparti; për këtë u përjashtua edhe nga Partia.

3 Xhoxhi Blushi në Kongresin I të PKSH nuk u zgjodh anëtar i Plenumit të KQ, por ai, si anëtar partie, eci dhe punon në rrugën e Partisë.

e) ... Bedri Spahiu bëhet përsëri anëtar i Byrosë Politike¹.
ë)... Tuk Jakova caktohet sekretar i Partisë për kuadrot (sekretar organizativ)².

f) Mbasni nga rezultati i analizës së Plenumit XI, i bërë në dritën e letrave të Partisë Bolshevike, vërtetohet se dënimet që u genë dhënë me rastin e Plenumit VIII sikur të ishin fraksionistë e armiq të Partisë, janë krejtësisht të padrejta... shoku Mehmet Shehu dhe shoqja Liri Belishova rikthehen si kandidatë të Komitetit Qendror që ishin më parë.

g) Pasi vendimet e Plenumit VIII kanë qenë krejtësisht të gabuara, masat që janë marrë në frymën e sëmurë të Plenumit VIII karshi anëtarëve të tjerë të Partisë të hiqen dhe të gjithë ata anëtarë partie të dënuar padrejtësisht të rikthehen në gjirin e Partisë.

*Botohet sipas broshurës:
«Rezolucioni i Plenumit XI
të Komitetit Qendror të Partisë
Komuniste Shqiptare»
Tiranë, 1948*

1 Kongresi II i PPSH duke marrë parasysh gabimet e rënda që Bedri Spahiu kishte bërë në të kaluarën nuk e zgjodhi atë anëtar të Byrosë Politike të KQ të PPSH, por e zgjodhi vetëm anëtar të KQ të PPSH. Bedri Spahiu jo vetëm që nuk bëri asnjë përpjekje për të ndrequr gabimet e së kaluarës, por vazhdoi veprimtarinë e tij armiqësore kundër Partisë; për këtë në Plenumin e KQ në qershor 1955, ai u përjashtua nga radhët e Partisë. (Shih Rezolucionin e Plenumit të qershorit 1955 të KQ të PPSH, i cili botohet në vëllimin II të Dokumentave kryesore të Partisë).

2 Plenumi IX i KQ të PPSH i vitit 1951 duke marrë parasysh veprimtarinë oportuniste të Tuk Jakovës vendosi shkarkimin e tij si sekretar i Komitetit Qendror të Partisë, e përjashtoi atë nga Byroja Politike duke e lënë si anëtar të Komitetit Qendror të PPSH. Tuk Jakova nuk diti të vlerësojë ndihmën që i dha Partia për të ndrequr gabimet e tij të rënda dhe vazhdoi veprimtarinë e tij armiqësore kundër Partisë. Për këtë në Plenumin e KQ në qershor të vitit 1955 Tuk Jakova u përjashtua nga Komiteti Qendror dhe më vonë nga Partia. (Shih Plenumin IX të KQ të PPSH të vitit 1951 dhe Plenumin e Qershorit të vitit 1955, rezolucionet e të cilëve botohen në vëllimin II të Dokumentave kryesore të Partisë).

DEKLARATË E KOMITETIT CENTRAL TË PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE ME ANËN E SË CILËS HIDHEN POSHTË SHPIFJET E KOMITETIT CENTRAL TË PARTISË KOMUNISTE TË MAQEDONISË

Shtator 1948

Agjencia «Tanjug» më datë 12 korrik 1948 dha Rezolutën e Komitetit Central të Partisë Komuniste të Maqedonisë kundër Byrosë Informative, ku midis të tjerave thuhej:

«Ne protestojmë gjithashtu kundër deklaratës dhe qëndrimit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, që ka fyer në mënyrë brutale partinë dhe popujt tanë.

Deklaratat dhe mënyrat e veprimit të udhëheqjeve të Partive Komuniste të Bullgarisë dhe të Shqipërisë janë një përkrahje e drejtëpërdrejtë që u jepet mbeturinave të elementëve reaksionarë bullgaromëdhënij dhe shqiptaromëdhënij në vendin tonë, duke u sjellë në këtë mënyrë dëme të paçmuarshme vendit tonë dhe kauzës së marrëdhënies miqësore midis shtetit tonë nga një anë dhe Republikës Popullore të Bullgarisë, Republikës Popullore të Shqipërisë nga ana tjetër. Me një luftë të pamëshirshme kundër të gjitha orvatjeve për ringjalljen e veprimtarisë së këtyre elementëve bullgaromëdhënij dhe shqiptaromëdhënij, ne do të bëjmë të mundur jo vetëm ndërtimin efektiv të socializmit në vendin tonë, por do të provojmë edhe një herë vendosmërinë tonë të patundur për të mbajtur marrëdhënie vëllazërore dhe miqësore me popujt e Bullgarisë dhe të Shqipërisë, mbi bazën e të drejtave të barabarta dhe do të provojmë në këtë mënyrë se ne jemi realizuesit konsekuentë dhe pa kompromis të politikës së internacionalizmit».

Deklarata e Komitetit Central të Partisë Komuniste të Maqedonisë është një dokument antishqiptar dhe antimarksist i bërë me qëllime të caktuara nga klika nacionaliste, trockiste e Titos me shokë.

Ky dokument ka për qëllim t'i mashtrojë popujt e Jugosllavisë dhe Partinë Komuniste Jugosllave mbi tragjedinë e tmerrshme që luhet në kurrizin e tyre nga ana e klikës nacionaliste të Titos me shokë, të shpifë poshtërisht karshi Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare duke e akuzuar për «një politikë shoviniste shqiptaromadhe» dhe të forcojë kësisoj pozitën nacionaliste të klikës së Titos duke armiqësuar popujt vëllezër të Jugosllavisë Federative Popullore me popullin shqiptar dhe me minoritetin shqiptar që jeton në Jugosllavi.

Akuzohemi se me deklaratën tonë të datës 1.VII.1948 gjoja kemi pasur për qëllim të nxisim elementët shovinistë shqiptarë të Kosovës, të Metohisë dhe të Maqedonisë kundër Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë. Një shpifje e tillë nuk do të gënjejë asnjëri dhe as nuk do të fshehë tradhëtinë e udhëheqësve trockistë jugosllavë dhe rrugën e tyre antimarksiste, antisovjetike, antishqiptare dhe kundër kampit të socializmit.

Partia Komuniste Shqiptare ka vuajtur shumë nga këto pikëpamje antimarksiste të Komitetit Central të Partisë Komuniste Jugosllave. Që në kohën e luftës dhe deri sot, Komiteti Central i Partisë Jugosllave, është përpjekur të krijojë një opinion të gabuar se gjoja ai ka qenë faktori kryesor i zhvillimit të drejtë të luftës të popullit tonë dhe se ka shpëtuar Partinë tonë nga disa pikëpamje të rrezikshme oportuniste ku kishin rënë gjoja udhëheqësit e Partisë sonë. Të tilla mburrje të marra dhe shpifje të poshtra janë karakteristikë jo e komunistëve, por e trockistëve dhe këto mund të gënjejnë për një kohë vetëm ata që s'janë në korrent të zhvillimit të luftës së popullit tonë dhe të Partisë sonë, pse realiteti qëndron krejt ndryshe.

Partia jonë Komuniste doli nga gjiri i popullit të vuajtur dhe luftoi për çlirimin e popullit shqiptar me heroizmin më të madh. Triumfin për jetën e saj dhe të popullit të saj, Partia jonë e lidhi në mënyrë të pazgjidhshme me luftën e Bashkimit Sovjetik e të Partisë Bolshevike. Partia jonë e re i dha provat dhe përmbushi me nder detyrën e vet të vështirë dhe militantët e rinj të Partisë sonë fituan në luftë një eksperiencë të madhe dhe luftuan me vetëmohim se në gjirin e tyre ziente lufta e lirisë shekullore e popullit tonë, në supet e tyre rëndonin vuajtjet dhe mizerjet e papërshkruara të popullit tonë, në zemrat e tyre vlonte dashuria për popullin e tyre, për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Bolshevike, për të madhin Lenin dhe për shokun e shtrenjtë Stalin. Partia jonë sytë dhe zemrën i kishte te Bashkimi Sovjetik, ajo ecte në shembullin e Ushtrisë famëmadhe të Kuqe dhe militantët e Partisë Komuniste Shqiptare dhe gjithë luftëtarët e popullit shqiptar u çelnikosën në luftime duke pasur kurdoherë parasysh mësimet dhe eksperiencën e pakufishme të Partisë së lavdishme Bolshevike, mësimet e Leninit dhe të Stalinit të madh.

Kështu e drejtoi Partia jonë popullin në fitore dhe këta janë nga faktorët e jashtëm kryesorë të krijimit të Partisë sonë, të forcimit të saj, të fitores së popullit dhe jo udhëheqësit trockistë të Komitetit Central të Partisë Komuniste Jugosllave. Por ajo përfitoi gjithashtu edhe nga eksperiencia e luftës së popujve të Jugosllavisë dhe të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Jugosllave gjatë luftës, duke qenë e bindur se lufta e popujve të Jugosllavisë ka qenë një luftë e drejtë dhe format organizative të asaj kohe kanë qenë në rrugën e drejtë. Komunistët shqiptarë me plot gojën e pohojnë këtë, por ndihma e pretenduar e Komitetit Central të Jugosllavisë, me të cilën mburren megalomanët trockistë të Beogradit, ka qenë e një natyre tjetër dhe me qëllime jo të pastra. Partia jonë që me formimin e saj luftoi pa u gabuar në rrugën e drejtë marksiste-leniniste-staliniane dhe pati suksese të pamohueshme, ajo luftoi dhe ruajti independencën e vet me tërë kuptimin e vërtetë të fjalës dhe njëkohësisht punoi dhe zhvilloi në masat e gjera të popullit një dashuri të sinqertë dhe të pastër për popujt e Jugosllavisë. Në këtë rrugë u rrit Partia jonë dhe në këtë rrugë do të zhvillohej edhe demokracia popullore në Shqipëri. Kjo gjë nuk i interesonte Komitetit Central të [Partisë Komuniste] Jugosllave. Komiteti Central i Partisë Komuniste Jugosllave nuk dëshironte që Partia jonë të mbronte një pikëpamje të tillë përse ai përket independencës së saj, por ai dëshironte të kishte në Shqipëri një parti komuniste që t'i nënshtrohej urdhërave të tij. Kjo natyrisht do të sillte me vete dhe nënshttrimin e popullit shqiptar dhe nënshttrimin e Republikës së ardhshme Popullore të Shqipërisë. Shkurt, Komiteti Central i Jugosllavisë që në atë kohë i kishte braktisur traditat internacionaliste të tij dhe ishte vënë në rrugën nacionaliste borgjeze, në rrugën antimarksiste dhe përpiquej që Partia Komuniste Shqiptare dhe Shqipëria e ardhshme, e re të ishin një bisht i Partisë Komuniste Jugosllave dhe i Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë. Në Kongresin e pestë Tito përmendi në mes të tjerash emrin e komunistit jugosllav Miladin Popoviçit si një aktivist që ka ndihmuar Partinë tonë Komuniste. Miladin Popoviçi, anëtar i Partisë Komuniste Jugosllave, i kapur nga forcat fashiste italiane në Kosovë e Metohi, u çlirua nga kampet e përqëndrimit në Shqipëri prej guerrileve shqiptare. Miladini vuri të gjitha forcat e tija për të ndihmuar Partinë dhe popullin tonë dhe ky u rrit me luftën e Partisë sonë dhe të popullit tonë dhe këtë [luftë] ai e shikonte, sikundër e shikonte e gjithë Partia jonë: nën prizmin e luftës të Bashkimit Sovjetik. Këtë gjë Partia jonë s'ja harron kurrë Miladin Popoviçit. Por Titua dhe shokët e tij fshehin diçka shumë të rëndësishme që nuk ja thanë kongresit [të tyre të pestë] dhe kjo është se Titua dhe Komiteti Central i Jugosllavisë kanë qenë gjatë gjithë kohës së luftës dhe deri në fund (me gjithë dekorimin e Miladinit me

«Urdhërin e Heroit të popujve të Jugosllavisë») në kundërshtim të hapët me pikëpamjet e Miladin Popoviçit. Klika trockiste e Beogradit e di fare mirë se Titua s'ka qenë dakord me pikëpamjet e Miladin Popoviçit dhe se ky i fundit ka qenë në kundërshtim të hapët me delegatët e ndryshëm të Komitetit Central të Jugosllavisë që kanë ardhur herë pas here në Shqipëri ose që kanë qenë në Jugosllavi, si gjeneral Milutinoviç, Bllazho Jovanoviç, Sfetozar Vukmanoviç, Velimir Stoiniç e të tjerë. Ku qëndronin këto kundërshtime? Këto ishin parimore siç [ishte] çështja kryesore e indipendencës së Partisë sonë. Miladin Popoviçi mbronte si komunist internacionalist me këmbëngulje pikëpamjet e Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare. Për Komitetin Central të Jugosllavisë Miladin Popoviçi ishte «një rrebel» që nuk u bindej verbërisht urdhërave të tyre. Miladin Popoviçin, në prakun e çlirimit të Shqipërisë, kur ai do të shihte realizimin e veprës së Partisë Komuniste Shqiptare, në shërbim të së cilës vuri forcat e trupit dhe të shpirtit të tij, Komiteti Central i Jugosllavisë në mënyrë të turpshme e thirri nga Shqipëria dhe e dënoi poshtërisht këtë shok që përfaqësonte denjësisht traditën internacionaliste të Partisë Komuniste Jugosllave. Miladin Popoviçi u vra tradhëtisht dhe në mënyrë misterioze në Kosovë e Metohi nga dora e një shovinisti shqiptar kosovar. Partia jonë nuk u vu në korrent mbi këtë çështje nga Komiteti Central i Jugosllavisë meqenëse ajo e konsideron Miladin Popoviçin si një pjesëtar heroik të saj dhe e nderon kujtimin e djalit të popullit të Malit të Zi dhe të Partisë Komuniste Jugosllave, si një komunist internacionalist që shërbeu në radhët e luftëtarëve më të shquar të popullit shqiptar.

Komiteti Central i Jugosllavisë për të zhdukur indipendencën e Partisë sonë, gjatë kohës së luftës është përpjekur të diskreditojë dhe të përçajë udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë. Shpifjet e Vukmanoviç Tempos, në Kongresin e pestë të Partisë Komuniste Jugosllave se gjoja udhëheqësit shqiptarë kanë qenë në pozita oportuniste me «Ballin», janë gënjeshtër të turpshme dhe Komiteti ynë Central që në atë kohë i ka përbuzur pikëpamjet e këtij antimarksisti jugosllav. Kurrë Komiteti ynë Central nuk ka qenë në pozita oportuniste me «Ballin Kombëtar». Partia jonë dhe populli ynë i dinë mirë qëndrimet tona karshi «Ballit». Të tilla shpifje janë bërë edhe tjetër herë prej delegatëve të Komitetit Central të Jugosllavisë. Ata vetë i dinin që s'ishin të vërteta këto akuza, por ata ishin të bindur vetëm për një «gabim» që bënte Komiteti Central i Partisë Komuniste Shqiptare që nuk u nënshtrohej urdhërave të tyre.

Pakënaqësinë për një situatë të tillë, udhëheqësit trockistë të Partisë Komuniste Jugosllave e shfaqën haptazi që në ditët e para të çlirimit të plotë të Shqipërisë. Me anë të delegatit të

tyre, ata, në mënyrë të palejueshme e të padrejtë ndërhyjnë direkt në punët e brendshme të Partisë dhe me intriga e me një punë antiparti goditën udhëheqjen e Partisë sonë, unitetin e Komitetit Central të Partisë sonë dhe krijuan një situatë të rëndë ku ata mund të manevronin më lehtë për qëllimet e tyre. Qëllimet e tyre ishin po ato të vjetrat, të dobësonin Komitetin Central të Partisë sonë, ta bënin atë një vegël të bindur që të zbatonte qëllimet antimarksiste, antisovjetike dhe antishqiptare të mëvonshme të Komitetit Central të Jugosllavisë. Duke shpërdoruar besimin që kishin njerëzit e Partisë sonë karshi Partisë Komuniste Jugosllave dhe pasi e krijuan një situatë të tillë të rëndë në Komitetin Central, ata kërkuan me anë të delegatit të tyre t'i dorëzoheshin të gjitha raportet që i vinin K[omitetit] C[entral] të P[artisë] K[omuniste] Sh[qiptare], nga organizatat e saja, ata kërkuan të kishin anëtarë të partisë së tyre në forumet e ndryshme të Rinisë Komuniste Shqiptare e të tjera ekzigjenca të tilla. Këto kërkesa shumë të çuditshme nuk u pranuan dhe u hodhën poshtë nga Komiteti Central i Partisë sonë, por vetëm Komiteti Central i Partisë Komuniste Jugosllave nuk i hodhi armët, ai ndërroi vetëm taktikë dhe nën shenjën e aleancës dhe të ndihmës reciproke u përpoq të mposhtë vullnetin e Partisë sonë. Qëllimet e drejta të aleancës dhe të ndihmës ekonomike u shtrembëruan nga Komiteti Central i Partisë Komuniste Jugosllave dhe ky i zhvilloi në rrugën kapitaliste, shfrytëzuese, koloniale në kurriz të popullit tonë. Klika nacionaliste e Titos synonte që Shqipëria të bëhej një republikë e shtatë e Jugosllavisë dhe të mposhteshin kështu pikëpamjet e drejta të Partisë sonë që luftonte për zhvillimin dhe ndërtimin e drejtë të socializmit në vendin tonë dhe për forcimin dita-ditës e më shumë të aleancës dhe të miqësisë me popujt e Jugosllavisë. Në parim edhe në praktikë pra, në lidhje me marrëdhëniet me Republikën Popullore të Shqipërisë dhe Partinë Komuniste të saj vija e Komitetit Central të Partisë Komuniste Jugosllave ka qenë në rrugën antimarksiste. Janë të njohura dhe të argumentuara kërcënimet, shantazhet, presionet ekonomike e të tjera të bëra karshi Partisë sonë dhe popullit tonë nga ana e Komitetit Central të Partisë Komuniste Jugosllave.

Nga ana tjetër pikëpamjet antisovjetike të udhëheqësve jugosllavë u manifestuan haptazi në vendin tonë. Komiteti Central i Jugosllavisë me anën e delegatëve të tij në Shqipëri, Josip Gjergja, Savo Zilatiç, gjeneral Kupreshanin, Drago Kosmerli, kolonel Spiro Sergjentiç etj. [bëri] po ato shpifje të poshtër që përdori në Jugosllavi, karshi këshilltarëve ushtarakë dhe civilë sovjetikë që ndihmonin popullin shqiptar në ndërtimin e socializmit dhe kjo dëshmon kjartë se antisovjetizmi në kuadrot e lartë jugosllavë ishte bërë një vijë. Delegatët e Titos në Shqipëri arritën deri atje sa të thonë haptazi se Bashkimi Sovjetik «do t'ua sakrifikojë Shqipë-

rinë imperialistëve» dhe barazonin kësisoj politikën e jashtme të Bashkimit Sovjetik me politikën e njerëzve të Munihut.

Populli shqiptar dhe Partia Komuniste e Shqipërisë i detyron Bashkimit Sovjetik fitoren, pse pa Bashkimin Sovjetik dhe pa luftën e tij populli ynë nuk do të çlirohej, ashtu sikundër edhe shumë popuj të tjerë, prandaj Bashkimi Sovjetik adhurohet në vendin tonë. Komiteti Central i Jugosllavisë me delegatët e tij në Shqipëri i quanin të rrezikshme dhe të dëmshme këtë dashuri të pakufishme dhe këto ndjenja të pastra që ushqenin Partia dhe populli ynë karshi Bashkimit Sovjetik. Komiteti Central i Jugosllavisë përpiquej që në vendin tonë dashuria për Bashkimin Sovjetik të ishte një gjë formale. Komiteti Central i Jugosllavisë me anë të delegatëve të tij për të luftuar këtë dashuri për Bashkimin Sovjetik, zyrtarisht bënin deklaratat se gjoja politika e qeverisë dhe e Partisë sonë karshi Jugosllavisë ishte ndryshuar. Kjo është e kurtë. Të duash Bashkimin Sovjetik, për Komitetin Central të Jugosllavisë, do të thotë të bësh një politikë kundër Jugosllavisë. Këto xheste armiqësore, antimarksiste dhe antisovjetike që pasoheshin me presione ekonomike, kishin për qëllim të izolonin Republikën Popullore të Shqipërisë nga Bashkimi Sovjetik dhe kampi demokratik antiimperialist, kishin për qëllim të zhvillonin dhe të shtonin luftën kundër Bashkimit Sovjetik dhe Partisë Bolshevike, kishin për qëllim të mposhtnin vullnetin e Partisë sonë dhe ta tërhiqnin atë në rrugën e tradhëtisë ku po ecte klika e Titos me shokë, kishin për qëllim ta bënin Shqipërinë një republikë të shtatë të Jugosllavisë dhe ta vinin në rrugën jo të drejtë marksiste-leniniste. Por Partia jonë i luftoi këto pikëpamje antimarksiste, antisovjetike dhe antishqiptare të trockistëve të Beogradit. Kolishevski¹ dhe Komiteti Central i Partisë Komuniste të Maqedonisë duhet të dijnë se këto dhe shumë të tjera të kësaj natyre janë arësyet që Komiteti Central i Partisë sonë dhe gjithë Partia jonë u solidarizuan me Partinë e lavdishme të Lenin-Stalinit, me Rezolucionin e Informbyrosë, kundër klikës tradhëtare të Titos. Sa të drejta dhe shpëtimtare janë kritikata e Partisë Bolshevike që ju bënë Komitetit Central të Partisë Komuniste Jugosllave, Partia Komuniste Shqiptare është një nga ato parti që mund të dëshmojë haptazi për ekzistencën e këtyre gabimeve. Partia jonë i ndjeu thellë këto kritika të drejta dhe i kuptoi drejt sido që nuk i ishin drejtuar asaj. Disa nga këto gabime që ka bërë Komiteti Central i Jugosllavisë, dhe që paturpësisht e me demagogji të madhe trockistët e Beogradit i mohojnë; janë pasqyruar edhe në Partinë tonë pse na janë shitur nga ana

¹ Lllazar Kolishevski në atë kohë ishte sekretar i Komitetit ekzekutiv të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Maqedonisë.

e tyre. Komiteti ynë Central nuk i fsheh këto gabime, por i njeh me ndershmërinë më të madhe dhe po i ndreq.

Partia jonë është një nga dëshmitaret e gabimeve të udhëheqjes tradhëtare të Jugosllavisë. Komiteti Central i Partisë Komuniste Jugosllave është përpjekur të futë në Partinë tonë metoda ushtarake në udhëheqje, të përçajë udhëheqjen, të na shesë forma oportuniste që synonin dobësimin e Partisë dhe të Republikës sonë Popullore, të na shesë forma organizative që shtypnin demokracinë e brendshme të Partisë që mbytnin kritikën dhe autokritikën etj. Por këto pikëpamje antimarksiste nuk kanë zënë rrënjë në Partinë tonë. Partia jonë e shëndoshë me nuhatje nuk lejoi që të zmadhoheshin këto gabime sikundër ngjau në Jugosllavi, praktika dhe lufta e përditshme e Partisë sonë s'i lejoi që këto gabime të huaja për të, të trasheshin. Dhe me plot të drejtë Partia jonë i është mirënjohëse përjetë Partisë Bolshevike që i hapi sytë për të korrigjuar këto gabime të rënda që mund të bëheshin të rrezikshme sikundër u bënë në Jugosllavi, por nga ana tjetër i është mirënjohëse Partisë Bolshevike që e shpëtoi nga kthetrat e klikës trockiste të Beogradit.

Lllazar Kolishevski dhe Komiteti Central i Partisë Komuniste të Maqedonisë shpifin poshtërisht kur thonë se Komiteti Central i Partisë Komuniste Shqiptare bën «një politikë shoviniste shqiptaromadhe» se «nxit elementët shovinistë shqiptarë të Kosovës dhe Metohisë kundër Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë». Një shpifje të tillë Komiteti Central i Partisë Komuniste Shqiptare e hedh poshtë me përbuzjen më të madhe, sepse qëndrimi i Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare karshi Kosovës dhe minoritetit shqiptar në Maqedoni ka qenë nga më të qartët dhe në rrugën e drejtë marksiste-leniniste që nga fillimi i luftës dhe deri tashti. Qëndrimi i Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare karshi Kosovës [ka qenë i drejtë që] gjatë luftës, në momentet më të vështira, kur okupatori dhe tradhëtarët e «Ballit Kombëtar» e vinin këtë çështje në radhën e parë dhe e përdornin këtë si një armë nga më të rëndësishmet kundër Partisë sonë dhe kundër Luftës nacional-çlirimtare të popullit tonë. Komiteti Central i Partisë Komuniste Shqiptare luftoi me heroizëm për vijën e drejtë marksiste-leniniste-staliniane në lidhje me problemin e minoriteteve. Komiteti ynë Central e edukoi Partinë dhe popullin shqiptar, u dha gjithashtu të kuptojnë shqiptarëve në Kosovë, Metohi dhe Maqedoni se cila ishte rruga e drejtë që ata duhej të ndiqnin. Partia jonë i tha popullit shqiptar se tash duhej luftuar me ashpërsinë më të madhe dhe pa kompromis kundër okupatorit për çlirimin e atdheut dhe të popujve tanë. Populli ynë e kuptoi drejt vijën e Partisë dhe luftoi heroikisht kundër okupatorit dhe tradhëtarëve shqiptaromëdhën. Nga ana tjetër Partia Komuniste Shqiptare me qën-

drimin e saj mbi këtë çështje dhe me traktin e përbashkët firmuar prej Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare dhe komitetit qarkor të Partisë Komuniste Jugosllave për Kosmetin, që e shpërndau në Kosovë e Metohi më datën 25.III.1942, u bënte thirrje shqiptarëve të Kosovës e të Metohisë të bashkoheshin me popujt e Jugosllavisë dhe me Partinë Komuniste Jugosllave dhe të luftonin me ashpërsinë më të madhe okupatorin, serbomëdhenjtë dhe shqiptaromëdhenjtë. Kjo ka qenë vija e Partisë Komuniste Shqiptare karshi minoritetit shqiptar në Jugosllavi dhe këtë s'mund ta përgënjeshtrojnë me shpifje Llazar Kolishevski dhe shokët e tij. Dhe pas çlirimit e deri sot vija e Komitetit Central të Partisë sonë karshi minoritetit shqiptar në Jugosllavi ka qenë nga më të drejtat. Mos të harrojnë Llazar Kolishevski dhe shokët e tij se sa e rëndë ka qenë situata në Kosovë përpara dhe deri në prakun e çlirimit dhe kjo situatë e rëndë i ka burimet në politikën shtypëse dhe gjakatare të kralëve të Serbisë. Mos të harrojnë Llazar Kolishevski dhe shokët e tij se ç'ka ngjarë në Kosovë e Metohi në prakun e çlirimit dhe ç'qëndrime janë mbajtur karshi shqiptarëve nga ana e udhëheqësve të Partisë në Kosovë. Këto qëndrime i dinë mirë udhëheqësit e Partisë Komuniste Jugosllave sa të gabuara ishin, ata dinë gjithashtu se kjo situatë e vështirë në Kosovë u përmirësua vetëm me vajtjen e divizioneve shqiptare. Qëndrimet e partizanëve shqiptarë që prej komandantit dhe komisarit më të lartë dhe deri tek partizani më i thjeshtë, kanë qenë një shembull i lartë se si Partia jonë i kishte mësuar njerëzit e saj dhe popullin e vet në rrugën e vërtetë marksiste-leniniste dhe të internacionalizmit. Le ta mohojnë Llazar Kolishevski dhe shokët e tij këtë gjë po të kenë mundësi. Titua, në Kongresin e pestë të Partisë Komuniste Jugosllave s'mungoi të përmendte për të përcmuar luftën heroike të popullit tonë, banditët si Preng Cali dhe shokët e tij që u përzien me okupatorin italian në shkeljen e Malit të Zi, banditë që pushteti popullor i Shqipërisë i shfrosi të gjithë. Por Titua dhe klika e tij harruan të përmendin heroizmat e divizioneve shqiptare që, të edukuar nga Partia jonë, derdhën gjakun pa u kursyer për çlirimin e popujve të Jugosllavisë dhe krijuan situata të favorshme për Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë në Mal të Zi, në Kosovë e Metohi e gjetkë. Nga ana e Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare janë mbajtur kurdoherë qëndrime të drejta karshi minoritetit shqiptar në Jugosllavi; janë dërguar mësues dhe profesorë, janë dërguar libra për shkolla etj. Nga ana e Komitetit Central të Jugosllavisë qëndrimi s'ka qenë korrekt. Në asnjë moment Komiteti Central i Jugosllavisë, qoftë edhe në mënyrë shoqërore, duke ndjerë si një detyrë, nuk ka vënë në korrent Komitetin Central të Partisë Komuniste Shqiptare për situatën në Kosovë, për reformat shoqërore që zbatoheshin dhe për qëndrimin e popullatës shqiptare

të Kosovës karshi këtyre masave, jo vetëm kaq, por Shqipëria mbahej krejtësisht e izoluar për zhvillimin e situatës në Kosovë.

Marrëdhëniet në mes të popullit shqiptar dhe popujve të Jugosllavisë po forcoheshin dhe kjo sillte patjetër me vete që marrëdhëniet e Shqipërisë me popullatën shqiptare të Kosovës duheshin të forcoheshin dhe të afroheshin. Por kjo nuk ngjau nga politika jo e drejtë dhe nacionaliste e Komitetit Central të Jugosllavisë. As populli shqiptar nuk di gjë si zhvillohet jeta në shqiptarët e Kosovës e Metohisë dhe as shqiptarët e Kosovës e Metohisë nuk dinë dhe s'janë të kjartë se si zhvillohet jeta në Shqipërinë e re. Shumë herë kanë shkuar grupe folkloristike nga Shqipëria në Jugosllavi, kanë vizituar gjithë Jugosllavinë, janë pritur me dashuri dhe entuziazëm nga gjithë popujt e Jugosllavisë, por Komiteti Central i Jugosllavisë kurrë nuk ka menduar dhe lejuar që këta të shkojnë në Kosovë dhe Metohi. Me dhjetëra udhëheqës kryesorë të Partisë Komuniste Shqiptare kanë shkuar në Jugosllavi, kanë folur dhe marrë kontakt me popullin vëlla jugosllav dhe kanë çimentuar vëllazërimin dhe miqësinë e ngushtë në mes të popujve tanë. Por kurrë Komiteti Central i Jugosllavisë nuk ka menduar dhe lejuar që këta shokë udhëheqës kryesorë të Partisë sonë të shkojnë në Kosovë e Metohi, të marrin kontakt me popullatën shqiptare të Kosovës, t'i flasin për këtë aleancë dhe miqësi të ngushtë që ekziston në mes të popujve tanë, t'i tregojnë se si zhvillohet jeta në Shqipërinë e re, t'u tregojnë kosovarëve rrugën e vëllazërimit me popujt e Jugosllavisë. Por Komiteti Central i Jugosllavisë ka shkuar edhe më tej në këtë çështje. Me urdhër janë hequr shumë kohë më parë nga shkollat shqipe të Kosovës e Metohisë librat në gjuhën shqipe që ishin shtypur në Shqipëri dhe që ishin kërkuar nga vetë qeveria jugosllave, janë hequr këngët partizane të Luftës nac.-çl. shqiptare dhe nxënësve shqiptarë të Kosovës nuk u flitet aspak për Luftën heroike n.-çl. të popullit shqiptar, por shkurtimisht u flitet për historinë e vjetër të Shqipërisë. Të gjitha këto qëndrime antimarksiste të bëra me qëllim shpjegohen duke thënë se «mbahen që të mos ngjallet ndjenja e shovinizmit shqiptar në Kosovë e Metohi». I çuditshëm ka qenë gjithashtu qëndrimi i Komitetit Central të Jugosllavisë me anë të delegatit të tij, kur ai u përpoq të luante lodrën vendimtare të tërheqjes së Partisë Komuniste Shqiptare në pozitë antimarksiste dhe antisovjetike. Komiteti [Central] i Jugosllavisë me anë të delegatit të tij Savo Zllatiçit i premtoi Komitetit Central të Shqipërisë se «kishte ardhur koha për zgjidhjen e problemit të Kosovës». Kjo ishte një lodër e turpshme që s'ka të bëjë aspak me një qëndrim me të vërtetë marksist-leninist, pse kur dështoi plani i tyre, Komiteti Central i Jugosllavisë filloi dhe po vazhdon me të madhe një politikë shpifëse karshi Komitetit Central të Partisë sonë në Jugosllavi,

në Kosovë e Metohi dhe Maqedoni. Partia jonë i njeh mirë kush janë ata agjentë shqiptarë kosovarë të klikës trockiste të Titos që bërtasin në Kongresin e pestë të Partisë Komuniste Jugosllave dhe në Kosovë e Metohi. Këta agjentë kryesorë shqiptarë kosovarë janë shokë të ngushtë të trockistëve shqiptarë Anastas Lulës dhe Sadik Premtes të dënuar me kohë nga Partia jonë për arësye se ata me fraksionin e tyre brenda në Parti u përpoqën për shkaktërrimin e Partisë, të likuidonin atë, të likuidonin organizatën e Rinisë Komuniste, të likuidonin Komitetin Central të Partisë sonë. Këta fraksionistë trockistë luftonin brenda në Partinë tonë për diskreditimin e Bashkimit Sovjetik në atë kohë, me gjuhën e ndytë hitleriane ashtu sikundër bëjnë tash trockistët jugosllavë. Fraksionistët trockistë shqiptarë me Anastas Lulën, Sadik Premten e shokët e tyre, që sot janë bërë çirakët e klikës nacionaliste të Titos, kanë qenë kundër Luftës nacional-çlirimtare të popullit shqiptar. Këta fraksionistë u shtypën pa mëshirë prej Komitetit Central të Partisë sonë dhe një nga luftëtarët më të ashpër kundër këtyre trockistëve ka qenë komunisti internacionalist jugosllav Miladin Popoviçi. Sot shokët e Anastas Lulës dhe Sadik Premtes në Kosovë e Metohi janë në elementin e tyre. Këta Ferhat Draga dhe Gani Kryezi të rinj, janë ata që pas çlirimit ju drejtuan shumë herë Partisë sonë me ankesa kundër Partisë Komuniste Jugosllave për politikën e padrejtë që ajo bënte në Kosovë e Metohi karshi elementëve komunistë shqiptarë, karshi shqiptarëve të Kosovës, ishin këta që erdhën e u tanë në Partinë tonë se reforma agrare jo vetëm që nuk u jepte tokë bujqve shqiptarë, por edhe shumë herë ua merrte dhe nga ana tjetër nuk prekte çifligarët e mëdhenj shqiptarë dhe jugosllavë. Komiteti Central i Partisë Komuniste Shqiptare i ka udhëzuar drejt këta njerëz të sëmurë dhe që i njihje prej kohe, duke i këshilluar të venë të qahen në Partinë Komuniste Jugosllave ku ata bënin pjesë. Këta sot janë bërë lakej të klikës së Beogradit në kurrizin e vëllazërimit të popullit të Kosovës me popujt e Jugosllavisë.

Kjo ka qenë vija e Komitetit Central të Partisë sonë karshi shqiptarëve në Kosovë e Metohi dhe në Maqedoni. Le ta rrëzojnë me shpifjet e tyre po të jenë në gjendje L Lazar Kolishevski dhe shokët e tij këtë politikë të drejtë të Partisë Komuniste Shqiptare. Politika e Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare nuk ka qenë dhe nuk do të jetë kurrë një politikë shoviniste, por politika e udhëheqjes të Komitetit Central të Partisë Komuniste Jugosllave është një politikë nacionaliste-shoviniste dhe shpifjet e L Lazar Kolishevskit dhe të shokëve të tij s'janë veçse konsekuencat e një politike të tillë antimarksiste.

Duke akuzuar Komitetin Central të Partisë Komuniste Shqiptare për «një vijë shoviniste shqiptaromadhe» qëllimi i Komitetit Central të Maqedonisë është të forcojë pozitat nacionaliste të

klikës së Titos dhe të nxitë ndjenjat nacionaliste shoviniste të serbomëdhenjve e të tjerë armiqve të popujve të Jugosllavisë kundër vendit tonë dhe zhvillimit të drejtë të socializmit në Jugosllavi. Komiteti Central i Maqedonisë përpiqet të armiqësojë popujt vëllezër të Jugosllavisë Federative Popullore me minoritetin shqiptar që jeton në Jugosllavi dhe me popullin shqiptar. Me deklaratën e vet Komiteti Central i Partisë Komuniste Shqiptare as nuk ka pasur dhe as nuk ka qëllim të nxitë elementët shovinistë shqiptarë, përkundrazi ai ka për qëllim t'i luftojë ata dhe klikën tradhëtare të Titos për të mirën e popujve të Jugosllavisë, për forcimin e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë dhe të kampit të socializmit. Partia Komuniste Shqiptare me këmbëngulje i këshillon shqiptarët e Kosmetit dhe të Maqedonisë të bashkojnë më fort se kurrë forcat e tyre me popujt vëllezër të Jugosllavisë për shpëtimin e tyre nga rreziku i madh që u kërcënohet nga klika nacionaliste e Beogradit, të forcojnë vëllazërimin, bashkimin dhe dashurinë me popujt e Jugosllavisë dhe me gjithë elementët e shëndoshë të Partisë Komuniste Jugosllave kundër antimarksistëve trockistë të klikës së Titos, të jenë solidarë deri në fund me Byronë Informative, të duan me gjithë zemër Bashkimin e madh Sovjetik, shpëtimtarin e popujve, të mbrojnë ndërtimin e vërtetë të socializmit në Jugosllavi, pse vetëm një rrugë e tillë do të sjellë shpëtimin dhe sigurimin e jetës më të mirë dhe të lumtur të popujve të Jugosllavisë dhe të minoritetit shqiptar që jeton i vëllazëruar me popujt e Jugosllavisë.

Në këtë situatë shumë të vështirë për popujt vëllezër të Jugosllavisë, Komiteti Central i Partisë Komuniste Shqiptare i këshillon me këmbëngulje shqiptarët e Kosmetit dhe të Maqedonisë të luftojnë me ashpërsinë më të madhe shovinistët shqiptarë dhe serbomëdhenj të Kosovës dhe të gjithë ata hyzmeqarë që i thurin lëvdata Titos dhe klikës së tij, pse këta janë armiqtë e popujve të Jugosllavisë dhe të minoritetit shqiptar në Jugosllavi. E vetmja rrugë e drejtë për shqiptarët e Kosmetit dhe të Maqedonisë është bashkimi i shëndoshë me popujt vëllezër të Jugosllavisë dhe me elementin e shëndoshë të Partisë Komuniste Jugosllave për të luftuar kundër klikës tradhëtare të Titos që po i bën varrin Jugosllavisë së re dhe që po përpiqet ta transformojë këtë në një koloni të imperializmit.

KOMITETI CENTRAL I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

Botohet sipas origjinalit që
gjetet në Arkivin Qendror
të Partisë

Botuar për herë të parë në
gazetën «Bashkimi» Nr. 1150,
4 shtator 1948

KONGRESI I I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

8-22 nëntor 1948

Kongresi I i PKSH u mbledh në Tiranë nga data 8-22 nëntor 1948. Në Kongres muarën pjesë 563 delegatë me të drejtë vote deliberative dhe 299 delegatë me të drejtë vote konsultative, të zgjedhur demokratikisht nga 584 organizata partie të qyteteve, rretheve dhe reparteve të Ushtrisë Popullore që përfaqësonin një numër të përgjithshëm prej 45382 anëtarësh dhe kandidatësh partie. Në Kongres merrnin pjesë delegacione të shtatë partive komuniste e punëtore motra dhe u përshëndet me telegrame nga KQ i PK të Bashkimit Sovjetik dhe shumë parti të tjera komuniste e punëtore që nuk patën mundësi të dërgonin delegacionet e tyre.

Kongresi i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

1. — Raport mbi punën e Komitetit Qendror dhe detyrat e reja të Partisë.
2. — Raport mbi planin ekonomik të shtetit.
3. — Raport mbi çështjet organizative dhe projektstatuti i Partisë.
4. — Zgjedhja e Komitetit Qendror dhe e komisionit të Revizionimit.

Kongresi dëgjoi, diskutoi dhe aprovoi Raportin «Mbi punën e Komitetit Qendror dhe detyrat e reja të Partisë» mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm shoku Enver Hoxha, analizo gjithë punën dhe veprimtarinë e Partisë që nga themelimi i saj, dënoi rëndë gabimet dhe punën armiqësore të zhvilluar në Partinë tonë nga udhëheqja revizioniste jugosllave dhe grupi trockist i Koçi Xoxes, dënoi gabimet e bëra në sektorët ekonomikë dhe dha orientimin e drejtë për ndërtimin socialist të vendit.

Kongresi aprovoi Statutin e Partisë dhe rivendosi normat leniniste në jetën e brendshme të Partisë. Në Kongres u vendos ndryshimi i emrit të Partisë Komuniste në Parti e Punës e Shqipërisë, gjë që bëhet vetëm për arësyje të përbërjes së saj sociale dhe në asnjë mënyrë nuk përbën ndonjë ndryshim as në qëllimet as në karakteristikat dhe as në rolin e Partisë. Partia e Punës e Shqipërisë, ashtu sikurse thuhet në Statut, është Partia në vazhdim direkt të Partisë Komuniste Shqiptare në konditat e sotme.

Duke aprovuar direktivat për planin dyvjeçar të zhvillimit të ekonomisë të RPSH kongresi dha orientimin për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Kongresi likuidoi përfundimisht grupin trockist të Koçi Xoxes dhe vendosi përjashtimin nga Partia të Koçi Xoxes dhe Pandi Kristos, si agjentë të udhëheqjes revizioniste jugosllave, armiq të Partisë dhe të popullit tonë.

Kongresi i PKSH zgjodhi organet udhëheqëse të Partisë: Komitetin e ri Qendror të PPSH me 21 anëtarë dhe 10 kandidatë për anëtarë të Komitetit Qendror si dhe Komisionin e Revizionimit me 3 anëtarë. Sekretar i Përgjithshëm i Partisë u zgjodh shoku Enver Hoxha.

Plenumi i Komitetit Qendror i mbledhur më datë 22 nëntor 1948 zgjodhi organet ekzekutive të Partisë, Byronë Politike me 7 anëtarë dhe Sekretariatin e Komitetit Qendror me 4 anëtarë.

KONGRESI I I PARTISË KOMUNISTE SHQIPTARE

8-22 nëntor 1948

Kongresi I i PKSH u mbledh në Tiranë nga data 8-22 nëntor 1948. Në Kongres muarën pjesë 563 delegatë me të drejtë vote deliberative dhe 299 delegatë me të drejtë vote konsultative, të zgjedhur demokratikisht nga 584 organizata partie të qyteteve, rretheve dhe reparteve të Ushtrisë Popullore që përfaqësonin një numër të përgjithshëm prej 45382 anëtarësh dhe kandidatësh partie. Në Kongres merrnin pjesë delegacione të shtatë partive komuniste e punëtore motra dhe u përshëndet me telegrame nga KQ i PK të Bashkimit Sovjetik dhe shumë parti të tjera komuniste e punëtore që nuk patën mundësi të dërgonin delegacionet e tyre.

Kongresi i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

1. — Raport mbi punën e Komitetit Qendror dhe detyrat e reja të Partisë.
2. — Raport mbi planin ekonomik të shtetit.
3. — Raport mbi çështjet organizative dhe projektstatuti i Partisë.
4. — Zgjedhja e Komitetit Qendror dhe e komisionit të Revizionimit.

Kongresi dëgjoi, diskutoi dhe aprovoi Raportin «Mbi punën e Komitetit Qendror dhe detyrat e reja të Partisë» mbajtur nga Sekretari i Përgjithshëm shoku Enver Hoxha, analizoi gjithë punën dhe veprimtarinë e Partisë që nga themelimi i saj, dënoi rëndë gabimet dhe punën armiqësore të zhvilluar në Partinë tonë nga udhëheqja revizioniste jugosllave dhe grupi trockist i Koçi Xoxes, dënoi gabimet e bëra në sektorët ekonomikë dhe dha orientimin e drejtë për ndërtimin socialist të vendit.

Kongresi aprovoi Statutin e Partisë dhe rivendosi normat leniniste në jetën e brendshme të Partisë. Në Kongres u vendos ndryshimi i emrit të Partisë Komuniste në Parti e Punës e Shqipërisë, gjë që bëhet vetëm për arsye të përbërjes së saj sociale dhe në asnjë mënyrë nuk përbën ndonjë ndryshim as në qëllimet as në karakteristikat dhe as në rolin e Partisë. Partia e Punës e Shqipërisë, ashtu sikurse thuhet në Statut, është Partia në vazhdim direkt të Partisë Komuniste Shqiptare në konditat e sotme.

Duke aprovuar direktivat për planin dyvjeçar të zhvillimit të ekonomisë të RPSH kongresi dha orientimin për ndërtimin e bazave të socializmit në vendin tonë.

Kongresi likuidoi përfundimisht grupin trockist të Koçi Xoxes dhe vendosi përjashtimin nga Partia të Koçi Xoxes dhe Pandi Kristos, si agjentë të udhëheqjes revizioniste jugosllave, armiq të Partisë dhe të popullit tonë.

Kongresi i PKSH zgjodhi organet udhëheqëse të Partisë: Komitetin e ri Qendror të PPSH me 21 anëtarë dhe 10 kandidatë për anëtarë të Komitetit Qendror si dhe Komisionin e Revizionimit me 3 anëtarë. Sekretar i Përgjithshëm i Partisë u zgjodh shoku Enver Hoxha.

Plenumi i Komitetit Qendror i mbledhur më datë 22 nëntor 1948 zgjodhi organet ekzekutive të Partisë, Byronë Politike me 7 anëtarë dhe Sekretariatin e Komitetit Qendror me 4 anëtarë.

STATUTI I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

18 nëntor 1948

HYRJE

Partia e Punës e Shqipërisë është Partia në vazhdim direkt të Partisë Komuniste Shqiptare në konditat e sotme.

Partia e Punës e Shqipërisë është pararoja e organizuar e klasës punëtore dhe e gjithë masave punonjëse të Shqipërisë.

Partia e Punës e Shqipërisë mban dhe zhvillon traditat më të mira të lëvizjeve progresiste të punëtorëve dhe të fshatarëve dhe të luftërave për tokë dhe për pavarësi kombëtare, të frymëzuara nga luftëtarët të dalë nga radhët e punëtorisë dhe të fshatarësisë ndër të cilët luftëtarët dhe militantët komunistë të shquar Ali Kelmendi dhe Qemal Stafa.

Partia e Punës e Shqipërisë ka për qëllim realizimin e socializmit dhe të komunizmit në Shqipëri.

Realizimi i socializmit do të thotë ndërtimi i një shoqërie në të cilën do të likuidohen klasat antagonistë, do të zhduket eksploatimi i njeriut nga njeriu dhe do të sigurohet parimi «nga secili simbas aftësisë, secilit simbas punës».

Qëllimi i fundit i Partisë së Punës të Shqipërisë është krijimi i një shoqërie komuniste, në të cilën do të likuidohen plotësisht diferencat e klasave, do të zhduket kontrasti midis qytetit dhe fshatit, do të krijohet bollëku në prodhim dhe do të sigurohet parimi «nga secili simbas aftësisë, secilit simbas nevojës».

Në aktivitetin e saj Partia e Punës e Shqipërisë udhëhiqet nga mësimet e themeluesve dhe mësuesve të marksizëm-leninizmit, Marks-Engels-Lenin-Stalin. Këto mësimet i japin mundësinë Partisë së Punës të Shqipërisë për njohjen, studimin dhe zgjidhjen e drejtë të gjithë problemeve dhe detyrave që shtrihen përpara saj zhvillimi shoqëror në interes të klasës punëtore dhe të mbarë popullit.

Në etapën historike të tanishme, Partia e Punës e Shqipërisë mobilizon dhe drejton klasën punëtore, fshatare dhe gjithë puno-

njësit e vendit në luftë kundër mbeturinave të fashizmit, të feudalizmit, kundër borgjezisë dhe reaksionit, për mbrojtjen e pavarësisë kombëtare dhe të integritetit tokësor, për forcimin e demokracisë dhe të pushtetit popullor, për rindërtimin e vendit, industrializimin dhe elektrifikimin e tij, për ndërtimin dhe zhvillimin e ekonomisë shtetërore dhe kooperativiste për ngritjen e nivelit ekonomik, kultural dhe teknik të masave punonjëse dhe të gjithë popullit. Partia e Punës e Shqipërisë do të përkrahë me të gjitha forcat rritjen dhe edukimin e proletariatit dhe të brezit të ri të Shqipërisë.

Partia e Punës e Shqipërisë udhëheq Frontin Demokratik të Shqipërisë dhe me qëllim që të realizojë aspiratat e të gjitha masave punonjëse, lufton në krye të tij për bashkimin e të gjitha forcave demokratike dhe progresiste të vendit tonë në këtë Front, për një Shqipëri demokratike, independente dhe të fortë në mënyrë që t'i sigurojë popullit lumturi dhe përparim.

Partia e Punës e Shqipërisë është roje e pafjetur e gjithë fitoreve të popullit shqiptar, mbrojtësja e lirisë së tij dhe e independencës kombëtare, ajo drejton përpjekjet për përmirësimin e konditave të jetesës së punëtorëve, fshatarëve, intelektualëve, nëpunësve, zanatçinjeve dhe të gjithë punonjësve, prandaj ajo është një Parti e masave të gjera punonjëse të qytetit dhe të fshatit.

Partia e Punës e Shqipërisë lufton për të forcuar e zhvilluar sa më shumë aleancën e pathyeshme të klasës punëtore me fshatarësinë nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe për të arritur në një shkallë gjithmonë më të lartë ndihmën e qytetit për zhvillimin dhe përparimin e gjithanshëm të fshatit.

Partia e Punës e Shqipërisë lufton pa u lodhur për forcimin e një paqeje të vërtetë demokratike dhe të gjatë kundër nxitësve të një lufte të re, pabarazisë raciale, për mbrojtjen e të drejtave nacionale dhe demokratike të pakicave, për të forcuar solidaritetin ndërkombëtar të punonjësve të të gjitha vendeve.

Partia e Punës e Shqipërisë përpiqet për një bashkëpunim të ngushtë me forcat e kampit demokratik antiimperialist, në radhë të parë, për një miqësi të sigurtë me Bashkimin Sovjetik, koka udhëheqëse e këtij kampi, dhe me shtetet e demokracive popullore.

Struktura organizative e Partisë së Punës të Shqipërisë ndërtohet në bazë të parimit të centralizimit demokratik. Të gjitha vendimet e Partisë merren në fund të diskutimeve absolutisht të lira të anëtarëve të Partisë, po menjëherë pasi merren vendime, me unanimitet ose me shumicë, ato bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë anëtarët e Partisë.

Të gjitha organet drejtuese të Partisë janë organe të zgjedhura nga poshtë-lart dhe çdo anëtar i Partisë ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet.

Partia e Punës e Shqipërisë është një organizatë lufte unike, organizatë e lidhur me një disiplinë të ndërgjegjshme dhe të detyrueshme njësoj për të gjithë anëtarët e Partisë.

Uniteti i Partisë së Punës të Shqipërisë është një konditë e domosdoshme për aftësinë e saj luftarake. Uniteti i Partisë së Punës të Shqipërisë është i papajtueshëm me ekzistencën e çdo lloj fraksioni ose grupazhi në Parti, me shtrembërimet e vijës kundër programit dhe Statutit, me thyerjen e disiplinës së Partisë dhe me qëndrimet e dyshimta dhe me dy faqe. Partia i pastron radhët e saja nga ata që shkelin programin, që nuk respektojnë statutin dhe vijën e saj.

Partia e Punës e Shqipërisë kërkon nga anëtarët e saj që të japin prova aktiviteti dhe vetëmohimi në punën për realizimin e programit dhe respektimin e plotë të Statutit të Partisë dhe të zbatojnë të gjitha vendimet e Partisë dhe programin e saj, që të sigurojnë unitetin e radhëve të Partisë.

Partia e Punës e Shqipërisë është fuqia udhëheqëse dhe drejtuese e të gjitha organizatave punonjëse, si shoqërore ashtu dhe shtetërore.

I

ANËTARËT E PARTISË, DETYRAT DHE TË DREJTAT E TYRE

1. — Anëtar partie mund të jetë cilido që pranon programin dhe Statutin e Partisë, që punon në një nga organizatat e saja, që u konformohet vendimeve të organeve të Partisë dhe paguan rregullisht kuotizacionin.

2. — Anëtar i Partisë ka për detyrë:

a) të jetë në radhët e masave popullore një luftëtar i vendosur për mbrojtjen dhe forcimin e Republikës dhe të pushtetit popullor, të punojë pa u lodhur për realizimin e bashkimit të pafytyrës të popullit në Frontin Demokratik, të jetë luftëtar i vendosur kundër borgjezisë, kundër mbeturinave të fashizmit, feudalizmit dhe kundër reaksionit;

b) të punojë pa u lodhur për të përvetësuar bazat e marksizëm-leninizmit dhe për ngritjen e nivelit politik dhe kultural të tij;

c) të respektojë pikë për pikë disiplinën e Partisë, të ruajë Partinë nga goditjet e armikut dhe unitetin e saj nga çdo armik i brendshëm dhe i jashtëm, duke zhvilluar vigjilencën revolucionare; të marrë pjesë aktive në jetën politike të Partisë dhe të

vendit, të aplikojë praktikisht politikën e Partisë dhe vendimet e organeve të saj dhe të jetë shembull sjelljeje dhe morali;

ç) të tregojë shembullin në respektimin e disiplinës si punëtor dhe si shtetas i Republikës Popullore të Shqipërisë duke zbatuar me përpikëri normat e punës dhe ligjet e shtetit. Të mësojë dhe të perfeksionojë zanatin e tij duke ngritur vazhdimisht cilësitë e tija profesionale dhe praktike;

d) të forcojë dita-ditës lidhjet me masat; të jetë në dijeni të nevojave dhe të kërkesave të punonjësve dhe njëkohësisht t'u përgjigjet këtyre kërkesave; t'u shpjegojë punonjësve vendimet e Partisë dhe kuptimin e tyre politik; t'i udhëheqë ato sipas vijës së Partisë; të punojë pa u lodhur për zhvillimin dhe organizimin e tyre dhe të bëhet kështu udhëheqës i vërtetë i masave;

dh) të bëjë pjesë në sindikata ose në një organizatë tjetër të masave dhe të punojë për krijimin e të tilla organizatave atje ku nuk ekzistojnë.

3. — Anëtar i Partisë ka të drejtë:

a) të marrë pjesë lirisht në diskutimet, në mbledhjet ose në shtypin e Partisë, për çështje të politikës së Partisë;

b) të shprehë lirisht mendimet e tij dhe të kritikojë, në mbledhjet e Partisë, aktivitetin dhe sjelljet e cilitdo anëtar partie, drejtuesi dhe organizate;

c) të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet drejtuese të Partisë;

ç) të marrë pjesë personalisht në diskutimet sa herë që të merret një vendim për aktivitetin ose sjelljet e tija;

d) të drejtohet për çdo çështje personale ose partie, të bëjë çdo pyetje dhe deklaratë në të gjitha organet drejtuese të Partisë gjer tek Komiteti Qendror.

4. — Pranimi në Parti:

Pranimi në Parti bëhet vetëm në mënyrë individuale.

Anëtarët e rinj të Partisë pranohen vetëm nga kandidatët për anëtarë partie, që kanë plotësuar stazhin e kandidatëve;

Anëtarët e rinj që pranohen në Parti duhet të vijnë nga radhët e masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit;

Nuk pranohen në Parti ata elementë që shfrytëzojnë punën e të tjerëve;

Për pranimin në Parti nuk bëhet dallim nacionaliteti, race dhe seksi;

Anëtarët e rinj që do të pranohen në Parti duhet të kenë mbushur moshën 18 vjeç.

Rregullat për pranimin e kandidatëve në Parti janë si vijon:

a) kandidatët për në Parti ndahen në tre grupe:

1) Punëtorë të qytetit dhe të fshatit;

2) Fshatarë të varfër, të mesëm dhe zanatçinjtë dhe shtresa të kësaj kategorie të qytetit;

3) Intelektualë.

Rregullat për pranimin në Parti për secilin grup janë:

1) *Grupi i parë:* Për ata që vijnë nga radhët e punëtorëve të qytetit dhe të fshatit duhet rekomandimi i dy anëtarëve të Partisë që kanë jo më pak se një vit jetë partie dhe që e kanë njohur kandidatin personalisht në punë të paktën 6 muajt e fundit.

2) *Grupi i dytë:*

a) Për ata që vijnë nga radhët e fshatarëve të varfër duhet rekomandimi i dy anëtarëve të Partisë, njëri nga të cilët duhet të ketë jo më pak se një vit jetë partie dhe tjetri dy vjet jetë partie dhe ta ketë njohur kandidatin personalisht në punë të paktën gjashtë muajt e fundit.

b) Për ata që vijnë nga radhët e fshatarëve të mesëm dhe të zanatçinjtëve dhe shtresave të kësaj kategorie të qytetit duhet rekomandimi i tre anëtarëve të Partisë, të cilët duhet të kenë jo më pak se dy vjet jetë partie dhe ta kenë njohur kandidatin personalisht në punë të paktën vitin e fundit.

3) *Grupi i tretë:* Për ata që vijnë nga radhët e intelektualëve duhet rekomandimi i tre anëtarëve të Partisë, të cilët duhet të kenë bërë jo më pak se tre vjet jetë partie dhe ta kenë njohur kandidatin personalisht në punë të paktën vitin e fundit.

Shënim:

a) Anëtarët e Komitetit Qendror dhe kandidatët për anëtarë të Komitetit Qendror rezervohen të japin rekomandime.

b) Propozimet për pranimin në Parti diskutohen dhe vendosen në mbledhjen e përgjithshme të organizatës bazë të Partisë. Në këtë mbledhje marrin pjesë edhe kandidatët për anëtarë partie, sidomos kandidati i propozuar. Vendimi për pranimin në Parti hyn menjëherë në fuqi vetëm pas aprovimit të komitetit më të lartë: komitetit të qytetit që nuk është ndarë në rajone, komitetit të rrethit dhe komitetit të rajonit.

Pas këtij aprovimi, anëtarit i jepet tesera.

Nuk është e detyrueshme që në mbledhjen e organizatës bazë,

kur diskutohet dhe vendoset për pranimin në Parti, të jenë prezent rekomanduesit.

c) Ish-anëtarët e Partisë Fashiste, të «Ballit», të «Legalitetit» dhe të grupeve të ndryshme bajraktare, mund të pranohen në Partinë e Punës të Shqipërisë vetëm në raste speciale dhe me rekomandimin e tre anëtarëve të Partisë, nga të cilët dy duhet të kenë jo më pak se pesë vjet jetë partie dhe tjetri të jetë anëtar Partie i vitit 1943. Vendimi për pranimin në Parti hyn në fuqi vetëm me aprovimin e Komitetit Qendror.

5. — Anëtarët e Partisë që bëjnë rekomandimin janë përgjegjës përpara Partisë për vërtetësinë e rekomandimit.

6. — Kur një anëtar partie, pa arsye të justifikueshme, për tre muaj me radhë nuk paguan kuotizacionin e anëtarësisë, organizata bazë e Partisë merr një vendim të përshtatshëm që duhet ta ratifikojë komiteti më i lartë, komiteti i qytetit që nuk është ndarë në rajone, komiteti i rrethit dhe komiteti i rajonit.

7. — Zakonisht përjashtimi nga Partia vendoset në mbledhjen e përgjithshme të organizatës bazë. Vendimi hyn në fuqi pasi të jetë ratifikuar nga komiteti më i lartë: komiteti i qytetit që nuk është ndarë në rajone, komiteti i qytetit dhe i rajonit, por gjersa të mos jetë dhënë aprovimi për këtë nga komiteti më i lartë përkatës, anëtarit të Partisë nuk mund t'i hiqet tesera dhe ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e organizatës bazë.

8. — Diskutimi mbi përjashtimin e një anëtari të Partisë ose mbi ripranimin e një të përjashtuari duhet të bëhet në një frymë shoqërore në mënyrë objektive, duke gjykuar me pjekurinë më të madhe dhe duke kontrolluar me kujdes, nëse akuzat që i bëhen anëtarit të Partisë janë të justifikuara.

Për shkelje të vogla, si mosmarrja pjesë në mbledhje pa arsye, mospagimi në rregull i kuotizacionit etj. duhet të zbatohen masa edukative dhe sanksione të parashikuara në statut dhe jo përjashtimi, i cili është dënimi më i rëndë në Parti.

9. — Çdo anëtar i përjashtuar ka të drejtë të bëjë apel kundër këtij vendimi. Apeli i tij duhet të shqyrtohet nga organet më të larta të Partisë brenda dy javësh nga dita e paraqitjes. Anëtarit i përjashtuar mund të bëjë apel edhe në Komitetin Qendror.

10. — Kur anëtarit i një organizate vendoset në rrethin e një organizate tjetër duhet të kërkojë të bëhet anëtar i saj. Anëtarët drejtues për të shkuar në një vend tjetër duhet të kenë lejen e organizatës së tyre. Çdo anëtar partie kur shkon në ndonjë vend të huaj duhet të ketë lejen e Komitetit Qendror.

Vërejtje: kalimi i anëtarëve të Partisë nga një organizatë në tjetrën bëhet sipas rregullave të caktuara nga Komiteti Qendror i Partisë.

KANDIDATËT PËR ANËTARË PARTIE

11. — Të gjithë ata që dëshirojnë të hyjnë në Parti bëjnë një stazh, i cili është i domosdoshëm që kandidati për anëtar partie të marrë njohuritë e programit, të Statutit, të taktikës së Partisë dhe që organizata të jetë në gjendje të vërtetojë cilësitë personale të kandidatit.

12. — Rregullat e pranimit për në stazhin e kandidatëve për anëtarë partie janë krejt të njëjta me ato që duhen për pranimin e anëtarëve të Partisë.

13. — Koha e caktuar për stazhin e kandidatëve është një vit; për punëtorët e industrisë dhe të minierave gjashtë muaj.

14. — Kandidatët për anëtarë partie marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e organizatës bazë ku ata bëjnë pjesë me të drejtë vote konsultative, detyrohen të marrin pjesë në të gjitha punët praktike, të paguajnë kuotizacionin dhe të zbatojnë gjithë vendimet e Partisë.

Kur kandidatët për anëtarë partie nuk zbatojnë detyrat dhe rregullat e caktuara, zbatohen për ta masat edukative njëjloj si dhe për anëtarët e Partisë.

III

NDËRTIMI I PARTISË, DEMOKRACIA E BRENDSHME E PARTISË

15. — Parimi drejtues i strukturës organizative të PPSH është centralizmi demokratik.

Kjo do të thotë:

a) Të gjitha organet drejtuese të Partisë zgjidhen nga poshtë-lart në mbledhje të përgjithshme, konferenca dhe kongrese.

b) Organet drejtuese janë të detyruara të japin llogari periodikisht për aktivitetin e tyre përpara anëtarëve të organizatave që i kanë zgjedhur.

c) Të mbahet disiplina e hekurt e Partisë dhe pakica t'i nënshtrohet shumicës. Vendimet merren në fund të diskutimeve të lira, por nga çasti në të cilin merret një vendim me unanimitet ose me shumicë votash të gjithë anëtarët e Partisë janë të detyruar ta zbatojnë pa diskutim.

d) Vendimet e organeve më të larta të Partisë janë të detyrueshme për organet më të ulta.

16. — Partia e Punës e Shqipërisë ndërtohet në bazë pro-dhimi-territori.

17. — Të gjitha organizatat e Partisë problemet lokale i zgjidhin në mënyrë autonome, por me konditë që zgjedhja e tyre të mos jetë në kundërshtim me vendimet dhe me vijën e Partisë.

18. a) Organi më i lartë i PPSH është Kongresi i Partisë, i cili zgjedh Komitetin Qendror dhe Komisionin Qendror të Rezivizionit.

b) Për organizatat e qyteteve, rretheve dhe rajoneve organet më të larta janë konferencat respektive (konferenca e qytetit, rrethit, rajonit), të cilat zgjedhin komitetin dhe komisionet e rezivizionit të tyre.

c) Për organizatën bazë është mbledhja e përgjithshme, që zgjedh sekretarin ose byronë e saj.

ç) Byrotë e organizatave bazë dhe komitetet që zgjidhen nga mbledhja e përgjithshme, konferencat dhe kongresi, janë organet ekzekutive dhe drejtojnë tërë punën e organizatës.

19. — Për drejtimin e mbledhjeve të përgjithshme, të konferencave dhe të kongresit zgjidhet një presidium.

20. — Në zgjedhjet e organeve të Partisë, ndalohej votimi i hapët si dhe votimi me listë.

Çdo anëtar partie ka të drejtë të pakufizueshme të tërheqjes dhe të kritikës së kandidatëve, gjithashtu ka edhe të drejtën e tërheqjes së kandidaturës së tij.

Zgjedhjet bëhen uninominale dhe me votim të fshehtë.

Të zgjedhur quhen kandidatët që kanë marrë shumicën e votave.

Numri i anëtarëve të komiteteve respektive caktohet nga organet drejtuese më të larta.

21. — Në qytetet, në rrethet dhe në rajone thirren mbledhjet e kadrove aktive të qytetit, të rrethit, të rajonit, sa herë që do të diskutohet mbi vendime të rëndësishme të Partisë.

Këto mbledhje nuk duhet të marrin një karakter formal dhe demonstrativ, po duhet të diskutohet realisht që vendimet të zbatohen sa më mirë në praktikë.

22. — Diskutimi i mirë dhe i shëndoshë mbi problemet e politikës së Partisë në organizatat e ndryshme ose në gjithë Partinë është për çdo anëtar partie një e drejtë e paprekshme që buron nga demokracia e brendshme e Partisë. Vetëm në bazë të demokracisë së brendshme të Partisë mund të zhvillohet kritika dhe autokritika e shëndoshë dhe të forcohet disiplina e Partisë e cila duhet të jetë koshiente dhe jo mekanike. Por një diskutim i gjerë mbi problemet e politikës së Partisë, sidomos një diskutim në gjithë Partinë, duhet të organizohet në mënyrë që të mos lejohen tentativa të një pakice për t'i imponuar vullnetin e saj shumicës dërmuese të Partisë ose tentativa për të krijuar fraksione me qëllim që të thyhet uniteti i Partisë, tentativa përçarjeje që tronditin forcën dhe soliditetin e Partisë.

Një diskutim i gjerë që intereson gjithë Partinë mund të bëhet në këto raste:

- a) Kur shihet e nevojshme nga shumë organizata të Partisë;
- b) Kur në Komitetin Qendror nuk ka një shumicë të theksuar mbi çështjet kryesore të politikës së Partisë.
- c) Kur pavarësisht nga një shumicë e theksuar që mund të ekzistojë në Komitetin Qendror, ky e çmon të nevojshme të verifikojë drejtësinë e politikës së tij me anën e një diskutimi në Parti. Vetëm në këto kondita mund të garantohet Partia nga shpërdorimi i demokracisë së brendshme nga elementë armiq të Partisë, vetëm kështu mund të sigurohet që demokracia e brendshme e Partisë të jetë e dobishme dhe të mos shfrytëzohet në dëm të Partisë.

23. — Skema organizative e Partisë:

- a) Për të tërë Partinë: Kongresi, Komiteti Qendror dhe Konferenca e PPSH.
- b) Për qytetin e ndarë në rajone: Konferenca e Partisë për gjithë qytetin (duke përfshirë edhe rajonet) dhe komiteti i qytetit.
- c) Për qytetin që nuk është ndarë në rajone, për rrethin dhe për rajonin: konferenca e qytetit, e rrethit dhe e rajonit.
- ç) Për qendrat e prodhimit: fabrika, transport, ndërtime për fshatin, për lagjen, për institucionet e ndryshme: mbledhja e përgjithshme e organizatës bazë dhe byroja e organizatës bazë të Partisë.

24. — Për studimin dhe punimin më të mirë të çështjeve të ndryshme si dhe për punimin dhe zbatimin praktik të vendimeve të Partisë, krijohen pranë Komitetit Qendror këto drejtori:

- a) Drejtoria e Propagandës dhe e Agjitacionit,
- b) Drejtoria e Organizimit dhe e Inspektimit,
- c) Drejtoria e Kuadrit,
- ç) Drejtoria e Bujqësisë.

Pranë komiteteve të qyteteve dhe rretheve, krijohen këto seksione:

- a) Seksioni i Propagandës dhe i Agjitacionit;
- b) Seksioni i Organizimit dhe i Inspektimit;
- c) Seksioni i Kuadrit.

Komiteti Qendror mund të krijojë seksione të tjera kur e sheh të nevojshme.

25. — Të gjitha organizatat e Partisë që aprovohen definitivisht do të kenë vulat e tyre. Këto vula do të dorëzohen vetëm nga Komiteti Qendror.

IV

ORGANET MË TË LARTA TË PARTISË

26. — Organi më i lartë i PPSH është Kongresi i Partisë. Kongreset e zakonshme mbledhen të paktën në tre vjet një herë.

Kongresi i jashtëzakonshëm mbledhet me iniciativën e Komitetit Qendror ose me kërkesën e 1/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Partisë të përfaqësuar në kongresin e fundit.

Thirrja e kongresit të zakonshëm të Partisë dhe rendi i ditës lajmërohen të paktën dy muaj përpara.

Kongresi i jashtëzakonshëm ka të drejtë të marrë vendime vetëm kur të jenë përfaqësuar të paktën gjysma e anëtarëve të Partisë që ishin përfaqësuar në kongresin e fundit të zakonshëm.

Normat e përfaqësimit dhe procedura e zgjedhjes së përfaqësuesve për kongresin ose konferencën nacionale të Partisë caktohen nga Komiteti Qendror i PPSH.

Mbledhja e kongresit të jashtëzakonshëm duhet të bëhet brenda dy muajve.

27. — Kongresi:

a) dëgjon dhe ratifikon raportin e Komitetit Qendror dhe të Komisionit Qendror të Revizionit;

b) rishikon dhe mund të ndryshojë programin dhe Statutin e Partisë;

c) cakton vijën taktike të Partisë për problemet kryesore të politikës aktuale;

ç) zgjedh Komitetin Qendror të Partisë dhe Komisionin Qendror të Revizionit;

28. — Kongresi cakton numrin e anëtarëve dhe të kandidatëve të Komitetit Qendror dhe të Komisionit Qendror të Revizionit dhe procedon në zgjedhjen e tyre.

Në rast se një ose më shumë nga anëtarët e Komitetit Qendror dalin nga KQ, vendet e tyre plotësohen me kandidatët e zgjedhur në kongres.

29. — Komiteti Qendror i Partisë mbledh plenumin e tij të paktën në tre muaj një herë.

Kandidatët për anëtarë të Komitetit Qendror asistojnë në mbledhje me të drejtë vote konsultative.

30. — Për punën politike dhe për udhëheqjen e përgjithshme të punës organizative Komiteti Qendror formon një Byro Politike dhe për kryerjen e punëve të përditshme të organizimit dhe të zbatimit krijon një Sekretariat.

31. — Komisioni Qendror i Revizionit të Partisë ka këto detyra:

a) Kontrollon shpejtësinë dhe saktësinë me të cilat kalojnë punët e Partisë në aparatet lokale të saj dhe në aparatet e Sekretariatit;

b) Kontrollon aktivitetin financiar të Partisë.

32. — Komiteti Qendror i PPSH në mes të dy kongreseve, drejton gjithë aktivitetin e Partisë, përfaqëson Partinë në marrëdhëniet me Partitë e tjera, me organizatat e masave ose institucionet e shtetit; organizon dhe drejton institute të ndryshme të Partisë; emëron redaksitë e organeve qendrore të Partisë, të cilat i udhëheq drejtpërdrejt, jep leje për botimin e organeve të Partisë në organizatat lokale më të rëndësishme të Partisë; organizon dhe drejton ndërmarrje të Partisë me karakter social, ndan kuadrot dhe mjetet teknike të Partisë; vendos për pagesat e funksionarëve të Partisë dhe administron arkën qendrore financiare.

33. — Komiteti Qendror i Partisë informon rregullisht organizatat e Partisë për aktivitetin e tij.

34. — Komiteti Qendror në mes të dy kongreseve mbledh të paktën një herë në çdo vit përfaqësuesit e organizatave lokale në një konferencë të Partisë për të marrë vendime për çështje me rëndësi dhe aktuale të politikës së Partisë.

Delegatët që do të marrin pjesë në Konferencën e Partisë, do të zgjidhen nga mbledhjet plenare të komiteteve të qytetit dhe të rrethit. Komiteti Qendror cakton si mënyrën e zgjedhjes ashtu edhe atë të përfaqësimit në konferencë.

Anëtarët e Komitetit Qendror, që do të marrin pjesë në konferencë, duhet të kenë mandatin e një organizate lokale. Ata anëtarë të KQ që nuk e kanë mandatin e një organizate marrin pjesë në konferencë, por me votë konsultative.

35. — Konferenca ka të drejtë të zëvendësojë një pjesë të anëtarëve të Komitetit Qendror d.m.th. të revokojë ata anëtarë që nuk kryejnë detyrat e tyre dhe t'i zëvendësojë me të tjerë, po në një proporcion që të mos kalojë 1/5 (një e pesta) e efektivit të Komitetit Qendror të zgjedhur në Kongresin e Partisë.

Konferenca plotëson efektivin e Komitetit Qendror me kandidatë për anëtarë të KQ të zgjedhur në Kongresin e Partisë dhe zgjedh në vend të tyre një numër të barabartë kandidatësh të rinj për anëtarë të KQ.

36. — Përveç vendimit mbi zëvendësimin e plotësimin e Komitetit Qendror, që merret në konferencë, të gjitha vendimet e tjera të saj duhet të ratifikohen nga Komiteti Qendror.

Vendimet e konferencës të ratifikuara nga Komiteti Qendror i Partisë, janë të detyrueshme për të gjitha organizatat e Partisë.

ORGANIZATAT E PARTISË TË QYTETIT, TË RRETHIT DHE TË RAJONIT

37. — Organi më i lartë në organizatën e qytetit, të rrethit dhe të rajonit është Konferenca e organizatës së Partisë dhe në mes të një konference dhe një tjetre është komiteti i qytetit, i rrethit dhe i rajonit.

Konferencat zhvillojnë punën e tyre në konformitet me vendimet e Partisë dhe të organeve drejtuese të saj.

38. — Konferenca e zakonshme e qytetit, e rrethit dhe e rajonit mbledhet nga komiteti më i lartë një herë në vit, kurse konferenca e jashtëzakonshme mbledhet me vendim të komitetit të qytetit, të rrethit dhe të rajonit ose kur e kërkon 1/3 (një e treta) e organizatës përkatëse.

Rregullat e zgjedhjeve dhe të përfaqësimit për konferencën e qytetit dhe të rrethit i cakton komiteti përkatës i Partisë në marrëveshje me Komitetin Qendror, ndërsa për rajonin i cakton komiteti përkatës në marrëveshje me komitetin e qytetit.

Konferenca e qytetit dhe e rrethit dëgjon dhe ratifikon raportin e komitetit përkatës, shqyrton problemet e punës së Partisë në qytet dhe rreth, zgjedh komitetin përkatës dhe delegatët për Kongresin e Partisë së Punës të Shqipërisë.

Konferenca e qytetit dhe e rrethit zgjedh komisionin e revizionit dhe cakton numrin e anëtarëve të tij. Komisioni i revizionit i qytetit dhe i rrethit ka po ato detyra që ka Komisioni Qendror i Revizionit për juridiksionin e tij. Ai nuk ka lidhje organizative me Komisionin Qendror të Revizionit, por raporton dhe është përgjegjës vetëm përpara konferencës respektive.

Konferenca e rajonit dëgjon e ratifikon raportin e komitetit përkatës, shqyrton problemet e punës së Partisë në rajon, zgjedh komitetin përkatës dhe delegatët për në konferencën e qytetit.

39. — Mbledhja plenare e komitetit të qytetit, të rrethit dhe të rajonit bëhet një herë në muaj.

40. — Komiteti i qytetit dhe i rrethit zgjedh një byro prej 9-11 vetësh me dy sekretarë, të cilët duhet të kenë të paktën tre vjet jetë partie. Byroja dhe sekretarët aprovohen nga Komiteti Qendror i Partisë.

Byrotë e komitetit të rajonit përbëhen prej 7-9 vetësh me dy sekretarë, të cilët duhet të kenë të paktën dy vjet jetë partie. Byroja dhe sekretarët aprovohen nga komiteti i qytetit, nga i cili varen.

41. — Komiteti i qytetit, i rrethit dhe i rajonit organizon dhe drejton organizatat bazë të Partisë në fabrikë, në transport, në ndërtime, në fshatra, në institucionet e ndryshme etj., aprovon

pranimin në Parti të anëtarëve të rinj, administron arkën e Partisë së organizatës së tij.

Komiteti i qytetit dhe i rrethit i paraqit Komitetit Qendror të Partisë një raport mbi aktivitetin e organizatës së vet në kohën dhe në formën e caktuar nga Komiteti Qendror, ndërsa komiteti i rajonit ja paraqit komitetit të qytetit, nga i cili varet.

42. — Në qytete të vogla nuk krijohen komitete të veçanta të Partisë për organizatat e këtyre qyteteve, por këto udhëhiqen nga komiteti i rrethit të tyre.

Në qytete më të mëdha krijohen komitete të veçanta, për qytetin, që gëzojnë të drejtat e komitetit të rrethit dhe lidhen direkt me Komitetin Qendror.

Në qytetet e mëdha krijohen me vendim të KQ të Partisë, komitete rajonesh të cilat varen nga komiteti i qytetit.

Për drejtimin e punës së Partisë në qendrat e rëndësishme të punës, Komiteti Qendror mund të emërojë seksione politike kurdoherë që e sheh të nevojshme.

VI

ORGANIZATAT BAZË TË PARTISË

43. — Organizatat bazë të Partisë janë organizatat e para të Partisë që ngrihen në fabrikë, në transport, në ndërtime, në institute, në fshatra dhe në reparte të Ushtrisë Kombëtare.

Organizatat bazë ngrihen atje ku ka jo më pak se tre anëtarë partie.

Atje ku ka më pak se tre anëtarë partie, formohen grupe kandidatësh partie, që udhëhiqen nga një anëtar partie i caktuar nga komiteti i qytetit, i rrethit dhe i rajonit.

Organizatat bazë të Partisë aprovohen nga komiteti, prej të cilit varen.

44. — Organizatat bazë të Partisë lidhin masat punonjëse të qytetit dhe të fshatit me organet drejtuese të Partisë.

Detyrat janë:

a) Të bëjnë në masat punonjëse punë agjitative dhe organizative për zbatimin e parullave dhe të vendimeve të Partisë;

b) Të pranojnë anëtarë të rinj për në Parti, t'i edukojnë politikisht dhe t'i lartësojnë në nivelin ideologjik.

c) Të mobilizojnë masat në qendrat e prodhimit dhe të punës për realizimin e planit të prodhimit, për forcimin e disiplinës në punë, për zhvillimin e emulacionit dhe të hovit në punë.

ç) Të luftojnë kundër çrregullimit dhe moskujdesisë në qendrat e prodhimit dhe të punës, të preokupohen dhe të kujdesen

vazhdimisht për të përmirësuar konditat materiale dhe kulturele të masave punonjëse.

d) Të marrin pjesë aktive në jetën ekonomike, politike dhe kulturele të vendit.

dh) Të kujdesen për organizimin dhe edukimin e punëtorëve dhe të brezit të ri.

45. — Për drejtimin e organizatës bazë, që ka më pak se 15 anëtarë partie, në mbledhjen e përgjithshme të saj zgjidhet demokratikisht një sekretar dhe një zëvendës nga anëtarët më aktivë dhe më të provuar të Partisë, ndërsa për drejtimin e organizatës bazë që ka më shumë se 15 anëtarë, zgjidhet një byro, e cila duhet të aprovohet nga komiteti më i lartë.

Sekretarët e organizatave bazë të Partisë duhet të kenë zakonisht një vit jetë partie.

Atje ku është e domosdoshme organizatat bazë më të mëdha të Partisë, organizohen në grupe partie. Çdo grup zgjedh drejtuesin e tij.

46. — Organizatat bazë të Partisë në ndërmarrje industriale, institute shtetërore, lagje dhe fshatra, formojnë së bashku organizatën lokale të Partisë, të rrethit, qytetit e rajonit.

VII

PPSH DHE RINIA POPULLORE

47. — Partia e Punës e Shqipërisë ka në drejtimin e saj organizatën e Rinisë Popullore¹, e cila grumbullon masat e rinisë rreth Partisë. Partia e Punës e Shqipërisë kujdeset në mënyrë të veçantë për edukimin e Rinisë Popullore në frymën e marksizëm-leninizmit dhe për bashkimin e forcimin e saj.

VIII

ORGANIZATAT E PPSH NË USHTRINË KOMBËTARE

48. — Puna e organizatave të Partisë në Ushtrinë Kombëtare drejtohet nga Komiteti Qendror i Partisë me anën e Drejtorisë Politike që është në rangun e një Drejtorie të KQ.

¹ Në Kongresin e Unifikimit të Rinisë që u mbajt më 10 shtator 1949 në qytetin e Shkodrës me shkrirjen e organizatës së Rinisë Komuniste dhe Rinisë Popullore të Shqipërisë, organizata e rinisë u quajt «Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë».

Organizata e Partisë në Ushtrinë Kombëtare ndërtohet simbas një rregulloreje të veçantë të aprovuar nga KQ i PPSH.

IX

MASA NDËSHKIMORE PËR SHKELJEN E DISIPLINËS SË PARTISË

49. — Detyra e parë e të gjithë anëtarëve të Partisë dhe e të gjitha organizatave është të mbajnë unitetin e Partisë, të luftojnë pa mëshirë shënjat më të vogla të tentativës së dukjeve dyfaqëshe, të luftës fraksioniste dhe të përçarjes dhe të aplikojnë disiplinën e Partisë dhe të shtetit.

50. — Vendimet e organeve qendrore të Partisë dhe të administratave të shtetit duhet të zbatohen shpejt dhe pikë për pikë.

Mosaplikimi i vendimeve të organeve më të larta dhe akte të tjera të cilësuar si delikte nga opinioni publik i Partisë sjellin me vete: për organizatën, vërejtjen dhe shpërndarjen e saj; për anëtarët e Partisë, vërejtjen me shënim në biografi, ndalimin e përkohshëm për të pasur një vend drejtues në Parti dhe përjashtimin nga Partia.

51. — Në rastet e shkeljes së disiplinës së Partisë dhe të shtetit, të fajit të përsëritur, të qëndrimit dy faqesh ose të frymës së fraksionit nga ana e anëtarëve të Komitetit Qendror, ky ka të drejtë të vendosë përjashtimin e tyre nga Komiteti Qendror dhe si masë ekstreme, përjashtimin e tyre nga Partia.

Konditë e nevojshme për aplikimin e kësaj mase ekstreme në anëtarët dhe kandidatët për anëtarë të Komitetit Qendror është thirrja e plenumit, në të cilin do të thirren të gjithë kandidatët për anëtarë në Komitetin Qendror. Në qoftë se plenumi i drejtuesve më përgjegjës të Partisë¹ njeh me 2/3 (dy të tretat) e votave nevojën e përjashtimit nga Komiteti Qendror të një prej anëtarëve të tij ose të përjashtimit edhe nga Partia, kjo masë duhet aplikuar menjëherë.

52. — Sanksionet e vendosura zbatohen simbas rregullave që cakton Komiteti Qendror.

¹ I Komitetit Qendror.

BURIMET FINANCIARE TË PARTISË

53. — Të ardhurat financiare të Partisë dhe të organeve të saj, përbëhen nga kuotizacionet, të ardhurat e ndërmarrjeve të Partisë dhe të ardhura të tjera.

54. — Kuotizacionet e përmuajshme për anëtarët dhe për kandidatët e Partisë janë:

Për ata që marrin deri 2000 lekë, 5 lekë.

Për ata që marrin prej 2001 deri 3000 lekë, 10 lekë.

Për ata që marrin prej 3001 deri 4000 lekë, 15 lekë.

Për ata që marrin prej 4001 deri 5000 lekë, 1 për qind.

Për ata që marrin prej 5001 deri 7000 lekë, 2 për qind.

Për ata që marrin prej 7001 e lart lekë, 3 për qind.

Për anëtarët e Partisë dhe kandidatët për anëtarë partie që nuk kanë rrogë fikse, Komiteti Qendror cakton kuotizacionin e tyre.

55. — Shokët që hyjnë në stazh të kandidatëve derdhin si të drejtë hyrjeje 2 për qind të rrogës së tyre.

Fshatarët derdhin si të drejtë hyrjeje në stazhin e kandidatëve për anëtarë partie 10 lekë.

Botohet sipas broshurës:

«Statuti i Partisë së

Punës të Shqipërisë»

Tiranë, nëntor 1948

REZOLUCIONI I KONGRESIT I TË PARTISË KOMUNISTE TË SHQIPËRISË

19 nëntor 1948

Prej datës 8-22 nëntor 1948, u zhvilluan punimet e Kongresit I të Partisë Komuniste të Shqipërisë në qytetin e Tiranës. Në kongres merrnin pjesë 563 delegatë me të drejtë vote deliberative dhe 299 delegatë me të drejtë vote konsultative, të zgjedhur demokratikisht nga organizatat e Partisë në të gjithë Shqipërinë. Në Kongres asistonin delegacione të Partive Komuniste e Punëtore motra të Bullgarisë, Çekoslovakisë, Francës, Greqisë, Hungarisë, Polonisë dhe Rumanisë. Kongresit i erdhën telegrame nga Partia e lavdishme Bolshevike dhe nga partitë e tjera motra.

Kongresi dëgjoi, shqyrtoi dhe aprovoi unanimitisht raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, mbi veprimtarinë e Partisë sonë dhe të Komitetit Qendror të saj për periudhën e kaluar, që nga formimi i Partisë dhe deri sot, si edhe raportin e sekretarit për kuadrot e Partisë, shokut Tuj Jakova, mbi zhvillimin e gjendjes së brendshme të Partisë dhe raportin e anëtarit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror, shokut Gogo Nushi, mbi zhvillimin e ekonomisë së vendit tonë. Kongresi përcaktoi vijën e Partisë për periudhën e ardhshme dhe aprovoi Statutin e Partisë.

Të gjitha punimet e kongresit u zhvilluan nën dritën e letrave të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave dhe nën prizmin e Rezolutës së Byrosë Informative të tetë partive komuniste «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave».

Duke marrë parasysh aspirimin e kontradiktave midis gjithë kampit monolit socialist në botë me në krye Bashkimin Sovjetik, nga njëra anë dhe grupit fraksionist të Titos, nga ana tjetër, kongresi konsideron se letrat e Partisë Bolshevike kanë një rëndësi të madhe historike për jetën e Partisë Komuniste Jugosllave, për partitë komuniste e punëtore motra të të gjitha vendeve, për kampin e socializmit dhe për Partinë tonë sepse:

a) Ato i heqin maskën tradhëtisë së grupit trockist-nacionalist të Titos ndaj marksizëm-leninizmit;

b) Ato janë mbrojtja besnike e marksizëm-leninizmit dhe zbulojnë e demaskojnë fraksionin trockist-nacionalist të grupit të Titos në gjirin e kampit unik të socializmit;

c) Ato janë drita e madhe marksiste-leniniste-staliniane që u ndriçon rrugën gjithë partive komuniste për të analizuar dhe ndrequr gabimet e tyre. Veçanërisht për Partinë tonë ato janë shpëtimtare, sepse në dritën e tyre Partia jonë do të realizojë kthesën e domosdoshme duke dalë përfundimisht nga gabimet e rënda që ajo ka bërë, nën influencën e udhëheqjes tradhëtare të Partisë Komuniste Jugosllave, duke dalë nga kthetrat e grupit trockist të Titos dhe duke u vënë me vendosmëri në rrugën e marksizëm-leninizmit që udhëheq me lavdi Partia Komuniste Bolshevike e Bashkimit Sovjetik;

ç) Ato janë ndihma e paçmueshme që u jep Partia Bolshevike e Lenin-Stalinit, Partisë Komuniste Jugosllave, të gjitha partive komuniste, punëtore dhe veçanërisht Partisë sonë.

Nga analiza që i bëri të gjithë veprimtarisë së Partisë, që nga formimi i saj dhe deri më sot, kongresi

K O N S T A T O I :

1) Partia jonë u formua më 8 Nëntor 1941, në zjarrin e luftës së popullit tonë kundër okupatorit të huaj. Ajo u krijua në një kohë kur Lufta e dytë botërore prej më se dy vjetësh kishte përfshirë të gjitha kontinentet dhe të gjitha vendet kryesore të botës, në një kohë kur me sulmin tradhëtar të Gjermanisë fashiste kundër Bashkimit Sovjetik, vendit paqedashës të socializmit, u bë e kuartë para gjithë popujve të botës gjendja politike ndërkombëtare dhe u përforcua karakteri antifashist i Luftës së dytë botërore. Me futjen e Bashkimit Sovjetik në luftë u bë dallimi i kuartë midis forcave të demokracisë dhe forcave të fashizmit, forcave të errësirës. Lufta kundër fashizmit ishte lufta kundër skllavërisë, ishte lufta e popujve për liri. Prandaj, në të gjitha vendet prej gjithë njerëzve përparimdashës u formua një bllok i fuqishëm në luftën kundër errësirës e robërisë, kundër armikut të betuar të njerëzimit, fashizmit. Dy blloqe të kundërta, armiq për vdekje në mes tyre, u formuan në botë, nga njëra anë blloku i luftës së padrejtë, i grabitjes, i skllavërisë e i errësirës, blloku i fashizmit, dhe nga ana tjetër fronti i luftës së drejtë, i luftës për liri e përparim, i luftës kundër fashizmit, i kryesuar nga mbrojtësi i lirisë së popujve, i kulturës e i qytetërimit, Bashkimi i madh Sovjetik dhe i përbërë nga vendet demokratike dhe nga popujt e shtypur e liridashës të gjithë botës. Për njerëzit progre-

sistë nuk ishte aspak njëloj se cili bllok do ta fitonte luftën. Bota demokratike interesohej që të shkatërrohej fashizmi, se me shkatërrimin e tij, shpëtonte njerëzimi nga skllavëria më e egër dhe hapeshin perspektiva për përparimin e lumturinë e mëtejshme të njerëzimit.

Në këtë situatë politike ndërkombëtare, Partia jonë, që porsa u krijua, e vuri veten në bllokun e luftës kundër fashizmit, në bllokun që luftonte për liri e përparim, për zhdukjen e zgjedhës fashiste që rëndonte mbi popullin tonë si mbi shumë popuj të botës. Me besim të patundur në fitoren e forcave të përparimit, të grumbulluara rreth Bashkimit të pathyeshëm Sovjetik dhe gjenisë së Stalinit, Partia jonë e udhëhequr me vendosmëri nga Komiteti Qendror Provizor, me në krye shokun Enver Hoxha, që në formimin e saj, vuri përpara anëtarëve të saj dhe gjithë komunistëve detyrën që «të gjënden në krye të luftës për një Shqipëri të lirë Demokratike dhe Popullore, duke luftuar krah për krah me lëvizjet nacional-çlirimtare të popujve të tjerë dhe të Bashkimit Sovjetik» dhe të punonin papushuar për të mobilizuar masat e popullit në lëvizjen nacional-çlirimtare.

Shokët Qemal Stafa dhe Vasil Shanto, anëtarë të KQ të Partisë sonë u bënë shembull heroizmi për anëtarët e Partisë dhe gjithë popullin shqiptar duke dhënë jetën për të kryer me nder detyrën që u vinte para Partia.

Duke ftuar anëtarët e saj dhe gjithë popullin në luftë kundër okupatorit fashist, Partia i ftoi njëkohësisht në luftë për një Shqipëri demokratike e popullore, për një Shqipëri ku të mos kishte vend regjimi gjakatar i Zogut, që karakterizohej nga sundimi i klasës feudalo-borgjeze, shtypëse, shfrytëzuese, hajdute, armike e betuar e popullit dhe shërbëtorë besnike e imperializmit, nga një ekonomi shumë prapanike e keqësuar nga shkatërrimet e Luftës së parë botërore dhe e shtrydhur pa mëshirë nga klasa sunduese dhe nga kapitali i huaj, gjë që forconte shtypjen dhe shtonte mizerjen e popullit tonë, nga kërcënimet e humbjes së indipendencës nga shkaku i politikës së jashtme kapitulluese që bënte klika e Zogut me fuqitë imperialiste të mëdha e të vogla.

2) E formuar në zjarrin e luftës së popullit tonë kundër okupatorëve të huaj dhe e udhëhequr nga parimi i forcimit të traditave revolucionare të popullit tonë, Partia jonë trashëgoi, për vetësoi, ruajti dhe zhvilloi traditat luftarake dhe progresiste të popullit tonë, që lindën gjatë luftërave dhe përpjekjeve që ka bërë populli gjatë shekujsh për liri e indipendencë dhe për tokë kundër zaptuesve të huaj dhe shërbëtorëve të tyre të brendshëm.

Partia jonë u formua, u rrit, u forcua dhe u edukua gjatë luftës së popullit tonë kundër fashizmit italian e gjerman dhe reaksionit të brendshëm, «Ballit Kombëtar», «Legalitetit» etj., gjatë Luftës nacional-çlirimtare, luftës më të madhe heroike të

popullit për liri dhe indipendencë. Formimi i Partisë sonë është i lidhur me Revolucionin socialist të Tetorit, pse nga ky u frymëzua rinia e vendit tonë në rrugën e saj progresiste. Formimi i Partisë sonë ishte konsekuencë e zhvillimit të traditave luftarake dhe progresiste të popullit tonë, e influencës dhe e ndihmës së luftës së madhe patriotike të Bashkimit Sovjetik dhe e influencës së luftës që bënin gjithë popujt liridashës kundër fashizmit. Formimi i Partisë sonë ishte një nevojë imperative që u vu përpara grupeve komuniste, që ndodheshin në vendin tonë menjëherë pas sulmit fashist kundër Bashkimit Sovjetik, nevojë e domosdoshme për zhvillimin e luftës së popullit tonë për liri, paqe, pavarësi kundër okupatorëve të huaj dhe shërbëtorëve të tyre.

Partia jonë e formuar sipas mësimëve të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, grumbulloi në radhët e saja bijtë më të mirë, më të vendosur e revolucionarë, më besnikë, të ndërgjegjshëm e më të ndershëm të masave punonjëse të vendit dhe i çelnikosi radhët e saja në luftë të ashpër kundër okupatorëve të huaj dhe të gjitha rrymave reaksionare të vendit, në luftën e pamëshirshme kundër të gjitha tendencave antiparti që u shfaqën në radhët e saja.

Partia jonë është Partia e revolucionit popullor, e reformave ekonomike-shoqërore që përmbysën bazat e klasave shfrytëzuese në vendin tonë, është Partia e përpjekjes së vazhdueshme me trockizmin e udhëheqjes jugosllave. Ajo, gjatë gjithë luftërave të saja është treguar e pamposhtur dhe e pamëshirshme para fashizmit dhe reaksionit, e papajtueshme me shfaqjet oportuniste dhe sektare në radhët e saja dhe e vendosur kundër frymës e metodës trockiste të udhëheqjes tradhëtare jugosllave e bashkëpunëtorëve të saj në Partinë tonë.

Partia jonë, e frymëzuar nga principet e marksizëm-leninizmit, e udhëhoqi me sukses popullin shqiptar në Luftën nacional-çlirimtare dhe me sukses e udhëheq edhe sot në rrugën për në socializëm.

3) Ne fituam indipendencën tonë duke çliruar vendin nga okupatorët e huaj dhe reaksioni i brendshëm, vendosëm pushtetin popullor, ngritëm republikën popullore, kryem një sërë reformash ekonomike-shoqërore dhe po ecim me vendosmëri në rrugën e ndërtimit të socializmit në vendin tonë, sepse në krye të luftës së madhe kundër fashizmit, dje, dhe kampit antiimperialist për një paqe të qëndrueshme e demokraci popullore sot, qëndron Bashkimi Sovjetik, pa luftën dhe heroizmin e popujve dhe ushtrisë të të cilit dhe pa përpjekjet e tija të paprera as ne e as popujt e tjerë të shtypur nuk do të mund të çliroheshim nga zgjedha fashiste e nuk mund të jetojmë në paqe e të lirë, sepse në krye të popullit tonë është Partia e Punës, Partia e popullit, besnike deri në fund e interesave të popullit dhe e rrugës mark-

siste-leniniste, sepse populli ynë u qëndroi besnik traditave të tija luftarake dhe patriotizmit të vërtetë, nuk kurseu asgjë për independencën dhe është i vendosur të sakrifikojë çdo gjë për ruajtjen e saj dhe për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

4) Partia jonë u formua nga shkrirja e grupeve komuniste që ekzistonin në vendin tonë, nga grupi i Korçës, grupi i Shkodrës dhe grupi i «Të Rinjve», të cilët e konsideronin veten gjer në atë kohë, gjithsecili për hesap të tij, si Parti Komuniste të Shqipërisë. Në realitet, asnjë nga këto grupe s'kishte të bënte me një parti komuniste. Këto ishin grupe komunistësh që kishin ndihmuar të ndjehej në Shqipëri një lëvizje komuniste, e cila kishte arritur disa suksese: ishte mbajtur një qëndrim politik, në momentet më të rëndësishme, qëndrim që kishte për qëllim mbrojtjen e interesave të popullit shqiptar dhe që inspirohej nga dashuria për BS dhe për proletariatin botëror, por se në to ishin vërtetuar gabime të mëdha organizative dhe politike. Këto grupe komuniste ishin të ndarë nga njëri-tjetri dhe luftonin njëri-tjetrin. Situata në të cilën u krijua Partia jonë kërkonte formimin e një partie të vetme të drejtuar nga një qendër, prandaj Partia, që u rrit sipas mësimave marksiste-leniniste, e konsideroi centralizmin demokratik si parimin themelor të ndërtimit të saj.

Partia jonë e re dhe pa eksperiencë, sado me përbërje shoqërore mjaft heterogjene, që në ditët e para të formimit të saj u hodh në luftë të ashpër kundër armikut. Ajo mobilizoi masat e gjera të popullit, i organizoi në Frontin Nacional-Çlirimtar dhe i udhëhoqi ato në luftën e armatosur duke u mbështetur në mësimet marksiste-leniniste mbi kryengritjen e armatosur të popujve.

Partia jonë fitoi simpatinë dhe besimin e masave të gjera të popullit, sepse politika e saj ishte e drejtë, sepse programi i Partisë ishte shprehja më besnike e interesave të popullit dhe sepse anëtarët e saj ishin kudo dhe kurdoherë shembull besnikëri ndaj kauzës së popullit.

Duke zbatuar vijën politike të saj, që gjatë luftës konkretizohet si një vijë lufte pa kondita dhe të ashpër kundër okupatorëve të huaj, e papajtueshme dhe e prerë kundër rrymave reaksionare, kundërshtarë e të gjitha shfaqjeve oportuniste ose sektare në radhët e saja, konsekuente dhe e vendosur për çlirimin e vendit nga okupatorët e huaj e tradhëtarët e vendit, për fitoren me çdo kusht të independencës dhe të lirisë së popullit, Partia jonë u tregua udhëheqëse e aftë dhe besnike e popullit.

Për të grumbulluar popullin shqiptar në një platformë organizative dhe politike të vetme, pa dallim feje ose krahine, seksi ose rryme politike, nën drejtimin e Partisë, Partia jonë Komuniste, më 16 shtator 1942 organizoi Konferencën e Pezës. Në këtë konferencë merrnin pjesë, përveç delegatëve të Komitetit

Qendror të Partisë sonë, të Rinisë Komuniste, të Grave Shqiptare edhe përfaqësuesit e tendencave të ndryshme të nacionalistëve shqiptarë dhe të rinisë nacionaliste. Konferenca e Pezës, në programin e saj politik kishte: luftën e organizuar, të ashpër, pa kompromis kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve në të gjithë Shqipërinë. Nga ana tjetër vendosi edhe krijimin e këshillave nacional-çlirimtare në të gjitha krahinat. Ky qe hapi i parë që i dha formën organizative dhe vijën politike Frontit Nacional-Çlirimtar. Me platformën e Konferencës së Pezës, Partia jonë i hapi perspektiva të gjera luftës sonë. Me këtë platformë Partia jonë mobilizoi masat e gjera të popullit, i organizoi ato dhe i udhëhoqi në luftë me armikun, krijoi Ushtrinë Nacional-Çlirimtare, krijoi e forcoi pushtetin popullor dhe korri suksese të mëdha.

Vija politike e Partisë sonë që në fillim ka qenë orientuar drejt Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike e Stalinit të madh. Është për këtë arsye që ajo mundi t'u rezistonte dhe të mposhte, që gjatë luftës, të gjitha manevrat dhe intrigat e anglo-amerikanëve, të cilët u munduan gjer në fund të sabotonin luftën tonë, të grumbullonin e të organizonin reaksionin e brendshëm në vendin tonë, ta hidhnin atë në luftë kundër lëvizjes nacional-çlirimtare, siç e hodhën, dhe të mbanin regjimin e tyre kapitalist në vendin tonë.

Vija politike e Partisë sonë u bë vija politike e vegjëlisë, e klasës punëtore dhe e masave të gjera të fshatarësisë së varfër e të mesme dhe e intelektualëve patriotë, sepse ajo ishte shprehja më besnike e aspiratave të këtyre masave, ishte e vetmja rrugë e shpëtimit të tyre nga robëria fashiste dhe nga shtypja e sundesve të vendit. Me këtë vijë të drejtë dhe konsekuente, Partia e mobilizoi në luftë minoritetin grek në Shqipëri dhe sot ajo i siguron të gjitha të drejtat dhe liritë demokratike.

Duke u zbatuar kjo vijë e Partisë sonë, populli ynë u çlirua nga robëria fashiste dhe e ndoqi okupatorin fashist me luftë jashtë kufive të vendit, brenda në tokën jugosllave duke ndihmuar në çlirimin e popujve të Jugosllavisë, spastroi vendin nga forcat e reaksionit, vendosi pushtetin e tij demokratik, mposhti tentativat e imperialistëve anglo-amerikanë për rrëzimin me vullnet të pushtetit popullor, bëri një sërë reformash ekonomiko-shoqërore me rëndësi dhe po ecën në rrugën e ndërtimit të socializmit në vendin tonë.

Prandaj vija politike e Partisë sonë gjatë luftës ka qenë e drejtë. Disa gabime politike që janë vërtetuar gjatë luftës si p.sh. Mukja, nuk mund të konsiderohen si vijë e Partisë; ato e kanë dëmtuar vijën e Partisë, por nuk mundën ta shtrembëronin atë; ato kanë qenë gabime personale, të kryera nga elementë me tendencë të huaja për Partinë si Ymer Dishnica etj. dhe janë goditur ashpër e në kohën e duhur nga Partia.

Në mars 1943 u mbledh Konferenca e parë e Partisë, në ilegalitet. Në Konferencë merrnin pjesë delegatë nga të gjitha organizatat e Partisë të zgjedhur demokratikisht, brenda mundësive të rrethanave të luftës. Konferenca aprovoi unanimisht vijën që kishte ndjekur Komiteti Qendror Provizor, caktoi qëndrimin që duhej të mbante Partia kundrejt okupatorit, «Ballit Kombëtar» dhe reaksionit në përgjithësi, dënoi punën antiparti dhe armiqësore të fraksionistëve Anastas Lula, Sadik Premte etj., caktoi vijën e Partisë për periudhën e ardhshme dhe zgjodhi Komitetin Qendror Definitiv dhe si Sekretar të Përgjithshëm të Partisë shokun Enver Hoxha. Në zgjedhjen e Komitetit Qendror u bë një gabim organizativ, sepse procedura e zgjedhjeve u bë në bazë të një konspiracioni të kalbur¹ dhe jo në bazë të rregullave organizative të Partisë që mund të lejoheshin në atë situatë. Rezultatet e konferencës patën një rëndësi historike për Partinë e popullin tonë. Konferenca sanksionoi vijën e drejtë të Partisë sonë në Luftën nacional-çlirimtare dhe i çeli Partisë perspektivën e sigurtë të fitoreve mbi forcat e armikut. Si rezultat i zbatimit të vijës së Partisë të caktuar në këtë Konferencë u zgjerua dhe u forcua Ushtria jonë Nacional-Çlirimtare, e cila u organizua në forma të rregullta të një ushtrie partizane, u krijua Shtabi i Përgjithshëm si koka drejtuese e të gjitha operacioneve luftarake të ushtrisë sonë, u forcua Fronti Nacional-Çlirimtar, u zgjerua lufta kundër okupatorëve e tradhëtarëve dhe u kalua nga fitorja në fitore.

5) Zhvillimi i gjendjes së brendshme të Partisë sonë gjatë luftës karakterizohet nga përpjekjet e Komitetit Qendror dhe e gjithë organeve të Partisë për vendosjen e principeve marksiste-leniniste në jetën e strukturën e Partisë, nga lufta e ashpër e gjithë Partisë kundër grupazheve dhe fraksionistëve si Niko Xoxi, Anastas Lula, Sadik Premte etj., të cilët u munduan me veprimtarinë e tyre armiqësore dhe antiparti të minonin themelet e Partisë sonë, ta dizorganizonin Partinë, ta dobësonin atë, të merrnin në dorë drejtimin e saj dhe ta likuidonin duke ja dorëzuar borgjezisë.

Partia u rrit dhe u forcua në luftë me grupazhet e fraksionet, duke spastruar radhët e saja pa hezitim nga fundërinat antiparti dhe nga elementët e lëkundur, duke i shtuar radhët e saja me njerëz të thjeshtë që dalloheshin në luftën e armatosur kundër armikut dhe të vendosur për komunizmin e duke u çelënikosur në zjarrin e luftës së ashpër çlirimtare.

Gjatë luftës në jetën e brendshme të Partisë u vendos drejt

¹ Është fjala për konspiracionin që ishte jo i kalbur, por i shtrembër.

parimi i demokracisë së brendshme, u zbatua parimi i zgjedhjeve të organeve drejtuese nga poshtë-lart dhe u zhvillua kritika dhe autokritika, sipas mundësive dhe rrethanave të kohës së luftës. Komiteti Qendror me aktivitetin e tij u bë koka drejtuese e vërtetë e Partisë dhe e udhëhoqi drejt Partinë, sipas mësimëve të Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit.

Partia jonë i formoi dhe i zgjodhi kuadrot e saj në fushën e luftës, duke ndjekur parimin që lufta është prova më e mirë për kuadrot. Duke u udhëhequr nga ky parim u arrit që në krye të Partisë dhe të pushtetit të dalin kuadro të regjur në vështirësitë e luftës, të ndërgjegjshëm e besnikë të Partisë e të popullit.

Vija organizative e Partisë sonë gjatë Luftës nacional-çlirimtare, në përgjithësi, ka qenë e drejtë. Disa gabime organizative që janë vërtetuar gjatë luftës si p.sh. zgjedhjet jo plotësisht demokratike të Komitetit Qendror në Konferencën e parë të Partisë nuk përbëjnë një vijë, nuk e kanë shtrembëruar vijën organizative të Partisë, por kanë rrjedhur nga mungesa e eksperiencës së udhëheqjes sonë.

Stili dhe metoda në punë e Komitetit Qendror dhe e gjithë organeve drejtuese të Partisë gjatë luftës ka qenë i drejtë, ka qenë metoda sipas parimit të aktivizimit të plotë të çdo udhëheqësi dhe e drejtimin në mënyrë operative duke kontrolluar zbatimin e vijës së Partisë në terrenin praktik, me marrjen kontakt direkt të organeve superiore me organet inferiore.

Në Kongresin [Antifashist] Nacional-Çlirimtar të Përmetit, në maj 1944 u muarën vendime me rëndësi historike, nën dritën e vendimeve të Plenumit I të Komitetit Qendror të Partisë sonë, mbajtur në Helmës po atë vit. Aty u vendos krijimi i Komitetit Antifashist me atributet e një qeverie provizore. Në krye të këtij komiteti u zgjodh demokratikisht, nga të gjithë delegatët e ardhur nga të gjitha qarqet e Shqipërisë, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë sonë shoku Enver Hoxha, i cili u zgjodh njëkohësisht edhe Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Këto masa organizative kishin një rëndësi të madhe për vendin dhe popullin tonë. Në këtë mënyrë u bë e mundur që të arrihej së shpejti në suksese edhe më të mëdha, në çlirimin e plotë të vendit. Me vendimet e Kongresit të Përmetit u vulos roli udhëheqës i Partisë sonë në të gjithë sektorët e jetës në vendin tonë. Influenca e Partisë sonë mbërriti kulmin dhe autoriteti i saj u bë autoritet suprem revolucionar në vendin tonë.

Më 29 Nëntor 1944, e gjithë Shqipëria u çlirua nga okupatorët e tradhëtarët, pas tre vjet e gjysmë lufte të pandërprerë të popullit tonë të udhëhequr nga Partia me në krye Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë, shokun Enver Hoxha, kundër një ar-

miku më të fortë. Partia jonë me luftën e saj provoi në jetë fjalët e Marksit e të Engelsit sipas të cilave:

«Një popull që don të fitojë pavarësinë, nuk duhet të kufizohet me metodat e *zakonshme* të luftës. Kryengritje në masë, luftë revolucionare, çeta partizane kudo — ja e vetmja mënyrë me të cilën një popull i vogël mund t'ja dalë një populli të madh, me të cilën një ushtri më pak e fortë mund të përballojë një ushtri më të fortë e më të organizuar»¹.

6) Pas çlirimit filloi një etapë e re për vendin tonë, etapa e rindërtimit dhe e kalimit prej kapitalizmit në socializëm. Veprimtaria e Partisë sonë gjatë këtyre katër vjetëve të pasluftës karakterizohet nga përpjekjet e mëdha të saja për organizimin dhe perfeksionimin e aparatit shtetëror dhe për mobilizimin e masave të gjera të punonjësve në rindërtimin e vendit. Këta katër vjetët e fundit karakterizohen nga ashpërsimi i vazhdueshëm dhe gjithnjë më i madh i luftës së klasave në vendin tonë gjatë së cilës pushteti popullor ka goditur të gjitha bazat ekonomike dhe politike të klasave shfrytëzuese të vendit, përfaqësuesit e të cilëve nuk kanë pushuar kurrë veprimtarinë e tyre reaksionare dhe antipopullore, duke u lidhur me imperializmin anglo-amerikan dhe duke u orvatur vazhdimisht që me ndihmën e imperializmit të përmbysnin pushtetin tonë popullor dhe të vendosnin pushtetin e tyre kapitalist. Këto katër vjetët e pasluftës karakterizohen edhe nga orvatjet sistematike të udhëheqjes trockiste jugosllave për të zhdukur independencën e Partisë e për të kolonizuar vendin tonë, duke ndërhyrë arbitrarisht e brutalisht në punët e brendshme të Partisë e të vendit tonë me mbështetjen efektive dhe koshiente të Koçi Xoxes, Pandi Kristos etj.

Gjatë këtyre katër vjetëve, Partia jonë ka qenë në luftë të vazhdueshme e të ashpër me armiqtë e jashtëm e të brendshëm të Partisë dhe të popullit, porse ajo ka mundur t'i kapërcejë të gjitha vështirësitë, ta udhëheqë drejt popullin në rrugën e ndërtimit të socializmit dhe të korrë suksese të dukshme në këtë drejtim. Me gjithë përpjekjet e imperialistëve anglo-amerikanë dhe të gjithë armiqtë të jashtëm të vendit për të sabotuar punën e Partisë dhe të popullit tonë dhe për të përmbysur pushtetin tonë popullor, me ndihmën e reaksionit të brendshëm dhe me gjithë përpjekjet e trockistëve jugosllavë dhe të bashkëpunëtorëve të tyre në gjirin e Partisë sonë për të zhdukur independencën tonë, sado që Partia dhe populli ynë u gjendën në mes

¹ K. Marks e F. Engels. Veprat, vëll. 6, f. 416, botim i dytë rusisht, 1957.

të dy zjarreve armiq, vendi ynë ka ecur përpara në rrugën e socializmit, ka korrur suksese të mëdha dhe këto në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë sonë, të patriotizmit të shëndoshë të popullit tonë trim e punëtor dhe të ndihmës së paçmueshme të Bashkimit Sovjetik.

a) Me zbatimin e reformës agrare tek ne u përmbysën raportet e vjetra feudale dhe borgjeze të pronësisë së tokës, u çlirova fshatarësia punonjëse nga shtypja shekullore e beut dhe e agait, u likuidua prona e madhe private bujqësore, u ndalua shitblerja e tokës, u krijua sektori socialist e kooperativist në ekonominë bujqësore dhe u hap perspektiva e zhvillimit të mëtejshëm të bujqësisë sonë drejt bujqësisë socialiste. Krijimi i një numri kooperativash bujqësore të punës është hapi i parë drejt kolektivizimit në fshat, sado që në këtë drejtim janë vërtetuar edhe gabime parimore si p.sh. ndarja e fitimeve që bëhej 40 për qind në bazë të pronësisë së tokës dhe 60 për qind në bazë të punës, gjë që nuk është aspak e drejtë sepse i lë rast spekulimit dhe lindjes së kapitalizmit në gjirin e kooperativave. Këto gabime kanë rrjedhur nga influenza e udhëheqjes trockiste jugosllave mbi format organizative dhe në të gjithë politikën ekonomike të Partisë sonë. Orientimi i parë i ekonomisë sonë bujqësore d.m.th. orientimi drejt prodhimit të bukës së popullit në vendin tonë dhe drejt prodhimit sa më të madh të bimëve industriale, ka qenë plotësisht i drejtë. Ky orientim u përmbys gjatë vitit 1947 me ndërhyrjen e udhëheqjes trockiste jugosllave në drejtimin e ekonomisë sonë dhe u zëvendësua me orientimin e gabuar të prioritetit të bimëve industriale në dëm të prodhimit të bukës së popullit, me qëllim që vendi ynë të varej nga Jugosllavia edhe për bukën e gojës¹. Me masat që ka marrë Partia dhe pushteti, me gjithë pengesat e hasura, bujqësia jonë ka bërë përparime të dukshme, është shtuar sipërfaqja e mbjellë, hynë për të parën herë kulturat industriale, janë ngritur stacionet e maqinave bujqësore dhe të traktorëve që i vijnë në ndihmë direkte fshatarit, janë zgjeruar e përmirësuar kooperativat e punës, janë modernizuar e zgjeruar feramat shtetërore, janë bërë përpjekje për aplikimin e një agroteknike të përparuar, janë marrë masa për seleksionimin e përmirësimin e racës së kafshëve, janë shtetëzuar kopetë e mëdha, është shtuar rendimenti i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale etj. Porse këto suksese nuk janë të mjafta. Përderisa në fshat ekziston prona private ekziston

¹ Ky orientim ishte i gabuar, sepse sipas tij vendi ynë nuk duhej të zhvillonte industrinë, por të kthehej në një prodhues të lëndës së parë bimësh industriale dhe mineralesh, kurse bukën dhe artikujt e fabrikuar duhej t'i sillnim nga jashtë, në radhë të parë nga Jugosllavia.

edhe rreziku i zhvillimit të kapitalizmit në fshat. Përderisa nuk janë krijuar akoma mundësitë e kolektivizimit të gjerë në bujqësi, mbetet kurdoherë një problem i madh për Partinë për t'i krijuar këto kondita në të ardhshmen.

b) Sot e gjithë industria është në duart e shtetit, fabrikat janë të popullit se shteti është i popullit dhe punëtori e drejton vetë punën e fabrikës. Fabrika nuk është më një vend skllavërimi, si më parë për punëtorin, por është një vend pune e nderi, një vend prodhimi, për vetë punëtorin e për gjithë popullin, është një shkollë ku punëtori mëson si të punojë e të drejtojë më mirë maqinën. Sot minierat tona prodhojnë shumë më tepër se sa prodhonin para luftës. Ne kemi ngritur fabrika të reja, kemi çelur puse vajgurore të reja, kantiere të reja pune etj. Me punën e palodhshme të klasës sonë punëtore, me ndihmën e madhe të Bashkimit Sovjetik dhe nën udhëheqjen e drejtë të Partisë, industria jonë ka bërë hapa përpara dhe zhvillohet çdo ditë e më tepër me gjithë shkatërrimet e luftës, me gjithë sabotimet e reaksionarëve të vendit, shërbëtorë të imperializmit anglo-amerikan, me gjithë veprimtarinë armiqësore të udhëheqjes trockiste jugosllave për ta vënë industrinë tonë në shërbim të interesave të saj grabitqare dhe me gjithë mungesën e eksperiencës së kuadrove tanë. Zhvillimi i industrisë dhe i minierave ka bërë dhe do të bëjë që të shfrytëzohen sa më mirë e sa më tepër pasuritë e tokës dhe të nëntokës së vendit tonë, të përmirësohen konditat e jetesës së popullit, të forcohet ekonomia jonë në përgjithësi dhe të shtohet e të forcohet klasa punëtore që është baza e Partisë sonë dhe drejtuesja e të gjitha masave punonjëse, si dje në luftën për çlirim të vendit ashtu edhe sot në luftën për paqe dhe për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Prandaj Partia ka pasur dhe do të ketë kurdoherë si objektiv me rëndësi industrializimin dhe elektrifikimin e vendit.

c) Duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm që duhet të luajnë financat popullore në sistemin tonë ekonomik është bërë një ndryshim rrënjësor në lëmin financiar dhe janë arritur suksese të dukshme. Është krijuar një sistem financiar krejt i ri, i cili bazohet në eksperiencën e financave sovjetike. Kanë hyrë në zbatim një sërë ligjesh financiare, të cilat u përgjigjen plotësisht detyrave të pushtetit popullor dhe zhvillimit të ekonomisë sonë popullore. Është krijuar një sistem tatimesh, i cili bazohet në parimet e tatimit progresiv «të ardhurat më të mëdha taten me tatime më të mëdha». U goditën rëndë me tatime tregëtarët e mëdhenj dhe spekullatorët. U organizuan ndërmarrjet shtetërore dhe u vendos në to parimi i rëndësishëm organizativ «hozrashoti», hyri në zbatim planifikimi financiar, kosto e planifikuar, u zhduk karakteri spontan i ligjit të vlerës dhe akumulimi shtetëror krijohet me plan sipas nevojave të buxhetit. Ndërroi krejtë-

sisht forma dhe struktura e buxhetit shtetëror. Banka e Shtetit u bë i vetmi institut krediti dhe mbështetje për financimin e ekonomisë sonë popullore. Por financat tona duhet akoma që të forcohen dhe të modernizohen në mënyrë që të bëjnë financimin efektiv e jo sipas planit, të normalizohen shpenzimet dhe të krijojnë kudo një regjim i fortë kursimi. Të perfeksionohet planifikimi financiar dhe të organizohet kudo një sistem modern i kontabilitetit. Kështu që nën drejtimin e Partisë dhe të mbështetura në eksperiencën e madhe të financave sovjetike, financat tona të bëhen me të vërtetë një armë e fortë në dorë të shtetit popullor për zhvillimin e forcimin e ekonomisë dhe të kulturës së popullit dhe të organizojmë si duhet qarkullimin monetar.

ç) Sot tregëtia kryesore që furnizon popullin, që vesh, mbath dhe ushqen popullin, është në duart e shtetit. Ne kemi ngritur kooperativat e shitblerjes, të cilat janë një ndihmë e madhe për popullin, me anën e të cilave shteti konkuron tregëtinë private dhe kufizon zhvillimin e kapitalizmit në vendin tonë. Shteti ka ndaluar shitjen e blerjen e tokës si dhe tregëtinë private me bukën e popullit, për të mos lejuar grumbullimin e tokës në duart e një pakice kulakësh dhe për të mos lejuar spekulimin e tregëtarëve privatë mbi bukën e popullit. E gjithë tregëtia me shumicë dhe në pjesën më të madhe ajo me pakicë bëhet nga shteti i ndihmuar nga sektori kooperativist.

Është ngritur një numër i madh ndërmarrjesh tregëtare; është zgjeruar rrjeti detaist¹ në tregëti, janë ngritur një numër i madh kooperativash konsumi dhe shitblerjeje, të cilat bashkë me sektorin shtetëror furnizojnë popullin e fshatit e të qytetit dhe luftojnë sektorin privat spekulator, aktiviteti i të cilit është zvogëluar. Shteti me sistemin e grumbullimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale, siguron furnizimin e popullit, plotëson nevojat e industrisë dhe forcon eksportimet. Porse tregëtia jonë ka qenë penguar shumë nga politika e udhëheqjes trockiste jugosllave në vendin tonë, politikë e cila synonte izolimin tonë ekonomik nga demokracitë e tjera popullore e sidomos nga Bashkimi Sovjetik. Tregëtia jonë ka bërë përmirësime të dukshme, porse ka akoma mjaft të meta si p.sh. mungesa e planifikimit të mirë të grumbullimit e të shpërndarjes, të importimit dhe eksportimit, të qarkullimit të shpejtë të mallit etj. Në drejtimin e Partisë dhe me ndihmën e madhe të Bashkimit Sovjetik, tregëtia jonë është duke u forcuar; ajo ka për objektiv ngritjen e nivelit të jetesës së masave punonjëse, forcimin dhe zgjerimin e sektorit kooperativist dhe kufizimin e tregëtisë private. Porse tek ne ekziston edhe sektori privat i tregëtisë që përbëhet nga

1 Detaist — rrjeti i tregëtisë me pakicë.

një numër i konsiderueshëm tregëtarësh të vegjël e të mesëm. Prandaj shteti nëpërmjet zhvillimit dhe forcimit të sektorit shtetëror dhe kooperativist në tregëti, dhe duke pasur në dorë monopolin e eksportimeve dhe të importimeve, duhet të drejtojë tregëtinë private në mënyrë që kjo të kufizohet, të punojë për interesin e popullit dhe të ndalohej spekulimi.

d) Në sektorin e ndërtimeve dhe të komunikacionit gjithashtu kemi pasur suksese. Me gjithë sabotimet e shumë teknikëve të vjetër që u vunë në shërbim të spiunazhit të huaj, me gjithë shkatërrimet që na la lufta, me gjithë pengesat dhe sabotimet e jugosllavëve në sektorin e ndërtimit ne kemi mundur të ndreqim të gjitha urat, rrugët, një pjesë të madhe të ndërtesave që na shkatërroi lufta, kemi bërë ndërtime të reja si kanale, rrugë etj. Për herë të parë në vendin tonë janë ndërtuar hekurudha. Të gjitha ndërtimet në vendin tonë kryhen nga ndërmarrjet shtetërore dhe jo nga ndërmarrjet private si më parë. Mjetet e transportit me fuqi motorike janë të gjitha në duart e shtetit. Porse transporti është akoma prapa dhe me zor të madh po i plotëson nevojat e planit të shtetit dhe të popullsisë.

dh) Arësimi sot është bërë i popullit. Kudo janë hapur shkolla fillore dhe do të hapen edhe atje ku nuk janë hapur akoma. Ne e kemi shtuar numrin e shkollave fillore, unike dhe të mesme gjatë këtyre katër vjetëve më tepër se sa gjatë 15 vjetëve të regjimit të Zogut. Gjithashtu numri i nxënësve është shtuar shumë. Puna e madhe që është bërë për të zhdukur analfabetizmin ka bërë që në kurset e gjera për këtë punë të mësojnë të shkruajnë dhe të këndojnë dhjetëra mijëra gra e burra. Djemtë e punëtorëve dhe të fshatarëve sot janë duke përvetësuar teknikën. Për herë të parë në historinë tonë djemtë e popullit po drejtojnë minierat tona, trena e maqineri të komplikuar. Qindra djem e vajza të popullit janë dërguar gjatë këtyre vjetëve të çlirimit në shkollat e larta e në universitetet e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracive popullore, të cilët do të jenë inxhinierët, agronomët, mjekët e profesorët e ardhshëm të vendit tonë. Kultura dhe arti kanë bërë hapa përpara tek ne, me gjithë përpjekjet e udhëheqjes trockiste jugosllave për t'i drejtuar ato në rrugën e shtrembër të nacionalizmit borgjez dhe me gjithë influencën borgjeze që ekziston akoma në njerëzit e kulturës dhe të artit që kanë studjuar në shkollat borgjeze. Nuk ka pasur përpjekje sa duhej nga ana jonë për ta edukuar inteligjencien e vendit tonë mbi baza të marksizëm-leninizmit dhe të bëhej diferencimi i nevojshëm në gjirin e saj. Sado që kemi pasur suksese të dukshme në sektorin e arësimit, të kulturës e të artit, na mbetet shumë akoma për të bërë në të ardhshmen, sidomos për sa i përket luftës që i duhet bërë influencës së ideologjisë borgjeze

në shkollën dhe inteligjencien tonë dhe edukimit të brezit të ri në baza të shëndosha të marksizëm-leninizmit.

e) Ndërsa në regjimet e mëparshme shëndeti i popullit ishte lënë në mëshirën e fatit, sot pushteti ynë i kushton atij një kujdes të veçantë. Një punë e madhe është bërë për luftën kundër malarjes dhe sëmundjeve të rrezikshme si tuberkulozi, sifilisi etj. Janë hapur spitale, ambulanca, sanatoriume, çerdhe fëmijësh etj.

ë) Sot ne kemi një ushtri të fortë e besnike. Ajo ka lindur nga Lufta nacional-çlirimtare; populli vetë e ka formuar duke luftuar vullnetarisht në radhët e saja gjatë luftës e duke e ndihmuar me çdo gjë. Ajo sot po forcohet e modernizohet në shembullin e Ushtrisë së lavdishme Sovjetike... Me gjithë përpjekjet e shumta të udhëheqjes trockiste jugosllave për ta transformuar ushtrinë tonë në një armatë jugosllave dhe për ta bërë atë një ushtri antisovjetike, ajo ruajti rrugën e drejtë që i caktonte Komiteti Qendror i Partisë sonë dhe Komandanti i Përgjithshëm. Ushtria jonë është e fortë e besnike se oficerët tanë, kuadrot e ushtrisë kanë dalë nga zjarri i luftës, se ushtarët tanë dinë përse mbajnë armën në dorë, sepse ata janë djemtë e punëtorëve, të fshatarëve e të masave punonjëse. Ajo është e fortë dhe besnike sepse u krijua dhe u rrit me frymën e besnikërisë ndaj popullit, ndaj Partisë sonë dhe Ushtrisë Sovjetike, Partisë Bolshevike e Stalinit të madh.

f) Klasa jonë punëtoare, që në të kaluarën shfrytëzohej gjer në palcë nga klasat sunduese, sot është çliruar nga çdo shtypje dhe gëzon të gjitha të drejtat. Dje ajo ishte në ballë të Luftës nacional-çlirimtare, udhëhiqte luftën e popullit. Sot ajo rritet dita-ditës, po edukohet nga Partia e saj, nga Partia e Punës, dhe nën udhëheqjen e Partisë ajo është në krye të luftës së popullit për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

Klasa jonë punëtoare, nga radhët e së cilës kanë dalë e po dalin me qindra sulmues, e frymëzuar nga shembulli i punëtorëve heroikë të BS ka mobilizuar të gjitha forcat e saja që vendi ynë të shkojë në socializëm dhe populli të gëzojë një jetë të lumtur e të begatshme.

Sindikatat, të krijuara menjëherë pas çlirimit e që kanë grumbulluar në radhët e tyre masat e punëtorëve e të nëpunësve të vendit tonë, kanë luajtur një rol të rëndësishëm duke ndihmuar Partinë në edukimin dhe ngritjen e koshiencës së klasës punëtoare, në mobilizimin e saj e në zhvillimin e emulacionit socialist për realizimin e planit të shtetit dhe kanë ndihmuar në forcimin e perfeksionimit e aparatit të pushtetit popullor.

g) Rinia jonë e udhëhequr nga Partia luftoi me heroizëm gjatë Luftës nacional-çlirimtare dhe pas çlirimit punon me vetëmohim për ndërtimin e vendit në fabrika, fshatra etj. Ajo ndërmori aksione të mëdha si ndërtimin e rrugës Kukës-Peshkopi,

të hekurudhës së parë të vendit tonë Durrës-Peqin, të hekurudhës Durrës-Tiranë etj., të cilat u bënë shkolla për kalitjen e rinisë, për zhvillimin e cilësive të larta që fitoi rinia gjatë luftës. Në shkolla, kurse, institucione kulturele etj., që ka ngritur pushteti popullor, me mijëra e mijëra djem të popullit punonjës po mësojnë me entuziazëm dhe po përgatiten ndërtuesit e rinj të socializmit. Rinia, duke zbatuar me entuziazëm dhe vendosmëri detyrat që i ngarkon Partia dhe shoku Enver Hoxha, është bërë mburrja e popullit tonë në luftën për ndërtimin e socializmit ashtu si ishte dje mburrja e popullit tonë në luftën për çlirimin e vendit. Organizata e Rinisë Komuniste ka qenë kurdoherë ndihmësja kryesore e Partisë, u bë shpirti i rinisë popullore dhe mobilizoi në vijën e Partisë masat e gjera të rinisë.

gj) Gruaja e cila në të kaluarën ishte më e shtypura nga të gjithë e s'gëzonte asnjë të drejtë në jetën politike e shoqërore, sot ka fituar të gjitha të drejtat demokratike, të garantuara me ligj, ka fituar barazinë me burrin në jetën ekonomike, politike, shoqërore e private. Të udhëhequra nga Partia masat e grave shqiptare dhanë një kontribut të rëndësishëm për çlirimin e vendit dhe për vendosjen e pushtetit popullor. Sot pjesëmarrja e tyre në prodhim dhe roli në jetën politike të vendit po rritet vazhdimisht. Organizata e Gruas Shqiptare ka mobilizuar masat e grave në vijën e Partisë për pjesëmarrjen në prodhim, për luftën kundër injorancës e prapambetjes etj. Por me gjithë këto gruaja akoma nuk është çliruar plotësisht nga paragjykimet prapanike dhe nga gjendja e prapambetur kulturele e shoqërore.

h) Fronti gjatë luftës për çlirimin e vendit i udhëhequr nga Partia Komuniste bashkoi e mobilizoi masat e gjera të popullit në luftë kundër okupatorit dhe tradhëtarëve për çlirimin e vendit. Pas çlirimit Fronti Demokratik nën udhëheqjen e Partisë ka mobilizuar masat e gjera të popullit për ndërtimin e vendit dhe për forcimin e pushtetit popullor.

Vija e Partisë në lidhje me Frontin ka qenë në përgjithësi e drejtë, megjithëse janë vërtetuar gabime serioze në praktikë si p.sh. mbajtja e Partisë në gjendje gjysmë legaliteti dhe fshehja e anëtarëve të Partisë nën titullin e anëtarëve të Frontit, mosdalja haptas në popull me flamurin e Partisë, por me flamurin e Frontit, fshehja e zyrave të Partisë nën emrin e zyrave të Frontit, gabime këto që kanë rrjedhur nga influenca e udhëheqjes trockiste jugosllave në Partinë dhe vendin tonë, e cila ka synuar në nënvleftësimin e rolit udhëheqës të Partisë, në konsiderimin e Frontit si forcën kryesore drejtuese të vendit dhe në shkrirjen e Partisë në Front.

7) Në kohën kur Shqipëria ishte në prakun e çlirimit të plotë të saj nga okupatorët gjermanë dhe reaksionarët e vendit, udhëheqja e Partisë Komuniste Jugosllave, duke u nisur nga

pozitat e saja nacionaliste-borgjeze me frymë trockiste, duke spekulluar në dashurinë dhe besimin e Partisë e të popullit tonë në Partinë dhe popujt e Jugosllavisë, dashuri e lindur dhe e forcuar në luftën kundër armikut të përbashkët, filloi ndërhyrjen e saj të hapët në punët e brendshme të Partisë dhe të vendit tonë. E gjithë periudha, që nga çlirimi i Shqipërisë dhe deri nga mesi i këtij viti, karakterizohet nga ndërhyrja direkte e udhëheqjes jugosllave në punët e Partisë e të vendit tonë. Me këtë ndërhyrje të padrejtë të udhëheqjes jugosllave, vija organizative e Partisë sonë u transformua nga një vijë në përgjithësi e drejtë në një vijë në përgjithësi jo të drejtë pasi e gjithë puna organizative e Partisë sonë u orientua nga vija organizative e Partisë Komuniste Jugosllave. Megjithatë vija politike e Partisë sonë mbeti në përgjithësi e drejtë deri aty nga fundi i vitit 1947, kur ndërhyrja e udhëheqjes jugosllave u shfaq në format më arbitrare e brutale dhe vija jonë politike u dëmtua shumë rëndë për një kohë. Porse udhëheqja trockiste jugosllave dhe bashkëpunëtorët e saj në Partinë tonë si Koçi Xoxe, Pandi Kristo etj., me të gjitha orvatjet e tyre të shfrenuara, nuk mundën dot kurrë të mposhtnin besimin e patundur të Partisë e të popullit tonë ndaj Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike dhe shokut Stalin. Në politikën e jashtme, orientimi i Partisë sonë ka qenë kurdoherë i drejtë, ka qenë orientimi ndaj Bashkimit Sovjetik, sado që në udhëheqjen e Partisë ka pasur elementë me tendenca antisovjetike të theksuara si Koçi Xoxe etj., që kanë zbatuar verbërisht politikën e udhëheqjes antisovjetike të Partisë Komuniste Jugosllave në Partinë dhe në vendin tonë.

Partia jonë në punën e saj të brendshme, gjatë luftës, ka hasur në pengesa të brendshme siç ka qenë veprimtaria antiparti e grupazheve dhe e fraksioneve të Anastas Lulës, Sadik Premtes etj. si edhe veprimtaria oportuniste e njerëzve si Ymer Dishnica dhe gabimet e Liri Gegës. Pas çlirimit, pengesa kryesore në punët e brendshme të Partisë sonë ka qenë veprimtaria trockiste e udhëheqjes së Partisë Komuniste Jugosllave me ndërhyrjen e saj brutale në punët e Partisë sonë si edhe veprimtaria armiqësore e trockiste e sekretarit organizativ të Partisë, Koçi Xoxe etj. Të gjitha gabimet e rënda, që janë vërtetuar në jetën e Partisë sonë e kanë burimin në influencën, presionin dhe ndërhyrjen e jashtligjshme të udhëheqjes trockiste jugosllave në udhëheqjen e Partisë sonë, në presionin e ideologjisë borgjeze mbi Partinë tonë, si refleks në Parti, i ashpërsimit të luftës së klasave të vendit, në nivelin e ulët ideologjik të Partisë sonë dhe në eterogjenitetin e përbërjes së Partisë sonë.

8) Plenumi II i Komitetit Qendror, i mbajtur në Berat në nëntor 1944, shënon fillimin e ndërhyrjes së udhëheqjes jugosllave në punët e brendshme të Partisë sonë, e përgatitjes së

zhdukjes së independencës së Partisë e vendit tonë nga udhëheqja jugosllave dhe bashkëpunëtorët e saj në Partinë tonë. Në këtë plenum, udhëheqja jugosllave, e mbështetur në disa udhëheqës karrrieristë dhe ambiciozë të Partisë sonë, organizoi një prapaskenë antimarksiste kundër vijës së drejtë të Partisë sonë, kundër unitetit të udhëheqjes dhe kundër Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha. Qëllimi i udhëheqjes trockiste jugosllave u realizua në Plenumin II: u spostua me mjeshtëri qëllimi i drejtë i plenumit në qëllimet antimarksiste të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave; u godit vija e drejtë e Partisë me armën e shpifjes se gjoja ajo kishte qenë një vijë oportuniste dhe sektare; u godit vija organizative me armën e prapaskenës me frymë grupazhi e fraksioniste, kurdisur nga i deleguari i udhëheqjes jugosllave; u godit padrejtësisht udhëheqja dhe Sekretari i Përgjithshëm i Partisë; u godit uniteti i udhëheqjes; u futën në Parti format organizative antimarksiste të Partisë Komuniste Jugosllave; u fut në udhëheqje të Partisë fryma oportuniste e Sejfulla Malëshovës dhe fryma sektare e trockiste e Koçi Xoxes. Në këtë mënyrë, u pregatit terreni i favorshëm në Partinë tonë nga udhëheqja jugosllave, për t'u kultivuar më pastaj nga të favorizuarit e saj Koçi Xoxe e Pandi Kristo, drejt nënshtrimit të plotë të Partisë e të vendit tonë ndaj udhëheqjes trockiste, antimarksiste e antisovjetike të Partisë Komuniste Jugosllave. Në këtë mënyrë, rezultatet e Plenumit II qenë mina e parë trockiste në themelet e unitetit të udhëheqjes sonë, të vijës organizative të Partisë, qenë fillimi i mohimit të vijës së drejtë të Partisë, të independencës së saj e të vendit.

9) Për ta çuar Komitetin Qendror, të dizorientuar, të Partisë sonë në rrugën marksiste-leniniste, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë, shoku Enver Hoxha, paraqiti në qershor 1946, para Byrosë Politike të Komitetit Qendror, tezat e tija mbi revizionimin e punimeve të Plenumit II. Këto teza nuk u aprovuan nga Byroja Politike, për shkak të kundërshtimit që u tregua nga ata anëtarë të Byrosë që kishin bashkëpunuar me ndërjegje me Komitetin Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave në organizimin e prapaskenës së Plenumit II sidomos nga Koçi Xoxe. Në këtë mënyrë, kontradiktat e brendshme në udhëheqjen e Partisë u ashpërsuan edhe më tepër dhe u krijua një gjendje e vështirë në udhëheqje, në të cilën mundi të mbështetej efektivisht udhëheqja jugosllave, për t'i thelluar akoma më tepër kontradiktat e brendshme në udhëheqjen tonë për qëllimet e saj antimarksiste, antisovjetike dhe kundër Partisë e vendit tonë.

10) Duke konsideruar se vendi ynë i vogël, i varfër dhe i shkatërruar nga lufta, nuk mund të rimëkëmbej ekonomikisht dhe të ndërtonte socializmin vetëm, pa ndihmën e miqve të jash-

tëm, Partia jonë e kërkoi këtë ndihmë nga Bashkimi Sovjetik dhe nga Jugosllavia e më vonë edhe nga demokracitë e tjera popullore, në një shkallë më të vogël. Traktati i miqësisë dhe i ndihmës reciproke që nënshkroi qeveria jonë në korrik 1946 me Qeverinë Federative Jugosllave ishte i drejtë. Komiteti Qendror i Partisë sonë i pranoi me besim të madh Konventën ekonomike dhe format e kreditit e të bashkëpunimit me Jugosllavinë Federative. Porse nën maskën e Konventës ekonomike dhe të protokolleve të tjera të mëpastajme, udhëheqja trockiste jugosllave fshihte qëllimet e saj antimarksiste, imperialiste, shfrytëzuese e koloniale kundër interesave të Partisë e të popullit tonë. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave i përdori këto marrëveshje e protokolle si një levë politike të mbështetur në disa udhëheqës antimarksistë e me frymë trockiste të Partisë sonë, për të varrosur pavarësinë e Partisë e të Republikës sonë. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare kërkoi vazhdimisht nga udhëheqja jugosllave që të përcaktoheshin mirë konditat e kreditit dhe ka kundërshtuar haptas zbatimin jo të drejtë të protokolleve të unifikimit të çmimeve, të parifikimit të monehdës dhe të bashkimit doganor me Jugosllavinë, megjithëse Komiteti ynë Qendror nuk i shihte akoma kjartë qëllimet e vërteta të udhëheqjes jugosllave dhe nuk ishte në gjendje që t'i zbulonte qysh atëhere këto qëllime djallëzore. Udhëheqja jugosllave kishte për qëllim që ekonomia jonë të zhvillohej vetëm nën prizmin e ekonomisë jugosllave, e kondicionuar dhe e varur nga ajo, që shfrytëzimi i pasurisë së nëntokës të vendit tonë të shërbente për të furnizuar me lëndë të parë «metropolin» Jugosllavi dhe kështu të mos kishte asnjë perspektivë dhe mundësi industrializimi dhe elektrifikimi në vendin tonë; që bujqësia jonë të mbej primitive, të prodhonte bimë industriale, të cilat duhej të shërbenin si lëndë të para për industrinë jugosllave, që Shqipëria të ishte në mëshirën e Jugosllavisë dhe të furnizohej me bukë e me artikuj të konsumit të gjerë të prodhuar në Jugosllavi, në sasi të që të donte Jugosllavia dhe me çmimet që të donte ajo. Për të mundur më lehtë që të realizonte qëllimet e saj në vendin tonë, udhëheqja trockiste jugosllave u përpoq me çdo mënyrë që ta izolonte vendin tonë nga demokracitë e tjera popullore e sidomos nga burimi mëmë i të gjitha fitoreve tona, nga Bashkimi Sovjetik, Partia Bolshevike dhe Stalini i madh.

11) Viti 1947 u karakterizua nga lufta dhe përpjekjet e klasës sonë punëtore dhe e gjithë masave punonjëse për realizimin e planit të shtetit, u karakterizua gjithashtu edhe nga lufta politike e ideologjike e Komitetit tonë Qendror që mbronte independencën ekonomike dhe politike të vendit, kundër politikës antimarksiste, antisovjetike e trockiste të grupit nacionalist të Titos e pikëpamjeve trockiste të Koçi Xoxes e Pandi Kristos. Në

krye të kësaj lufte parimore kundër tendencave shfrytëzuese e koloniale, tashmë të dukshme, të grupit të Titos, ka qenë shoku Enver Hoxha, shoku Nako Spiru dhe mjaft shokë të tjerë të Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror.

12) Udhëheqja antimarksiste jugosllave, duke parë se pjesa më e shëndoshë e udhëheqjes së Partisë sonë me në krye shokun Enver Hoxha, po tregonte një rezistencë të ashpër në luftën parimore të Komitetit Qendror të Partisë sonë kundër saj, duke parë se Koçi Xoxe, Pandi Kristo e të tjerë, në të cilët ajo mbështetej efektivisht, nuk mundnin vetëm për vetëm të mposhtnin vullnetin e shokut Enver Hoxha, e të shokëve që ishin solidarë me të në mbrojtjen e vijës së drejtë të Partisë sonë, vendosi të akuzonte haptas Komitetin Qendror të Partisë sonë. Akuza e parë e udhëheqjes jugosllave, e bërë në pranverë 1947, kundër Komitetit Qendror të Partisë sonë pretendonte sikur gjoja vija e Partisë sonë po shtrembërohej dhe se në të po kristalizohej një vijë e dytë «me frymë antijugosllave». Byroja jonë Politike e hodhi poshtë këtë akuzë si të padrejtë dhe tendencioze. Në marrjen e vendimit për hedhjen poshtë të kësaj akuze, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo u treguan të hezitur sado që nuk mundën të viheshin në kundërshtim të hapët me Byronë Politike.

13) Objektivat kryesore të udhëheqjes trockiste jugosllave në vendin tonë, kapja e të cilëve do të përcaktonte zhdukjen e indipendencës sonë, ishin Partia, Sigurimi i Shtetit, ekonomia dhe ushtria. Sigurimin e Shtetit ata e shtinë nën influencën e tyre me anën e Koçi Xoxes. Partinë ata e kishin minuar me sukses në udhëheqjen e saj, po me anën e Koçi Xoxes dhe të Pandi Kristos. Porse Partia akoma nuk ishte mposhtur. Masat e Partisë me gjithë përpjekjet e Koçi Xoxes që me metodat e tija trockiste të huajtura nga udhëheqja jugosllave e kishte transformuar në një detashment partizan me një regjim burokratik nën kontrollin e Sigurimit të Shtetit, i kishin sytë nga shoku Enver, nga Partia Bolshevike dhe Stalini i madh e jo nga Koçi Xoxe, udhëheqja jugosllave dhe trockisti Tito. Ekonomia jonë me të gjitha përpjekjet e jugosllavëve, gjithashtu zhvillohej drejt simbas vijës së caktuar nga Komiteti [Qendror] i Partisë sonë, në kundërshtim me vijën ekonomike që donin të na impononin udhëheqësit jugosllavë. Në ushtri, duke u përkrahur plotësisht dhe verbërisht nga Kristo Themelko e Pullumb Dishnica, udhëheqja trockiste jugosllave bëri të gjitha përpjekjet për transformimin e ushtrisë sonë në një armatë jugosllave e antisovjetike dhe për të zëvendësuar artin ushtarak stalinian, sipas të cilit po modernizohet ushtria jonë, me të ashtuquajturin «art special ushtarak» të Titos. Por edhe në sektorin e ushtrisë udhëheqja trockiste jugosllave, deri nga fundi i vitit 1947, nuk pati sukses për shkak të rezistencës së fortë që ushtronte shtatmadhuria jonë

e cila mbronte vijën e drejtë të Komitetit Qendror të Partisë sonë, zbatonte urdhërat dhe direktivat e drejta të Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, mbronte indipendencën e ushtrisë e të vendit si edhe artin ushtarak stalinian kundër pikëpamjeve antisovjetike e antishqiptare të udhëheqjes jugosllave. Kështu udhëheqja trockiste jugosllave mejttoi se do t'i kapte edhe të tre objektivat e tjerë, Partinë, ekonominë dhe ushtrinë me anën e shantazheve e presioneve nga jashtë dhe me metodat puçiste e trockiste që nga brenda me anën e Koçi Xoxes etj.

14) Për t'ua arritur qëllimeve të tij, për të mposhtur objektivin kryesor d.m.th. udhëheqjen e Partisë sonë, grupi nacionalist i Titos, duhej para së gjithash të mposhte vullnetin dhe pikëpamjet e drejta të Komitetit Qendror të Partisë sonë dhe të shokut Enver Hoxha, në të cilin ata shihnin pengesën më të madhe për rrugën e tyre në vendin tonë. Grupi trockist i Titos kërkonte të eliminonte nga udhëheqja, bashkë me shokun Enver Hoxha edhe shokët Nako Spiru, Mehmet Shehu etj. që ishin solidarë me Sekretarin e Përgjithshëm të Partisë në luftën për mbrojtjen e vijës së drejtë politike të Partisë sonë dhe që udhëheqësit trockistë jugosllavë i konsideronin si një pengesë të madhe.

15) Në nëntor 1947, udhëheqja trockiste jugosllave e akuzonte Partinë tonë shumë rëndë. Partia jonë akuzohej haptazi pse luftonte për forcimin e marrëdhënieve të shumanshme dhe për shtimin e dashurisë për Bashkimin Sovjetik, për Partinë Bolshevike dhe për shokun Stalin. Trockistët jugosllavë akuzuan haptazi shokun Enver Hoxha se pas ardhjes së tij nga Moska ai e kishte «ndryshuar politikën karshi Jugosllavisë». Ata akuzonin Partinë tonë se gjoja kjo kishte lejuar një front antijugosllav në vendin tonë dhe si rrjedhim akuzonin qeverinë tonë se gjoja ajo lidhur me Jugosllavinë, bënte një politikë në kundërshtim diametral me aspiratat e popullit shqiptar. Akuzonin qeverinë tonë se kjo bënte një politikë shkëputjeje nga Jugosllavia, politikë që gjoja kishte shkaktuar që marrëdhëniet në mes të popullit shqiptar dhe atij jugosllav të ishin përtokë. Ata akuzonin qeverinë shqiptare se kishte hartuar një projektplan pesëvjeçar që ishte ireal dhe autarqik, që e çonte ekonominë tonë në shkëputjen nga ekonomia jugosllave. Ata akuzonin Qeverinë dhe Partinë tonë se në lëmin kultural ato orientoheshin nga kultura borgjeze perëndimore. Grupi trockist i Titos akuzonte haptazi shokun Nako Spiru si bashkëpunëtor me armikun. Këto akuza shpifarake të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave ishin një grusht vdekjeprurës për Partinë tonë. Këto ishin arma më e fortë që i dhanë mundësitë Koçi Xoxes e Pandi Kristos të dilnin si «heronj» të situatës, si «shpëtimtarë» të Partisë nga «frak-

sioni» në kokë të Partisë që gjoja ekzistonte. Koçi Xoxe u paraqit sikur jugosllavët me këto akuza i dhanë atij flamurin e shpëtimtarit të Partisë, ndërsa në të vërtetë udhëheqja antimarksiste jugosllave u dha në dorë Koçi Xoxes, Pandi Kristos etj. kazmën trockiste, për të shkallmuar themelet e Partisë dhe të independencës së vendit tonë.

16) Për të plotësuar qëllimet armiqësore të udhëheqjes trockiste jugosllave dhe për të realizuar aspiratat e tyre arriviste dhe ambicioze Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo u bënë flamurtarët dhe mbrojtësit më të zjarrtë të platformës trockiste të udhëheqjes jugosllave në Byronë tonë Politike. Ata me metoda trockiste izoluan më parë udhëheqjen e vërtetë të Partisë sonë, Sekretarin e Përgjithshëm, shokun Enver Hoxha, duke e rrethuar këtë me shpifje, intriga, shantazhe, gënjeshtër. . . Ata i bënë këto veprime përgatitore, duke influencuar e duke imponuar vullnetin e tyre në shokët e tjerë të Byrosë, me qëllim që të mposhtnin vullnetin e shokut Enver Hoxha dhe të mundnin më lehtë të godisnin për vdekje shokun Nako Spiru, të përgatisnin terrenin për të likuiduar të gjithë shokët që kishin qenë solidarë me Sekretarin e Përgjithshëm dhe të dilnin si «heronj» të situatës. Në shqyrtimin e çështjes së shokut Nako Spiru Byroja Politike nuk u suall aspak në mënyrë shoqërore karshi tij, përkundrazi u suall në mënyrë armiqësore, sidomos Koçi Xoxe, Pandi Kristo dhe Kristo Themelko, që influencuan edhe në shokët e tjerë me sjelljen e tyre të egër, tendencioze dhe policore karshi shokut Nako Spiru. Në këtë situatë jashtëzakonisht të vështirë, shoku Nako Spiru që kishte mbrojtur me vendosmëri vijën e drejtë të Partisë sonë kundër qëllimeve trockiste të udhëheqjes jugosllave nuk mundi të rezistonte dhe vrau veten. Ky ishte gabim nga ana e tij. Ai këtë nuk duhej ta bënte. Shoku Nako Spiru ra viktimë e intrigave të poshtër të udhëheqjes trockiste jugosllave dhe bashkëpunëtorëve të saj, në Partinë tonë, Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo. Një përgjegjësi e madhe bie mbi Byronë Politike që influencoi në vetëvrasjen e shokut Nako Spiru dhe përgjegjësia kryesore në këtë drejtim bie mbi Koçi Xoxen dhe Pandi Kriston, të cilët e kurdisën situatën sikur ta kishin dëshiruar me gjithë zemër vetëvrasjen e shokut Nako!

17) Plenumi VIII i Komitetit Qendror u mblodh në një atmosferë dizorientimi e nervozizmi ku predominonte shpifja, intriga, gënjeshtër, ambicia personale dhe toni despotik i Koçi Xoxes e Pandi Kristos. Platforma e Plenumit VIII ishte akuza e udhëheqjes jugosllave dhe fjalimi i Koçi Xoxes para Shkollës së Partisë. Plenumi VIII u mblodh pas një përgatitje sistematike nga ana e Koçi Xoxes e Pandi Kristos, pasi ishte izoluar e neutralizuar plotësisht Sekretari i Përgjithshëm, pasi ishin neutralizuar e influencuar shokët e Byrosë e të Komitetit Qendror që kishin qenë

solidarë me shokun Enver Hoxha para akuzës jugosllave, pasi shoku Nako Spiru kishte vrarë veten, pasi shokët e tjerë që kishin qenë mbështetje efektive e shokut Enver në mbrojtjen e vijës së Partisë, si shoku Mehmet Shehu etj. ishin flakur si elementë antiparti jashtë Komitetit Qendror dhe në Komitetin Qendror ishin kooptuar shokë që konsideroheshin si adaptë e të predispozuar për të zbatuar platformën e atij plenumi. Në këtë mënyrë u përgatit terreni për nënshkrimin e plotë të Partisë e të vendit tonë ndaj udhëheqjes trockiste jugosllave. Në këtë mënyrë Plenumi VIII ishte mina e vdekjes në themelet e Partisë sonë që do të përmbyste krejtësisht independencën tonë më vonë, po të që se Partia jonë nuk do të bënte kthesën historike dhe shpëtimtare që bëri dhe që e plotësoi, nën dritën e letrave të Partisë Bolshevike. Rezultati i punimeve të Plenumit VIII dhe vija që u caktua në atë plenum ishin antimarksiste, antisovjetike dhe kundër Partisë e vendit tonë. Në këtë mënyrë, u transformua Partia jonë në një aparat policor ku sundonte frika e persekutimit nga aparati i Sigurimit të Shtetit që drejtohej nga Koçi Xoxe.

Me teorinë e «fraksionit në kokë të Partisë», të fabrikuar në prapaskenë nga Koçi Xoxe, Pandi Kristo etj. dhe i deleguari i Komitetit Qendror të Jugosllavisë, Savo Zllatiç e njeriut të OZNES, Josip Gjergjes, u eliminuan pengesat e hasura nga udhëheqja trockiste jugosllave e njerëzit e saj në Partinë tonë, u përgatit terreni për eliminimin e mëpastajmë të shokut Enver Hoxha dhe u maskua mjeshhtërisht fytyra e trockizmit të sotëm nën formulime dhe frazeologji demagogjike, gjoja marksiste-leniniste.

18) Si konsekuencë e paevitueshme e marrëdhënieve tona me Jugosllavinë, e influencës direkte të udhëheqjes trockiste jugosllave mbi udhëheqjen e Partisë sonë, e veprimtarisë me frymë të theksuar trockiste të Koçi Xoxes e Pandi Kristos dhe e nivelit të ulët ideologjik të Partisë sonë janë vërtetuar tek ne gabime të rënda, sidomos në punën organizative dhe me kuadrot e Partisë:

a) Partia jonë deri më sot nuk ka pasur një Statut të saj të aprovuar nga masat e Partisë. Mungesa e Statutit ka influencuar në dezorientimin e Partisë sonë në çështjet organizative dhe si rrjedhim rregullat organizative që drejtojnë të gjithë jetën e brendshme të Partisë nuk njihen mirë jo vetëm nga masat, por edhe nga vetë organet e Partisë. Mungesa e Statutit ka rrjedhur nga nënvleftësimi që ne u kemi bërë çështjeve organizative të Partisë.

b) Partia jonë nuk ka akoma një program të saj in të aprovuar nga masat e Partisë. Në vend që vija e Partisë të dilte nga vetë programi i Partisë, nga nevoja për mbërritjen e objektivave të caktuar në programin e Partisë, kjo vijë ka qenë përcaktuar pa

pasur programin e vet¹, por duke u orientuar nga mësimet e marksizëm-leninizmit dhe eksperiencia e Partisë Bolshevike dhe është shprehur drejt dhe në kohën e duhur ndër konferenca, vendime të Komitetit Qendror, fjalime të udhëheqësve, trakte, shkrime. Të influencuar nga udhëheqja jugosllave, ne kemi kujtuar, sado që nuk e kemi thënë, se programi i Frontit është edhe programi i Partisë. Në këtë mënyrë ne kemi nënvleftësuar rolin udhëheqës të Partisë duke e fshehur programin e saj nën hijen e programit të Frontit.

c) Ne kemi shkelur parimin themelor mbi të cilin ndërtohet Partia, parimin drejtues të strukturës organizative të Partisë, centralizmin demokratik.

1) Në Partinë tonë përveç zgjedhjeve që u bënë për delegatët e këtij kongresi, zgjedhjet e tjera s'janë bërë në bazë të rregullave organizative të Partisë. Zgjedhjet e sekretarëve të celulare nuk janë bërë drejt sepse në procedurën e tyre është influencuar në mënyrë të tepruar që nga lart, kandidaturat kanë qenë paracaktuar jashtë mbledhjes së organizatave bazë në konsultime intime, ka munguar kritika dhe autokritika dhe janë bërë jo me votim sekret, por me votim të hapët. Zgjedhjet e fundit të komitetit të dikastereve sado që procedura e tyre ka qenë në përgjithësi e drejtë, prapëseprapë nuk mund të konsiderohen si të drejta meqenëse janë bërë në rrethana të një gjendjeje të brendshme të Partisë jo të shëndoshë, ku Partia jetonte akoma në frymën e Plenumit VIII, platforma e të cilit ishte antimarksisiste dhe ishte zhdukur demokracia e brendshme, kështu që masa e Partisë nuk mund të vepronte vetë dhe vetë ta zgjidhte çështjen e zgjedhjeve. Zgjedhjet e Komitetit Qendror në Konferencën e parë të Partisë nuk janë bërë drejt sepse u procedua në bazë të një konspiracioni të kalbur. Të gjitha organet e tjera të Partisë, si byrotë e organizatave bazë, komitetet e rretheve dhe në pjesën më të madhe edhe vetë Komiteti Qendror nuk janë zgjedhur nga poshtë, por janë emëruar e kooptuar nga lart.

2) Në Partinë tonë organet superiore nuk kanë dhënë llogari rregullisht përpara masave të Partisë. Edhe ngandonjëherë kur organet drejtuese kanë bërë ndonjë raport të punës së tyre para

1 Në të vërtetë Partisë së Punës të Shqipërisë asnjëherë s'i ka munguar programi i vet për etapat e ndryshme të revolucionit. Por ky program s'ka qenë e mundur të formulohet njëherësh sepse mungonte përvoja e domosdoshme e udhëheqjes revolucionare, që nuk fitohet nga librat, por në valën e veprimit revolucionar. Në fillim të çdo etape janë hedhur themelet e programit, janë përcaktuar qartë qëllimi e detyrat strategjike të Partisë, vijat themelore të taktikës së saj. Pastaj shkallë-shkallë me grumbullimin dhe përgjithësimin e përvojës revolucionare të Partisë e të masave programi është plotësuar, është thelluar dhe korrigjuar.

organizatave që ato drejtojnë, mbledhjet e bëra në këto raste nuk kanë luajtur rolin e tyre si duhet dhe janë transformuar në meetingje për të aprovuar solemnisht raportet e udhëheqjes. Në këtë mënyrë ka munguar kontrolli i masave të Partisë mbi organet drejtuese të Partisë.

3) Në Partinë tonë ka munguar disiplina e hekurt dhe e ndërgjegjshme. Disiplina tek ne ka qenë më tepër mekanike se sa e ndërgjegjshme. Dhe kjo vetëkuptohet, sepse gjersa në Partinë tonë mungonte demokracia e brendshme, nga e cila buron disiplina e ndërgjegjshme, s'kishte si të ndodhte ndryshe. Në Partinë tonë ka qenë vënë disiplina zyrtare përmbi disiplinën e Partisë. Kjo ka rrjedhur nga futja e metodave ushtarake dhe policore në drejtimin e Partisë dhe në zgjidhjen e çështjeve të saj, ka qenë rezultati i punës me frymë të theksuar trockiste të Koçi Xoxes, i cili drejtonte punën organizative të Partisë. Një disiplinë e tillë formale dhe policore i ka shtypur kuadrot e Partisë, ka penguar zhvillimin e inisiativës së tyre dhe në shumë raste është përdorur si mjet nga Koçi Xoxe për të dëmtuar dhe demoralizuar anëtarët e ndershëm të Partisë, sepse ata nuk pajtoheshin me pikëpamjet e tija.

4) Çështja e nënshtrimit të organeve inferiore kundrejt organeve superiore në Partinë tonë formalisht ka ekzistuar. Por duke marrë parasysh konditat në të cilat jetonte Partia para Plenumit XI ky nënshtrim ka qenë më tepër formal dhe jo i ndërgjegjshëm. Nga ana tjetër nënshtrimi i organeve inferiore kundrejt organeve superiore presupozon udhëheqjen unike të organeve inferiore nga organi qendror i Partisë, nga KQ dhe Byroja Politike. Në Partinë tonë një udhëheqje e tillë nuk është ushtruar, nga fakti se puna e Partisë ishte monopolizuar plotësisht nga sekretari për kuadrot i KQ Koçi Xoxe, i cili e mbante larg KQ dhe Byronë Politike nga punët e brendshme të Partisë. Por edhe nënshtrimi formal nuk ka qenë i plotë. Organizatat e Partisë të aparatit të Sigurimit të Shtetit e kanë refuzuar këtë. Fakti i mospranimit nga ana e organizatës bazë të Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit pranë Ministrisë së Brendshme për të asistuar në mbledhjet e saja të deleguarit e komitetit të dikastereve që caktoheshin prej tij, por kërkonte që ky të dërgonte në këtë organizatë një anëtar të tij të caktuar nga vetë organizata bazë e Drejtorisë së Sigurimit, tregon jo vetëm thyerjen e parimit të nënshtrimit karshi organeve superiore të Partisë, por edhe nënvleftësimin që i bëhej Partisë nga organet e Sigurimit. Kjo donte të thoshte që Sigurimi i Shtetit nuk pranonte të kontrollohej nga Partia, por ta kontrollonte Partinë.

Kështu ka qenë shkelur parimi i centralizmit demokratik në Partinë tonë.

c) Vija organizative e Partisë sonë është shkelur rëndë nga fakti se sekretari organizativ i Partisë ka qenë njëkohësisht edhe

ministër i brendshëm. Kjo formë organizative antimarksiste e huajtur nga udhëheqja trockiste jugosllave, ka lejuar që sekretari organizativ i Partisë duke qenë njëkohësisht edhe ministër i brendshëm, ta vinte veten në pozita të privilegjuara, të monopolizonte punën në duart e tija, të spostonte rolin drejtues të Sekretarit të Përgjithshëm e të luante de fakto rolin e këtij dhe ta vinte Partinë nën kontrollin e Sigurimit të Shtetit.

Kjo formë organizimi ka bërë që të futen në Parti metodat ushtarake, që të dobësohet vigjilenca revolucionare në Parti dhe të zëvendësohet me informacionin policor, të krijohet frika në anëtarët e Partisë nga represionet dhe persekutimi, të ngjallet dyshimi dhe pasiguria në ta.

Kjo formë organizimi antimarksiste dhe kjo frymë e theksuar trockiste e Koçi Xoxes kanë çuar në shkeljen e demokracisë së brendshme në Parti, në mbytjen e kritikës dhe të autokritikës, në futjen e metodave ushtarake në udhëheqje, në mungesën e unitetit në udhëheqjen e Partisë, në shkeljen e centralizmit demokratik, në vënien e Partisë në fakt nën kontrollin e Sigurimit të Shtetit, në shfaqjen e burokracisë, arrivizmit dhe servilizmit në Partinë tonë.

d) Në Partinë tonë nuk i është dhënë rëndësia e duhur metodës së punës kolektive dhe sidomos në udhëheqjen e Partisë. Mungesa e një metode të tillë pune në Byronë Politike dhe në Komitetin Qendror ka shkaktuar që puna organizative e Partisë t'i shpëtonte kontrollit të shëndoshë nga ana e Byrosë Politike, Komitetit Qendror dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë dhe ka lejuar që sekretari organizativ të mos jepte llogari për punën që bëhej në sektorët që ai drejtonte, të bënte një politikë kuadrosh me frymë krejt sektare, personale dhe lokaliste.

Në udhëheqjen e Partisë sonë ka munguar uniteti i shëndoshë dhe përgjegjësia për këtë rëndon mbi Koçi Xoxen dhe Pandi Kriston, veprimtaria e të cilëve që nga Plenumi i Beratit e këtej ka pasur karakterin e një pune të ndërjegjshme dhe të organizuar grupazhi dhe trockiste. Koçi Xoxe e Pandi Kristo duke vepruar sipas dëshirës së udhëheqjes trockiste jugosllave, duke u bërë mbështetja kryesore e saj në udhëheqjen e Partisë sonë dhe duke punuar me ndërjegje për qëllime karrieriste, e kanë konsideruar Partinë si një detashment partizan në krye të të cilit qëndronin këta dy «kryetarë», të lidhur me një familjaritet të sëmure me njëri-tjetrin dhe në këtë mënyrë e kanë dëmtuar rëndë Partinë dhe vendin tonë.

dh) Tek ne ka munguar organizimi i informacionit operativ, pa të cilin nuk është e mundur që udhëheqja të drejtojë si duhet punët e Partisë. Për kontrollimin e zbatimit të direktivave të Partisë, udhëheqja është bazuar më tepër në raportet informative që i vinin nga poshtë, pa ushtruar kontrollin në vend të zbatimit të

direktivave nëpërmjet njerëzve të udhëheqjes. Jo vetëm kaq, por organet drejtuese të Partisë janë bazuar më tepër në raportet informative të Sigurimit të Shtetit se sa në informacionin operativ të Partisë, sidomos në çështjen e kuadrit.

e) Gjatë Luftës nacional-çlirimtare, agjitacioni dhe shtypi klandestin kanë luajtur një rol shumë të madh për mobilizimin e masave të popullit në vijën e Partisë. Pas çlirimit janë arritur mjaft rezultate për zhvillimin e agjitacionit e të shtypit si edhe janë organizuar mjaft kurse për ngritjen e nivelit ideologjik të kuadrove. Megjithkëtë puna propagandistike ka qenë e dobët, niveli ideologjik i anëtarëve të Partisë është i ulët dhe puna politike me masat e dobët, sidomos në fshat. Shtypi, literatura marksiste e sovjetike dhe materiali propagandistik ka ardhur duke u shtuar, por nuk është shfrytëzuar aq sa duhet. Në punën e propagandës është përdorur edhe material nga Partia Komuniste Jugosllave.

ë) Politika e kuadrove në Partinë tonë, e drejtuar nga Koçi Xoxe, karakterizohet si një politikë e gabuar dhe cilësohet si një politikë ku ka predominuar fryma personale në seleksionimin dhe avancimin e kuadrove si dhe lokalizmi e sektarizmi. Në politikën e kuadrove ka predominuar koncepti i gabuar dhe sektar i Koçi Xoxes sipas të cilit «punëtorët nuk gabojnë dhe intelektualët janë armiq», duke u nënvleftësuar kështu kuadri i shëndoshë intelektual, duke u futur të gjithë intelektualët në një kallëp, pa u marrë parasysh fakti se midis tyre ka komunistë të vendosur për Partinë që kanë dhënë prova në luftë dhe në punën e Partisë si besnikë të klasës punëtore dhe të popullit. Nga ana tjetër kjo ka qenë një demagogji pse janë luftuar kuadrot e shëndoshë punëtorë dhe nuk është bërë asnjë përpjekje për përgatitjen e kuadrove punëtorë.

f) Në lidhje me luftën e klasave Partia jonë ka qenë kurdoherë e kjartë dhe tek ne lufta e klasave është ashpërsuar çdo ditë e më tepër. Partia jonë e ka pasur të kjartë se rruga e tranzicionit nga kapitalizmi në socializëm kalon nëpërmjet ashpërsimit të paevitueshëm të luftës së klasave, ashpërsim i cili vjen gjithnjë duke u shtuar¹.

g) Një e metë e madhe në punën tonë ka qenë paaftësia për të lidhur drejt punën ekonomike me punën politike të Partisë. Tek ne nuk është kuptuar se sukseset ekonomike janë të lidhura ngushtë me punën politike të Partisë dhe për më tepër varen prej saj. Organet tona të Partisë nuk i njohin mirë problemet ekonomike dhe nuk përpiqen sa duhet për t'i kuptuar këto probleme. Shpesh, vija e Partisë është interpretuar keq, sikur vija politike është diçka e shkëputur nga vija organizative dhe nga vija ekonomike

¹ Shih në këtë vëllim shënimin f. 497.

dhe jo sikur çështjet politike ashtu edhe ato organizative dhe ekonomike përbëjnë së bashku një vijë të vetme, vijën e Partisë.

g) Lidhjet e Partisë me masat punonjëse nuk kanë qenë në lartësinë e duhur. Kjo ka rrjedhur nga vetë fakti se udhëheqja e Partisë nuk ka pasur lidhje të ngushta as me masën e Partisë. Dhe vetëkuptohet se kur nuk ekzistojnë lidhje të ngushta midis udhëheqjes dhe masave të Partisë, nuk ka si të pretendohet ekzistenca e lidhjeve të shëndosha midis Partisë dhe masave të popullit.

Por në këtë të metë kanë influencuar edhe metodat trockiste në punë të Koçi Xoxes, të cilat nuk mund të lejonin që lidhjet e Partisë me masat e popullit të ishin të shëndosha.

h) Në këto katër vjetët e fundit, që nga Plenumi II dhe gjer në Plenumin XI Partia është dëmtuar rëndë nga ish-sekretari për kuadrot i KQ Koçi Xoxe e ish-anëtari i Byrosë Politike Pandi Kristo, të cilët duke përfaqësuar politikën e udhëheqjes trockiste jugosllave dhe duke vepruar me ndërgjegje, me qëllime karrieriste e arriviste, kanë zbatuar vijën trockiste të udhëheqjes jugosllave në Partinë e vendin tonë.

Ata edhe pas analizës që u bë nga Plenumi XI i KQ të Partisë mbi gjendjen e brendshme në Partinë tonë kanë mbajtur një qëndrim të padenjë për komunistët karshi gabimeve të tyre shumë të rënda. Autokritika e tyre në Plenumin XI nuk ishte e kurtë, e plotë dhe në lartësinë e një udhëheqësi, dhe autokritika e tyre para aktiveve të Partisë ka qenë akoma më e dobët. Ata pas Plenumit XI kanë vazhduar më tej në rrugën e tyre trockiste. Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo i kanë fshehur Partisë të vërtetën. Ata nuk kanë treguar përpara Kongresit dhe Partisë qëllimet e tyre armiqësore karshi Partisë e popullit. Jo vetëm kaq, por ata u munduan ta përdorin të drejtën e fjalës në Kongresin I të Partisë si tribunë për të sulmuar vijën e drejtë të Partisë, Kongresin e Partisë, të gjithë Partinë e të mbronin në mënyrë konsekuente vijën e tyre trockiste. Veprimtaria e Koçi Xoxes karakterizohet si një veprimtari anti-parti, antisovjetike, trockiste që ka dëmtuar rëndë Partinë dhe interesat e independencën e vendit tonë.

Mbi shokët Kristo Themelko, Pullumb Dishnica dhe Xhoxhi Blushi¹, rëndojnë faje të rënda, sepse kanë qenë nga më të influencuarit nga udhëheqja trockiste jugosllave dhe kanë zbatuar me ndërgjegje vijën e udhëheqjes jugosllave në Partinë e vendin tonë dhe kanë bashkëpunuar ngushtësisht me Koçi Xoxen dhe Pandi Kriston duke e dëmtuar rëndë Partinë dhe vendin me veprimtarinë e tyre. Shoku Kristo Themelko ka bërë autokritikë para Partisë. Xhoxhi Blushi nuk ka bërë autokritikë të shëndoshë dhe nuk e ka kuptuar përmbajtjen e letrave të Partisë Bolshevike. Pullumb

¹ Shih në këtë vëllim shënimet 1, 2, 3, f. 505.

Dishnica megjithëqë bëri autokritikë para KQ qëndrimi i tij më vonë tregoi se autokritika ka qenë formale dhe tregon se ka qëndruar në pozitat e vjetra. Do të varet tash nga vetë ata të shkojnë në rrugën e Partisë, me ndihmën që do t'u japë atyre Partia dhe me punën e tyre të përditshme. Partia do të shohë në punën e tyre të përditshme në zbatimin e vijës së Partisë, se sa i kanë kuptuar ata gabimet dhe fajet e tyre të rënda.

VIJA DHE DETYRAT E PARTISË PËR PERIU DHËN E ARDHS HME

Duke marrë parasysh zhvillimin e gjendjes ndërkombëtare, në të cilën kontradiktat midis kampit demokratik dhe antiimperialist me Bashkimin Sovjetik në krye nga një anë, dhe kampit imperialist dhe antidemokratik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga ana tjetër, janë duke u thelluar çdo ditë e më tepër; duke marrë parasysh se kampi demokratik antiimperialist në përgjithësi dhe kampi unik socialist veçanërisht janë duke u forcuar çdo ditë e më tepër dhe sidomos me demaskimin e grupit trockist të Titos si fraksion në gjirin e kampit socialist, duke marrë parasysh ashpërsimin e vazhdueshëm dhe progresiv të luftës së klasave në vendin tonë dhe forcimin e Partisë sonë në kthesën e saj historike nën dritën e letrave të Partisë Bolshevike, Kongresi I i Partisë Komuniste të Shqipërisë vendosi që vija e Partisë në periudhën e ardhshme të jetë:

I. — Në politikën e jashtme:

Partia e Punës e Shqipërisë është dhe do të jetë me kampin demokratik dhe antiimperialist, me kampin unik socialist, me Bashkimin Sovjetik në krye. Ajo do të punojë me të gjitha forcat e saja, në gjirin e këtij kampi, për një paqe të qëndrueshme, për një demokraci popullore, kundër të gjithë nxitësve të luftës, armiqve të njerëzimit që janë rreshtuar në kampin imperialist e antidemokratik. Ajo është dhe do të mbetet me Partinë Bolshevike, Stalinin e madh dhe me Byronë Informativë të Partive Komuniste dhe Punëtore motra, kundër udhëheqjes antimarksiste, antisovjetike dhe antishqiptare të Partisë Komuniste Jugosllave me Titon në krye. Ajo është dhe do të mbetet e frymëzuar nga ndjenja e miqësisë së singertë, dashurisë dhe vëllazërimit me popujt e Bashkimit Sovjetik, me popujt e demokracive popullore dhe me të gjithë popujt paqedashës dhe do të punojë pa u lodhur për ta përforcuar edhe më tepër këtë miqësi, dashuri e vëllazërim. Partia jonë është dhe punon për ruajtjen e miqësisë dhe vëllazërimin me

popujt e Jugosllavisë që u zhvillua dhe u çelnikos në luftën e përbashkët për çlirimin e popujve tanë dhe do të jetë në luftë të pajtueshme me grupin nacionalist-trockist të Titos. Ajo është dhe do të mbetet besnike e solidaritetit të internacionalizmit proletar. Ajo është për marrëdhëniet e shëndosha e të sinqerta politike, ekonomike dhe kulturale me Bashkimin Sovjetik dhe me demokracitë popullore e do të punojë pa u lodhur që këto marrëdhënie të forcohen çdo ditë e më tepër. Ajo është dhe do të mbetet e gatshme dhe e vendosur për të mbrojtur me të gjitha mjetet dhe forcat e saja independencën kombëtare, integritetin tokësor dhe lirinë e popullit tonë nga çdo armik i jashtëm imperialist që do të tentojë të dëmtojë vendin tonë. Ajo do të luftojë kundër të gjithë atyre që do të tentojnë ta largojnë nga kjo rrugë.

II. — Në politikën e brendshme:

Partia e Punës e Shqipërisë punon dhe do të punojë me të gjitha forcat për ndërtimin e socializmit në vendin tonë:

1) *Ruajtja e fitoreve të luftës dhe përforcimi i mëtejshëm i Pushtetit Popullor:* Partia do të punojë pa u lodhur për ruajtjen e fitoreve të luftës së popullit, për ruajtjen e independencës kombëtare dhe të pushtetit popullor duke luftuar pa mëshirë të gjitha tentativat e armiqve të brendshëm dhe të jashtëm. Në këtë drejtim Partia do të drejtojë luftën e klasave, që nuk vjen duke u pakësuar, po vjen duke u ashpërsuar çdo ditë e më tepër, duke punuar për përforcimin dhe sigurimin e aleancës së pathyeshme midis klasës punëtore dhe fshatarësisë, për sigurimin e përforcimin e rolit udhëheqës të klasës punëtore në këtë aleancë dhe për luftën e ashpër kundër klasave shfrytëzuese që synon në kufizimin e elementëve kapitalistë në fshat dhe në qytet. Në këtë drejtim Partia do të punojë për përforcimin dhe perfeksionimin e aparatit të shtetit, për forcimin, shtimin e potencialitetit mbrojtës të vendit dhe për shfaqjen e të gjithë armiqve që do të tentojnë të cenojnë pushtetin tonë popullor.

2) *Bujqësia:* Politika e Partisë kundrejt fshatarësisë duhet të orientohet nga mbështetja e fortë e Partisë në fshatarësinë e varfër, nga aleanca me fshatarësinë e mesme dhe nga lufta për kufizimin e elementëve kapitalistë të fshatit. Orientimi i Partisë në bujqësi duhet të jetë drejt rritjes progresive të prodhimit bujqësor, me anë të rritjes së rendimentit në punë, të mekanizimit të bujqësisë, përmirësimit të racës së kafshëve të punës dhe zgjerimit të

sipërfaqeve të mbjella, bonifikimeve etj. Të prodhohet buka e popullit dhe të zhvillohen bimët industriale, blegtoria dhe frutikultura. Partia do të orientohet nga përforcimi i sektorit socialist në bujqësi (fermat shtetërore) dhe nga kolektivizimi gradual, i matur dhe vullnetar i tokës në fshat me anën e kooperativave bujqësore të punës, duke i përkrahur shteti këto kooperativa politikisht, ekonomikisht dhe organizativisht në mënyrë që fshatarët të inkurajohen dhe të hyjnë vullnetarisht në kooperativat bujqësore të punës.

3) *Industria:* Partia do të punojë për industrializimin dhe elektrifikimin e vendit. Në këtë drejtim ajo do të orientohet nga shfrytëzimi sa më i plotë i pasurive të tokës dhe të nëntokës, nga zgjerimi, përmirësimi e racionalizimi i industrisë egzistuese, nga ngritja e stabilmenteve të reja industriale që të prodhojnë në shkallë të mjaftueshme artikuj industrialë të përdorimit të gjerë dhe nga shfrytëzimi i energjisë hidroelektrike për elektrifikimin e vendit. Industrializimi dhe elektrifikimi i vendit do të ndihmojnë drejtpërsëdrejti në ngritjen e standardit të jetesës së masave të gjera punonjëse, do të forcojnë klasën punëtore në sasi e në cilësi e do të shpejtojnë zhvillimin e vendit tonë drejt socializmit.

4) *Tregëtia:* Partia në lëmin e tregëtisë do të orientohet nga forcimi i sektorit shtetëror të tregëtisë, nga zgjerimi e perfeksionimi i sektorit kooperativist dhe nga përforcimi i kontrollit mbi tregëtinë private, në mënyrë që kjo të bëhet një ndihmëse e sektorëve shtetërorë e kooperativistë e të pengohet zhvillimi i kapitalizmit tregëtar në vendin tonë. Tregëtia jonë duhet të orientohet nga qarkullimi me ritmin maksimal të sendeve të tregëtisë, nga ulja e çmimeve, nga vendosja e rregullit dhe e disiplinës së fortë në grumbullimin e shpërndarjen e sendeve të tregëtisë në bazë të planit të shtetit. Tregëtia jonë duhet të orientohet nga përforcimi i marrëdhënieve tregëtare me Bashkimin Sovjetik dhe me demokracitë popullore sipas parimit të barazisë dhe reciprocitetit, duke shtuar vazhdimisht eksportimin e sendeve të tregëtisë. Tregëtia duhet të sigurojë furnizimin e tregut të brendshëm në mënyrë që të krijohen konditat materjale për qarkullimin sa më të shpejtë të monedhës.

5) *Politika financiare* e Partisë sonë duhet të jetë:

a) Të forcohen çdo ditë e më tepër financat tona dhe të shtohen të ardhurat shtetërore nëpërmjet një sistemi të drejtë tatimesh.

b) Gjithë zhvillimi i tyre të mbështetet në eksperiencën e financave sovjetike.

c) Të aplikohet një regjim i fortë kursimi kudo, të bëhet luftë për uljen e shpenzimeve dhe të kostos së prodhimit.

ç) Banka të bëhet i vetmi institut krediti dhe politika e kreditit të jetë e tillë që të ndihmojë zhvillimin e ekonomisë, shtimin e prodhimit dhe të ndihmojë në forcimin e zgjerimin e sektorit kooperativist, sidomos në fshat. Krediti të jepet vetëm për qëllime të caktuara.

6) *Ndërtimi dhe komunikacioni*: Partia do të orientohet nga zgjerimi i ndërtimeve në përgjithësi e në radhë të parë nga ndërtimi i rrugëve hekurudhore, ndërtimi i porteve, mirëmbajtja e përmirësimi i rrugëve automobilistike, ndërtimi i fabrikave, shkollave e spitaleve si dhe rindërtimi i shtëpive të djegura gjatë luftës. Komunikacioni do të orientohet në radhë të parë nga transporti hekurudhor, transporti detar e automobilistik dhe të bëhen përpjekje për një shfrytëzim më të mirë të të gjitha mjeteve të transportit e për mirëmbajtjen e shtimin e tyre si edhe për shfrytëzimin më të plotë të mjeteve ndihmëse të transportit si karrot e kuajt. Komunikacioni do të orientohet, gjithashtu nga zgjerimi e perfeksionimi i rrjetit të telekomunikacionit për një ndërlikdhje të pandërprerë e të shëndoshë midis qendrës e periferisë.

7) *Arësimi, arti dhe kultura*: Në lëmin e arësimit, të artit e të kulturës Partia jonë do të orientohet nga parimi që arësimi dhe kultura të bëhen të popullit duke u përvetësuar nga masat e gjera punonjëse. Në këtë drejtim Partia do të punojë që të zbatohet arësimi fillor i detyrueshëm, të luftohet për zhdukjen e analfabetizmit, të punohet për ngritjen kulturele të të rriturve me anën e kurseve të natës, të punohet për ngritjen e kuadrove me anë kursesh periodike, shkollash profesionale, fakultetesh për punëtorët etj. dhe të përgatiten kuadro të lartë jashtë shtetit, në shkollat e larta e universitete të Bashkimit Sovjetik e vendeve të demokracisë [popullore]. Të shtohet numri i shkollave fillore, unike e të mesme, të përforcohet Instituti i lartë Pedagogjik dhe Instituti i Shkencave dhe të krijohen konditat për zhvillimin e arësimit të lartë. Për zhvillimin e kulturës nacionale me përmbajtje socialiste, për të ngritur nivelin kultural të popullit duhet t'i jepet rëndësi zhvillimit të folklorit, të shtohen bibliotekat popullore dhe të zhvillohet teatri. Arësimi, kultura dhe arti ynë duhet të orientohen nga arësimi, kultura dhe arti sovjetik, arësimi, kultura dhe arti ynë progresist në botë, që bazohen në parimet marksiste-leniniste. Të shkohet më shpejt drejt likuidimit të të gjitha teksteve të vjetra shkollore me përmbajtje borgjeze dhe të zëvendësohen këto me tekste të reja të bazuara në eksperiencën e Bashkimit Sovjetik dhe në konditat tona konkrete. Partia jonë orientohet nga lufta e ashpër që i duhet bërë çfarëdo influence të ideologjisë borgjeze në vendin tonë duke u mbështetur në shkencën marksiste-leniniste. Vihet si detyrë studimi i gjuhës ruse.

8) *Shëndetësia*: Për mbrojtjen dhe forcimin e shëndetit të popullit të zgjerohet e të modernizohet rrjeti i instituteve shëndetësore; të shtohet lufta kundër sëmundjeve ngjitëse si: malarja, tuberkulozi, sifilizi etj., të tregohet më shumë kujdes për mbrojtjen e mëmës dhe fëmijës, të zgjerohet shtypi dhe propaganda sanitare, për edukimin sanitar të popullit kudo e sidomos në fshat.

9) *Ushtria*: Ushtria jonë duhet të modernizohet në bazë të artit ushtarak stalinian, të edukohet politikisht dhe ideologjikisht në bazë të shkencës marksiste-leniniste, të frymëzohet nga shpirti patriotik e të ruajë traditat e shëndosha luftarake të popullit tonë. Ushtria jonë duhet të forcojë disiplinën e hekurt dhe koshientë; të përvetësojë teknikën dhe taktikën luftarake moderne, të forcojë dashurinë e besimin ndaj popullit e Partisë sonë si edhe dashurinë e besimin ndaj Ushtrisë Sovjetike, popujve sovjetikë dhe gjithë popujve të tjerë liridashës, të zhvillojë urrejtje kundër armiqve të popullit të jashtëm dhe të brendshëm dhe të jetë e gatshme për të mbrojtur në çdo moment independencën kombëtare, lirinë dhe pushtetin e popullit.

10) *Sigurimi i Shtetit*: Partia do të punojë që Arma e Sigurimit të Shtetit të forcohet sa më tepër sepse ajo është arma e dashur e pushtetit që drejtohet nga Partia, që ruan Partinë dhe pushtetin nga puna armiqësore e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm. Arma e Sigurimit të Shtetit duhet të ndreqë gabimet e bëra kur ka qenë drejtuar nga Koçi Xoxe dhe të luftojë pa mëshirë të gjitha mbeturinat e influencës së udhëheqjes trockiste jugosllave dhe të Koçi Xoxes në metodën dhe format e punës. Arma e Sigurimit duhet të shtojë urrejtjen dhe të jetë e pamëshirshme kundër të gjithë armiqve të Partisë e të popullit dhe të shtojë dashurinë për Partinë dhe popullin. Të punohet për ngritjen ideologjike të punëtorëve të sigurimit që të mos mbeten në praktikizëm, por të jenë në lartësinë e detyrës.

11) *Rinia*: Rinia Komuniste dhe Rinia Popullore të shkrihen në një organizatë të vetme të rinisë, e cila do të jetë nën drejtimin direkt të Partisë së Punës dhe do të ndihmojë Partinë për edukimin e rinisë në frymën e socializmit, do të jetë rezervë dhe ndihmësja e Partisë.

Partia duhet t'i japë rëndësi shumë të madhe drejtimit të organizatës së rinisë dhe kuadrot e Partisë të marrin pjesë direkt për edukimin e rinisë. Sigurimi i udhëheqjes së Partisë është detyra kryesore e organizatës së rinisë pse ajo (udhëheqja e Partisë) është burimi i forcës dhe i fitoreve të saja.

Rinia duhet të edukohet sipas traditave të saja të shkëlqyera të formuara gjatë Luftës n.-çl. nën drejtimin e Partisë dhe të or-

ganizatorëve të saj Qemal Stafa, Nako Spiru, Misto Mame, Alqi Kondi; ajo duhet të frymëzohet nga eksperiencia e madhe dhe shembulli i lavdishëm i komsomolit heroik. Të tregohet më shumë kujdes për edukimin ideo-politik të rinisë në baza të marksizëm-leninizmit, për arësimin dhe zhvillimin e saj kultural, për edukimin teknik dhe profesional, për edukimin e saj fizik dhe të tregohet interes për jetën dhe dëfrimin e saj.

Rinia të mobilizohet për realizimin e vijës së Partisë dhe të jetë në radhët e para të luftës për realizimin e planit të shtetit për ndërtimin e socializmit, si ishte dje në radhët e para të luftës për çlirimin e vendit.

12) *Sindikatat*: Organizatat e Partisë duhet të mobilizohen për të forcuar organizatat e sindikatave. Duhet të kuptohet drejt dhe mirë se me një punë sa më të shëndoshë të Partisë në organizatat sindikale, aq më të fuqishme dhe më të afta do të jenë këto, për forcimin e vazhdueshëm të klasës sonë punëtore në rolin e saj si mbështetja dhe forca kryesore e Partisë, si baza e pushtetit tonë popullor dhe si udhëheqja e masave punëtore të vendit nën drejtimin e Partisë për realizimin e socializmit në vendin tonë. Organizatat sindikale duhet të bëhen shkolla të komunizmit për edukimin e klasës punëtore në bazë të mësimëve marksiste-leniniste-staliniane. Ato të bëhen organizata të fuqishme të klasës punëtore për mobilizimin e saj sa më të gjerë për realizimin e planit të shtetit, për krijimin e një jete më të lumtur, për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

13) *Gruaja*: Pjesëmarrja e gruas e roli i saj për ngritjen e fuqisë ekonomike e realizimin e planit për përparimin e vendit duhet të rritet vazhdimisht. Për këtë Partia të kujdeset që niveli politik, kultural dhe arësimor i gruas të ngrihet e në radhë të parë të luftohet gjerësisht analfabetizmi; të edukohen nënat për një rritje më të mirë, dhe edukimin e fëmijëve e të rinisë sonë në frymën e demokracisë popullore (e pedagogjisë sovjetike). Organizatat e Partisë të jenë në krye në luftën kundër paragjyqimeve, zakoneve prapanike dhe fanatizmit si dhe të çdo nënvleftësimi të gruas. Të hapen më me besim dyert e Partisë për gratë më revolucionare e besnike. Partia të forcojë, të mobilizojë sa më gjerë organizatën e gruas për gjithë këto detyra e për bashkimin e masave të grave shqiptare në Frontin e fuqishëm të grave demokratike të gjithë botës kundër nxitësve të një lufte të re.

14) *Fronti*: Fronti, organizata e masave të gjera të popullit që gjatë luftës i udhëhequr nga Partia Komuniste mobilizonte masat e gjera në luftë kundër armiqve dhe tradhëtarëve për çlirimin e vendit, do të mbetet si organizatë masash e udhëhequr nga Partia

jonë e Punës, për t'i mobilizuar këto masa, për realizimin e planit të shtetit dhe të vijës së Partisë, sidomos në fshat dhe kudo ku mungojnë organizatat e tjera të masave.

III. — Mbi gjendjen e brendshme të Partisë:

Për të realizuar vijën e saj politike dhe organizative, për të plotësuar kthesën historike të saj dhe për t'u vënë vendosmërisht në rrugën e marksizëm-leninizmit, Partia jonë e Punës ka këto detyra përpara:

1. — Të legalizohet menjëherë Partia e Punës si udhëheqëse e klasës punëtore dhe e të gjitha masave punonjëse të qytetit dhe të fshatit si forca e vetme drejtuese e të gjithë aktivitetit të vendit tonë dhe që drejton vendin me vendosmëri për në socializëm.

2. — Të mobilizohen të gjitha organizatat e Partisë, për t'u shpjeguar masave punonjëse dhe gjithë popullit rolin e vërtetë, të Bashkimit Sovjetik si dje në luftë kundër fashizmit, ashtu edhe sot në luftë për një paqe të qëndrueshme, për një demokraci popullore. Të edukohen të gjithë anëtarët e Partisë dhe organizatat e tjera të Frontit Demokratik, i gjithë populli shqiptar me frymën e besnikërisë ndaj BS, Partisë Bolshevike dhe shokut Stalin, sepse ata janë shpëtimtarët e njerëzimit nga skllavëria fashiste, mbrojtësit më të fuqishëm të paqes dhe të demokracisë, janë koka drejtuese e kampit demokratik, antiimperialist e socialist në botë. . .

Të përvetësojmë sa më tepër eksperiencën e Bashkimit Sovjetik dhe të Partisë Bolshevike në të gjitha drejtimet e aktivitetit të Partisë e të vendit tonë, të ndjekim me besnikëri mësimet marksiste-leniniste të udhëheqësit të madh të proletarietit ndërkombëtar, mikut më të shtrenjtë të Partisë e të popullit tonë, Josif Vissarionoviç Stalinit.

3. — Të mobilizohen të gjitha organizatat e Partisë, për t'u shpjeguar masave të gjera punonjëse, gjithë popullit shqiptar zhvillimin e gjendjes ndërkombëtare, për të shtuar vazhdimisht urrejtjen kundrejt armikut të njerëzimit, armikut më të madh të vendit tonë, kundër imperializmit amerikano-anglez, pasardhësit besnik të nazizmit gjerman, që përpiqet të skllavërojë botën me anë të një lufte të re botërore.

4. — Të mobilizohen të gjitha organizatat e Partisë për t'u skjaruar sa më mirë masave të gjera punonjëse tradhëtinë ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj kampit unik socialist, ndaj çështjes së internacionalizmit proletar nga ana e udhëheqjes trockiste jugosllave. T'u skjarohen masave qëllimet grabitqare dhe veprimtaria djallëzore ndaj vendit tonë nga ana e udhëheqjes tradhëtare jugosllave, përpjekjet e Partisë sonë kundër politikës trockiste të grupit të Titos si edhe ndihmën shpëtimtare që na ka dhënë Partia

Bolshevike dhe vetë shoku Stalin me anën e letrave të tyre historike, për të dalë nga kthetrat e grupit trockist të Titos e për ta vënë Partinë e vendin tonë në rrugën e vërtetë, në rrugën që udhëheq me lavdi Partia Bolshevike e Bashkimit Sovjetik.

5. — Të plotësohet sa më shpejt kthesa e madhe e Partisë duke vendosur sa më shpejt parimet marksiste në strukturën dhe jetën e brendshme të Partisë, në bazë të Statutit të Partisë. Këto parime të zbatohen me rigorozitet dhe të luftohet pa hezitim kundër tentativave që synojnë shkeljen e këtyre parimeve:

a) Të zbatohet dhe të ruhet si drita e syve parimi leninist-stalinian i centralizmit demokratik si parimi kryesor mbi të cilin ndërtohet Partia dhe i cili konsiston në zgjedhshmërinë e të gjitha organeve drejtuese të Partisë nga poshtë-lart, në dhënien llogari nga koha në kohë prej organeve drejtuese para organizatave që i kanë zgjedhur e që ata drejtojnë mbi të gjithë aktivitetin e tyre, në ruajtjen e disiplinës së hekurt e të ndërgjegjshme të Partisë, në nënshkrimin e pakicës ndaj shumicës dhe në detyrimin e organeve inferiore për t'ju bindur pa kondita organeve superiore.

b) Të luftohet për zhdukjen e shfaqjeve jomarksiste, burokratike, policore dhe vdekjeprurëse për Partinë në jetën e brendshme të Partisë, duke ruajtur dhe zhvilluar vazhdimisht demokracinë e brendshme në të gjitha organizatat e Partisë, ku të respektohen plotësisht të gjitha detyrat dhe të drejtat e anëtarit të Partisë në bazë të Statutit të Partisë, ku të gjitha çështjet e Partisë të zgjidhen me metodën marksiste-leniniste të kritikës dhe autokritikës së shëndoshë, ku anëtari i Partisë ta ndjejë veten si në shtëpinë e vet në organizatën e tij dhe të mos ketë asnjë druajtje për të kritikuar drejt cilindo funksionar e organ të Partisë, ku të çelnikoset disiplina e hekurt dhe e ndërgjegjshme në bazë të demokracisë së brendshme të Partisë nga e cila ajo buron.

c) Të zhduket metoda orientale e zgjidhjes së çështjeve principale të Partisë nën prizmin personal duke u nisur nga pozita jomarksiste dhe dëmprurëse për jetën e Partisë me frymën e paragjytimeve e prapamendimeve mikroborgjeze e trockiste. Të vendoset metoda marksiste në zgjidhjen e të gjitha çështjeve të Partisë në bazë të parimeve leniniste-staliniane mbi unitetin e mendimit e të veprimtimit, në bazë të kritikës dhe autokritikës së shëndoshë, në bazë të centralizmit demokratik.

ç) Vlerësimi i veprimtarisë së anëtarit të Partisë të bëhet në bazë të fakteve konkrete si ai e ka mbrojtur ose e ka dëmtuar vijën e Partisë me veprimtarinë e tij dhe jo në bazë të supozimeve të pathemelta dhe të paragjytimeve personale, prapanike, mikroborgjeze.

d) Të forcohet vigjilenca revolucionare për të ruajtur vijën e Partisë dhe vetë Partinë nga veprimtaria e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm të Partisë. Informacioni në Parti të mos trans-

formohet në një informacion policor, por të jetë një informacion i shëndoshë e marksist-leninist, i saktë, i plotë dhe aktual, që t'i vlejë Partisë për të njohur se si zbatohet vija e saj në terrenin praktik. Vigjilenca revolucionare duhet të kuptohet si një detyrë e çdo anëtari të Partisë për të ruajtur zbatimin e vijës së Partisë dhe të parimeve marksiste-leniniste në jetën dhe në veprimtarinë e Partisë. Të luftohet pa hezitim, ashpër dhe drejt, çfarëdo shfaqje e influencës së borgjezisë, së udhëheqjes trockiste jugosllave ose e Koçi Xoxes etj. që çenojnë vijën dhe parimet marksiste-leniniste të Partisë.

dh) Të forcohen lidhjet e Partisë me masat e gjera punonjëse. Anëtari i Partisë duhet të mësojë si të dëgjojë zërin e punëtorit e të fshatarit punonjës, të kuptojë gjendjen dhe nevojat e tyre dhe t'u përgjigjet me kohë. Për të forcuar lidhjet me masat punonjëse duhet t'i jepet rëndësi më tepër punës së organizatave bazë që janë hallka e parë që e lidhin Partinë me masat punonjëse, duhet gjithashtu që udhëheqësit e Partisë të shkojnë shpesh poshtë në terren për të marrë kontakt direkt dhe personalisht me masat. Organizatat e Partisë do t'i forcojnë lidhjet me masat duke kuptuar mirë se në periudhën e tranzicionit prej kapitalizmit në socializëm në të cilën ndodhet vendi ynë, lufta e klasave nuk shuhet meqë armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm të demokracive popullore dhe të socializmit, nuk do t'i ndalojnë për asnjë çast përpjekjet e orvatjet e tyre për të penguar zhvillimin e vendit tonë drejt socializmit, për të përmbysur pushtetin tonë popullor dhe për të vendosur regjimin e tyre kapitalist. Sa më mirë dhe sa më drejt ta udhëheqin dhe ta zhvillojnë organizatat e Partisë këtë luftë të klasave në jetën e përditshme, aq më tepër ato do të lidhen me masat e gjera punonjëse. Organizatat e Partisë dhe anëtarët e Partisë duhet të jenë në krye të detyrës dhe të luajnë rolin drejtues. Anëtari i Partisë duhet të zhvishet nga të gjitha të metat personale, nga mbeturinat mikroborgjeze që mund të jenë akoma në personin e tij ose që mund të reflektohen tek ai nga presioni i ambientit të borgjezisë. Anëtari i Partisë duhet të punojë për të fituar simpatinë e masave punonjëse, t'i mësojë masat, të mësojë prej tyre dhe t'i drejtojë ato në vijën e Partisë.

e) Të vendoset e të ruhet si drita e syve uniteti marksist në udhëheqjen e Partisë, i cili do të bazohet në parimin e zgjidhjes së çështjeve principale të Partisë në bazë të kritikës dhe autokritikës së shëndoshë dhe jo në baza të kalbura të pozitave personale. Të luftohet pa mëshirë kundër të gjithë atyre që do të tentojnë të çenojnë unitetin e Partisë dhe të udhëheqjes së saj. Të forcohet metoda e udhëheqjes kolektive në Parti dhe të luftohet kundër metodës së frymës trockiste të Koçi Xoxes, kundër metodës individuale me frymë trockiste, sektare, lokaliste, pesimiste. Të bëhet një ndarje më e mirë e punës në udhëheqje dhe të aktivizohen të

gjithë anëtarët e kandidatët e Komitetit Qendror. Komiteti Qendror duhet të mblidhet rregullisht për të shqyrtuar punët e Byrosë Politike, gjithashtu edhe konferencat e kongreset e Partisë, siç e përcakton Statuti i Partisë. Të mblidhen, sa herë shihet e nevojshme, aktivet e Partisë, për të shqyrtuar konkretisht problemet e rëndësishme të Partisë. Të gjitha çështjet me rëndësi të Partisë, duhet më parë të gjykohen dhe të aprovohen nga forumi para se të paraqiten nga anëtarët e forumit. Bashkë me udhëheqjen kolektive duhet të forcohet edhe ndjenja e përgjegjësisë personale e çdo udhëheqësi dhe anëtari të thjeshtë të Partisë. Komiteti Qendror duhet të informojë rregullisht organizatat e Partisë mbi vendimet që merr, me anë letrash të posaçme, qarkoresh, aktivesh dhe vendimet më me rëndësi të publikohen.

ë) Në politikën e kuadrove Partia duhet të orientohet nga parimet staliniane mbi kuadrot, d.m.th:

«Së pari, t'i çmosh kuadrot si fondin e artë të Partisë dhe të shtetit, t'i ruash si një gjë të shtrenjtë, të kesh respekt për ta.

Së dyti, t'i njohësh kuadrot, t'i studjosh me kujdes cilësitë e mira dhe të metat e çdo kuadri, të dish se në ç'post ai mund t'i tregojë më mirë aftësitë e veta.

Së treti, t'i rritësh kuadrot me kujdes, të ndihmosh çdo kuadër, që është në rritje, për t'u ngritur, të mos e kursesh kohën për t'u «marrë» me durim me këta kuadro dhe për ta shpejtuar përparimin e tyre.

Së katërti, të ngresh në kohën e duhur dhe pa frikë kuadro të tjerë të rinj, pa i lënë ata të rrinë gjatë dhe të ndryshken në vendin e vjetër.

Së pesti, t'i shpërndash kuadrot nëpër postet e tyre, në mënyrë që secili ta ndjejë veten në vendin e vet, që secili të mund t'i japë çështjes sonë të përbashkët maksimumin e asaj që mund të japë në saje të cilësive të veta personale, që drejtimi i përgjithshëm i punës për shpërndarjen e kuadrove t'u përgjigjet plotësisht kërkesave të vijës politike, për zbatimin e së cilës bëhet kjo shpërndarje»¹.

Për të zbatuar këto parime marksiste-leniniste të shokut Stalin në politikën e kuadrove në Partinë tonë duhen varrosur më parë pikëpamjet e gabuara me frymën personale, sektare, lokaliste, pesimiste dhe trockiste të Koçi Xoxes në politikën e kuadrove. Partia duhet ta shikojë problemin e kuadrit si një nga problemet më kryesore të saj.

f) Partia duhet të luftojë format burokratike dhe të forcojë

metodat operative leniniste-staliniane të drejtimit të partisë e të shtetit. Partia duhet të përpiqet për një kombinim më të shëndoshë midis punës politike dhe punës ekonomike. Në këtë drejtim Partia jonë duhet të udhëhiqet nga parimi stalinian sipas të cilit:

«...sukseset ekonomike, qëndrueshmëria dhe jeta e tyre varen tërësisht dhe plotësisht nga sukseset e punës organizative dhe të punës politike të Partisë, se pa këtë kusht sukseset ekonomike mund të jenë si të ndërtuara mbi rërë»¹.

6) E gjithë jeta dhe veprimtaria e Partisë të drejtohet në bazë të rregullave dhe parimeve që përshkruhen në Statutin e saj që ka aprovuar ky kongres. Të luftohet kundër të gjitha shfaqjeve që kanë për qëllim cënimin e rregullave dhe parimeve organizative të Partisë të caktuara në Statutin e saj.

7) Për të zhdukur prapambetjen politike dhe ideologjike të Partisë sonë të bëhet një punë sistematike nga të gjitha organet dhe organizatat e Partisë për përvetësimin e bazave të marksizëm-leninizmit, për përforcimin e ndërgjegjes komuniste të anëtarëve të Partisë, për njohjen e ligjeve të zhvillimit ekonomik-shoqëror. Partia duhet ta konsiderojë problemin e ngritjes politike dhe ideologjike të anëtarëve të saj si një nga problemet më me rëndësi dhe që duhet të marrë një zgjidhje të drejtë dhe urgjente. Prandaj:

a) Të forcohen e të perfeksionohen kurset e Partisë që ekzistojnë dhe të çelen edhe kurse të tjera. Të zgjerohet dhe të perfeksionohet Shkolla e Partisë.

b) Të forcohet puna edukative, ideo-politike në të gjitha organizatat e Partisë, me anë të studimit sistematik e të pandërprerë të Historisë së Partisë Bolshevike të bazave të marksizëm-leninizmit, të Statutit të Partisë dhe të ligjeve themelore që drejtojnë kalimin prej kapitalizmit në socializëm. Të përgjithësohet metoda e studimit me anë të kruzhoqeve dhe të përdoret edhe metoda e studimit individual nga kuadrot e avancuar të Partisë duke filluar që nga anëtarët e Byrosë Politike dhe të Komitetit Qendror. Drejtoria e Agjitacionit dhe e Propagandës pranë Komitetit Qendror duhet të studjojë më me hollësi metodat dhe format konkrete të studimit dhe të planifikojë e të drejtojë të gjithë punën për ngritjen e nivelit ideologjik të Partisë.

c) Byroja Politike të organizojë studimin shkencor të realitetit në vendin tonë nga pikëpamja marksiste-leniniste për të shkruar mirë Partinë, mbi gjendjen dhe zhvillimin e luftës së klasave

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 243.

¹ J. V. Stalin. Veprat, vëll. 14, f. 107.

në vendin tonë, mbi spostimin dhe marrëdhëniet midis klasave të ndryshme e mbi konditat konkrete të kalimit të vendit tonë nga kapitalizmi në socializëm.

c) Duhet të zhvillohet më tepër dhe në mënyrë sistematike puna e agjitacionit dhe e propagandës sidomos në fshat për të zhvilluar ndërgjegjen e masave punonjëse dhe për të ngritur nivelin e tyre politik.

d) Duhet një punë më sistematike dhe e vazhdueshme për ngritjen profesionale e kulture të përgjithshme të anëtarëve të Partisë, me anën e kurseve profesionale, shkollave të natës etj.

dh) Të fillohet puna për nxjerrjen e historisë së Partisë sonë nga një komision redaktues që do të caktojë Byroja Politike. Të punohet për të botuar në gjuhën shqipe sa më tepër lëndë teorike marksiste-leniniste që do të shërbejë për t'u studjuar nga anëtarët e Partisë.

8) E gjithë Partia duhet të angazhohet me punën e saj praktike për të mobilizuar masat e gjera punonjëse për realizimin e tejkalimit e planit të shtetit, me qëllim që të forcohet potenciali ekonomik dhe forca mbrojtëse e vendit tonë, të ngrihet standardi i jetesës së masave punonjëse dhe të ecet më shpejt në rrugën për në socializëm. Anëtarët e Partisë duhet të jenë të parët që të hidhen në sulm për realizimin e planit. Ata duhet të jenë shembull kudo dhe kurdoherë në përmbushjen e detyrave të tyre.

9) Të rishikohen të gjitha ligjet, urdhëresat, literatura në përdorim, për t'u zhdukur çdo gjë që reflekton influencën borgjeze si dhe influencën e eksperiencës së udhëheqjes trockiste jugosllave dhe të bazohemi në eksperiencën sovjetike duke e përshtatur këtë në konditat tona.

10) Të rishikohet me kujdes çështja e kandidatëve për anëtarë partie dhe të futen menjëherë në Parti ata që i kanë konditat. Të punohet me një kriter më të shëndoshë me kandidatët për anëtarë partie, të ndihmohen ata nga organizatat bazë dhe t'i jepet fund frymës së vjetër të organizatës bazë kundrejt kandidatëve për anëtarë partie. Të mos përdoret më praktika e plakjes së kandidatit për anëtarë partie dhe të mbetet ky si i tillë për vjete me radhë.

11) Komiteti Qendror duhet të marrë në shqyrtim përjashtimet e padrejta që janë bërë deri më sot në Parti nga puna trockiste e Koçi Xoxes.

12) Duke marrë parasysh se në vendin tonë shumica e popullsisë përbëhet prej fshatarësisë që arrin gati 90 për qind kurse klasa punëtore, që vetëm tani është në zhvillim e sipër, është akoma shumë e vogël dhe duke marrë parasysh se edhe në vetë përbërjen shoqërore të Partisë, përqindja e punëtorëve arrin vetëm 22,6 për

qind¹ kurse ajo e fshatarësisë së varfër është 54,3 për qind, [e fshatarësisë] së mesme 13 për qind dhe 10 për qind intelektualë, zanatçinj etj., kongresi vendosi të ndryshojë emrin e PKS-h në Parti e Punës e Shqipërisë, ndryshim që është i drejtë për arsye të kompozicionit shoqëror të vendit e të Partisë sonë dhe që bazohet në shkencën marksiste-leniniste.

13) Kongresi aprovoi me unanimitet Statutin e Partisë së Punës të Shqipërisë.

14) Për gabimet dhe fajet e tyre të rënda, të dëmshme dhe antiparti, për veprimtarinë e tyre të ndërgjegjshme deviatore, trockiste, antimarksiste, antisovjetike dhe antishqiptare, të bërë në kurriz dhe në dëmin e Partisë dhe të popullit dhe për shkak se me këtë veprimtari armiqësore, në bashkëpunim të plotë dhe të koordinuar me grupin nacionalist-trockist të Titos dhe Rankoviçit u munduan të shkallmonin Partinë tonë, të zhduknin independencën e vendit tonë dhe të degjeneronin Republikën tonë Popullore, në një koloni jugosllave e në një republikë borgjeze vasale e imperializmit, kongresi

v e n d o s i :

Përjashtimin nga Partia të Koçi Xoxes dhe Pandi Kristos si elementë trockistë dhe që kanë vepruar me ndërgjegje dhe në mënyrë armiqësore kundër Partisë dhe popullit tonë.

*Botohet sipas broshurës:
«Rezolucioni i Kongresit I të
Partisë Komuniste Shqiptare».
Tiranë, nëntor 1948*

1 Shifra 22,6 për qind që tregon përqindjen e anëtarëve të Partisë me gjendjen shoqërore punëtore është e gabuar. Në Kongresin II të PPSH, punëtorët në Parti përbënin 11,5 për qind kurse në Kongresin III 17,7 për qind. Vetëkuptohet se në Kongresin I përqindja e punëtorëve në Parti ka qenë më e vogël, jo më shumë se 10 për qind. Përqindja është dhënë gabim për arsye se para Kongresit I nuk ka pasur të dhëna të sakta dhe një përcaktim të drejtë të origjinës dhe të gjendjes shoqërore të anëtarëve të Partisë.

TREGUESI I LËNDËS

Parathënje	Faqe
1941	
1. Rezolucioni i mbledhjes së grupeve kryesore komuniste të Shqipërisë për krijimin e Partisë. Nëntor 1941.	11
2. Thirrja e parë e KQ të PKSH drejtuar popullit shqiptar pas krijimit të Partisë. Nëntor 1941.	28
3. Letër e KQ të PKSH drejtuar Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste të Shqipërisë në përgjegje të përshëndetjes me rastin e krijimit të organizatës së Rinisë Komuniste Shqiptare më 23 nëntor 1941. Nëntor 1941.	33
1942	
4. Qarkore për organizimin e «Javës së Partisë». Janar 1942	34
5. Thirrje e KQ të PKSH drejtuar ushtarëve, nënoficerëve dhe oficerëve shqiptarë. Shkurt 1942	36
6. Letër e KQ të PKSH drejtuar komiteteve qarkore në lidhje me ditën e Ushtrisë Sovjetike. Shkurt 1942	40
7. Direktiva të KQ të PKSH në lidhje me organizimin e aksioneve dhe të luftës së armatosur kundër pushtuesit fashist dhe tradhëtarëve. Mars 1942	47

	Faqe
8. Nga rezolucioni i Konsultës së parë të Aktivit të Partisë Komuniste Shqiptare. 8 prill 1942	55
9. Thirrje e KQ të PKSH drejtuar popullit shqiptar. Prill 1942 ..	68
10. Direktiva të KQ të PKSH në lidhje me krijimin e Frontit Nacional-Çlirimtar, krijimin e Këshillave Nacional-Çlirimtare, organizimin e guerrileve dhe të çetave partizane, forcimin e punës organizative të Partisë. Qershor 1942	77
11. Qarkore e KQ të PKSH me rastin e dënimit të punës armiqësore të grupit të Anastas Lulës e Sadik Premtes në Konferencën e Jashtëzakonshme të Partisë. Korrik 1942	82
12. Thirrje e KQ të PKSH drejtuar fshatarëve shqiptarë. Korrik 1942	89
13. Kryeartikulli i numrit të parë të «Zërit të Popullit». 25 gusht 1942	94
1943	
* 14. Letër e KQ të PKSH drejtuar komitetit qarkor të Partisë Komuniste të Shqipërisë për Korçën mbi qëndrimin ndaj «Ballit Kombëtar». Janar 1943	97
* 15. «Direktivat e Internacionales Komuniste dhe Lufta Nacional-Çlirimtare» (Referat i mbajtur në mbledhjen e KQ të PKSH). Shkurt 1943	102
16. Rezolucioni i Konferencës I të Partisë Komuniste Shqiptare. 17 mars 1943	120
17. Thirrje e KQ të PKSH drejtuar popullit shqiptar. 7 prill 1943.	146
18. Qarkore e KQ të PKSH në lidhje me organizimin e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. 10 prill 1943	152
19. Qarkore e KQ të PKSH në lidhje me krijimin e organizatës Antifashiste të Grave Shqiptare. 14 prill 1943	155

	Faqe
* 20. Letër e KQ të PKSH drejtuar komitetit qarkor të Partisë Komuniste të Shqipërisë për Korçën mbi forcimin e punës me rininë dhe mbi qëndrimin ndaj «Ballit Kombëtar». Prill 1943.	158
21. Thirrje e KQ të PKSH drejtuar fshatarëve dhe gjithë popullit shqiptar. Qershor 1943	161
22. Qarkore e KQ të PKSH në lidhje me likuidimin e fraksionit të Sadik Premtes në organizatën e Vlorës. 17 qershor 1943	164
23. Qarkore e KQ të PKSH në lidhje me krijimin e formacioneve më të mëdha partizane dhe veçanërisht të Brigadës I Sulmuese. 20 qershor 1943	175
24. Përshëndetje e KQ të PKSH drejtuar Konferencës së parë të organizatës së Rinisë Komuniste Shqiptare. Qershor 1943	177
25. Qarkore e KQ të PKSH në lidhje me masat për armatosjen e UNÇSH. 2 gusht 1943	180
26. Qarkore e KQ të PKSH në lidhje me dënimin e marrëveshjes së Mukjes. 8 gusht 1943	181
* 27. Letër e KQ të PKSH drejtuar komitetit qarkor të PKSH për Vlorën mbi formimin e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, mbi bisedimet me «Ballin Kombëtar» dhe dënimin e oportunitetit të Ymer Dishnicës në Mukje. 17 gusht 1943	183
28. Direktiva e KQ të PKSH në lidhje me gjendjen e krijuar pas kapitullimit të Italisë fashiste. 10 shtator 1943	190
29. Udhëzime të KQ të PKSH mbi forcimin e organizatave të Partisë në Ushtrinë Nacional-Çlirimtare. 23 shtator 1943	199
30. Letër e KQ të PKSH mbi masat për forcimin e pushtetit të Këshillave Nacional-Çlirimtare dhe të Partisë, mbi qëndrimin kundrejt «Ballit Kombëtar», kundrejt «Legalitetit» dhe kundrejt misionëve ushtarake angleze. 1 tetor 1943	204
31. Letër e KQ të PKSH drejtuar komitetit qarkor të Partisë Komuniste të Shqipërisë për Gjirokastrën në lidhje me qëndrimin kundrejt «Ballit Kombëtar», «Legalitetit» dhe misionëve ushtarake angleze. 1 tetor 1943	210

32. Direktiva e KQ të PKSH për forcimin e lidhjeve me Bashkimin Sovjetik, për qëndrimin kundrejt «Ballit Kombëtar», «Legalitetit» dhe misionëve ushtarake angleze, për forcimin e Frontit, të Këshillave dhe të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare, për forcimin e Partisë dhe të organizatave të tjera antifashiste. 3 nëntor 1943.	215
* 33. Letër e KQ të PKSH drejtuar komitetit qarkor të Partisë Komuniste të Shqipërisë për Berat, me anën e së cilës dënohen lidhjet e dobëta me Komitetin Qendror dhe kompromisi me gjermanët në Berat. 5 nëntor 1943	234
1944	
34. Qarkore e KQ të PKSH në lidhje me vendimin për mbledhjen e Kongresit I Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe zgjedhjet e delegatëve për në kongres. 16 prill 1944	236
* 35. Udhëzime të KQ të PKSH mbi funksionimin dhe detyrat e organizatave të Partisë në Ushtrinë Nacional-Çlirimtare. Prill 1944	239
36. Thirrje e Komitetit Qendror të PKSH drejtuar popullit shqiptar me rastin e ditës së 1 Majit. 1 Maj 1944	240
* 37. Raport përpara Plenumit I të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë. 15 maj 1944	255
38. Qarkore e KQ të PKSH për popullarizimin e vendimeve të Kongresit I Antifashist Nacional-Çlirimtar të Përmetit. 15 qershor 1944	278
39. Qarkore e KQ të PKSH drejtuar komisarëve dhe zëvendëskomisarëve të UNÇSH mbi forcimin e punës politike-edukative në Ushtrinë Nacional-Çlirimtare. 16 qershor 1944	283
* 40. Qarkore e KQ të PKSH në lidhje me organizimin e seksioneve të ekonomisë pranë Këshillave Nacional-Çlirimtare dhe me zgjidhjen e çështjeve ekonomike të kohës së luftës. 3 gusht 1944	287
41. Qarkore e KQ të PKSH në lidhje me disa ndryshime në format organizative të Partisë në Ushtrinë Nacional-Çlirimtare. 17 gusht 1944	289

42. Udhëzime të KQ të PKSH në lidhje me krijimin e komisioneve për zbulimin e kriminelëve të luftës, komisioneve të asistencës sociale, komisioneve për shqyrtimin e fitimeve të luftës nga tregëtarët dhe në lidhje me punën që duhet të bëjnë këto komisione. 28 dhjetor 1944	295
---	-----

1945

43. Udhëzime të KQ të PKSH për forcimin më tej të punës politiko-edukative dhe organizative të Partisë në Ushtrinë Nacional-Çlirimtare. 15 janar 1945	299
44. Udhëzime të KQ të PKSH për forcimin e punës së komisioneve për fitimet e luftës. 31 mars 1945	306
45. Udhëzime të KQ të PKSH në lidhje me kremtimin e ditës së 1 Majit. 25 prill 1945	309
46. Udhëzime të KQ të PKSH për forcimin e punës së organizatave të Gruas Antifashiste Shqiptare. 15 maj 1945	313
47. Udhëzime të KQ të PKSH mbi punën politike me rastin e zgjedhjeve të delegatëve për në Kongresin I të Frontit Demokratik të Shqipërisë. 20 korrik 1945	319
48. Letër e KQ të PKSH mbi konspiracionin. 25 korrik 1945	322
49. Udhëzime të KQ të PKSH mbi punën përgatitore për Kongresin I të Sindikatave (Bashkimeve Profesionale) të Shqipërisë 2 shtator 1945	324
50. Udhëzime të KQ të PKSH në lidhje me shpalljen e Ligjit të Reformës Agrare nga Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar. 2 shtator 1945	329
51. Nga udhëzimet e KQ të PKSH për kuotizacionet. 5 tetor 1945	332
52. Rezolucioni i Plenumit IV të KQ të PKSH. 17 tetor 1945	335

1946

53. Nga konkluzionet dhe vendimet e Plenumit V të KQ të PKSH. 21 shkurt 1946 342
- * 54. Tezat për rishikimin e Plenumit II të KQ të PKSH. 9 qershor 1946 351

55. Udhëzime të KQ të PKSH mbi përgatitjen teorike marksiste-leniniste të anëtarëve të Partisë. 4 dhjetor 1946 372

1947

56. Udhëzime të KQ të PKSH për çështjet organizative të Partisë. 10 shkurt 1947 379
57. Udhëzime të KQ të PKSH për zgjedhjen e sekretarëve të celulave të Partisë. 26 mars 1947 415
58. Udhëzime të KQ të PKSH mbi propagandën, agjitacionin dhe punën kulturele me masat. 14 prill 1947 419
59. Letër e KQ të PKSH dërguar organizatave të Partisë në terren dhe në ushtri në lidhje me oportunizmin e Sejfulla Malëshovës dhe me dënimin e këtij oportunizmi nga Komiteti Qendror i Partisë. 10 maj 1947 426
- * 60. Letër e KQ të PKSH drejtuar gjithë organizatave të Partisë mbi ruajtjen e sekretit. 1 qershor 1947 433
61. Udhëzime të KQ të PKSH mbi masat politike të Partisë në fshat në lidhje me grumbullimin e drithit. 14 qershor 1947 .. 436
62. Udhëzime të KQ të PKSH mbi punën e Partisë për forcimin e kooperativave të ndryshme. 15 qershor 1947 440
63. Udhëzime të KQ të PKSH për forcimin e vigjilencës dhe të luftës kundër punës armiqësore të misionëve anglo-amerikane dhe të armikut të klasës në vendin tonë. 17 qershor 1947 446
- * 64. Komunikatë e KQ të PKSH me anën e së cilës solidarizohet me komunikatën e Konsultës së Byrosë Informativë që u mbajt në Varshavë. 24 tetor 1947 460

- * 65. Letër e KQ të PKSH drejtuar gjithë organizatave të Partisë në terren mbi edukimin ideologjik, kultural dhe arës'mor të brezit të ri. 19 nëntor 1947 464

1948

66. Udhëzime të KQ të PKSH mbi masat politike në lidhje me zgjedhjet e Këshillave Popullore. 9 janar 1948 468
67. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PKSH mbi shtetëzimin e kopeve të mëdha. 21 prill 1948 473
- * 68. Komunikatë e KQ të PKSH me anën e së cilës solidarizohet me Rezolutën e Byrosë Informativë «Mbi gjendjen në PKJ», ku dënohet rruga tradhëtare e udhëheqjes së PKJ. 29 qershor 1948 475
69. Rezolucioni i Plenumit XI të KQ të PKSH. 24 shtator 1948 .. 480
- * 70. Deklaratë e Komitetit Central të Partisë Komuniste Shqiptare me anën e së cilës hidhen poshtë shpifjet e Komitetit Central të Partisë Komuniste të Maqedonisë. Shtator 1948 507
71. Statuti i Partisë së Punës të Shqipërisë. 18 nëntor 1948 520
72. Rezolucioni i Kongresit I të Partisë Komuniste të Shqipërisë. 19 nëntor 1948 536